

BIBLIOTË

814-31

D 2A

SHTETI

SHIROKASTËR

NDOC
PAPLEKA

Gjyaku i tokës

roman

891.983-31.

1891-92

8JH31
P24.



Ndoc
Papleka

GJAKU I TOKËS

roman

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor

XHEZAIR ABAZI

PJESA E PARË

Ujët që rrëshqiste mbi gurët e bardhë e të lëmuar, në vendet e pjerrëta dukej si një brez i argjend-të prej shkume e vezullimesh. Omeri ndiente një marra-menth të lehtë, një dridhje të të gjithë qenies. Një rrjedhë e tejdukshme si lumi që kishte përpara, gurgullonte brenda tij. Të pres, Jerinë, thoshte ajo rrjedhë. Të pres, të pres, të pres... Ajo pritje ishte dielli që e mbushte me mijëra reflekse gëzimi, si vezullimet që formoheshin nga thyerja e rrezeve mbi lumë. Të pres, Jerinë!...

Sytë po i dhembnin nga lodrimet e ujit dhe Omeri e largoi shikimin nga lumi i shkumëzuar. Qielli i kthjellët, i ngushtë pushonte mbi kreshtat e dhëmbëzuara ku kishin mbetur disa lara bore. Çdo vit ato lara merrnin forma të çuditshme. Sidomos forma kafshësh. Në shpatin e malit përballë ishte një larë e madhe. Dielli e hante dita-ditës. Kur ajo larë zvogëlohej e merrte formën e një kali, ngjiteshin tubat në bjeshtë. Në fëmijëri Omerit i dukej sikur shalonte kalin e larës së borës për të shkuar te tëbana. Vërtet

ai e kishte shaluar atë kalë shumë herë në ëndërr, kur priste me padurim të udhëtonte përmes ahishta-ve e pllajave. Të bridhte nëpër livadhet me bar të rritur e lule që luhateshin nga filladi. Të dëgjonte këmborët, cingaret e trokat e tubave që mblidheshin përpara tëbanave. Të luante me shokët e lagjeve të tjera, që i gjente çdo verë më të rritur.

Pas këtyre ëndrrave, në vend të kalit të bardhë të borës hipte në kalin e kuq të shtëpisë. Trok e trok, trok e trok... Orë të tëra përplasja e potkonjve në gurët e rrugës së bjeshkës. Prapa kësaj trokëllime mbetej zhuzhëllima e tokës që po thahej në diell dhe cinxë-rima e gjinkallave të fshehura nëpër lëvoret e lisave. Mbetej verdhësia dhe era e rëndë e barit që po për-cëllohej nga dielli i fortë. Mbeteshin plisat e çarë, gjethet e misrit të mbledhura fitil.

Kur hipte në ndonjë majë, Omeri shikonte po-shtë, matanë kodrave e luginave, dhe kërkonte me sy shtëpitë e fshatit të tij që i mbështillte një tis i hollë, i ndritshëm, diçka si mjegullnajë verbuese, e krijuar nga drita që thyhej në faqet e gurëve të zhveshur. Ai shquante vetëm ndonjë pjesë të përrenjve të tharë, të mbushur me gurë të bardhë e të lëmuar.

Omeri e kishte provuar pushtetin e tmerrshëm të thatësirës, vetëm kur kishte zbritur në vërri për të marrë miell e pemë. Imazhi i saj e ndiqte si makth për disa ditë, edhe pasi ngiitej prapë në bjeshkë. Mandej tretej dalëngadalë në hijet e pyjeve e të mri-zeve, në freskun e burimeve e të majave. Shtërëngimi i saj i mundimshëm e lëshonte, siç të lëshon angushtia e një ëndrre të ligë.

Duke u rritur, Omeri po e ndiente se ai mur i bri-shtë që ngrinte mosha midis tij e thatësirës, do të shembej. Në ato çaste të shkurtra, drithëruese, kur tek i riu shfaqet papritmas burri, siç duken qartë malet e vagëlluara nga muzgu në dritë të vetëtimës, ai mendonte se nuk ishte larg ajo verë e pashmangshme, kur thatësira do të qëndronte përballë tij, bishë e kre-

shpëruar me sy të ndezur, kuçedër me nëntë krerë që nxjerr nga të nëntë gurmazët rrëke prushi e vrushkuq flake. Këto përfytyrime të frikshme zinin fill e ushqeheshin nga gojëdhënat e lashta, që tregonin pleqtë e Gurajës për luftërat midis kuçedrave e dragonjve, për shterjen e Përroit të Thatë, i cili qëmoti e mbushte fshatin me rropamën dhe freskinë e ujërave të tij.

Me të vërtetë shtrati i Përroit të Thatë ishte shumë i gjerë. Në të kishte gurë të mëdhenj sa një kullë, që ishin rrokullisur e lëmuar nga ujërat e shumta të lumit të qëmotshëm. Në disa vende, përgjatë brigjeve të tij, kishte mbetëza muresh të thata. Aty kishin qenë mullinjtë që bluanin natë e ditë grurin dhe thekrën e pllajave të Gurajës. Kaq drithë bëhej asokohe në ato pllaja, sa që në dimër u jepnin edhe bagëtive të majmëshin e t'u forcoheshin gjymtyrët. Shterja e lumit ujëshumë sollti edhe shterjen e gjinjve pjellorë të tokës, e cila u tha, u plasarit, u ngurtësua dhe nuk i mëkoi më, kërcejtë e hollë e të brishtë të bimëve. Si mishi që mblidhet nga dhimbja, jeta u tkurr nga djegia e pamëshirshme e thatësisë. Në trupin e arave të mbetura djerr u ngulën çaponjtë dhe kthetrat e barërave të egra. Agonia e arave që e gjatë, e dhimbshme. Në vend të prekjes së duarve dhe të shputave të zbathura të njeriut, ato ndienin mbi vete trupin e ftohtë e të birtë të rrëshqanorëve, barkun e butë të egërsirave që hapnin në të vrima e strofulla të errëta.

Në lirishta e pyllnaja, ku s'ta merrte mendja se do të kishte kaluar ndonjëherë veshi i plorit apo hapi i farrarit, barinjtë pleq i kishin treguar Omerit gjurmët e lëmenjve, ku stërgjyshërit kishin shirë grurin dhe thekrën...

Omeri nuk ia ndante sytë larës së borës që ishte shndërruar në një shumëkëndësh të çrregullt. Pas disa ditësh ajo do të merrte formën e një kali. Sot ishte hera e fundit që Omeri do të shihej me Jerinën, para se të ngjiteshin në bjeshkë. I kishte lëshuar dhitë herët, më herët se të gjithë barinjtë e tjerë të fshatit

dhe i kishte sjellë nga kjo anë ku kullotnin edhe tubat e Breglumit.

Në shpatet e maleve e të kodrave, në të dy brigjet e lumit që gjarpëronte midis tyre tringëllinin cingaret e bronza. Herë pas here heshuja e kullotave ndërpritej nga blegërima dhish a nga thirrjet e barinjve.

Kurrë nuk më ka dalë fjale e nuk më ka lënë të pres kaq shumë, mendoj Omeri. Ata e kishin lënë të takoheshin në mëngjes, kurse tani ishte bërë mesditë. Ishte zheg, një zheg i parakohshëm që paralajmëronte një verë përvëluese. Dhitë ishin ulur në mriç e po përtypeshin, duke tundur lehtë mjekrat e mprehta. Bluanin me nge lastarët e blertë e tërë lëng të shkozave e të lajthive.

Omeri çau përmes pyllnajës dhe zbriti te lumi. Stër-piklat e ujit që përplasej pas gurëve i ranë në fytyrë dhe ia mbështollën me një cipëz të hollë freskie. Megjithatë i dukej sikur diçka po ia digjte kraharorin, ballin, fytyrën e pëllëmbët. Një thatësi që s'e kishte njohur më parë. Një afsh i nxehtë që po ia përcëllonte mushkëritë. Fjalët iu mblodhën fitil si gjethet e misrit të paujitur, mendimet iu kthyen së prapthi si fletët ngjyrë rrase të blireve. Pëllëmbët ia mbuloi bari i kuqërruar dhe në buzë ndjeu ashpërsinë e plisave të tharë.

Tani qenia e tij ishte si një hapësi e munduar nga thatësira, që sfilitej nën një diell zhuritës e moskokëçarës. Ishte Guraja pa lumë, pa ujëra, që afshonte në mes të korrikut. Shikoi fytyrën e tij të pasqyruar në një pellg të qetë. Si bebëzat e Jerinës, mendoj Omeri. Ai ishte befasuar kur i kishte parë këta sy: me një kaltërsi të qelqtë, të pikëlluar. Krejt ndryshe nga Ujëbardha që shkumëzonte e gurgullonte aty përpara tij. Që rrokullisej midis gurëve si e ndërkrayer, duke tundur mbi shpatulla jelen e argjendtë të valëve. Krejt ndryshe nga ngjyra e saj e kaltër që bëhej e argjendtë. Që herë-herë bëhej aq e tejdukshme, si një lumë i paqenë, i ëndërrt...

Kurse sytë e Jerinës kishin një ngjyrë të thellë, të topitur, që nuk të ngazëllente, nuk të dehte, por të mbërthente, të hutonte. Omeri e kishte vënë re se sytë e saj nuk qeshnin asnjëherë. Por ata nuk ishin as të fjetur, as të mërzhitur. Në ta ishte një ndjesi tjetër, që ai nuk e gjente dot se ç'ishte. Nuk dinte të shpjegonte, as t'i vinte një emër. Ajo ishte pikërisht kështu: një ndjesi pa emër, e pazakonshme. Kur gëzohej Jerina, kur qeshte Jerina, sytë mbeteshin në hije si burimet në thellësi të pyjeve, nën degë të kapërthyera ahesh e bredhash të moçëm. Gëzimi i rridhte fytyrës e grumbullohej në të dy qukat që i krijoheshin në faqe. Dy quka të vogla, si të thelluarat e rrumbullta në majë të mollëve të pjekura.

Çfarë po ma përcëllon kështu kraharorin?! — tha me vete Omeri me të habitur, me të rënkuar, pa lëvizur nga guri ku ishte mbështetur. Fytyra e tij ishte e ngjitur pas fundit të pellgut të tejpashëm e të palëvizshëm.

Ai u afrua te buza e ujit, mbështeti gjunjët mbi gurët e rrumbullakët dhe zhyti fytyrën në rrjedhë. Uji i ftohtë. e flladiti menjëherë. E ndjeu veten të lehtësuar si të kishte hequr nga shpatullat gurë të nxehtë. E zhyti prapë fytyrën në ujë, derisa nuk i mbeti asnjë shenjë e angushtisë dhe e zhegut që po e sfilitnin disa çaste më parë. U ngrit në këmbë me dhimbje në gjunjë e me fytyrën e veshur me bulëza uji. Zuri të ecte pranë lumit, teposhtë. Ndiqte me sy vallen e valëve, të shkumës, të reflekseve. Dëgjonte murmurimën e pandërprerë të lumit, që dukej sikur pyeste brigjet, sikur rënkonte, sikur qeshte. Kështu ecën edhe koha, mendoi Omeri. Edhe jeta është si ky lumë që nis në gji të maleve dhe sos diku larg, larg...

Ndonëse tashti ishte i bindur se Jerina nuk do të vinte, diçka brenda tij ende priste që vajza të shfaqej midis barishteve fletëgjera të bregut si një lule e bardhë. Të hovte prapa një druri a kaçube si një zog. Ta befasonte midis shkrepave të heshtur si një gurrë... U ndal. E vështrroi me drithërimë tërë atë pjesë të dukshme të shtegut, nëpër të cilën kishte ardhur aq herë Jerina. Kurrkund ngjyra e bardhë e shamisë së saj. Kurrkund degë që tunden disa çaste, kur një njeri kalon midis tyre.

Omerin e nxori nga ajo përhumbje zëri i një bariu që po këndonte në shpatin e përtejme të lumit. Zëri vinte që andej i qartë, i forcuar nga gryka e luginës:

*O, krisi vallja në Gurajë,
Martoi Rexha t'voglin djalë.
Kur i mbushi nusja nandë net,
Ka zanë llafin me t'kunett:
— Amanet, kunetnit t'mi,
A po m'leni t'shkoj n'gjini?
— Amanet-o nuk po t'lamë,
Se atje ban therra rrush,
Atje ban mali larushk,
Atje ban pela tre mushq,
Atje vejat s'i merr kush...*

Omeri nuk mundi të rrinte më mbështetur pas myshkut të butë të trungut. Fjalët e këngës i gumëzhinin në vesh si grerëza. Kjo këngë e kishte acaruar gjithmonë, por sot ajo i hyri në damarë si vrer dhe ia pezmatoi gjithë qenien.

Ti nuk je këngë, por gjarpër që të kafshon zemrën, pëshpëriti Omeri. Cili njeri zemërgur, cila gojë e mallkuar të ka nxjerrë për herë të parë nga buzët? Çfarë e ka shtyrë ta quajë Gurajën e thatë, Gurajën pa ujë si një burg ku nuset nuk i lënë të venë te prindërit e tyre, nga frika se mos nuk kthehen më?!

Zëri vinte nga shpatin ku kullotnin tubat e Breglu-

mit, të fshatit ku rridhte midis arave e kopshteve Ujëbardha, nusja e bjeshkëve, e kthjellët si loti. Për Breglumin Ujëbardha ishte mbarësi, ishte pjellori, ishte jetë. Vajzat e Gurajës ëndrronin të fejojeshin me djemtë e Breglunit dhe në ëndrrat e tyre, midis pajës ku shkrinin tërë vajzërinë, fekste brezi i Ujëbardhës, prej shkume e vezullimesh. Ndërsa djemtë e Gurajës i kërkonin nusët e tyre deri në shtatë ditë larg, përtej shtatë maleve. I kërkonin dhe mezi i gjenin. Shpesh etërit e djemve të pamartuar ktheheshin me fytyra më të vrenjtura e më të rrudhosura sesa kur niseshin për udhë. Askush nuk donte ta jepte vajzën e tij atje ku edhe gjarpri nuk ngihej me ujë. Në të gjithë fshatrat përreth përdorej mallkimi: Të zëntë gjarpëri i Gurajës!

Harroje këtë këngë, i tha Omeri vetes. Harroje, harroje!... Nofullat i kërcitën sikur po bluante një krodhë të tharë, të ashpër. Muskujt e fytyrës iu tendosën nga ngërçi i dhimbjes e i mllëfit. Megjithatë ai e dinte se nuk mund ta bluante krodhën e këngës së moçme. Ajo ishte si shkëmbinjtë e hirtë e të zhveshur, që rrethonin Gurajën e ngulur në brinjë të bjeshkëve. Këta shkëmbinj e ndanin nga Ujëbardha me ujë të kulluar. Shkëmbinj që binin thikë sikur t'i kishte hedhur nga qielli ndonjë hakmarrës i pamëshirshëm.

Kënga që vinte nga shpati kundruall kishte kohë që kishte pushuar. Por jo brenda Omerit. Madje ajo kishte zgjuar edhe këngë të tjera, që flisnin për vajza të cilat betoheshin se më parë do të mbyteshin në lumë ose do të hidheshin nga shkëmbinjtë, sesa të martoheshin në Gurajë.

Një re e zuri diellin. Ishte një bashkë e vogël që era e kishte sjellë prej s'di se kah. Omerit i shkuan sytë te lumi që u mbulua nga hija e resë. Vezullimet verbuese u zhdukën dhe tashti Ujëbardha dukej si një peshk pa jetë, që ia kanë hequr leskrat e ndritshme dhe e kanë lënë midis zallit.

Omeri futi dhinë në vathë dhe vajti te burrat që po kuvendonin në oborr. Rreth tyre sillej tymi i duhanit, tymnajë pluhuri në kohë thatësire. Kur pa midis tyre Murat Gjokën, Omeri e mori me mend që ata po flisnin për thatësirën dhe për ujin.

Murat Gjoka dhe uji, uji dhe Murat Gjoka! — mendoj Omeri vetmevete. Ata ishin si njeriu dhe hija e tij. Murat Gjoka e mbante veten si magjistarin e ujërave, si zbuluesin e tyre, por ujët ikte prej tij, siç ikën hija nga njeriu që vrapon pas saj. Guraja e munduar nga thatësira dëgjonte pa u lodhur parashikimet e Murat Gjokës dhe mbante shpresë të nginjëj me ujë.

Sa mote kishte që po i dëgjonte parashikimet dhe premtimet e tij?... Sytë e kuqërruar të gurajasve sikur flisnin: Na thuaj ku mund të gjendet uji. Ne jemi gati të gërmojmë deri në ka të zi, vetëm të gjejmë ujë, ujë...

Dhe magjistari i ujit ia mbërthente sytë tokës së thatë, tokës së heshtur, sikur do ta zhbironte me shikimin e tij, mandej ulte gishtin mbi një pikë të caktuar. Atëherë dëgjohej zhurma e kazmave në tokë, hapec një gropë e thellë si varr. Njerëzit shpresonin që në atë varr të groposnin etjen dhe dëshpërimin e tyre, të shumë e shumë brezave, të hasnin damarin e ujit që do të vezullonte në thellësi të tokës si syri i magjistarit, kur bisedonte në muzgje me fshatarët e lodhur...

Puhia që vinte nga bjeshkët ishte ngarkuar me një erë mjalti që dilte nga gështenjat e sapolulëzuara. Xixëllonjat vërtiteshin rreth kokave të fshatarëve që i kishte rrëmbyer biseda dhe nuk u bëhej ta linin në mes. Ato koka përvijoheshin në mugëtirë si shkrepë stralli, që i godiste një uror i padukshëm e i pazhurmë. Ky përfytyrim përftohej nga prushi i cigareve që fekste e platitej nën hi dhe nga drita e xixëllonjave endashqitej prej tyre.

— ... Dhe zëri në ëndërr më tha: «E zhbirove tokën e Gurajës si urithi, Murat Gjoka, e mbushe me puse

dymbëdhjetë pashë të thella, por etjen s'ia shove dhe thatësirën s'ia largove...»

Sytë e fshatarëve u picërruan për të dalluar sadopak buzët e atij që fliste dhe nofullat e tyre u shtrënguan me dhimbje, sikur donin të mbanin brenda tyre klithmën «Ujë! Ujë!»

— «... Sepse është njëloj si të përpiqesh të kapësh e të mbash demin për bishti!», më tha. «Demi mbërthehet te koka dhe uji kapet tek ama.» Po ku është ama e ujit? — i thashë. «Përroi i Thatë sot është i tharë, por ai nuk ka qenë gjithmonë kështu», më tha zëri...

Fshatarët u shtangën për të dëgjuar vazhdimin e atyre fjalëve që i përpiu heshtja e natës, siç përpin zallishta në piskun e verës një rrëkezë të hollë uji. Reshti flladi që frynte, pushuan pëshpërimat e gjetheve të kumbullës, u platit prushi i cigareve poshtë hirit. Vetëm çibuku i Muratit u gjallërua dhe vetëtiu në errësirë si sy i kuq, i zjarhtë. Katallani! — mendoj Omeri duke vështruar siluetën e kërrusur të magjistarit të ujërave përballë tij. Ai u habit pse nuk i kishte ardhur në mendje më parë një krahasim i këtillë dhe bëri buzën në gaz. As që e priste të buzëqeshte aq shpejt pas hidhërimit që kishte provuar buzë Ujëbardhës atë ditë që s'kishte ditur të ngrysej kurrë. Megjithatë nuk e qortoi veten për këtë gjë. Tani tërë vëmendja e tij ishte përqendruar te ngjashmëria midis Muratit e Katallanit të përrallave që i kishte dëgjuar aq e aq herë.

Mëria e tij ndaj magjistarit nuk ishte as e sotme, as pa shkak. Disa vjet më parë ai kishte ardhur në shtëpinë e tyre dhe ia kishte mbushur mendjen babës së Omerit për të hapur një pus të ri. Pasdarke kishin dalë jashtë dhe kishin vënë në tokë, përmbys, tepsitë e mëdha prej bakri që Murati i merrte me vete kudo që shkonte. Këtë punë e kishin bërë disa net me radhë, duke ua ndërruar vendin tepsive e duke parë sasinë e vesës që grumbullohej në to. Pas këtyre provave, Murati kishte vendosur që pusi i ri të hapej te lëndina prapa shtëpisë, ku Omerit i pëlqente të rrinte, duke vështruar bletët dhe fluturat që kullotnin mbi lulet

e panumërta. Gjatë punës për hapjen e pusit lëndina u shkel, u prishi dhe vende-vende bari nuk doli më. Ashtu si i vjetri, edhe pusi i ri nxori pak ujë, që shterej kur shtrëngonte vapa.

E vërteta është se kjo mëri fëmijërore nuk ishte aspak e vetmja mëri ndaj Murat Gjokës në Gurajën e munduar nga thatësira. Madje ajo nuk ishte as më e thella e më e përhershme. Ashtu siç ekzistonte një nevojë e brendshme për Murat Gjokën në Gurajë, ekzistonte edhe një mëri e përgjithshme dhe e turbullt, që nuk shpërthente kurrë jashtë buzëve dhe nuk arrinte kurrë te njeriu që e shkaktonte. Ajo ishte më tepër një mëri e ndier, sesa e menduar, që hollohej nga frika dhe bestytنيا për pushtetin e magjistarit, siç hollohet e zbutet vera me ujë.

Ky njeri me emër të përzier, gjysmëmuhamedan e gjysmë të krishterë, kishte ardhur nga një krahinë e largët para shumë kohësh dhe nuk ishte ndarë më nga Guraja. Njerëzit e mbanin mend prej vitesh me po ato petka, me atë trup të gjatë si ah i tharë, me atë fytyrë eshtake ngjyrë gruri të mbyllët, me po ato rrudha e zhubra si plasaritjet në tokën e Gurajës, saqë u dukej sikur ai jetonte diku përtej kohës, atje ku nuk mund të arrijë as pleqëria, as vdekja. Sytë e tij të kërcyer, në ngjyrë të kulumbrive të pjekura, ishin shumë të rrumbullakët dhe ngjisnin me dy guralecë lumi. Por shenja më e veçantë në fytyrën e tij ishte një lyth i madh në flegrenë e majtë të hundës së hollë. Ndonjë hokatar i guximshëm thoshte se ky lyth ishte brirthi me të cilin Murat Gjoka prekte tokën, për të kërkuar ujë në thellësi të saj...

Ndonëse fitimet më të mëdha i nxirrte duke hapur bunarë, nganjëherë, kur i luteshin ata që besonin në forcën e magjive të tij, bënte edhe «mrekulli» të tjera.

Në Gurajë ishte një burrë që kishte pesëmbëdhjetë vjet që ishte martuar. Megjithëse ishte ndër më të pasurit e fshatit dhe kishte një grua të hijshme, nuk i qeshte kurrë buza, ngaqë nuk kishte fëmijë. Shihte në ëndërr sikur kishte vdekur dhe kushërinjtë ia nda-

nin tokën copë-copë, siç copëtojnë korbati trupin e një lope të rrëzuar në bjeshkë. I dilte gjumi në mes të natës dhe orë të tëra rrinte pa fjetur. Hija e zezë e këtij makthi e ndiqte edhe ditën, kur shkrepnte dielli.

Pasi u mendua e u çmendua, thirri Murat Gjokën në shtëpi dhe iu lut ta ndihmonte. Çibuku i ndezur i magjistarit flakëroi si syri i një katallani të babëzitur.

— Do ta provoj një herë për hatrin tënd, — i tha Murati. — Por me kusht që të mos i kallëzosh kujt. Po të kallëzosh, magjia nuk zë...

Ai e kishte hallin gjetiu: nuk donte ta merrnin nëpër gojë dhe të dyshonin në «aftësitë» e tij. U trembej sidomos shpotive të hokatarëve, të cilët, po t'u binte në vesh kjo ngjarje, do të gjenin një rast të mirë për t'u tallur me të. Megjithatë tundimi i fortë fitoi mbi ndjenjën e rrezikut. Fshatari e vështronte me përgjërime, me ata sy të ndezur që dukeshin në fytyrën e tij të pikëlluar si zjarre që digjen natën në fund të shpellave.

— Që të mbetet me barrë gruaja jote, duhet të rri në qiler me të, në terr, — i tha Murati. — Nuk duhet të rrijë kush brenda shtëpisë, se do të mbledh xhindet. Po të afrohet kush derisa të thërras unë, magjia nuk zë dhe xhindet do ta çartin...

Të nesërmen gruaja u shtri në shtrat, duke u dridhur nga një frikë e pashpjegueshme. I shoqi mbylli derën e avllisë nga brenda dhe u struk në sanën e një mullari që e kishin ndukur lopët e kuajt kur kalonin përbri tij. Murati mori një pe të zi, bëri disa nyja me të dhe u fut në qilerin e gruas.

Të yshturit zgjati rreth një orë. Magjistani lidhi disa nyja të tjera, lëshoi spërka pështyme nëpër këndet e kthinës së errët, pëshpëriti fjalë të pakuptueshme, nxori hungërima të mbytura e të frikshme, duke tundur krahet në ajër si lakuriq nate.

I mbështetur pas barit që lëshonte një duhmë të

rëndë, fshatari belbëzonte me buzët që i dridheshin:
— O zot i madh që dridh qiellin e tokën, falma një djalë, falma një djalë!...

Trupi i hajthëm e i gjatë i gruas që e kishte vesh-truar me dëshpërim barkun e saj për vite të tëra, u bë me një xhungë në mes si ato pemët e shartuara dhe fryhej dita me ditë. Aty nga muaji i tetë xhunga u bë aq e madhe, saqë gruaja mezi lëvizte nga vendi.

Fshatari vështronte barkun e së shoqes, por as tani nuk ishte i qetë. Ndiante një ankth më të madh sesa atëherë kur ky bark ishte i dystë si dërrasë. Po sikur të jetë vajzë?! — pyeste veten. — Po sikur të jetë vajzë?!

Thirri Muratin për darkë, i preu një qengj dhe i tha të shihte në shpatull se çfarë do t'i lindte e shoqja. Si e breu mirë e mirë mishin e saj të shijshëm, magjistari e ktheu shpatullën kundruall dritës së zjarrit dhe ia nguli sytë e tij në ngjyrë të kulumbrive të pjekura. Nëpër ashtin e hollë që përshkohej nga drita, ravijë-zoheshin disa njolla të errëta. Pikërisht këto njolla i kundroi Murati një copë herë, mandej tha:

— Edhe si djalë duket, edhe si vajzë duket...

Kur lindën dy binjakët një vajzë e një djalë, fshatari desh u çmend nga gëzimi. Në këtë dalldisje ngazëllimtare i rrodhi edhe goja e u tregoi disa të afërmve për magjinë që i kishte bërë Murat Gjoka së shoqes dhe për parashikimin e tij.

E fshehta, si ajo fara e ahut që natyra e ka pajisur me flatra për të fluturuar tutje, u përhap tejendanë Gurajës. Disa besonin në mrekullinë e magjistarit, por nuk ishin të paktë edhe ata që qeshnin me gojë në grusht, sepse e merrnin me mend si ishte bërë magjia. I ati i binjakëve i fali Muratit një oqiç, një palë petka

të reja dhe e nderonte si mikun më të mirë të shtëpisë, ku mund të hynte e të dilte në çdo kohë.

Binjakët u rritën, filluan të belbëzojnë e të ecin. Herë për hokë, herë për shpoti ndokush i quante «binjakët e magjistarit». Megjithatë, i ati i fëmijëve nuk prekej, ngaqë këtë shprehje nuk e merrte në kuptimin e njëmendtë të saj. Sidoqoftë edhe kjo ngjarje u harrua shpejt, sepse në Gurajë andrallat ishin të shumta dhe ndodhitë e jashtëzakonshme pasonin e mbulonin njëra-tjetrën si borërat në dimër.

— Ne do të gërryejmë tek ama e Përroit të Thatë dhe do ta gjejmë damarin e ujit, — vazhdoi Murati.

— Ujin nuk mund ta gjejmë, — tha Cungeli. — Atë e ka mbyllur kuçedra.

— Unë do ta çliroj lumin nga kuçedra, — tha Murati.

— E si!? — tha Cungeli.

— Do të presim tre desh të zinj atje ku ka humbur uji nën dhë e do të gërmojmë derisa të ndeshim një rrasë. Nën atë rrasë është ujët. Kur ta çajmë rrasën, ujët do të dalë prapë mbi tokë, — tha Murati.

— Po sikur të mos dalë?! — tha Kingji.

— Unë them se do të dalë... — tha Murati.

— Edhe herët e tjera kështu ke thënë! — tha Kingji. Në zërin e tij përziheshin shpotia dhe mllefi.

Qerpikët e Muratit u përpëliten në muzgëtirë, por askush nuk mundi ta vinte re këtë përpëlitse. Ishte hera e parë që magjistari dëgjonte sy ndër sy një zë kundërshtues që e fajësonte.

Kutitë dhe trastat e duhanit kaluan dorë më dorë. Fshatarët bisedonin me nge në atë vakësi të mbrëmjeje, duke thithur herë nikotinën e helmët, herë erën e mirë të gështenjave të lulëzuara. Biseda e tyre i ngjiste një përroi shushuritës, ku derdheshin ngjarje mynxyrëmdha, që lidheshin me thatësinë dhe shkretimin e saj, me grindjet dhe vrasjet për vijat e ujit. Siç ndodhte përherë në Gurajë, në çdo bisedë që bëhej për ujët, nuk munguan as legjendat që flisnin për tragjedinë e moçme të fshatit, për shterjen e Përroit të Thatë...

— Në atë kohë në Gurajë ishte një nuse e bukur si ajo! — tha Cungeli, duke flakur tutje bishtin e ndezur të cigares. — S'i gjendej shoqja gjithkrah e shkel këmba e kalit e gjithkrah i bie dielli tokës. Lahutarët e vunë në këngë dhe emri i shkoi deri në kralitë e largëta. Një ditë prej ditësh një harambash erdhi në Gurajë, hipur mbi gjok, veshur me petka shqiptare. Ai bujti në kullën e nuses së bukur, gjeti rastin të fliste me të, ia mori mendjen dhe ikën bashkë natën. Kur doli drita, u mor vesh se nusen e bukur e kishin grabitur dhe Përroi i Thatë ishte shterrur. Gurajasit u trandën si t'i kishin gjuajtur dy rrufe. Megjithëse këto të dy kobe ngjanë në të njëjtën kohë, askujt nuk i shkoi në mendje se mund të kishte ndonjë lidhje në mes tyre... Shumë kohë më vonë, duke ndjekur një rremb ushtrie që kishte hyrë në trojet tona, disa gurajas i qiti lufta në një katund të kralisë. Ata u futën në një kullë të madhe, që i kishte hunjtë e lartë të avllisë të mbushur me rrashta njerëzish. Në atë kullë gjetën një plakë asht e lëkurë, të mbledhur gërmuq. Plaka e mori vesh se ishin shqiptarë dhe u tha shqip:

«Prej nga jeni?»

«Prej Malësie.»

«Prej ç'katundi?»

«Prej Guraje.»

Kur dëgjoi emrin e Gurajës, plaka u drodh nga dënesat dhe ia shkrepri të qarit.

«Ç'ka ke? Pse po të bien lot nga sytë?» — i thanë gurajasit.

«Mbill e mos korr, lidhu e mos u piq: pa bukë e pa pemë! Thatësira të nxin jetën e ta merr shpirtin për së gjalli,» — tha plaka.

«Ku e di ti këtë gjë?» — i thanë gurajasit.

«Përmes Gurajës rridhte një lumë që ujiste arat e livadhet, pemët e vreshtat. Sa herë i kam larë sytë e teshat në breg të atij lumi! Dhe jeta ime atje është sosur...» — tha plaka.

«Sa vjeç je?» — e pyetën gurajasit.

«Nuk i mbaj mend vjetët,» — tha plaka.

Gurajasit po e këqyrnin me habi atë plakë asht e lëkurë e të mbledhur gërmuq.

«A del më ujë te Përroi i Thatë?» — pyeti ajo.

«Nuk del asnjë pikë ujë, — i thanë gurajasit. — Kështu e kemi gjetur kur kemi lerë.»

«Po kanali a është përkrye arave të Gurajës?»

«Është prishur, por shenjat janë. Duken edhe sot vende-vende.»

Plaka ia dha të qarit prapë.

«Nuk më del shpirti kurrë pa shkuar edhe një herë në Gurajë, atje te Përroi i Thatë. Gjithë toka e Gurajës ujitej nga ai lumë. Harambashi që më grabiti, më detyroi ta mbyllja burimin e tij. Dhe pa e nxjerrë atë ujë, nuk vdes kurrë.»

«Si e ndale ujët e lumit?» — e pyetën gurajasit.

«Atje tek dilte ujët shtrova lesh dhensh të palarë dhe sipër leshit vura vé e dhjamë derri që s'kalbet kurrë. Leshin, vétë e dhjamin i mbuluam me plisa e me gurë... A e dini ku ka dalë ai ujë?»

«Në fund të Gurajës, kufi me Breglumin, shpërthejnë tri burime të mëdha, që nxjerrin sa një brez burri ujë secili.»

«Tash më kanë lënë këmbët e nuk mund të eci, — tha plaka. — Nuk peshoj më rëndë se një pupël zogu. Po të më merрте në kosh dikush, do ta nxirrja prapë atë ujë...»

Mbasi mbaroi lufta, gurajasit u kthyen në fshat dhe ua treguan pleqve fjalët e plakës. Tre vjet më vonë u nisën e shkuan te kulla që kishte rreth e rreth rrashta njerëzish të ngulur majë hunjve, por morën vesh se ajo ishte bërë brevë¹⁾, kishte dalë jashtë dhe nuk ishte parë më.

Omerit i pëlqeu shumë legjenda që tregoi Cungeli, sepse ajo ishte më afër përjetimeve të tij të asaj dite. Ashtu siç ia kishte rrëmbyer motit lumin Gurajës një grua e bukur, ashtu ia kishte vjedhur Omerit lumin që gurgullonte brenda tij Jerina.

1) gjarpër i madh uji që besohej se ishte kuçedër.

I la burrat në oborr, nën atë përshkënditje yjesh, xixëllonjash dhe çibukësh të ndezur, duke folur për thatësirën, për ujët dhe për ringjalljen e Përroit të Thatë. O, sa të moshuar e ndiej veten sonte! — tha me vete dhe psherëtiu thellë. I dukej sikur kishte në kurriz të gjithë hidhërimet e Gurajës. Në sytë e tij u shfaq fytyra e Jerinës, Gurajë e mbështjellë nga pluhuri dhe e venitur nga dielli i fortë.

Omerit i ishte ngulur në kokë imazhi i Ujëbardhës së mbetur në hije, pa vezullime, si një peshk me leskra të qëruara. Fantazia e tij e kotulluar nga gjumi e mbërtheu fort këtë imazh dhe nisi të luante me të...

Atë mëngjes Guraja qëndronte pezull midis ankthit e gëzimit:

— Do të ngjallet Përroi i Thatë!

Megjithatë tek-tuk u dëgjuan edhe zëra të pakënaqur e kundërshtarë, që nuk e shikonin me sy të mirë këtë përpjekje të re të Murat Gjokës.

— Mjaft ia kemi dëgjuar fjalën magjistarit! Na i ka bërë arat e livadhet vrima-vrima sikur në Gurajë jetojnë gjarpërinj e jo njerëz. Tash s'i ka mbetur vend tjetër ku të shpojë, prandaj përpiqet të na i marrë mendtë e të na çojë të gërryejmë në Përrua të Thatë! — thoshin disa me mllef.

— Po ta prekim Përroin e Thatë, kushedi ç'gjëmë e re do të bjerë mbi Gurajën! Ndoshta do të thahet edhe ai ujë i paktë i krojeve e i puseve që kemi a do të bjerë rrufeja mbi shtëpitë tona. Zoti që vran e kthjell ia mori lumin e vet Gurajës dhe ai i lumi (i qofshim falë ditë e natë!) e di pse ia mori. Ne nuk mund të ngrihemi kundër vullnetit të zotit. Po të zemërohet i madhi zot, jeta në Gurajë do të bëhet keq e tukeq! — thoshin të tjerët me përvujtëri e frikë...

Në pjesën e sipërme të fshatit, në krye të një fushe që nuk e lëronte dhe nuk e kosiste askush, ishte një rrënojë e mbuluar me ferra, driza e barishte të egra, midis të cilave lëvrinin gjarpërinj, hardhuca e breshka. Ferrat e kulprat kishin mbështjellë me degët e dredhulet e tyre edhe një kabanë të rëndë, mbi të cilën tundeshin nga flladi lulekëmborat e bardha, sikur ngacmonin simotrën e tyre prej bronzi, të mbërthyer nga paraliza. Aty ishte gërmadha e kishës së dikurshme të Gurajës, që turqit e kishin djegur, kur kishin ardhur në këto vise t'i nënshtonin gurajasit e t'u ndërronin fenë.

Gjysmë shekulli më vonë veziri i thirri në saraj krerët e Gurajës, i gostiti, u dha grada e kobure të veshura me serm. Ata, jo vetëm i morën dhuratat e çmuara të vezirit dhe u përkëdhelën në sedër nga ndëret e tij, por edhe pranuan të ndërronin fenë. Më vonë këtë gjë e bënë edhe të afërmit e miqtë e tyre, sepse ndërrimi i fesë u siguronte mbështetjen e vezirit dhe u krijonte lehtësira për të shkuar në tregjet e qyteteve të mëdha.

Megjithëse u islamizua pothuajse gjysma e fshatit, feja e re në Gurajën e thatë e shkëmbore mbeti si ai bari që mbin nëpër faqet e gurëve e që i ka rrënjët tepër të cekëta. Ajo solli pak ndryshime në jetën e besimtarëve të saj, të cilët ndërruan emrat, nuk hanin mish derri dhe nuk pinin verë.

Pasardhësit të vezirit plak as që i ra ndër mend ndonjëherë për Gurajën dhe për parinë e saj, që e kishte syrin te koburet e lara me argjend e te mexhitet e bardha. Kështu në Gurajë nuk u ndërtua xhami, ndërsa kisha e djegur, e cila edhe më parë kishte mbetur pa prift, nuk u ngrit më në këmbë...

Te Bliri i Madh, që ishte për Gurajën si minarja e xhamisë apo kabanorja e kishës për fshatrat e tjera, u mblodhën paria dhe burrat e fshatit. Kuvendi mori valë që në fjalët e para që tha Murat Gjoka. I frymëzuar edhe nga disa potira me raki që i kishte rrëkëllyer para se të vinte aty, ai foli me afsh për

ringjalljen e lumit, për mbarësinë që do të sillte, për përtëritjen e ardhshme të Gurajës. Këto fjalë ranë në vetëdijet e gurajasve siç bien xixat e strallit në fijet e thara e të shprishura të eshkës.

Ndonjë zë kundërshtar e ndjellakeq që u dëgjua edhe në kuvend, u mbyt nga ngazëllimi i përgjithshëm. Ai ishte si një shkarpë përpara ortekut. Guraja ishte dehur me këtë iluzion të ri dhe, të përpiqeshe ta zhdehje atë, ishte njëlloj si t'i thoshe: Lidhi duart kryq dhe prit ditën e vdekjes, sepse s'ke shpëtim nga thatësira. Ajo do të të vrasë!

Por gurajasit kurrë s'i kishte lëshuar shpresa se ata do ta mundnin thatësirën një ditë. Për të mbajtur e për të paguar ata që do të gërmonin tek ama e Përroit të Thatë, u vendos që çdo familje të jepte nga pesë dele ose dhi. Po të ngjallej lumi i zënë, ai që nuk do të jepte gjë, s'do të kishte të drejtë as të pinte ujë me grushte në rrjedhën e tij. Kjo i bëri të dorëzoheshin edhe më të lëkundurit e më të pakënaqurit, sepse askush nuk donte të ndahej nga shokët, të hiqte dorë nga vegullia ngacmuese e lumit të mbushur si dikur, me ujëra të shkumëzuara e buçimtare.

Edhe për të mos fyer e për të mos zemëruar zotin u gjet rrugëdalja: nga fshatrat e afërme do të thirreshin një prift e një hoxhë, që do të bekonin fillimin e punimeve. Këtë gjë e mori përsipër vetë Murati. Sigurisht ai ishte njeriu më i përshtatshëm për këtë punë, sepse kishte miqësi me të gjithë priftërinjtë e hoxhallarët e fshatrave rreth e rrotull, hante e pinte me ta.

Cërr-cërr, tuk-tuk! cërr-cërr, tuk-tuk... vinte nga pylli përballë shtëpisë zhurma haremadhe e zogjve të zgjuar që pa zbardhur drita. Kjo zhurmë arrinte në

vetëdijen e përgjumur të Omerit, që kishte filluar të kthjellohej dhe rrëkëllehej nëpër qenien e tij si afshi i një pijeje të ëmbël, gudelisëse, që e bënte gati të papeshtë.

Nga ky kotullim e shkëputën disa vërrime dhish në oborr. U ngrit nga shtroja menjëherë dhe futi kryet në dritaren e ngushtë. Tërë ëmbëlsia dhe ëndja e atij mëngjesi u prish nga ajo që pa. U vesh, mbathi çorapet, opingat dhe zbriti në oborr, ku blegërinin dhinë e ndara nga tuba. I ati ishte ulur mbi një trung e po thithte çibukun. Sytë e Omerit u takuan me sytë e tij, po kësaj here sikur u përplasën.

— S'kemi si t'ia bëjmë, — tha i ati. — Nuk mund të veçohemi prej shokëve e të mbetemi pa ujë.

— Pa cilët ujë?!

— Pa ujët e Përroit të Thatë.

— Përnjëmend beson se do të ngjallet Përroi i Thatë, babë?

— Murat Gjoka di se çka flet, biro.

— Murat Gjoka po tallet me ne e me tërë Gurajën. Jo vetëm tash, po prej vitesh. Ai po luan arushë me ne...

Omeri fliste me duf, pa u menduar mirë. Ai e ndiente se fjalët e tij po shkonin shumë më larg nga ç'kishin shkuar ndonjëherë, edhe kur mendonte vetmevete. Të shtyra nga era e vrullshme e mllëfit që provonte atë çast jo vetëm për magjistarin, por për çdo gjë të keqe e të gënjeshtërt që kishte vënë re në jetë, ato rrokulliseshin si dallgë të hakërryera shtrëngate. Ky shpërthim i papritur ishte shenjë e burrërimit dhe e guximit për t'u ballafaquar me jetën, me fatin e tij si njeri, si banor i këtij skaji të botës.

I ati kishte ulur kryet si kau plak, kur i vërsulet ndonjë dem i harbuar.

— Nuk e kam se po më dhimbsen këto të pesë dhi, por më mirë t'i kishte ngrënë ujku a t'i kishte zënë gjarpri, sesa t'i hajë Murat Gjoka!

— Atëherë shko e gërryey në Përrua të Thatë. Kështu edhe nuk paguajmë gjë, edhe ujë do të marrim.

— Kurrë mos e prit këtë prej meje! Më mirë marr

kazmën e filloj të hap varrin tim, se të gërryëj si i marrë zallin e Përroit të Thatë....

Është rritur shumë kohët e fundit, mendoj Demushi, duke vështruar trupin e gjatë të të birit. Vërtet është i hajthëm, por është një shuplakë më i gjatë se unë. Nuk më vjen mirë që është kaq i rrëmbyer. Kushedi cilit gjysh a stërggjysh do t'i ketë ngjarë...

Nuk më vjen mirë që është kaq i rrëmbyer, tha prapë me vete. Guraja është tërë shkëmbinj e humnera dhe mund të marrësh lehtë në thua. Dhe kur ke një djalë të vetëm, të duket sikur tërë shkëmbinjtë e humnerat janë bërë enkas që të marrë në thua djali yt....

Pa thënë asnjë fjalë tjetër, Omeri mori trastën e bukës, vuri përpara tubën e dhive e u nis drejt malit. Mendonte t'i mballonte sa më larg, ku nuk do të takonte asnjë bari tjetër, ku do të dëgjonte vetëm cicërimat e zogjve dhe shushurimat e drurëve. Atë mëngjes ishte i bindur se njerëzit bënë çmos vetëm si e si të prishnin gëzimin e njëri-tjetrit me fjalët e veprimet e tyre.

Megjithëse ishte herët, gjinkallat ia kishin filluar këngës së tyre nëpër koret e lisave gungaçe e të zgavruar. Kjo gjë e trishtoi edhe më tepër Omerin tek ecte në shtegun me pluhur të verdhë e kakërdhi të thara. Vështroi gjithë mëri larën e ndritshme të borës, atje larg, e cila s'donte që s'donte të merrte formën e kalit. Pështyma e tij, e vetmja mënyrë për të shprehur mllëfin që ndiente atë çast, ra në pluhurin e verdhë të shtegut dhe u shndërrua në një shuk të rrumbullakët si brumbull.

Kur dhitë vrapuan tatëpjetë një shpati, për të zbritur të përroi ku pinin ujë, pluhuri u çua përpjetë e u bë tymnajë. Befas u dëgjua një britmë e gjerrë: Omeri e njohu zërin e Shytës. Atë dhi e donte më tepër se të gjitha të tjerat. Gjatë ditës, në mriç a në kullotë, ajo i afrohej duke blegërirë dhe i lëpinte dorën.

Omeri e gjeti Shytën në mes të shpatit, të shtrirë përtokë. E kishte zënë gjarpri në hundë. Sa çel e mbyll sytë u enjt e u bë tupan. Ai ia preu veshin me brisk e zuri t'ia rrihte me një fiskël. Nga e prera rridh-

te gjak i zi, i përzier me helmin e gjarprit të shullërit. Pas një grimë here trupi i buhavitur i Shytës u drodh dhe koka e saj ra përdhe.

Omeri e ndjeu se po i lageshin sytë. Nuk bëra mirë që fola ashtu me tim atë, mendoj ai. Me Murat Gjokën a pa Murat Gjokën, neve nuk do të na qeshë buza kurrë. Guraja është e nëmur. Edhe ne jemi të nëmur. Po pse?! Pse?!...

Erë gështenjash të lulëzuara, erë lisne, erë lulësh e çaji të egër, erë mishi të pjekur. Fërlikët silleshin mbi prush majtas-djathtas, majtas-djathtas. Dhjami pikonte mbi kongjij, avullohej, tretej në ajër, hynte në mushkëritë e njerëzve, ngjitej në qiell si tymi i flive të lashta... Të falem, o qiell, të falem, o Përrua i Thatë, të falem, o dhë i errët, ku nuk mund të arrijë mendja dhe syri i njeriut, kthena përsëri ujin tonë, ujin që na e mohove dikur.

Fshatarët lëviznin nëpër atë ernajë, nëpër atë tymnajë të kaltëryer me sy të përshkënditur nga ekstaza, me buzë të drithëruara nga shpresa, nga lutja e tyre përgjëruese që shpërndahej rreth e qark si avulli i mishit të pjekur... Uji është gjaku i tokës, gurët janë eshtrat e saj, balta është mishi i saj. Pa ujë toka vdes. Mos e lër tokën e Gurajës sonë të sëmuret, të digjet e të vdesë për ujë, o Përrua i Thatë!

Midis drurëve të gjelbër u dukën kali i kullmë i hoxhës dhe mushka e zezë e priftit.

— Po vijnë!... Po vijnë!... — thanë njerëzit që ishin ulur mbi gurët e rrrumbullakët të Përroit të Thatë. Me të parë klerikët, lutja pagane, regëtimë e gjakut të tyre, u ndërpre menjëherë. Ata u ngritën në këmbë, të turbulluar, të çuditur nga ai ndërrim i beftë i qenies së tyre.

Hoxha dhe prifti zbritën nga kafshët, i dhanë dorën bajraktarit të Gurajës, Grosh Malotës, kurse fshatarët e tjerë i përshëndetën pa i veçuar, sikur të kishin të bënin me një krijesë të vetme me shumë kokë e me shumë gjymtyrë. Klerikët thithnin ephërisht ajrin ngacmues që vinte nga ana e fërlikëve dhe përzihej me kundërmimin e bimësisë së harlisur të pyllit. Me të marrë vesh për mbërritjen e tyre, Murat Gjoka erdhi nga vendi i flijimit duke vrapuar.

— Të bekuara qofshin këmbët tuaja që po shkelin dheun e Gurajës në këtë ditë të madhe! — u tha magjistari me një të folur euforik që ia frymëzonte ajo ceremoni e pazakontë.

Të cytur nga era e mishit të pjekur, klerikët dëshironin t'i jepnin fund sa më shpejt asaj ceremonie që nuk kishte në vetvete asgjë të keqe as për zotin e tyre të përbashkët, as për fetë e tyre të veçanta dhe do të pasohej nga një drekë e shijshme në ajër të pastër.

— A është gjithçka gati? — tha hoxha.

— Gjithçka, efendi! — tha Murati. — Vetëm ju po ju prisnim.

Tek ama e Përroit të Thatë ishte një shpellinë e gjerë, e krijuar nga ndonjë shembje e qëmotshme, mbase qysh në atë kohë kur lumi kishte humbur nën tokë, nëpër të çarat dhe fytëzat e shkëmbinjve gëlqerorë. Orteqet dhe rrëketë e shirave e kishin mbushur gati përgjysmë, kështu që ajo dukej si goja e një bishe që i ka ngecur në grykë një grumbull eshtrash dhe ulërin nga dhimbja. Pranë saj, në një lis binjak ishin lidhur tre desh të zinj, siç kishte porositur magjistari.

Fshatarët u mblodhën në trajtë rrethi përçark shpellinës, ashtu si u qëlloi, të paveçuar sipas lagjeve a feve. U kryeshtruan të gjithë, duke hequr nga koka plisat e bardhë, shallet e gjata, shamitë e kuqe e të zeza.

Veç e veç, njëri pas tjetrit, hoxha dhe prifti e bekuan lumin, i bekuan fshatarët dhe Gurajën e thatë. Nëpër shtratin e heshtur të lumit jehuan fjalët e tyre të pakuptueshme arabisht e latinisht dhe mbi gurët e vakur nga dielli ranë spërkat e pështymës së tyre.

Ata as që e çanin kokën nëse në ato brigje do të përplaseshin a jo valët e lumit të ringjallur.

Si e bënë punën e tyre, klerikët u larguan nga vendi i ceremonisë, u ulën mbi sixhade nën hijen e një gështenje dhe filluan të bisedonin për vlerat e mishrave të ndryshme, të mishit të zier e të mishit të pjekur...

I erdhi radha magjistarit. Ai ua bëri me dorë ndihmësve të vet, që i sollën në mes të shpellinës të tre deshtë e zinj. Deshtë vështronin trembshëm turmën e njerëzve dhe blegërinin, duke tundur kryet me forcë. Brirët e tyre të gjatë pengoheshin e kërcisnin pas gurëve.

Magjistari e shtriu dashin e parë përdhé. Ndërsa ndihmësi po e mbante nga këmbët, ai i vuri gjurin e djathtë në shpatull, ia hapi leshrat e dendura te qafa dhe i mëshoi me një thikë të gjatë. Currilat e gjakut shpërthyen si një lumë që buron nga toka. Një fshatar tjetër u afrua menjëherë dhe vuri nën qafën e dashit të therur një tepsì që u mbush me gjak.

Magjistari i futi duart në tepsì, i mbajti një çast në të, mandej drejtoi trupin e i ktheu pëllëmbët e përgjakura kah dielli. Ai qëndroi ashtu derisa u përtha gjaku në pëllëmbë. Pasi ia bëri diellit blatimin e parë të këtij flijimi, i lagu prapë duart në gjakun e tepsisë dhe zuri të lyente me të gurët e lumit.

— Siç po i njom këta gurë me gjak, u njomshin me ujërat e Përroit të Thatë! — thirri ai, duke marrë një pamje të frikshme, që njerëzit e Gurajës nuk ia kishin parë ndonjëherë tjetër. Madje po ta shihte fytyrën e tij ato çaste, do të habitej edhe ai vetë. Kushe-di çfarë refleksesh të ndonjë flijimtari të lashtë ishin zgjuar e gjallëruar befaz në nënvetëdijen e tij. Ishte një Përrua i Thatë, i shteruar qëmoti, që gufi e u ringjall nga ky rit i lashtë i stërgjyshërve që i përkisnin një kohe tjetër....

— Thërritni edhe ju bashkë me mua! — u tha fshatarëve magjistarit. Sikur të kishin qenë duke ndenjuri gati për të zbatuar urdhrin e tij, nga fyftet e fshatarëve gufoi sakaq një rrëke tingujsh:

— Siç po i njom këta gurë me gjak, u njomshin me ujërat e Përroit të Thatë!

Kjo thirrje e fortë, drithëruese, e formuar nga dhjetëra zëra të ndryshëm, kumboi disa herë në lugajën e shpellinës, aq sa të dukej sikur atë po e përsëriste vetë ama e lumit.

Ndërsa magjistari mori tepsinë plot gjak që kishte nisur të droçkëzohej dhe e derdhi në mes të shpellinës, fshatarët thërrisnin me një zë, sikur t'u jepte shenjë një dorë e padukshme:

— Siç po i njom këta gurë me gjak, u njomshin me ujërat e Përroit të Thatë!... Siç po i njom këta gurë me gjak, u njomshin me ujërat e Përroit të Thatë!...

Ashtu siç veproi me dashin e parë, magjistari bëri edhe me të dy deshtë e tjerë, i përcjellë nga thirrja e njëzëshme e fshatarëve, që përplasej në faqet e lugajës e kthehej prapë në veshët e tyre. Tashmë gjaku kishte mbuluar jo vetëm duart e krahët e magjistarit, të përveshur gjer në bërryla, por edhe fytyrën e petkat e tij. Ai vërtitej midis gurëve sikur hidhte një valle rituale dhe mbështeste mbi ta pëllëmbët që pikonin gjak.... Tani shpellina e përgjakur i ngjiste gojës së një bishe që ka shqyer e ka pirë gjakun e një kopeje të tërë. Magjistari shkundi duart, duke i dhënë fund ritit të ngjalljes së lumit.

— Ta lëmë lumin të pijë gjakun që i dhamë, — tha ai. — Padsreke do të fillojmë punën.

Fshatarët u larguan nga buzët e shpellinës, duke bërë lëvizje të ngathëta, si të dehur nga një pije magjike, që ua mpinte muskujt e kyçet dhe ua lidhte gjuhën. Ata zunë vend mbi trungje, mbi degë të thyera, mbi fier të prerë. Murati u tha ndihmësve të rripnin deshtë e therur gjatë ceremonisë e t'i shtinin në hell. Si lau duart, vajti te klerikët, që u ishte shtuar së tepërmi sasia e lëngut në gojë dhe pak nga pak po u sosej durimi.

Dreka u shtrua në një lirishtë, nën hijen e drurëve. Hoxhës, priftit e magjistarit u vunë përpara nga një fërlik të paprekur në korita të mëdha druri. Aty

pranë ishin shekët me kos, kungujt me verë, caliku me raki.

— Ju bëftë mirë, o njerëz të perëndisë, — u tha Murati klerikëve, duke vënë buzën në gaz. — Fjala jonë shkoftë në vesh të zotit!

Ashtu siç ishte me petka të stërpikura me gjak, u përkul mbi fërlikun erëndshëm dhe ia nguli dhëmbët në brinjë. E mbushi gojën plot me mish të vakët e të shijshëm. Kur zuri të mbllaçitej me ato nofulla e dhëmbë që dukeshin të moçëm sa bota, nëpër cepat e buzëve i rrodhën currila lyre.

Edhe prifti e hoxha ia nisën të shqyenin fërlikët e tyre, duke përdorur herë thikat, herë gishtat. Ata nuk ishin më pak të babëzitur nga magjistari e nuk u latërzyen më pak me lyrën e vakët që u vezullonte buzëve e mjekrave.

Më tej, të ulur nën hijen e drurëve, ende me vegimin e ceremonisë në sy, fshatarët përçapnin copën e mishit që u kishte takuar dhe kalonin dorë më dorë kungullin e verës.

Pasdreke, i rënduar nga të ngrënët e i trullësuar nga të pirët, por jo aq sa të mos i bindeshin gjymtyrët, Murati nguli kazmën e parë te vendi ku do të fillonte gërmimi. Menjëherë pas tij kazma të tjera qëlluan shtresën e trashë të zallishtës të ngjeshur nga motet. Ato lëshonin një krismë metalike që shungullonte në lugajë, sikur shkërbente njerëzit që thërrisnin aty para disa orësh. Kur kazmat përplaseshin pas tyre, gurët nxirrniñ xixa, thuase një qenie mitike po kërcëllinte dhëmbët me zemërim.

Ceremonia për ngjalljen e Përroit të Thatë u bë strumbullari i bisedave që zhvilloheshin në kthina, në rrugë, në pushimet gjatë punës, në orët e vona të natës. Për të flisnin ata që besonin në mundësinë e ngjalljes së lumit të tyre, si edhe ata të paktë që nuk besonin, por edhe nuk e shprehnin hapur mosbesimin e vet. Pse nuk ishte e lehtë, as e këndshme ta bëje këtë gjë në Gurajën e mjeruar, e cila luante me ilu-

zionet e saj si fëmija që luan me flluska sapuni dhe pandeh se mund të ngjitet në qiell duke u kapur pas tyre.

Megjithatë edhe ky ngazëllim që jetëshkurtër, ashtu siç ishte jetëshkurtër pothuajse çdo gjë e mirë në Gurajë: pranvera, vlaga e tokës, harlisja e bimësisë, ëndërrimet e të rinjve, nusëria e grave dhe vetë jeta e njerëzve. Jetëgjata ishin vetëm thatësira dhe vuajtja. Gurajasit nuk u përkundën gjatë në shregullën e këtij ngazëllimi. Një ngjarje e re i preu litarët e saj dhe ata u plandosën në tokën e ashpër të realitetit si fëmija që rrëzohet nga shregulla e këputur.

Këta litarë i preu thika e një fjale të zakonshme, thirrja e një njeriu të lekosur e të larë në djersë, që arriti duke vrapuar tek ajo pjesë e fshatit që mbahet si qendra e tij e ku kishte një tregtores, një rrobapëpës e një farkëtar:

— Tagrambledhësi!

Kjo fjalë e elektrizoi trupin e Gurajës më fort se të gjitha formulat magjike të magjistarëve të vdekur e të gjallë, që kishin shkelur mbi dheun e saj. Me një shpejtësi të mahnitshme lajmi u ngjiti nga lagjet e poshtme deri te shtëpitë që ndodheshin kufi me ahishtat e livadhet alpine. Trupi i Gurajës u mblodh, u ngërçua, u forcua si muskujt e njeriut që bëhet gati të presë goditjet e një kamxhiku të ashpër. Fshatarët e dinin se mund të përdorej edhe kamxhiku, edhe huri, për t'i detyruar të paguanin taksat e rënda, të cilat i kishin kundërshtuar që prej tre vjetësh. Ata ishin ankuar disa herë te nënprefekti duke thënë se ishin tepër të varfër e s'kishin mundësi të paguanin.

Madje Kingj Sokoli kishte mbushur një trastë me «qela», kallinj misri të vegjël sa gishtit dhe kishte

shkuar me të deri në kryeqytet. Pas shumë mundimesh ia kishte dalë të takohej me një njeri të oborrit mbretëror. Guraja që e kishte zakon t'i zmadhonte gjërat, thoshte se ai ishte takuar me vetë naltmadhninë. Kur ishte futur në zyrë, Kingji kishte nxjerrë kallinjtë nga trasta dhe i kishte vënë në tryezë.

— Tëka e Gurajës është tokë e varfër e pa ujë, — i kishte thënë Kingji. — Ja çfarë drithi bëhet në të. Edhe pa taksa po vdesim urie. Fshati ynë nuk i ka paguar taksa as sulltanit. Zotni, kur bleta s'ka mjaltë, i zoti s'ka çka merr në të, veç në qoftë se don ta mbytë krejt!

Zyrtari i kishte premtuar se do të bënte çmos për t'ia hequr taksat Gurajës. Kingji ishte larguar, duke lënë në tryezë kallinjtë e rrëgjuar nga thatësira. Ç'është e vërteta, kishte pasur njëfarë shprese se përçapja e tij nuk do të shkonte kot. Mirëpo edhe kësaj here as mbreti, as qeveria nuk e kishin vënë dorën në zemër për Gurajën. Ajo duhej të paguante, mandej le të vdieste në daç nga thatësira, në daç nga uria...

Me të marrë lajmin për mbërritjen e tagrambledhësit, apo «togermbledhësit», siç e quanin me tallje gurajasit, nga çdo shtëpi u nis një njeri për të njoftuar barinjtë në kullota. Secili e kishte menduar me kohë atë mënyrë që i dukej më e mirë për t'iu shmangur taksave.

Me tagrambledhësin ishin një kapter e dy xhandarë. Ata shkuan te shtëpia e kryeplakut për të ngrënë drekë. Aty bujtnin, hanin e pinin të gjithë zyrtarët që vinin nga nënprefektura e, tepër rrallë, nga kryeqyteti. Bajraktari i Gurajës kishte një «njollë»: kishte marrë pjesë në kryengritjen e përgjithshme, që kishte dëbuar nga Shqipëria mbretin e sotëm. Pas rrëzimit të qeverisë së Nolit ishte dorëzuar i pari dhe ishte penduar thellë. Mbreti e kishte ftuar në pallat bashkë me bajraktarët e tjerë dhe i kishte lidhur rrogë të përmuajshme, por për njerëzit e qeverisë mbi të binte hija e krimit politik që kishte kryer më parë.

Prapa kësaj ngacmueshmërie morale fshihej diçka

tjetër. Kulla e vjetër e bajraktarit, me frëngji, dritare të ngushta e mure të pasuvatuara, nuk kishte asgjë tërheqëse. Krijt ndryshe ishte shtëpia e re e kryeplakut, ku kthinat ishin me suva, me tavane të skalitura, me dritare të gjera. Kryeplaku ishte më i pasuri i Gurajës, kishte arat e kullotat më të mira e tubat më të mëdha. I vëllai i tij kishte hapur tregtoren¹⁾ e vetme në fshat. Ai çonte në qytetin që ishte dy-tri ditë larg mushkat e ngarkuara me lesh, lëkurë, vezë, gjalpë, mjaltë, arra e gështenja që ua blinte fshatarëve dhe sillte që andej kripë, opinga llastiku, pëlhurë, penj, shami koke, rruaza, bojëra për të ngjyer, plorë, kazma e vegla të tjera.

Megjithëse e dinin se ai i shiste mallrat e qytetit deri në dhjetëfish më shtrenjtë nga sa i blinte, fshatarët ishin të detyruar të shkonin në tregtoren e tij. Rrugat e gjatë, e mundimshme për në qytet ishte njëri shkak. Shkaku tjetër ishte se ata e kishin të vështirë t'i gjenin sendet që u duheshin, ndërsa tregtari kishte marrëveshje e miqësira me shumë tregtarë të qytetit.

Në shtëpinë e kryeplakut kishte gramafon dhe grave u vinte era livandë. Gjithsesi aty hahej e pihej më mirë se kudo. Njeriu i qeverisë, që vinte aty, e ndiente veten të mbrojtur nga mjerimi i Gurajës, nga grafullima e tokës së djegur dhe e ajrit të nxehtë.

Kjo mikpritje ishte malli që shitej më shtrenjtë dhe i sillte kryeplakut fitimet më të majme.

— Ai di ta mjelë «bujarinë» e tij, — thoshin gurajasit për të.

Kapter Seferi dhe tagrambledhësi e kaluan natën në shtëpinë ku vinte era livandë, kurse xhandarët shkuan te disa fshatarë, ku do t'u vihej përpara koka dhe shpatulla e qengjit.

Kryeplaku mbloodhi krerët e lagjeve, u dha urdhër që të nesërmen bagëtitë të mbaheshin në vathë, se do të bëhej regjistrimi i tyre.

1) dyqan

Tubat u kthyen nga mali të përgjysmuara, disa nuk u kthyen fare. Këtë gjë kryeplaku e mori vesh menjëherë nga njerëzit e tij, të cilët e njoftonin për gjithçka që ngjiste në fshat. Ai ua tregoi dredhinë e fshatarëve mysafirëve të tij, jo pa mburrje. Tagrambledhësit iu bë fytyra si lafshë gjeli dhe fikthi, tepër i kërcyer përpara, iu drodh si t'i kishte mbetur në fyt një copë kraharor pule.

— Tani është radha jote të merresh me këta malokë të mallkuar! — i tha kapterit që po kruante me një kleçkë dhëmbët e tij kataroshë e të gjatë si çataj derri të egër. Ata dhëmbë bënë një kontrast të fortë me trupin e tij të paktë e me fytyrën imcake dhe i jepnin pamjen e një brejtësi. Edhe kur fliste, dukej sikur fishkëllente. Kapteri e flaku kleçkën në vatër dhe zgurdulloi sytë si qeni kur e ndërson i zoti. Por në vend të krifës që i mungonte, u kreshpëruan vetullat, mustaqet e dhëmbët kataroshë.

Regjistrimi i bagëtive u pezullua. Kapteri ishte autorizuar të përdorte çdo mjet, me qëllim që të kryhej vjelja e taksave. Ai kishte një përvojë jo të vogël për të shtypur kundërshtimin e fshatarëve. Nuk vepronte kurrë rrëmbyerazi, por ngadalë, me gjakftohtësi, në mënyrë metodike, tamam si brejtës i vërtetë. Në fillim lidhi fshatarët me kryekëcyer, më të pabindur që i kishin fshehur të gjitha bagëtitë në mal. Po të thyheshin ata, kundërshtimi i të tjerëve do të ishte si një fije kashte...

Të lidhurit i futën në një ahur të kryeplakut. Kapteri i mori në pyetje një nga një, i kërcënoi, por asnjëri nuk pranoi se i kishte fshehur bagëtitë në mal. Edhe me këta të lidhur ai vendosi të përdorte metodën që e quante «prerja e majës». Kur kishte qenë fshatar, kishte vënë re se, për t'i penguar drurët që të rriteshin përpjetë, u pritëshin majat. Mandej, për t'i bërë çufrakë si shkurre, u pritëshin edhe degët e sipërme.

«Maja» e të lidhurve ishte ai fshatari trupmadh, me të cilin ishte ndeshur edhe më parë gjatë opera-

cionit ndëshkimor pas kthimit të mbretit. Kapiterit i vinte inat, sepse, sa herë që ndodhej pranë këtij fshatari, ndiente një dobësi të pashpjegueshme, një zvogëlim të vetvetes që shkaktohej jo aq nga trupi i madh, por më tepër nga diçka e pathyeshme, që fshihej brenda tij. Kur e shante, apo kur e qëllonte me kamxhik, në vend që të zhdukeshin, ajo dobësi dhe ai zvogëlim i vetvetes shtoheshin edhe më tepër.

Kapterin e kënaqnin më shumë ato tortura që e sfilitnin, e ligështonin të lidhurin, sesa ato që e gjakosnin, apo e gjymtonin rëndë.

— Ti e di mirë se cili jam unë!

— Besa-besë, jo vetëm unë, por gjithë Guraja e di se çfarë fytyre ke!

— Urdhri i mbretit thotë të bindesh e të paguash taksat!

— I kam fëmijët pa bukë. Nuk kam ndër mend të laj asnjë taksë, edhe sikur ta bësh plesht mbi plesht deri në tra!

Dhëmbët kataroshë të kapterit lëshuan një gërvimë të lehtë brejtësi. Ashtu kishin gërvirë disa vjet më parë në zyrën e nënprefekturës, para fshatarit me duar të lidhura.

— Ka dhënë urdhër mbreti të ndërrosh emrin!
— i kishte thënë kapteri.

— E pse ta ndërroj emrin, more zotni?!

— Emrin e mbretit nuk mund ta mbajë askush tjetër!

— Pasha tokë e qiell, nuk jam kah e ndërroj, mbasi s'ma ka vënë ai. Ta ndërrojë ai, se është më i ri se unë...

Zog Buzhetën, që kishte emër të njëjtë me mbretin, e mbajtën në burg disa muaj, por ai s'hoqi që s'hoqi dorë nga emri i vet. Atëherë nënprefekti urdhëroi t'ia ndryshonin emrin në të gjithë regjistrat dhe dokumentet e shtetit. Megjithatë Guraja që s'dinte shkrim e këndim, vazhdoi ta thërriste me emrin që i kishin ngjitur nëna e baba. Nuk ishte e lehtë t'i ndryshoje gjërat në Gurajë, qoftë edhe me urdhër të mbretit!

Këtë herë do të të shtyp kripë në kokë! — tha kapteri me vete. U dha urdhër xhandarëve t'i bënin Zogut (fshatarin e quajti me emrin tjetër, zyrtar,) «torturën e mjaltit». Ai mburrej jo vetëm për shpikjen e kësaj torture, por edhe për emërtimin e saj interesant. Në vështrim të parë tortura dhe mjalti dukeshin dy gjëra të papërputhshme. Por ata që e kishin parë «torturën e mjaltit» dhe aq më tepër ata që e kishin provuar atë, ishin bindur se shpikësi i saj assesi nuk mund të quhej kokëtrashë...

Duke e shtyrë me qytat e pushkëve, xhandarët e çuan Zogun duarlidhur në skaj të kopshtit të kryeplakut. Ia çorrën këmishën copë-copë, e mbështetën për trung të një kumbulle të vogël dhe e lidhën me litar. Një xhandar solli aty një tepsi me mjaltë. Zhyti dorën në lëngun e trashë ngjitës dhe zuri të lyente me të njeriun e lidhur në kumbull. Ishte mjaltë i vjetër, që kishte nisur të kokërrzohej. I vinte erë e fortë lule gështenje. Zogu vështronte kapterin që kishte ulur kapelen deri në vetull të syrit dhe buzëqeshte përballë tij. Ndiente një idhtësirë, një therje të mprehtë në zemër. Pse nuk m'u thanë këmbët, kur nisa të vija këtu?! E dija se nuk po më thërrisnin për mirë. E dija ç'më priste. Atëhere pse erdha?!...

Përgjigjja ishte e thjeshtë: për hir të fëmijëve. Ishin shtatë fëmijë, që mblidheshin në darkë rreth tij si kokrrat në një bistak rrushi. Shtatë vocërrakë flokë-verdhë e qafëhollë që donin bukë prej tij. Për hir të tyre e kishte ndryrë kaq herë pezmin në zemër. Ai e parandiente se pezmi do të shpërthente një ditë, por ishte munduar ta shtynte atë ditë sa më larg... Dora e xhandarit, putër ariu, zhytej në enë, mandej lëvizte ngadalë-ngadalë mbi parzmin, krahët, supet dhe fytyrën e fshatarit të mbërthyer me litar për trung të kumbullës. Pothuajse tërë lëkura e zhveshur e trupit të tij u mbulua me një shtresë të hollë mjalti.

Atë ditë në qiellin e Gurajës nuk kishte asnjë cukël reje. Edhe qielli dukej i largët, si i tëhuajtur nga toka e nga ato që po ndodhnin mbi të. Sikur nuk

donte të përzihej në andrallat e fshatarëve, as të merrte pjesë në torturën e Zog Buzhetës.

Dielli nxehte pa hile, siç thonë gurajasit. Zogut i dukej sikur brenda tij ishte nderur një zjarr i madh që po ia digjte brinjët, mushkëritë, fytin, anrrat e barkut. Mjalti i kishte mbyllur vrimëzat e lëkurës dhe nuk e linte djersën të dilte jashtë. Por kjo gjë edhe mund të durohej. Llahtara e madhe ishte luzma e insekteve që uleshin e ngriheshin mbi trupin e tij. Arëza, bletë, miza, fluturza, pleshta gjethesh e cimbinin, e pickonin pareshtur. Gretha të mëdhenj laramanë, në ngjyrë të verdhë e të zezë, i vinin përçark duke lëshuar një fishkëllimë metalike, që të gërvishte trutë. I hante lëkura, aq sa dëshironte të kishte një mijë thonj e të çirrte me ta trupin e vet deri në gjak.

I shtrënguar fort nga litari, përdridhej pas trungut si gjarpri që futet midis dy gurëve për të zhveshur lëkurën e vjetër. Nga thumbimet dhe helmi i insekteve mishi iu enjt e iu bë gunga-gunga si një ah i rrëzuar, ku gëlojnë me dhjetëra bulledra. Në fytyrën e buhavitur mezi dalloheshin dy të çara, saqë nuk të besohej se prapa tyre ishin dy sy njerëzorë.

I ulur në hije, përballë tij, kapteri ndiqte me vëmendje çdo gjë që ndodhte, çdo lëvizje të të torturuarit, si një çunak shpirtkazmë që kënaqet duke ia këputur një nga një gjymtyrët një brumbulli. Ishte i bindur se nga një çast në tjetrin prej atyre nofullave të shndërruara në darë do të dilte një britmë, një lutje për mëshirë. Ajo britmë kishte kohë që i buçiste në veshë, por kapteri priste me ankth të shikonte për-vjeljen e buzëve të enjtura të fshatarit dhe gojën e errët. Errësirën e zezë të gojës që bërtet. Ai mendonte se edhe britma që do të dilte nga ajo gojë, do të ishte e zezë...

Por goja përkundraill nuk u hap. Nuk pati as gojë të errët, as britmë.

Ai nuk do të kërkojë mëshirë edhe sikur t'ia çukitin sytë korbat dhe orlat t'i zhveshin eshtrat për së gjalli, mendoi kapteri me pikëllim. I erdhi si të fikët.

Një krizë e fortë dobësie, pafuqie. Një vocërrim i dhimbshëm i vetvetes. Iu duk sikur edhe ai u bë greth me shirita ngjyrë ari e të zinj, që vërtitej për-qark të lidhurit dhe thumbonte trupin e tij. E thumbonte dhe fuste në të helm. Por iu kujtua se bleta ose grerëza mund të thumbonte vetëm një herë, sepse, pasi e linte thumbin me helm në trupin e kundërshtarit, ajo vdiste. Mos vallë edhe atij do t'i mbetej thumbi helmues në trup të këtij fshatari e do ta priste vdekja?! Ndjeu se po i zihej fryma. U koloviti. U mbështet në supin e xhandarit që kishte pranë tij. Xhandari e pa me shqetësim.

— Nuk kam gjë, — i tha kapteri. — Diell i fortë...

Urdhëroi që fshatarët e tjerë t'i mbyllnin në ahurin me bajga të kryeplakut. Një xhandari i tha të ulej nën hijen e pemëve e të ruante Zog Buzhetën, të cilit sa s'po i çajej lëkura nga thimthat e insekteve e nga rrezet e pingulta të diellit.

Në dhomën e miqve, në shtëpinë e kryeplakut, ishte freskët. Nga drita e fortë e diellit që ishte jashtë, aty mugëtira dukej blu. Kapteri e mori veten dhe kriza i kaloi. Pas drekës së bollshme nuk ndiente më ligështi. U shtri në dyshekun e trashë e të butë të merrte një sy gjumë. I çuan për të ngrënë edhe xhandarit që ruante fshatarin e lidhur. Madje këtë mendim e dha kapteri: xhandari duhej të hante në sy të të lidhurit. Ai e merrte me mend se sa e mundimshme do të ishte për të të dëgjonte gurgullimën e verës që rrëkëllehej nëpër fytyrën e xhandarit.

Kryeplaku, tagrambledhësi e xhandari tjetër shkuan të bënin kontrollin e bagëtive, që nuk ishin lëshuar në kullotë e të kërcënonin fshatarët që nuk i kishin sjellë tubat nga mali.

Kur u zgjua pas dy orësh, kapteri vajti te dritarja. Ndjeu se po i visheshin sytë dhe po i priteshin këmbët. Kumbulla dhe fshatari i lidhur pas saj ishin zhdukur. U vesh dhe vrapoi si i ndërkryer në kopsht. Xhandari që ruante po gërhiste rrëzë një peme.

Aty ku disa orë më parë ishte kumbulla me

njeriun e lidhur pas trungut të sai, nxinte një gropë e errët. Rreth saj kishte vetëm zhele këmishe, të holluara nga të larët, që i kishte grisur xhandari para se të fillonte tortura. Ajo gropë e errët po e përpinte kapterin si goja e një egërsire të përbindshme që trupin e kishte të fshehur nën tokë. Ai kishte shpresuar se pas qëndrimit të gjatë në diell, fshatari do të thyhej. I shushatur, i dëshpëruar, kapteri rrinte bri gropës së errët si buzë një humnere...

Së largu u dëgjua një ulërimë ngjethëse. Kaq e largët ishte ajo ulërimë, sa të dukej sikur vinte nga qielli. Edhe në të fshihej një ankth, një dhimbje. Jo, dhimbja s'mund të jetë kurrsesi heshtje, mendoi Omeri. Dhimbja është ulërimë. Ulërimë deri në qiell. Ulërimë e paskajshme.

Ata u ngritën nga zjarri dhe vështruan rreth shpellës ku ishin mbyllur kopetë. Drurët shushurinin ngadalë. Dhitë përtyreshin të qeta. Ata u kthyen prapë te zjarri me nga një krah degë të thata.

— Cili po ruan i pari? — tha bariu i moshuar.

— Po ruaj unë, — tha Omeri. — Nuk kam gjumë...

— A mos po të bie ndër mend për kë? — tha bariu me gozhup.

— Paj, s'është hall pa të rënë në mend për dikë! — Omeri u mundua të buzëqeshte.

— E ka kohën t'i bjerë ndër mend për dikë, — tha bariu i moshuar. — Eh, jetë, o jetë, sa e rrejshme paske qenë!

Pranë tyre kaloi një zog i trembur, duke dridhur ajrin me flatra. Atë e përpinë heshtja dhe mugëtira e pyllit.

— E di veten si ky djalë, kur edhe mua më ishte larguar gjumi, — tha bariu i moshuar. — Më ishin

prerë fjalët e buka. Dhe sa i lehtë më dukej vetja!
Jo sikur isha mish e asht, po shkumë tampli.

— A ishte e bukur? — tha bariu me gozhup.

— Për mua ishte e pakurrkushoqe, — tha bariu i moshuar. — Edhe sot më qan zemra për të.

— Pse nuk e more grua? — tha Omeri.

— Ishim prej një fisi. E dhanë në një katund tjetër. Prej malli ia ngjita një qengjëze emrin e saj. Gjithë ditën i thërrisja qengjës nëpër mal, por në të vërtetë i thërrisja asaj... Kanë kaluar gjashtëdhjetë vjet e më duket sikur kjo punë ka ndodhur dje.

— Kurrgjë s'është ieta e njeriut. Rig shiu.

— Bëj çudi me veten time nganjëherë: jetojmë në këtë vend të nëmur, me iu dhimbtë gurit e drurit e prapë jeta të duket e ëmbël!

— Me jetë s'ngihet kush. Njëqind e tridhjetë vjet ka jetuar giyshi im. Kur e pyetën: «Sa t'u dukën?», ka thënë: «Nuk paskan qenë as trembëdhjetë ditë!».

Bariu i moshuar shprushi në zjarr. Gacat e kuqërremta vezulluan ndeztas, mandej pak nga pak u mbuluan me një shtresë të lëbardhme hiri, qefini i tyre. Pas një ore nga ato gaca do të mbetej vetëm hi...

Kështu është edhe jeta e njerëzve, mendonte Omeri. Por dru të tjera do të vihen në ziarr, do të bëhen gaca. Mandej prapë gacat do të bëhen hi. Mandej prapë dru të tjera, gaca, hi. Dru — gaca — hi. E në u fiktë ky ziarr, diku do të ndizen zjarre të tjera. Zjarre të reja. Zjarre pranë të cilave dikush do të mendojë për dikë. Do të rrijë pa gjumë. Do të psherëtiqë. Do t'ia shtrëngojë zemrën malli dhe ajo do të rrahë te brinjët që ulen e ngrihen, sikur pëshpërit pambarimisht një emër të dashur. Omerit i dukej sikur zemra e tij ishte një bari që i thërriste nëpër mal qengjës me emrin e së dashurës. Bardhe, Bardhe! Bardho-o-okë!... Dhe qengjëza blegërinte sa herë që dëgjonte zërin e bariut. Blegërinte e rendte drejt tij.

Lart, mbi malet që rrethonin Gurajën, qielli i yjzuar i ngjante një livadhi me vesë të praruar. Në atë bulëzim yjesh Omerit i dukej sikur ishin edhe sytë e Jeri-

nës. Vetëm sytë e saj... Ajo i kishte lënë sytë atje, për ta parë gjithnjë, për ta ndjekur kudo, për t'i qëndruar mbi krye natë e ditë, natë e ditë. Ai nuk mund t'i shpëtonte atij shikimi më sa edhe atyre yjeve të pamërritshme, që ndizeshin çdo mbrëmje e veniteshin çdo agullim, por nuk shuheshin kurrë.

Edhe unë të shoh ty, Jerinë. Të shoh në ëndrrat e netëve. Në çdo çast të ditës fytyra jote më rri ndër sy si hija e drurëve që rriten buzë Ujëbardhës e pasqyrohen në ujin e saj të qashtë. Ti je në ngrohtësinë e gjakut tim, Jerinë. Je në fërgëllimin e trupit, në heshtjen time, në mendimet e mia. Megjithatë unë e di se ne jemi ndarë përgjithmonë. Diçka na ka ndarë. Përgjithmonë, Jerinë. Vërtet tashti unë jam Guraja pa ujë. Vallë, cila kuçedër të ndau nga unë? Sa kokë kishte kjo kuçedër? A lëshonte për goje flakë të verdhë dhe a nxirrte nga varrët e saj gjak të zi? Jo, ajo nuk nxori gjak të zi, sepse asnjë dragua nuk u përlesh me të. Sepse unë nuk qeshë dragua. Unë qeshë vetëm një marrok, që besoja se nuk do të ndaheshim kurrë. Dhe të prita aq shumë. Të prita në breg të Ujëbardhës që ishte stolisur me vezullime argjendi, siç do të nusëroje ti, me kapuçin me pare, kur të bënim dasmën tonë. Por dasma jonë s'do të bëhet kurrë. Do të ketë vetëm gjëmë tonën. Dasma ime dhe dasma jote do t'i kenë tupanat të shurdhët e fyejt memecë...

Ai u ngrit në këmbë, sepse po e kotullonte gjumi. Bëri disa hapa për t'u shpirë. Diku larg ranë pushkë. Krismat e tyre sikur hapën vrima të thella në trupin blu të natës. Nga shpella ku flinin bagëtitë, vinte herë pas here ndonjë teshtimë a tingull cingareje kur ndonjë dhi kruhej me brirë. Të dy barinj të tjerë flinin të mbështjellë me tallaganët e mëdhenj ku pikëlonte vesa. Shprushi zjarrin dhe vuri në të një trung të thatë e disa degë të holla. U ul në vendin e mëparshëm, kundruall qiellit. Tani ai i ngjante me një vatër të mbushur me prush, që dikush e trazon me një urë dhe nuk e lë të shuhet kurrë, ashtu siç nuk e lënë njerëzit të shuhet zjarrin e vatrave të tyre. Zjarrin që i ngroh e i ndri-

çon. Zjarrin që i mbron nga terri, nga ankthi, nga egërsirat...

Malet e bruzëta, gjigantë të kërrusur që rrethonin vatrën e ndezur të qiellit, ngroheshin në prushnajën e yjeve. Omeri luftonte me gjumin, me kujtimet... Jerinën e kanë fejuar, i kishte thënë tezja që ishte e martuar në Breglum. Ai nuk i mbante mend fjalët e tjera që i kishte thënë tezja. As me kë ishte fejuar, as ku. Jerinën e kishin dhënë, kur ai po e priste buzë Ujëbardhës dhe ajo do të bëhej gruaja e një tjetri. E NJË TJE-TRI!... Megjithëse zemra i ndillte zi edhe më parë, nga ky lajm ishte tronditur si njeriu që përplaset në errësirë pas një shkëmbi. Ishte vrarë, ishte gjakosur. Ishte një gjakderdhje e brendshme, pa plagë. Blanë e mavijhtë, thua i nxirë. Tërë qënia e tij ishte një gulç që nuk shpërthente dot. Një gulç dhimbjeje dhe mllefi.

*Sa i mban lulet një qershi,
Aq kohë dada s't'harron ty...*

Por ai e dinte se Jerina nuk do ta harronte kurrë. Qershitë do të lulëzonin e do t'i shkundnin lulet e tyre vit për vit. Jerina do të shikonte lulet e rrëzuara dhe në fytyrë do t'i rrëzoheshin pika loti, të bardha si ato lule.

Ditët e para ishte munduar ta harronte. Ose, së paku, të mos mendonte për të. Por pikërisht nga kjo gjë kujtimi i saj e përndiqte, e sfiliste; e trazonte më shumë. Ishte hakmarrja e Jerinës që gjëllinte në qenien e tij, që ishte bërë pjesë e vetvetes. Në shtëpi hynte e dilte si hije. Nuk mund të fliste me asnjëri. Ishte gëzuar, kur i kishin thënë të mos kthehej në fshat, ngaqë kishte ardhur tagrambledhësi. Të rrinte në pyll, larg Gurajës, larg njerëzve, të shprushte kujtimet për Jerinën, ja, si këtë zjarr nën qiell të hapur, të...

Njëri nga tallaganët lëvizi dhe u hap. Bariu i moshuar u çua më këmbë

— M'u bë nëpër gjumë sikur ranë pushkë.

— Po... Krismat erdhën nga Guraja:

- Do të jetë vrarë kush për gjak.
- Ndoshta kanë shtënë mbi xhandarët.
- A thua?
- Paj, kështu do të ishte mirë...
- Po, po... Kështu do të ishte mirë e mbarë. Por Guraja dhe e mbara rrinë larg e larg sa toka qiellit.
- Vend i nëmur.
- Njerëz të nëmur... Bjer e fli.
- Po bie... Veç s'di a do të më marrë gjumi.
- Përpiqu të flesh me zor. Kushedi edhe sa kohë do të mbetemi në mal...
- Si u mbështoll me tallagan, Omeri u shtri anës zjarrit, pranë bariut tjetër që po flinte.

Arratisja e Zog Buzhetës që edhe për Gurajën një rrufe për së kthjellëti. Ajo u deh me këtë ngjarje, si të kishte pirë njëherësh verën e dhjetë vjetëve. Fantazia e saj u bë më pjellore se kurrë... Legjendat gufën gjithandej si bari i harlisur pas shirave pranverore.

Në këto çaste gurajasit e ndienin veten Zog Buzhetë, ishin vetë Zog Buzheta i përfytyrimeve të tyre, Zog Buzheta i mitizuar dhe jo banorë të zakonshëm të një fshati që terrorizohej nga thatësira dhe nga shteti.

Shteti donte t'u rrëmbente currilin e hollë e të bardhë të qumështit. Ta shterte atë curril. Por shterja e atij currili do të thoshte shterja e currilit të qumështit në gjinjte e grave. Do të thoshte fytyra të rrëgjua foshnjash si arat e Gurajës pa ujë.

Në sy të tyre shteti ishte një thithlopë e stërmadhe, një qenie ogurzezë, kusare, e pashpirt. Ishte një djegagur i pamëshirshëm. Kaq e fortë ishte kjo ndjenjë, saqë edhe ngjyra e artë e gradave fshatarëve u dukej si një copë dielli përvëlues. Ishte përvëlimi i shtetit,

të cilit i binte në mend se Guraja gjendej diku brenda kufijve të tij vetëm kur mblidheshin taksat.

Qëndresa gjatë torturës dhe arratisja e Zog Buzhetës zgjuan krenarinë e nëpërkëmbur nga dhuna e operacioneve ndëshkimore, nga rrahjet, burgimet dhe vrasjet e Batalionit Shëtitës. Në vetëdijen e tyre bëri majë, si ai kërcelli i farës së porsambirë, mendimi se ata mund ta sfidonin edhe shtetin, edhe ushtrinë e mbretit, se mund të mateshin me të keqen.

Kapteri e kuptoi se kjo ngjarje i kishte kushtuar shumë. Vendosi të vepronte me ngut, ndryshe nga ç'e kishte pasur zakon. Duhej të pengonte me çdo kusht ngjalljen e kundërshtimit në Gurajë. Ai e dinte se Guraja ishte një ndër fshatrat e fundme që ishte shkelur nga ushtria e mbretit dhe asnjëherë nuk kishte qenë e qetë.

Pasi kërkoi ndihma nga nënprefektura, kapteri u nis maleve me xhandarët e me disa fshatarë që kishin armë me leje dhe ishin besnikë të mbretit. Ai përpiquej të kapte barinjte dhe tubat e fshehura, por synimi kryesor ishte të gjurmonte, të zinte gjallë ose të vriste Zog Buzhetën. Ta asgjësonte atë që të çlirohej nga ajo dobësi dhe nga ai vocërrim i vetvetes. Pas Zog Buzhetës, do t'i vinte radha Gurajës. Fëmijët e saj do të ulërinin për një pikë qumësht dhe nënat e tyre do t'i kryeshtroheshin e do t'i luteshin atij, gjykatësit të jetës e të vdekjes së tyre, si zotit...

Omeri u zgjua trembshëm nga britma të forta, të cilat vinin nga një shpat përbri malit ku gjendej shpella e tyre.

— U ka rënë ujku, — tha bariu i moshuar.

Britmat vazhduan gjatë. I hipur mbi një shkëmb, Omeri ndiqte me sy urët e ndezura, me të cilat barinjte

gjuanin egërsirat. Ato bënin një hark të ndritur në errë-sirë si yje që digjen.

Kur menë britmat, qielli kishte filluar të lëbardhej nga drita e paraagullimit. Omerit nuk i flihej më. E kishte kokën plot me ato britma të largëta, rrëqethëse dhe me vazhdat e urëve të ndezura. Britmat dhe vazhdat e zjarrta ndërlikseshin me njëra-tjetrën në përfytyrimet e tij dhe atëherë i dukej sikur britmat ishin prej zjarri, apo sikur urët ishin britma që linin prapa tyre një hulli të përflakur...

U gdhi. Barinjte donin të dinin se ç'kishte ngjarë atë natë te shpella përbri tyre.

— Po shkoj të shoh ç'ka ndodhur, — tha Omeri.

— Mirë, por mos u vono, — tha bariu i moshuar.

Omeri thithte ajrin e freskët të ahishtës që po shpërgjumej ngadalë. Më të rrallë dëgjohej ndonjë cicërimë zogu. Rrezet rridhnin përmes degëve të kapërthurura të aheve si qumështi që hidhet në kullojsë. Gjethet dridheshin nga puhia e mëngjesit dhe toka rreth trungjeve mbështillëj me një valëzim të pambaruar dritëhijesh. Omerit i dukej jo sikur, po ecte nëpër pyll, por sikur po truponte në liqen të valëzuar, të mrekullishëm. Dhe pyeste veten: Pse të ketë pabesi? Pse të ketë dhi- mbje? Pse të ketë ujç? Pse të ketë xhandarë?...

Dëgjoi blegërima. Nxitoi drejt tyre.

Barinjte i kishin nxjerrë kopetë nga shpella dhe po mundoheshin t'i qetësonin. Nga sytë e barinjve, Omeri e kuptoi se dëmi ishte i madh. U përshëndet me ta.

— Ujqit hynë nëpër një grykë të fshehtë që nuk e dinim, — i tha një bari.

Në shpellë kishte pellgje e hulli gjaku, bagëti të mbytura: të shqyera në bark, në ije, në qafë.

— Ploja është bërë! — tha bariu. — Edhe kaq i kanë mbytur e i kanë lëshuar nëpër pyll. T'i dëgjoje blegërimat e ulërimat e mbrëmshme, të ngjethej mishtë.

— Më mirë kështu, sesa në duar të tagrambledhë-sit! — tha një bari tjetër.

Omeri ndenji me ta një copë herë, mandej u kthye te shokët dhe u tregoi ato që pa te shpella.

— Hallall bishës së malit, por jo taksidarit! — tha bariu i moshuar.

— Kështu thanë edhe ata, — tha Omeri. — Një bariu i kishin mbetur nga tuba vetëm tetë dhi.

— Do t'i japim nga tubët tona, — tha bariu i moshuar. — A i the kështu?

— Nuk më ra ndër mend kjo gjë, — tha Omeri...

Hoqën drurët që i kishin vënë kryq e tërthor te hyrja e shpellës dhe i nxorën dhitë jashtë. Omerin nuk e gëzoi si herët e tjera ajo muzikë gazmore prej blegërimash e tringëllimash që mbushi pyllin. Atë gëzim e pengonin gurët e përgjakur, dhitë e shqyera nga ujtit në truallin e shpellës dhe midis drurëve të pyllit në shpatin përbri.

Dielli ishte çuar nja dy pushkë të gjata. Papritmas nga fundi i luginës u ngjit përpjetë një vikamë e fortë:

— O, ikni se po vijnë xhandarët, moreee!

Mu në këtë çast xhandarët dolën nga pylli dhe u dukën në fund të shpatit ku po kullotnin tubat e dhive.

— Grahuni dhive përpjetë, se unë po i pengoj sa të mundem, — tha Omeri...

Ai shkulte gurë gjithë mllef dhe i lëshonte rrokullimthi drejt xhandarëve. Ishte e pamundur të ngjiteshe lart, sepse gurët që rrokulliste Omeri merrnin me vete dhjetëra gurë të tjerë. Kur xhandarët pushonin së shtëni, dilnin që prapa trungjeve e fillonin të ngjiteshin përpjetë, ai lëshonte teposhtë një ortek të ri gurësh. Me ata gurë sikur rrokulliste urrejtjen e Gurajës. Duart iu gërvishtën në dy-tri vende, por ai as që i ndiente të gërvishturat...

Tashmë shokët ishin larguar bukur shumë. U përvodh prapa shkrepit dhe ngau drejt tyre, që të mos i humbisnin nga sytë.

Vargani i dhive po kalonte nëpër një rrëpirë të rrezikshme. Omeri u ndal për t'u mbushur me frymë. Ishte me sy në të, kur bariut të moshuar iu shkul guri poshtë këmbës. Ai shkau rrëpirës së thiktë dhe ra në

humnerën e thellë, i ndjekur nga një rropamë e gjëmshme gurësh.

Vetëm copërat do t'i gjenden! — mendoj Omeri me tmerr. — Vetëm copërat... Në rrëpirë nxinte tallagani i errët. Kurse bariu plak nuk kishte më as trup, as fytyrë, as zë. Vetëm copëra do të mbeteshin prej tij. Vetëm kujtimi dhe një emër.

Omerit iu kujtua e ëma. Fytyra e saj e përvuajtur. Zëri i saj i ëmbël, i pikëlluar. Zë i ngrohtë e i përmallshëm si gjiri i nënës.

*Në ujë rafsh, mos u mbytsh,
Shkambit shkofsh, mos u rrëzofsh!...*

Edhe bariut plak do t'i ketë kënduar kështu e ëma, mendonte Omeri. Ai i ka dëgjuar ato fjalë dhe është strukur në gjirin e saj. Kurse tashti është në fund të rrëpirës, në humnerën e errët. Pa zë e pa trup. Një mori copërash të përgjakura... Ah, sikur të mund t'i bëja copë-copë këto bjeshkë e t'i rrokullisja mbi kokat e xhandarëve! Mbi kokën e të gjithë atyre që i bien në qafë Gurajës së thatë! Që duan t'ia grabitin edhe currilin e hollë të qumështit që e mban gjallë!....

Këmbët e kapter Seferit ishin bërë flluska-flluska. Ai kafshonte buzët e gulçonte, por as që mendonte për t'u ndalur, për t'u çlodhur. Pas tij xhandarët dihatnin si qe të rraskapitur, duke fshirë djersët herë me trinën e dorës, herë me shamitë e lerosura. E vështronin me ankth kapterin, duke pritur që t'u thoshte: Hajt të ulemi te kjo lëndinë, a të pushojmë te kjo bregore, a të freskohemi një copë herë te ky burim. Por këso fjalësh nuk dilnin nga buzët e tij që heshtnin si të

ishin buzë të vdekuri. Kapteri ecte e ecte përpara tyre si i dalldisur, si i përhenur.

Duke parë sytë e tij që digjeshin si në ethe dhe shkumën e bardhë në anë të buzëve, trembeshin se mos kapteri kishte shkalluar, sepse vetëm i çmenduri mund të rendë ashtu. Megjithatë nuk guxonin t'i flisnin, t'i kërkonin pushim, t'ia prishnin atë heshtje të veçantë që e rrethonte.

Kishte disa ditë që po ravgonin nëpër ato shpate e gryka nga mëngjesi në darkë. Bënin një pushim të shkurtër në mesditë, sa për të ngrënë bukë. Ende pa fshirë mirë mustaqet, kapteri turrej përpara.

Megjithatë nuk kishin zënë as Zog Buzhetën e asnjë bari a tubë të fshehur. Sapo binin në gjurmë të tyre dhe hë-hë po u afroheshin, një vikamë, sikur shpërthente nga toka, jepte kushtrimin:

— O, ikni, se po vijnë xhandarët, morreee!

Kapteri bëhej helm e vrer. Këqyrte andej-këndej me sy të çakarritur nga inati për të dalluar njeriun e padokshëm. Askush Asnjë lëvizje. Shtrengonte revolen në dorë, por kë të qëllonte? A mund të qëllonte atë zë misterioz? A duhej të qëllonte në tym? Jo, një shtet (dhe ai ishte mishërimi i tij) nuk duhej të qëllonte në tym, sepse do të bëhej qesharak.

— O, ikni, se po vijnë xhandarët, moreee!

Zëri që sokëllinte ishte zëri i Zog Buzhetës. Atë ditë, gjatë «torturës së mjaltit», Zog Buzheta e kishte tërbuar me heshtjen e tij, tani po e çmendte me këtë vikamë.

Zog Buzheta mund ta vriste pa vështirësi që prapa një shkëmbi e trangu të zgavruar njeriun që mishëronte shtetin, shpikësin e «torturës së mjaltit». Por kapteri i kishte një borxh të madh. Një borxh që duhej larë. Ai duhej të paguante për «torturën e mjaltit».

Dhe Zog Buzhetës i kishte ardhur në mend një ngjarje që kishte ndodhur shumë vite të shkuara në Gurajë. Një bari kishte kapur në kurth një ujk. Nuk e kishte vrarë, por kishte marrë një sferk e ia kishte vënë në qafë, që të mos e kafshonte. Kishte gjetur një

këmborë, ia kishte lidhur me tel në qafë dhe e kishte lëshuar ujkun nga çarku. Me atë këmborë në qafë që oshëtinte sa dëgjohej një orë larg, ujku ishte endur andej-këndej, pa mundur t'u afrohej kopeve a të gjente diçka për të ngrënë. Edhe ujqit e tjerë largoheshin të tmerruar prej tij. Më vonë ujkun me këmborë e kishin gjetur të ngordhur në një shpellë.

Zog Buzheta donte që edhe kapteri të ngordhte nga tërbimi si ujku me këmborë. E ndiqte këmba-këmbës me atë vikamë sokëllitëse, të beftë. Kapteri e dinte mirë se kush ishte ai që thërriste, por ec e gjeje ku ishte fshehur! Pas cilit gur e pas cilit trung?! Në cilën shpellë a në cilën zgavër?! Sa shumë gurë ka në këto anë! — mendonte ai me tmerr. — Gurë dhe shpella të panumërta. Ah, Gurajë, Gurajë e mallkuar!.... Gurët e tu mund të më bëhen gurë varri, por unë edhe nga varri do të ngrihem të të bëj zap!...

I parruar, i djersirë, i pluhurosur, me krodha shku-me të tharë te buzët, me uniformë të ndotur e të zhubravitur, kapteri kacavarej nëpër bjeshkët e thepisura të Gurajës, i ndjekur nga xhandarët që mezi zvarriteshin pas tij. Tani, me të dëgjuar sokëllimën, kapteri shtinte me revole majtas, djathtas, mbi gurë, mbi trun-gje, ku t'ia hante mendja se mund të fshihej armiku i shtetit...

Ndoshta është çmendur, tha me vete Zog Buzheta. Ka rrezik të vrasë ndonjë bari a ndonjë druvar. Mbështeti pushkën në bigën e një panje dhe shënoi në kokën e kapterit, i cili u plandos përtokë pa bërë oh as uh. Ishte një vdekje memece, fundi i një agonie të shurdhët. Xhandarët u përvodhën midis kaçubave dhe zbritën nga mali të zbehur, me një pikë shpirt.

Zog Buzheta iu afrua kapterit që dergjej mbi disa gurë gëlqerorë, ku kishte rënë fare pak gjak. Me këtë vdekje të shurdhët, pa gjak, ai mishëronte thatësisën e shtetit, të atij shteti me të cilin e kishte njëshmuar veten deri në çastin e fundit. Një njollë të vogël gjaku lënë prapa edhe brejtësit e vvarë. Dhëmbët kata-

roshë të kapterit nuk do të gërvinin, nuk do të kërkëllinin më. Duke parë atë trup pa jetë, mëllëri i ashpër në fytin e Zog Buzhetës u zbut, u zvogëlua.

Nëpër shpatet e maleve s'kishte më asnjë larë bore. Të gjitha tubat ishin ngjitur në bjeshkë. Me përjashtim të besnikëve të regjimit, gurajasit kishin vendosur të dilnin kaçakë, por të mos pranonin të shkruanin bagëtitë e të paguanin taksa.

Xhandarët bënë çmos për t'i kapur në befasi, por edhe fshatarët kishin marrë masat e tyre: nëpër udhëkryqe e shtigje të dyshimta përgjonin vazhdimisht pleq të lekosur, që s'i hiqnin nga goja çibukët me bisht të gjatë prej shqemeje. Me të vënë re xhandarët, pleqtë lajmëronin shtëpinë më të afërt. Me anë të disa shenjave — secila lagje kishte shenjat e veta — brenda disa minutash njoftoheshin të gjitha shtëpitë e Gurajës.

Duke ndjekur fshatarët, ata nuk harronin për asnjë çast Zog Buzhetën. Pagan njerëz për ta gjurmuar. E rrethuan dy herë, por Zog Buzheta shpëtoi pa i hyrë ferrë në këmbë, ndërsa u vra një xhandar, u shituan tre-katër të tjerë. Gurajasve u bëhej zemra mal. S'po munden ta zënë më sa plaku pleshtin! — thoshin dhe ia shkrepnin gazit....

Sytë e ftohtë prej gjarpri të nënprefektit u picërruan. Ata dukeshin si të ngrirë. Krejt sy gjarpri, që mbliidhet kutullaç në kaçubë e hiqet sikur fle.

Mbreti po bën reforma, tha me vete nënprefekti.

Ai ka në mend ta bëjë Evropë vendin tonë të humbur. Sigurisht ngatërresat me fshatarët nuk do t'i pëlqenin në këto çaste bamirësie, ngazëllimi, kur populli po shijon dhuratat bujare të sovranit të vet. Këto ngatërresa do të ishin bëzhdile në dollitë e hareshme, fatlume të këtyre ditëve...

Ai i fshiku me sy tërë ata tituj me germa të mëdha, që mbushnin gazetatat, ku ishin shpallur reformat e reja, që premtinin qytetërim, begati e zhvillim. Në veshë i tringëllinin krisma qelqesh. Qelqesh që trokiten e qelqesh të thyera. Atij i dukej sikur të gjitha ditët që do të kalonte në këtë nënprefekturë skajore të shtetit, ishin qelqe të thyera.

Unë do të jap urdhër që xhandarët të tërhiqen, por ti, Gurajë, do ta paguash shtrenjtë rebelimin tënd. Do ta gjej mënyrën që ti të paguash, të gjunjëzohesh dhe mbreti të mos zemërohet. Do të mbetesh jo vetëm pa ujë e pa qumësht, por edhe pa gjak. Të rëntë mbi kokë zjarri i skëtërrës!

Omeri ua la tubën shokëve dhe zbriti në vërri për të marrë miell. Sa më tepër që u afrohej shtëpive të fshatit, i dukej sikur po shkonte drejt një furre ku piqej gëlqere.

Qielli veror, saç i nxehtë; toka e përtharë, çerep i skuqur. Kështu ishte Guraja atë ditë. Në të gjitha ditët e asaj vere. Puset që kishte hapur Murat Gjoka lëshonin një erë të rëndë uji të ndenjtur. Ishte e pamundur ta futje në gojë atë ujë, llurbë e nxehtë. Prroskat ishin shterur. Vetëm aty-këtu kishte mbetur ndonjë fund pellgu, që s'ishte avulluar ende. Edhe në këto pellgje uji nuk dukej, ngaqë ishte mbuluar me një shtresë të verdhëmtë lëmashku. Në të çarat e asaj shtrese lëviznin larvat e zeza të bretkosave. Së shpejti

ato fulterëza të grumbulluara kokë më kokë do të ngordhnin bashkë me vdekjen e pellgut. Lëmashku ngjyrë vreri do të përthahej dhe lymërishtja do të pritej rriska-rriska si një pite. Dikur Omerit i pëlqente të ecte mbi ato petëza balte që thyheshin e bënin krrap-krrap nën këmbë.

Nga të katër anët buçiste kënga e gjinkallave. Ishte një zhurmë dridhëse, monotone, e bezdisshme. Një kujë mortore si kuja e grave të Gurajës, kur qanin mbi të vdekurit. Një kujë që të shurdhonte veshët e të futej deri në eshtra. Ndoshta për të mos dëgjuar këtë klithmë gjinkallash, burrat e Gurajës i mbështillnin veshët me shami të zeza a të kuqe...

Kur mbërriti te shtëpia e parë e lagjes së tij, Omeri u ndal pranë gardhit të fliste me fshatarin që po rrinte në krye të arës e po shihte bimët e fishkura. Para dy javësh ai fshatar ecte këmbëzbathur midis rreshtave të misrit, duke shkukur barishtet e këqija a ndonjë bimë të tepërt. Sa qetësi e kënaqësi kishte atëherë në fytyrën e tij! Tani ajo fytyrë ishte e zbërdhylur, e topitur, e zhuritur si ajo mesditë vere, si ara që po jepte shpirt.

Fshatari vuri dorën si strehë dhe vështroi lart: diell, vetëm diell dhe asnjë cukël reje! Kurrë s'kishte të mbaruar ajo ditë! Kurrë s'do të perëndonte ai diell!...

— Puna e mbrapshtë të qoftë, more diell, shumë kobin e bëre sot në këtë arë! A po i merr opingat e mia e ec pak më shpejt?!...

Omeri u largua menjëherë nga gardhi dhe vazhdoi rrugën, duke ecur me kujdes, që të mos bënte zhurmë. Nuk donte që fshatari ta merrte vesh se e kishte dëgjuar dikush, kur po fliste me diellin. Ai e dinte se, kur njeriu flet me vetveten, i ka ngjarë diçka e rëndë, i janë mbyllur të gjitha shtigjet.

Plepi në oborr të shtëpisë dukej si i ngrirë. Nuk i lëvizte asnjë fletë. Ngjante më tepër me heje akulli se me një dru. Omeri pati përshtypjen se, po ta qëllonte me diçka të rëndë, plepi do të këputej e do të

thërrmohej në oborr si akujt e gjatë të strehëve, që i thyente në dimër.

Në pluhurin e oborrit pulat kishin mihur gropa të vogla dhe ishin fshehur në to që të preknin me trup thellësinë e tokës, ku ishte disi më freskët. Ato as që lëvizën nga vendi, kur Omeri kaloi midis tyre. Atij iu duk sikur ato pula të pluhurosura e me pendë të shpupurisura po kllloçitnin vapën e asaj dite, që nesër do të çelte dhjetëra zogj të tjerë. Zogj me sqepa të zjarrtë, që do të çukisnin trupin e Gurajës...

Pasi e pyeti për bagëtinë e për kullotën e bjeshkës, i ati i tha:

— Po na merr zhegu, bir!

Edhe kjo ishte një shprehje që e përdornin vetëm gurajasit. Ata thoshin: «e mori zhegu», siç thoshin në raste të tjera: «e mori lumi», «e mori orteku», «e mori vdekja». Zhegu ishte i llahtarshëm e i papërballueshëm si vërshimi i ujërave, si orteku që rrokulliset nga mali, si vdekja.

Kur e pa aq të pikëlluar, Omerit i erdhi keq për t'atin. Iu duk më njerëzor, më i afërm se asnjëherë. E kishte hequr atë zhguallin e vrazhdësisë e të ftohtësisë së zakonshme. I erdhi ta përçafonte, por e ndrydhi këtë ndjenjë, sepse këtë gjë nuk e kishte bërë që i vogël.

I ra në sy diçka e re edhe në vështrimin e t'et. Me siguri do t'i thoshte diçka të rëndësishme. Mos kishte marrë vesh gjë për punën e tij me Jerinën?! U drodh lehtë. Por Jerina tashti ishte e fejuar. Ata ishin si të paqenë për njëri-tjetrin. Mandej vështrimi i t'et ishte edhe miklues...

Pasi hëngrën bukë, Demushi drodhi një cigare me duhan të ri, të tharë e të shkërmoqur me dorë.

— Në mos rëntë shi, s'do të hyjmë me drapër në dorë në arat tona sivjet, — tha ai.

— Në mos rëntë shi, do të sjellë ujë Murat Gjoka!
— tha Omeri.

Shikimi i t'et u bë më i përvuajtur.

— Me zotin nuk lufton kush!

— Por, ai ka thënë se do të ngjallë Përroin e Thatë...

— S'është çudi dhe e ngjall, more bir, por jo për këto të korra.... Këto të korra po shkrumbohen.

Një brumbull ngjyrë smeraldi u fut në kthinë. Përplasej në mur e rrëzohej përdhe, duke lëshuar një zukamë vërshëlyese.

— Por unë kam një hall tjetër, — vazhdoi Demushi.

— Kam hallin tënd.

-- Hallin tim?

— Po, bir. Ka ardhur koha të martohesh. Një mik më ka çuar fjalë se më ka gjetur një vajzë të mirë...

Omeri dëgjonte pa bëzajtur. I dukej sikur po flitej për njeri tjetër e jo pikërisht për atë. Martesa pa Jerinën nuse ishte e papërfytyrueshme dhe pa kup-tim. Megjithatë nuk kundërshtoi, nuk foli fare. Pse, po të fliste, do të kundërshtonte dhe do të pikëllonte t'atin. Ai nuk donte ta shihte edhe më të pikëlluar sesa ishte.

I ati nuk u shty shumë në këtë bisedë dhe Omeri u qetësua.

Ai vajti te kumbulla verore të merrte disa kokrra. Mbi barin që po çngjyrorej nga thatësira e po kalonte nga e gjelbra e çelët në të hirtë, kishte me dhjetëra kumbulla të rrëzuara, të krimbura, të qullojura. Nëpër degët kishin mbetur fare pak kokrra, por edhe ato ishin të flashkëta. Iu kujtua pamja e kumbullës së lulëzuar. Para disa muajsh kishte ëndërruar nën të për Jerinën. Rrezet e hënës e mbështillnin me një flurorë bardhullorë. Kur frynte flladi dhe ia tundte degët ngadalë, si me druajtje, ai trembej se mos pema flurore, e papeshtë, do të ngrihej në ajër e do të zhdukej në qiell duke e lënë të vetmuar, të shtangur nga habia, nën atë natë të hënëzuar.

Nuk këputi asnjë kokërr dhe u kthye në shtëpi. Megjithatë era e thartë e kumbullave të rrëzuara, të kalbura, nuk iu nda. Ishte erë e prishjes, erë lëngate...

E ndihmoi t'atin të hidhte miellin në trastë. I

dukej sikur nuk do të vinte kurrë ai çast, kur do të shpëtonte nga ajo grafmë, nga ajo përzhitje e Gurajës që lëngonte dhe s'mund ta shpëtonte askush. Zhuritja e tokës, e pemëve, e bimëve dhe e barit futej thellë në qenien e tij. Kjo zhuritje nuk do të largohej plotësisht prej tij, as kur të ngjitej në bjeshkë e të mblidhte në grusht currilat e ortekut.

Kur ra hëna, ata u drithëruan si faqja e ujërave që i fshik një pui e lehtë. Kishin ecur me nxit, prandaj ishin larë në djersë. Kishin shpresuar ta kapërcenin kufirin pa dalë hëna. Tani ishin së paku një gjysmë ore larg tij. Hëna nuk do të perëndonte deri në mëngjes. Mandej do të agonte dielli. Të ndaleshin në atë vend, në atë bokërrimë të zhveshur, ku kishte vetëm disa dëllinja të vetmuara, ishte edhe më e rrezikshme sesa të ecnin.

E larë në dritë hëne, bokërrima dukej si e mbuluar me një breshnizë të praruar e të rrëshqitshme. Tamam si ato shpatet në dimër, kur mbi shtresën e trashë të borës bie një rig shi dhe fill pas tij ia beh cingërima. U bëhej sikur do të rrëshqisnin befaz në atë hapësirë vezullimtare e do të gremiseshin në fund të saj, në një hon të errët...

Nata ishte e qetë, e vakët. Megjithatë pikërisht në heshtjen e saj fshihej gjëma. Fshiheshin ato krisma të papritura e të pabesa, që mund t'ua gozhdonin jetën (por edhe vdekjen!) në atë bokërrimë ku rriteshin vetëm dëllinja si krifa të blerta të një bishe të kërleshur.

Në ato boka rrëzë kufirit «shumë vetë i kishin lënë zorrët», siç thuhej në Gurajë. I ngulur padrejtësisht e përdhunisht nga Fuqitë e Mëdha në mes të tokave shqiptare, ai kufi i ndante Gurajën dhe të gji-

tha fshatrat e atyre viseve nga tregu i tyre, ku kishin shitur e kishin blerë djalë mbas djali. Më parë në atë treg kishin marrë drithëra, armë, petka e stolira për nuset. Po tani në ato boka me dëllinja ishte ngulur kufiri dhe ruanin natë e ditë ushtarët e huaj. Gurët e bardhë të kufirit u dukeshin fshatarëve si gurë varresh.

Vit për vit fshatarët kapërcenin kufirin që të blinin misër në tregun e qytetit ku kishin të afërm e të njohur që mund t'i ndihmonin. Dhe vit për vit dikush «i linte zorrët» midis dëllinjave të kreshpëruara. Për t'u futur tmerrin fshatarëve, por edhe të shtyrë nga dëshira për të qëlluar, ushtarët e huaj shtinin përnatë mbi kurrizet e kërrusura të bokave. Plumbat e tyre përplaseshin pas gurëve, nguleshin në dheun e paktë e nganjëherë edhe në mish njeriu. Rrënjët e dëllinjave pinin gjak të kuq e të ngrohtë. Megjithatë nuk mungonin kurrë ata që kapërcenin kufirin menjëherë pas gjëmës, sepse, siç thoshin gurajasit kur qanin hallet me njëri-tjetrin, «çka ta bën barku, s'ta bën laku!» dhe «buka e fëmijëve të shtie gjallë në dhë». Duke u përvjedhur midis dëllinjave me thes të zbrazët a të përthekuar, secili mendonte se do të ishte me fat, se nuk do të diktohej e do të kthehej shëndoshë e mirë te fëmijët e vet. Kështu zhvillohej një dyluftim rrëqethës midis urisë dhe frikës së vdekjes, midis shpresës dhe plumbave të verbër të kufitarëve...

Duke parë se plumbat nuk po i pengonin dot fshatarët e uritur që kalonin në kufi, mbretëria e huaj kishte vënë në përdorim edhe një mjet tjetër, më të rrezikshëm e më të frikshëm: minat. Ushtarët kishin minuar të gjitha qafat dhe shtigjet afër kufirit.

Qotësia e natës trazohej vetëm nga dihatjet e dy burrave të ngarkuar dhe nga zhurma e guralecëve që shkisnin poshtë opingave të tyre. Hëna, bukë çerepi prej misri të verdhë, si ai që kishin në kurriz, lëshonte në sofrën e qiellit avull të praruar.

Të shtëna të befta çanë ajrin. Nata fërgëlloi nga thikat e mprehta që u ngulën në trupin e saj. Rama

u rrëzua përtokë. Edhe Cungeli u shtri pas një dëllinje të madhe.

— Ramë, mos rri aty! Dukesh në dritë të hënës.

— Nuk mund të lëviziz.... jam shituar.

Cungeli hoqi litarët e thesit nga krahët dhe iu afrua Ramës duke u hequr zvarrë.

— Ku të ka marrë pushka?

— Në këmbë.

Pasi e ndihmoi të shkarkonte thesin, Cungeli e tërhoqi Ramën te dëllinja. Mandej mori edhe thesin dhe e vuri nën dëllinjë, pranë thesit të vet.

— Çka po bën?

— Po i fshih. Do të të nxjerr ty matanë, mandej do të vij të marr thasët.

— Do të marrësh thasët?!

— Nesër mbrëma.

— Në qofshim gjallë deri atëherë...

Cungeli nuk iu përgjigj. E mori të plagosurin mbi shpatulla si duaj dhe eci deri te dëllinja tjetër. Duke kaluar dëllinjë më dëllinjë, bënë një copë rrugë. Kufitarët shtinë përsëri, por kësaj here plumbat ranë në një shpat tjetër.

Ata pushuan pak, mandej u nisën prapë. Në krah të majtë ishte një përrua i vogël, i tharë. Kur zbritën në shtratin e tij, sikur arritën në shtëpi. Tani Cungeli e mbante Ramën për krah. Nëpër atë shtrat kaluan kufirin dhe u ndalën te një grumbull lisash. Në horizont përvijoheshin kreshtat e dhëmbëzuara të maleve si nofulla të gurta. Të dukej sikur ato nofulla kresh-tash zgjatëshin në qiell për të kafshuar hënën e rru-mbullakët si bukë e verdhë misri. Rrëzë atyre kreshtave ishte Guraja.

— E dija se nuk do të shpëtoja shëndoshë, — tha Rama.

— Pse? — tha Cungeli.

— «Pashë gjirin që të kam dhënë, mos u nis për këtë rrugë!» më tha nëna. Unë nuk e dëgjova dhe u nisa.

— Varra nuk është e rëndë, — tha Cungeli, që po i vinte në plagë duhanin e kutisë. — Mund të ishim ndarë edhe më keq...

E ndiqte me sy ujin e paktë që dredhonte nëpër vijën e plasaritur nga të nxehtët, sikur donte t'i jepte zemër, ta nxiste. Hë dhe pak!... Hë dhe pak!... — pëshpëriste me vete, duke vështruar herë pas here arën e tij e duke matur me sy largësinë që kishte mbetur. Dhe uji hiqej zvarrë ngadalë-ngadalë si një bollë e stërgjatë, e kuqërremtë, e plagosur rëndë. Zvarritej me barkun e butë, duke kapërcyer me vështirësi të çarat që donin ta pengonin. Dheu i zhuritur shushurinte si metali i nxehur kur i japin ujë.

Më në fund ujët mbërriti në krye të arës. Demushi ia sheshoi udhën me shat, që të shkonte te bimët. Në ajër u përhap një erë e amësht, e rëndë. Ishte hukama e arës së shkruar që po lëmekej nga etja. Ndoshta kjo është toka më e etur në botë, — mendonte Demushi. — Kurrë s'na ka ngopur me bukë. Ajo hakmerret ndaj nesh për etjen e saj. Por ne edhe kështu e duam. Vuajmë bashkë me të. Nuk mund të shkulemi prej saj e t'ia kthejmë shpinën. Po ta bënim këtë gjë, do të ishim si bimët e shkulura që shumë zor zënë rrënjë në një vend tjetër.

Demushi u binte me shat plisave, megjithatë uji nuk ecte. Dheu i kuqërremtë e thëthinte me grykësi atë lëng të përbaltur e të nxehtë, që mbase i përvëlonte edhe më keq rrënjët e misrit. Mirëpo Demushi nuk mund ta braktiste atë rrëkezë uji, qoftë edhe ashtu të përbaltur e të nxehtë. Hiqte gurët e vegjël, copëtonte basat e dheut, ngjishte baltën me shuplakën e shatit deri te rrënja e bimës.

Misri po lidhte kokërr. Demushi e dinte se nga

kjo ujitje varej buka e një viti. Në sy iu përhi magjja e zbrazët. Magjja si një varr i zbrazët, i errët, që pret dikë...

Tani dielli kishte hipur në zverkun e tij. I hante trupi nga djersa dhe nga pjalmi i verdhë i kallëzave të misrit, që i futej nga qafa dhe të çarat e këmishës së vjetër. Në gojë kishte një shije finje: edhe nga të pangrënët, edhe nga hidhërimi.

Uji i përbaltur po nxirrte shkumë nga nxehtësia e madhe si i sëmuri me ethe të forta. I dëshpëruar, fshatari u mbështet në bisht të shatit dhe rroku arën me sy. Përpara asaj thatësire përcëllimtare, e ndiente veten të pafuqishëm si një thnegël. Aty, në sy të tij, po thahej ara e tij e blertë, ajo nuse e hijshme, e stolisur me xhufka të praruara e me tufa ngjyrë vishnje. Po digjeshin të korrat e tij, buka e tij. Dhe ai nuk mund të ndalonte këtë gjë, nuk mundej...

Nuk ecën më! Nuk ecën... Nuk ecën... Kjo britmë, ku përziheshin ankimi dhe zemërimi, i drejtohej arës, diellit, askujt. Demushi vuri shatin në sup dhe doli nga ara. Me atë ujë të paktë nuk mund të ujiste më. Do ta hidhte në pus, që t'i përdorte natën ujët e rrëkesë dhe ujët e pusit njëherësh.

Mbylli vrimën e pusit me kujdes, e puthiti me këmbë plisin që zinte vrimën dhe u nis për në shtëpi. Shputat e zbathura i digjnin sikur të ishte duke ecur mbi shpuzë të nxehtë. Dikush i thirri në emër. Ishte Kingji. Shkoi e u ul pranë tij, nën hijen e një kumbulle vjeshtore. Kingji i dha kutinë. Demushi zuri të dridhte një cigare.

- Shumë të mërzhitur po të shoh.
- Po të më kafshojë gjarpri i bokës, e helmoj!
- Burri duhet të bëjë durim.
- Por soset edhe durimi dikur! — Demushi vështronte në hapësirë. — Ara po më digjet. Po më del duarsh buka e një motmoti. Deri këto dy-tri ditë bima ishte si s'ka më e mirë. E tash po e merr zhegu. Të duket sikur po ta merr bukën prej goje...

— Shihe edhe arën time: është bërë si hi... Më thanë se është shterur edhe Kroi i Orëve.

— Edhe Kroi i Orëve?!

— Nuk rrjedh as edhe një pikë ujë nëpër gurrë të tij, më thanë. E pra, nuk mbahet mend as prej pleqve që Kroi i Orëve të jetë shterur ndonjëherë.

— Zi e më zi për Gurajën!... Ka për t'u bërë një kob i madh, dëgjoje fjalën time. Prite kur të na turren xhandarët prapë.

— Edhe në ardhshin, do t'ua bëjmë siç ia bëri kapterit Zog Buzheta.

— Thuaj çka të duash, por ne s'mund të hahemi me shtetin. Ti vret një xhandar, vijnë dhjetë mbas tij. Shteti është si kuçedra që ka zënë Përroin e Thatë.

— Edhe po ta pijë tërë gjakun tonë, shteti nuk ngopet më sa kuçedra e Murat Gjokës, o Demush!

Kingji ia shkrepiti të qeshurit. Ishte gaz marazi, ishte shkrimllëfi e shpotie ndaj magjistarit të ujërave dhe ndaj shtetit.

— Kam qenë tek ama e Përroit të Thatë. Ata kanë gërryer një gropë të thellë e të gjerë sa një truall shtëpie. Verën që vjen uji i lumit të ngjallur do të rrjedhë nëpër arat tona. Kështu tha Murati.

— Me gjithë mend u zë besë këtyre fjalëve?

— Si të mos u besoj, o Kingj? Po të mos besoja në diçka, do të çmendesha. Ti e sheh se zhegu po na djeg për së gjalli. Për ta larguar pak mendjen nga zhegu, mendoj për Përroin e Thatë. Mendoj se do t'i vijë fundi zhegut, thatësirës, se arat tona do të jenë të gjelbra, gjithë shëndet dhe çdo bimë do të ketë nga dy kallinj....

— Kjo punë mund të bëhet, Demush... por jo me magjinë e Murat Gjokës. Thatësirës mund t'i vijë fundi me të vërtetë, por vetëm nga duart tona.

— E si u bëka kjo punë?!

— Duke sjellë në Gurajë ujët e Ujëbardhës.

— Mos ma nxirr gazin, o Kingj, se gazi sot është gaz i zi... Le që Breglumi nuk do të na e lëshonte kurrë ujët e lumit të vet, por edhe po të na thoshte

«merrni sa të doni», uji nuk është zog, nuk ka krahë që të vijë në arat tona.

— Të thashë: ujët mund të vijë me krahët tanë... Me kanal. E kam dëgjuar nga gjyshi se dikur Guraja mernte ujë në Ujëbardhë. Uji vinte nëpër lugje druri, të mbërthyerat gojë më gojë me njeri-tjetrin.

— Thonë se ka shkuar njeriu nga Guraja deri te lumi, duke ecur nëpër këto lugje, kaq të forta kanë qenë.

— Me lugje do të vinte pak ujë. Nuk do të njo-meshin me të as arat e një lagjeje. Gurajën do ta shpë-tonte nga thatësira vetëm kanali.

— Të mos të vijë keq, o Kingj, por mua s'ka njeri që ma mbush mendjen se mund të hapet kanal nëpër Kersh të Kuq. Është rrasë e gjallë. Mezi mund të kalojnë andej edhe dhinë e egra, pale njerëzit!... Guraja është e nëmur. I kalon lumi përkaj dhe ajo digjet për ujë, përvëlohet nga zhegu. Ndoshta kështu do të jetë gjithmonë.

Të gjitha gjethet e Blirit të Madh ishin kthyer së prapthi. Ai ngjante si një dru i çuditshëm prej kallaji, që rrëzëllinte nën diellin e fortë. Në hijen e gjerë të blirit ishte freskëti. Te rrënjët e tij, mbështetur me kurriz pas trungut, ishte ulur Prruk Moti. Përbri kishte një shtagë të skalitur nga një mjeshtër i Gurajës dhe një trastë, ku dukej bishti i një lahute të vjetër.

Rreth bishtit të lahutës përdridhej trupi i një gjar-pri, kurse në majë ishte koka e një dhie të egër. Sipas besimeve të hershme që ende gjëllinin në Gurajë, gjar-pri e dhia simbolizonin nëntokën dhe tokën, d.m.th. zërat e të vdekurve dhe zërat e të gjallëve, pavdekësinë dhe jetën që shtegtonin nëpër mote mbi kalin e drurtë

të lahutës e mbi udhën kumbuese të kularit që e lëvizte dora e lahutarit...

Përveç asaj lahute të moçme e shtagës së skalitur, Prruku kishte edhe një kullë guri, ku shkonte shumë rrallë për të fjetur. Disa vite më parë kolera ia kishte shfarosur të gjithë njerëzit e shtëpisë. Kishte mbetur gjallë vetëm ai. Të vdekurit i kishin hedhur në gropën e gëlqeres për të ndaluar përhapjen e sëmundjes. Sa herë që i kujtohet ajo kohë e tmerrshme, i dalin para syve trupa njerëzish të zhytur në gëlqere të gjallë dhe i duket sikur ata përpëlitën nga dhimbjet si peshqit që i nxjerrin në zall. Këto përfytyrime e mendojnë sidomos kur fle në kullë. Për këtë arsye të shumtën e herës fle ku e zë nata: dimrit në shtëpitë dhe kasolet e Gurajës; verës, në shpella, nën trungjet e lisave e në fushë të hapur.

I rrëgjuar nga motet e nga tallanditë e jetës, tani Prruku i ngjante një lisi plak që i kanë mbetur vetëm dy a tri degë të njoma. Gurajasit thoshin se «në të ri ai kishte qenë burri më i fortë në zotin e këndej». Për trimërinë dhe mençurinë e tij tregonin ngjarje nga më të pabesueshmet...

Aty nga fundi i shekullit të kaluar erdhën disa tabore, për të shtruar Gurajën. Të drejtuar nga Prruk Moti, malësorët s'e lanë të qetë për asnjë çast dhe e gjakosën keqas ushtrinë e huaj që mbeti e ngujuar në gryka malesh si bisha që bie në kurth. Thuhej se Prruku ishte njeri që s'e kapte plumbi, që mund të fluturonte si zog. Këto legjenda u përhapën gjithandej, aq sa ranë edhe në vesh të pashait.

Taborët e gjymtuar u tërhoqën nga Guraja pa ia arritur qëllimit të vet. I nxitur nga kërsëria dhe nga gojëdhënat që kishte dëgjuar për Prruk Motin, pashai e thirri në besë për t'u takuar me të. Prruku e ndjeu veten ngushtë nga kjo kërkesë e pashait. Të mos shkonte, iu duk ligështi, paburrëri. Pashai do të mendojë se pata frikë, — mendoj Prruku. Por hall i madh ishte edhe të shkonte, sepse ai ishte shtatmesatar e i hajthëm, njeri më se i zakonshëm.

Të dilte para pashait kështu, i dukej ulje. Do të përgënjështronte gojëdhënat, do të zbehte e do të çmitizonte vetveten dhe Gurajën.

Që të ngjante sa më i bëshëm e më madhështor, u vesh trashë, ngjeshi për mesi dy rrethatore me fishedë, ndërsa dy rrethatore të tjera i kryqëzoi mbi kraharor. Në brez vuri dy kobure e dy thika, të gjitha të stolisura me argjend. Edhe kështu pashait nuk do t'i dukej i jashtëzakonshëm. Atëhere mori dy brirë dashi të mëdhenj e të përdredhur, i vuri në kokë e i shtrëngoi fort me shallin e gjatë, që të mos lëviznin sadopak.

Shokët e përcollën deri në afërsi të shatores ku do të takohej me pashanë dhë u fshehën aty pranë, për t'i ardhur në ndihmë në rast nevojë. Kur e panë ushtarët duke ardhur rrugës njeriun me brirë, u zmbropsën të tmerruar. Edhe pashai nuk mbeti më pak i mahnitur. Ai e ftoi të ulej e të rrinte, por Prruku nuk pranoi. Eci praptazi, derisa doli nga shatorja, i gatshëm t'i nxirrte koburet nga brezi si vetëtima e t'ia zbraste pashait në trup, po të hetonte ndonjë rrezik. Jashtë nuk i bënte befë syri. Po t'i shtie dy hapa ndërmjet, s'ka plumb që më zë, — thoshte Prruku. U bashkua me shokët që po e prisnin. u kallëzoi si i kishte zgurdulluar pashai sytë kur e kishte parë me brirë në kokë. Ata qeshën një copë herë dhe u kthyen në Gurajë...

— Në tërë botën nuk e di kush më mirë se Prruk Moti çka bën deti, — thoshin gurajasit për lahutarin e tyre, i cili merrej edhe me parashikimin e motit. Për këtë arsye mbiemri i vërtetë i Prrukut ishte zëvendësuar me nofken Moti. Edhe nga pamja e jashtme ky plak ishte si një shëmbëllim i gjallë i hyjnisë së lashtë të shiut. Kapuçi majë kokës të kujtonte retë e shiut, shamia e kuqe që e lidhte rreth ballit i ngjiste një vetëtime dhe mjekra e bardhë që i vërshonte drejt kraharorit dukej edhe si mjegull që mbush luginat, edhe si rrjedhë e shkumëzuar, edhe si shi i pjerrët e kokërrmadh,

Si vrojtues i hollë, i vëmendshëm edhe i ndryshimeve më të vogla e më të padallueshme të motit, Prruku kishte krijuar një kod shenjash, që në mjaft raste i jepte dorë të parashikonte me përafërsi se kur do të binte shi a borë, kur do të frynte era a do të vinte moti i mirë. Të shumtën e herës këto parashikime dilnin, disa ditë më herët a më vonë. Ato mbështeteshin në trajtat e reve, te mënyra e shpërndarjes së avujve, te lëvizja e mjegullës, te ngjyrat që merrte qielli në mëngjes e në mbrëmje...

Mbi të gjitha Prruk Motin njerëzit e donin dhe e nderonin si lahutar që «këndonte si zana e malit».

I mbetur fillikat, si një lis i vetmuar në një pyll të djegur, Prruku nuk hoqi dorë nga lahuta. I la të mbjellat, të korrat, kositjen, vjeljen, por jo këngët. Tokën ia mbillte, ia prashiste e ia kornte vëllazëria. Bagëtitë ia ruante një kushëri. Prruku nuk interesohet fare për to. Tani ai merrej me lahutën e këngët e moçme, interesohet për retë, mjegullat, shiun dhe borën...

Duke parë njerëzit e grumbulluar rreth tij, lahutari plak e nxirrte lahutën nga trasta, merrte në dorë kularin me qime të sarta kali dhe, pa prituri që t'i luteshin, ia niste këngës që dilte nga kraharori i tij eshtak si gurra e bardhë që del nga një shkëmb i murrmë. Ishte një gurrë që rridhte nëpër mote e s'kishte të sosur. Thatësira e Gurajës nuk kishte mundur ta shterte këtë gurrë, megjithatë e kishte pakësuar rrjedhën e saj. Edhe Prruku e vinte re me hidhërim këtë gjë dhe nganjëherë, në vend që t'i mbaronte këngët me mbylljet e zakonshme, thoshte:

*Vetë u lodha e ju u shurdhova,
Kangë e gjeta e kangë e këndova,
Besa, shumë fjalë në të i harrova...*

Në këto thënie shprehej jo vetëm pikëllimi për lodhien dhe pleqërinë e tij, por edhe shqetësimi e keqardhja për plakjen e këngëve, për gjyftimin e tyre... Sidoqoftë çaste të këtilla ishin të rralla. Me sy të pe-

rënduar e të përhumbar në hapësirë, si të ishte i verbër, i mëshonte kularit, dridhte gishtat e këndonte duke ikur me flatrat e përfytyrimit në vise e në kohëra të tjera. I dukej sikur merrte pjesë në luftërat e dyluftimet, në rrëmbimet, torturat, trimëritë e dredhitë, në djegiet e dasmat, në dashuritë e pabesitë, në vdekjet e ringjalljet, për të cilat fliste kënga; sikur çetonte bashkë me kreshnikët nëpër Lugjet e Verdha, kuvendonte me Orë e me Zana, me diellin e me hënën, u priste kryet kralëve e harambashëve të huaj. Nga të tundurit ritmik të kokës, të supeve dhe të trungut, ai i ngjiste një kalorësi të plakur që kthehet nga lufta mbi gjok të bardhë.

Te bliri erdhën disa fëmijë të vegjël të gurajasve të varfër, që s'kishin mundësi të dilnin në bjeshkë. Ata i sollën Prrukut mollë verore, megjithëse ai kurrë nuk u kërkonte gjë. Vocërrakët nuk dinin si ta shprehnin ndryshe mirënjohjen e tyre për përrallat, gojëdhënat dhe gjëzat e bukura që dëgjonin prej tij. Ata nuk mund ta kuptonin se vezullimet në sytë e tyre, të qeshurat, habia, keqardhja dhe thirrjet gazmore për ngjarjet a personazhet e ndryshme, ishin dhuratat më të vyera për lahutarin plak...

Në të ngrysur te Bliri i Madh u mblodhën edhe burra e pleq, që kishin në fytyrë gjurmët e zhegut e të pikëllimit për arat e tyre. Prruku e ndjeu se ishte çasti të kapte lahutën, e nxori ngadalë prej trasës së leshtë dhe e shtrëngoi kordën, derisa nxori tingullin e duhur. Ishte një tingull i veçantë, drithërues, ku plekseshin klithma e çjerrë e gjinkallave dhe gurgullima e rrëkeve, afshi i tokës së djegur dhe njomështia e shiut që bie. Pas pak, me tingullin e vetmuar e drithërues të lahutës, u bashkua zëri i tij pleqëror e i pamoshë, kumbues e piskatës, që të kujtonte herë thellësinë e tokës, herë paanësinë e qiellit. Tingulli i lahutës dhe zëri i njeriut takoheshin, ndaheshin, ndiqnin njëri-tjetrin në rrafshinën e paskajshme të mbrëmjes; takoheshin e ndaheshin përsëri, ndiqeshin përsëri në pambarim.

Njerëzit dëgjonin fjalët e këngës dhe ndienin se si qenia e tyre mbushej me atë muzikë e me atë zë. Ajo ishte Kënga e Diellit, himn i perëndisë së hershme të dritës e të jetës, të begatisë e të gëzimit, të cilit stërgjyshërit i ngrinin faltore në majat e maleve. Rrebeshet e kohërave i kishin shembur gurët e ledhet e faltoreve, i kishin shuar zjarret e pishtarët e ndezur në to, por ajo këngë e moçme lartësohej në qiell: pemë përherë e blertë, pemë e mbirë në mushkëri e në zemër të njeriut...

— O ti Diell, o Diell i bardhë, — thoshte kënga, — pash atë dritë që të flakëron në ballë, mos e lër zjarrin të shuhet në vatrat tona, mos e lër dritën të fiket në sytë tanë. Shtere detin e bëje re, silli retë mbi malet e fushat tona, ujiti arat e kullotat, ngjalli gurrat e përrrenjtë, mbushi pemët me kokrra dhe hardhitë me bistakë, o ti Diell, Diell i bardhë!

Pak ka zgjatur, shumë s'ka zgjatur, e ka shterur detin Dielli i bardhë, dhe është mbushur qielli me re të zeza, dhe kanë plasur vetëtimat e bubullimat, dhe ka rënë shi shtatë ditë e net, ka rënë shi mbi male e fusha, ka ujitur arat e kullotat, i ka ngjallur gurrat e përrrenjtë, i ka mbushur pemët me kokrra dhe hardhitë me bistakë, ka flakëruar zjarri në vatrat tona, ka shkrepur gëzimi në sytë tanë, lum për ty, o Diell, që ndrit botën, lum për ty, o Diell, o Diell i bardhë!...

Mbasi mbaroi kënga, një copë herë vazhdoi një heshtje e pazakontë, mpirëse. Vocërrakët rrinin të nemitur, kurse të rriturit të shtangur. Në veshët e tyre ende zhurmonte shiu që s'rreshti shtatë ditë e shtatë net, shiu i këngës së lashtë që e solli Dielli i bardhë. Ndonjë plak njomte me majën e gjuhës buzën e përtharë dhe i dukej sikur mbi fytyrë po i kullonte shiu jetëdhënës.

Edhe Prruku ndjeu një drithërimë të lehtë nga ajo heshtje. Në vend që t'i ngazëllente fshatarët që e dëgjonin, kënga e tij i kishte pikëlluar. Ai deshi të ujjste shpirtin dhe shpresat e tyre me shiun e këngës, me besimin se shiu do të vijë dhe do ta varrosë tha-

tësirën në thellësi të tokës. E kuptoi se kënga nuk mjaftonte për ta bërë këtë gjë.

— Merrini vesh fjalët e mia, — tha Prruku. — Shtatë herë rresht nuk do t'i bjerë dielli tokës, pa e njomur shiu Gurajën!

Prruku e kishte tretur vështimin në qiell. Në jugperëndim, atje ku horizonti dukej si një buzë e çarë nga etja dhe e përgjakur, kishte zgjatur kokën një re e madhe, e kuqërruar.

— E mërkurë, një; e enjte, dy; e premte, tri; e shtunë, katër; e diel, pesë; e hënë, gjashtë...

Demushi numëronte me zë dhe shtrinte gishtërinjtë e mbledhur. Çdo gisht ishte një ditë pa shi, pa ujë, me zheg përvëlues, me këngë gjinkallash. Gishtërinj të shtrirë, si të vdekur të shtrirë në dërrasë.

Gjashtë ditë dhe shiu s'po duket, mendonte ai, Gjashtë ditë të gjata, të pambaruara, përvëluese. Gjashtë ditë me shpresë. A thua e shtata do të jetë vdekja e kësaj shprese?! Se ndoshta shiu i shpresuar, i shumëpritur nuk do të vijë. Nuk do të vijë... Nuk do të vijë... Atëherë do të vijë gjëma: do të mbetemi pa shi e pa shpresë. Nën qiellin saç. Nën diellin që endet nëpër qiell si një kacadre i kuqërremtë që e ka lidhur me pe një fëmijë dhe e detyron të endet ditë për ditë nga lindja në perëndim, nga lindja në perëndim...

Ai mendonte për shiun, për diellin, për gjithçka, që të harronte sadopak urinë. Në magje ishte një pëllëmbë bukë. Tërë miellin që kishte pasur, e kishte çuar në bjeshkë.... Në fund të një tinari ishte edhe një blojë drithë. E ruante për ditën më të vështirë. Dhe deri te buka e re, ishin gjithë ato ditë. Ai mendohej ta harronte atë blojë drithë. Të harronte edhe pëllëmbën e bukës në magje. Mendohej t'i rrallonte

të ngrënat. T'i shtynte sa më larg njëra-tjetrës. Të duronte qoftë edhe një orë më shumë.... Edhe një gjysmë ore....

— O hiq kush të jesh se vdiqa urie!

Ai u trand nga kjo thirrje, si të ishte rrokullisur në fund të një honi të errët. Ajo thirrje ishte një hon i errët, trallisës. Pandehu se mos i kishin bërë veshët, apo kishte folur vetmevete. Apo ajo klithmë kishte dalë nga barku i tij, nga goja e tij padashur, vetvetiu... Jo, ishte e pamundur të kishte thirrur ai! Ky s'ishte zëri i tij. Ishte zëri i dikujt tjetër. Në vetëdijen e tij zëri u bë më i qartë. Fqinji!... Kjo përplasje mendimesh ndodhi sa çel e mbyll sytë. U turr drejt magjes. Rrëmbëu copën e bukës dhe doli jashtë.

Sytë ia vrau drita e fortë e diellit, por ai rendi verbtazi drejt kasolles së fqinjit. Kur mbërriti në oborr të kasolles, u shtang. Fqinji ishte shtrirë për-tokë. Gojën dhe sytë i kishte të hapur. E preku në ballë, në kraharor: po ftohej. Zemra nuk i rrihte më. Po ftohej gjithnjë e më tepër. Ia uli qepallat me gishta, por goja nuk i mbyllej. Ruante formën që i kishte dhënë ngërçi i vdekjes. Goja e hapur ishte e errët. Humnerë. E mbramja fjalë që kishte dalë nga ato buzë mavi, kishte qenë fjala «u». Edhe nofullat e buzët e tij të ngërçuara nga vdekja formonin atë fjalë të mbrame e tepër të shkurtër, tmerrisht të shkurtër: «u».

Rreth të vdekurit nisën të mblidheshin mizat. Mizat gjelbëroshe, të sarta. Ato vërtiteshin rreth tij e zukanin. Edhe zukama e tyre ishte një «u» e pandërprerë. Formonte fjalën më të shkurtër në botë: «u».

Ai ndjeu diçka si marramenth nga zukama e mizave të vdekjes që i oshëtinte në tërë qenien. Theu një degë dardhe dhe zuri të trembte me to mizat që bënin «u-u-u» dhe s'donin të iknin nga i vdekuri.

Erdhën fqinjët e tjerë që u bëri zë dhe e futën të vdekurin në kasolle. Sofra ishte e shtruar. Në të kishte vetëm një kusi me nenë të ziera. Një qullësirë

e gjelbëremë. Mizat e vdekjes. Ngjyra e tyre. Kudo ngjyra e tyre... Demushit iu kujtua biseda që kishte bërë me njeriun e sapovdekur disa ditë më parë. «Si je me bukën?» — i kishte thënë. «Kam edhe pak, Demush...» — ishte përgjigjur ai, duke kthyer kryet mënjanë. Këtë gjë e kishte bërë për të fshehur të vërtetën. Buka i ishte mbaruar dhe hante vetëm nenë të ziera me boça misri të shtypura. Kishte muaj që magjja e tij rrinte e mbyllur. Ajo nuk binte erë miell e brumë, por vetëm një erë të rëndë myku. Ishte era e miellit të prishur që kishte mbetur në plasat e thella të dërrasave. Në skutat e errëta të magjes vareshin cerga të hirta merimangash që përgjonin prenë e tyre. Por gjëja që e pezmatonte më tepër se kjo erë dhe këto cerga, ishte ai pluhur i verdhë, vegulli e miellit që mungonte. Tani ai nuk do të ndiente dhe nuk do të shihte më kurrgjë. Mizat e vdekjes zukatnin rreth tij «u-u-u», «u-u-u»...

Në oborr ia behu një grumbull fëmijësh, duke folur e duke qeshur me të madhe. Midis tyre ishte një djalë i vogël, i mbështjellë me degë e kulpra, aq sa i dukeshin vetëm sytë. Në kokë kishte një si kësulë të bërë me gjethe të gjera kungulli.

— O i zoti i shtëpisë! — thirrën fëmijët.

Demushi doli jashtë e u tha të largoheshin. Ai i ndoqi me sy tek ikën të heshtur, buzëvarur e ëndjeprishur. Shkuan te një shtëpi tjetër e thirrën në oborr. E zonja e shtëpisë doli jashtë me një tas ujë në dorë: Ajo e derdhi grushte-grushte ujët e tasit mbi Shiun, siç quhej djali i mbështjellë me degë e me kulpra. Djali-Shi u hodh pupthi dhe ujët e derdhur mbi të u shpërnda përçark tij e spërkati tokën. Fëmijët e tjerë, të rreshtuar në formë rrethi, ia nisën këngës me zë të lartë:

*Bjerë, o shi! Bjerë, o shi,
Të na rritet drithi i ri,
Të na rritet drithi e sana,
Shtati ynë — deri te hana!...*

Me të mbaruar kënga, e cila u përsërit tri herë, e zonja e shtëpisë u dha fëmijëve disa kokrra mollë e një copë bukë. Ata e uruan të ketë bereqet sa ujët e detit dhe vrapuan drejt një shtëpie tjetër. Për këta fëmijë të varfër, ky rit që ua kishin mësuar gjyshet, kishte një rëndësi të trefishtë: u dukej se po bënë një punë të vlefshme, argëtoheshin dhe së paku atë ditë ngopeshin me copërat e bukës që merrnin shtëpi më shtëpi...

Gërmimet tek ama e Përroit të Thatë vazhduan gjithë verën. Aty thatësira dhe vapa nuk ishin aq të padurueshme sa në Gurajë. Vendi nuk rrihej nga dielli. Puhia dhe fresku i bjeshkës zbriste nëpër luginë nga ahishtet e afërme. Murat Gjoka kishte blerë misër te tregtari dhe gërmuesit nuk mbetën asnjë ditë pa bukë. Gjellën e bënte një fshatar te vendi i punës, ndërsa buka gatuhej në fshat, sepse ishte e ndaluar që gratë t'i afroheshin amës së lumit.

— Gra këtu të mos shoh, se ato më bëjnë sherr!
— kishte thënë Murat Gjoka atë ditë që kishte filluar gërmimi. — Kryet dhe shpatullën e djathtë të berrit do të m'i jepni mua për çdo ditë, se më duhet t'i këqyr...

Shpinëkërrusur, të heshtur, me një drojë të lehtë në zemër, që nuk davaritej krejt as në valën e punës, fshatarët gërmonin nga mëngjesi derisa muzgej. Flisnin lirshëm, bënë hoka e qeshnin vetëm kur pushonin në drekë nën hijen e drurëve ose te tëbana, para se të flinin. Megjithatë edhe atje bisedat e të qeshurat e tyre ishin të kufizuara, sepse puna e lodhshme ua thithte të gjitha forcat. Magjistari çante me duar rrashtën e zier të dhisë dhe nxirrte trutë nga zgavra me gishtat gjatoshë, të cilët i lëpinte mirë e mirë.

Pas kokës, i qepej shpatullës së djathtë, e cila, sipas tij, tregonte më me përpikëri se çka do të ndodhte, se kur do të shpërthente ujët...

Në mes të shpellës u hap një zgavër e gjerë, ku pritej me ankth e me shpresë të gufte nga çasti në çast lumi i ringjallur.

Një ditë magjistari u shtri në fund të asaj zgavre dhe ngjeshi veshin pas tokës.

— Po e dëgjoj! — thirri ai. — Po e dëgjoj!...

— Çka po dëgjon?!

Në sytë e gërmuesve lodronin hamendjet më të çuditshme.

— Po dëgjoj gurgullimën e ujërave! Përroi i Thatë po ringjallet. Edhe pak, fort pak na mbetet për të gërmuar. Oburrani, mos e kurseni veten! Do t'ia shuajmë etjen Gurajës.

Ky lajm i ri u dha zemër gërmuesve. Ai zbriti si fillad bore edhe në Gurajë, në mes të piskut të vapës, kur disa fshatarë kishin filluar t'i shkulin arat e zhuritura e t'i vinin në mullar. Gërmuesit qëllonin me mllef mbi gurët dhe zhavorrin e trashë, duke shfryrë mbi ta tërë hidhërimin e Gurajës, mërinë e saj ndaj zhegut e thatësirës.

Qëllonin e sillnin në mend arat e shkultura. E dinin se shumë nuse do të mbeteshin pa marrë e shumë dasma do të shtyheshin për shkak të atyre arave të shkultura. E dinin se do të ulërinte vdekja, ujkonjë e uritur, te dyert e shtëpive përbri arave të shkultura.

Qëllonin dhe përfytyronin lumin që do të dilte nga nëntoka e errët. Atë çast do të harronin që ishin të rritur, që disa prej tyre kishin thinja në kokë. Do të shllapuriteshin nëpër ujë si fëmijë, do të spërkatin njëri-tjetrin, do të qeshnin me të madhe. Dhe kurrë më s'do të kishte thatësirë në Gurajë, s'do të kishte ara të shkultura, dasma të shtyra, varre të hapura nga uria!...

Magjistari kishte vajtur në fshat. Një gërmues u tha shokëve ta ndërpritnin punën.

— Pse? — i thanë ata të habitur.

— Dua të dëgjoj me veshët e mi gurgullimën e ujërave.

Në zgavrën e muzgëllyer ra heshtja. Pushoi zhurma e kazmave, e lopatave. Dëgjohej edhe pipëtimja e gjetheve, edhe zukama e kandrave që fluturonin në ajër. Gërmuesi u shtri në truallin e zgavrës dhe mbështeti veshin pas tokës.

Ai qëndroi ashtu gjatë-gjatë-gjatë. Qenë çaste që zgjatën sa një përjetësi. Gërmuesit e tjerë i kishin ngulur sytë mbi të. E tejngacmuar nga ankthi, qenia e tyre kapte çdo zhurmërimë. Ata dëgjonin edhe ritmin e zemrës së tyre, që rrihte me forcë.

Gërmuesi që po përgjonte, mbështeti pas tokës edhe veshin tjetër. Qëndroi prapë edhe një copë herë të madhe. Pritja u bë e padurueshme, e dhimbshme.

Ai u ngrit nga fundi i zgavrës me fytyrë të bërë dhé. Shkundi petkat qetë-qetë si të mos kishte ndodhur asgjë. Por gërmuesit e tjerë e dinin se ajo që kishte ndodhur ishte gjëmë.

— Kurrëgjë nuk dëgjohet! — tha gërmuesi. — Murat Gjoka na ka mashtruar. Ai na ka mashtruar gjithë jetën; edhe me pusët, edhe me ngjalljen e Përroit të Thatë. Lumi ynë nuk do të ngjallet kurrë...

Ato fjalë ranë mbi ta si lopata me dhé, sikur po i varrosnin për së gjalli. Gërmuesit ulën sytë për tokë. Jo, ata nuk e prisnin, nuk mund ta përballonin një goditje kaq të rëndë, të pamëshirshme. Nuk mund të pranonin të hiqnin dorë nga ëndrra për ujë, për të shuar etjen e tokës së tyre.

— Ti nuk thua të vërtetën, sepse nuk di të merrësh me këtë punë. Ujët mund ta dëgjojë vetëm Murat Gjoka. Ai është i dijshtëm. Vetëm ai është magjistari i ujërave.

— Besojini Murat Gjokës e bëni ç'të doni, — tha gërmuesi që përgjoi në fund të zgavrës. — Kjo është punë për ju. Por edhe në gërmofshi deri në ka të zi,

Përroi i Thatë nuk do të ngjallet kurrë, prej tij s'do të bjerë në Gurajë asnjë pikël uji!... Edhe mua më pikon zemra gjak, kur i them këto fjalë, por kështu është e vërteta.

Ai hyri në tëbanë, mori gunën, trastën, vuri kazmën në sup dhe u kthye nga gërmuesit e tjerë që rrinin si të zanuar.

— Mirë mbetshi, shokë!... E di se edhe ju, herët a vonë, do të bëni si unë.

Asnjeri nuk ia ktheu përshëndetjen.

Hapat e tij humbën në pyll. Prapa zhurmës së atyre hapave mbeti shumë heshtje.

— Po sikur të dëgjojë ndonjë prej nesh? Ndoshta e ka dëgjimin më të hollë, — tha një fshatar i parruar, qimekuq. Fytyra e tij dukej si livadhet e kuqërruara të Gurajës.

— Jo, nuk do të dëgjojë askush tjetër, veç Murat Gjokës. Ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në punët e tij.

— Drejt e ke. Vetëm Murat Gjoka i di këto punë. Vetëm ai flet me orë e me zana. Ne të tjerët jemi për të gërmuar. Kapni kazmat e lopatat!

Rifilluan punën, por pa ëndjen e vrullin e mëparshëm.

Edhe ritmi i gjakut të tyre sikur ishte bërë më i ngadalshëm. Në qënien e tyre po kjasonte¹⁾ lodhja, mosbesimi, si ajo lagështira që plasarit e çan edhe shkëmbinjtë. Këtë gjë Murat Gjoka e pikasi me t'u kthyer nga Guraja, ku kishte marrë vesh edhe për largimin e fshatarit që s'besonte më në ngjalljen e Përroit të Thatë. Tani do t'i duhej të luftonte dhëmb për dhëmb me këtë mosbesim, ashtu siç luftonin gërmuesit me gurët dhe zallin e lumit të qëmotshëm. Ai kishte vrarë mendjen gjatë gjithë rrugës se si ta mposhte atë mosbesim, që e kishte parandier.

— Diçka na ka bërë sherr të madh, — tha ai. —

1) kjason — depërton uji shkëmbin, murin në formë lagështire.

A ju kanë zënë sytë ndonjë grua, sa kohë që s'kam
genë këtu?

— Për së afërmi, as për së largu s'kemi parë grua
me sy!

— Ajo do të jetë avitur fshehurazi, — tha Murati
i menduar.

— Ne s'kemi as pushkë me vete, — tha Kurteshi.

— E pse t'u dashka pushka?

— Edhe po ta kishim parë kuçedrën, s'do të kishim
pasur çka t'i bënim, — tha Kurteshi.

— Çka po na thua edhe ti! Sikur u vraka kuçedra
me pushkë!...

— Edhe e kanë vrarë, — tha Kurteshi.

— S'e zë besë!

— S'e zë besë ti, por ndodhur ka... — tha Kurteshi,
duke vështruar Muratin, i cili pohoi me kokë.

Gërmuesit shkundën çibukët, flakën bishtat e ciga-
reve që s'mund të thitheshin më dhe zbritën në zga-
vër. Murat Gjoka nuk u largua më nga ama e Përroit
të Thatë. Një vargua i ri frike e lidhte tash e mbrapa
me atë vend, ku në pranverë kishte përjetuar atë nga-
zëllim të madh, apoteozën e fuqisë së tij si magjistar.
Parandjenja e errët se gërmuesit mund ta braktisnin
dhe ai mund të mbetej fillikat ndanë zgavrës, si ndanë
një varri, përvidhej si gjarpër në vetëdijen e tij.

Një kanal i gjerë e i thellë, ku gurgullonte uji i fres-
kët e i kulluar, kalonte përkrye arës së tij. Ai e spiktoi¹⁾
ujët e kanalit nëpër vijat e gjata e të tërthorta të
arës që binte erë shkumb nga thatësira. U fut midis
bimëve me shat në dorë. Priste që uji të vinte poshtë,
t'i kthente krødhat e plisave të tharë në brumë të

1) ndaj ujët pjesë-pjesë në arë

butë. Priti e priti e priti, por uji nuk po rridhte. Nuk po e njomte dheun. Duke dihatur, shkoi te kanali, ku uji gurgullonte pa ndërprerje. I vinte të ulërinte nga dhimbja e nga çudia. Tërë mllef, shtrëngoi bishtin e shatit me të dyja duart dhe nisi të qëllonte me të rrjedhën e ujit që gurgullonte para tij. E copëtonte atë rrjedhë me tehun e shatit, sikur po priste trupin e një shllige, por rrjedha e ujit, si për inat të tij, i shëronte menjëherë plagët që i bënte shati dhe ikte tutje e palënduar, moskokëçarëse. Kjo gjë e bëri të godiste edhe më me tërbim. Stërkalat e ujit që ngriheshin përpjetë, i lagnin fytyrën, teshat, trupin...

Çeli sytë dhe u ngrit ndenjor. Ishte bërë ujë në djersë. Zabullima e kthinës po i zinte frymën. Rekonte si delet në vapë. Një zhurmë e njohur, zhurma e strehëve kur bie shi, e rrëqethi. Doli me të shpejtë në oborr. Pika të mëdha e të dendura shiu binin nga retë e murrme e të ngjeshura, që po dyndeshin nga ana e jugperëndimit. Toka e tharë oshëtinte nën pikat e mëdha të shiut si lëkura e nderë e një daulleje që e godasin njëherësh mijëra shkopinj. Ajri ishte i rëndë, i amësht dhe kundërmonte dhë i lagur. Gjethet e pemëve, të lara nga shiu, kishin marrë një shkëlqim të metaltë. Në cepat e tyre vareshin sumbulla të tejudkshme. Mijëra sumbulla që pikonin, pikonin, pikonin... Po qajnë, — mendoj Demushi. — Po qajnë nga gëzimi. Ndjeu se edhe atij po i njomeshin sytë. Po i vesohej tërë qenia. Kapërceu oborrin me hapa të mëdhenj e vrapoi drejt arës. Shiu po bëhej më i dendur e më i fortë.

— Qofsh i bekuar!... Qofsh i bekuar! — murmuriste Demushi.

Shputat e zbathura i zhyteshin në baltë. Plisat e lagur nga shiu po fryheshin si brumë i ardhur. Lëmuesësia e baltës ia gicilonte lëkurën. Ishte një prekje ngashnjyese, e këndshme.

— Qofsh i bekuar!... Qofsh i bekuar!...

Murmuritjet e tij bashkoheshin me zhurmërimën e shiut që binte i qetë, i njëtrajtshëm. Petkat e qu-

llura i rëndonin, por nuk e bezdisnin. I vështronte bimët me përgjërime dhe i vinte të ndalej pranë secilës, ta prekte me dorë, ta përkëdhelte. Fletët e çrrudhura ishin mbushur me sumbulla të argjendta. Edhe ara po qan nga gëzimi, — mendoi ai. Një rrymë njomë-shtie i lëvizte nëpër trup. Këmbët i shllapuriteshin në baltë, dhe ai murmuriste:

— Qofsh i bekuar!... Qofsh i bekuar!...

Kështu murmuriste tërë Guraja, që vështronte e mrekulluar herë qiellin bujar, me retë e përfryra si gjinj të kolmë, herë tokën e plasaritur që pinte e etur lëngun e jetës, shiun shpëtimtar.

Muzikën ngazëllimtare të shiut e ndërprente disa krisma pushke. Krisma nervoze, blasfemuese.

— Mos qëllo!... Mos qëllo!... — u ngritën zëra nëpër shi, edhe ata nervozë, sokëllitës.

— Do të trembet shiu!... Do të ikë nga arat tona!...

— Mos gjuaj me pushkë, të gjuajttë moti!...

Por krismat nervoze nuk u ndërprejnë. Fshatari që shtinte me pushkë qëndronte në mes të arës së tij të zverdhur e të zhuritur aq shumë, sa që nuk mund ta njomnin e ta shpëtonin më të gjitha shirat e botës. Ai donte të vriste retë, shiun, që për të erdhën tepër vonë.

Fshatarët ia hoqën me vështirësi pushkën nga dora. Ata u tmerruan nga vështrimi i tij prej të çmenduri. E morën me forcë dhe e çuan në shtëpinë e tij.

Lajmi për bujkun e çmendur u përhap menjëherë. Njerëzve u erdhi keq për të, por ata e harruan shpejt fatkeqësinë e tij. Nuk kishin as kohë, as forca të merrshin me të. Tani tërë qenia e tyre ishte përqendruar te shiu që binte i shtruar, i freskët. Te shiu bujar, i begatshëm, që po këndellte çdo gjë...

Shiu ra pa pushim atë pasdite, gjithë natën e të nesërmen. Atëherë njerëzit që e prisnin shiun me padurim, filluan të shqetësoheshin. Vërshimet e përmbytjet do të rrezikonin arat e tyre që kishin shkuar në zgrip nga thatësira.

Ditën e tretë rreziku nga ujët e shiut nuk ishte më një parandjenjë, por një mundësi. U çuan peshë të gjithë përrrenjtë e Gurajës, ku për javë të tëra nuk kishte rrjedhur pikë uji. Ata vërsuloheshin teposhtë si bisha të egërsuara, me krifa të kërleshura shkume, me ujëra si të përgjakura, duke kafshuar brigje, stome, buzë arash e livadhesh; duke marrë me vete vigje, kërcunjtë, lisa të shkukur. Kjo lukuni e etur për shkatërrim hungëronte, sikur ndillte vdekjen dhe zhdukjen e Gurajës.

Edhe shiezat e shterura, që mbusheshin me ujë vetëm në vjeshtë e në kohën e shkrirjes së borës, mblidhnin ujërat e shpateve e të kreshtave dhe turreshin drejt Gurajës. Fshatarët vështronin me pikëllim e frikë nga qielli, ku shtëllungat e zeza të reve tashmë nuk ngjanin me gjinj të fryrë, por me varganë të përzishëm, me grumbuj vajtojcash.

Midis zhurmërimës monotone të shiut befas u zgjat, bisk i blertë, një zë i hollë fëmije:

*Re, re, bobore,
Që ma zune diellin-o,
Ta zëntë therra shpirtin-o!...*

Dridhej, ulej e ngrihej në qiellin e Gurajës ai zë fëmije, pëllumb i bardhë me krahë të lagur që fluturon nëpër shi. Sa mbaronte kënga, zhurmërima e shiut, hungërimat e përrrenjve sikur bëheshin më të forta, më shqetësuese e më këmbëngulëse. Por zëri i fëmijës ngrihej përsëri i hollë, i dridhshëm, sfidues.

— Thuaje edhe një herë! — i lutej gjyshja me sy të shuar. — A nuk e sheh? Shiu po meh, retë po ikin, po dalin ylberët... Thuaje edhe një herë, sokoli i gjyshes!

Dhe kënga pingëronte në buzët e fëmijës e rridhte në hapësirë si fiskajë rrezesh....

Atë natë askush nuk mbylli sy në Gurajë. Një mijë tupana binin pareshtur nën qiellin e saj të ulët. Vetë-tinte e bubullinte. Rrufetë binin me rropamë mbi kreshtat e maleve dhe mbi majat e drurëve të lartë. Retë që vinin nga jugperëndimi s'kishin të sosur dhe gjinjtë e tyre s'kishin të shteruar. Vijat e kanalet që ishin hapur ndanë arave, ishin mbushur buzë më buzë.

Me pishtarë në dorë, gurajasit nxitonin përgjatë këtyre kanaleve. Vinin në buzët e tyre plisa, gurë, fier, degë të thyera e trungje. Hiqnin me shat bëzhdilet e llomishtrat që pengonin rrjedhjen e ujit. Megjithëse i mbronin me gunat që i kishin hedhur në kokë, pishtarët fikeshin herë pas here. Ata i ndiznin prapë. Ecnin përgjatë kanaleve në dritë të pishtarëve e të vetëtima-ve...

U gdhi.

Shiu vazhdonte.

Gurajasit ruanin kanalet.

— Ndihmë!... Ndihmë!....

Te një kanal i thyer bri një are, një grua ishte shtrirë për së gjati në të çarën që kishte bërë uji. Mbahej me thonj pas tokës, për t'i bërë ballë rrëkesë së vrullshme që e qëllonte në kurriz e në ije. Mbronte me trupin e saj arën, një pjesë të jetës së Gurajës. Ishte grua e ve.

Fqinjët e dëgjuan britmën e saj. Ata sollën me vete një derë shtëpie dhe e vunë tek e çara e kanalit, përballë ujit. Gruaja u çua në këmbë. Rreth derës vunë gurë të mëdhenj e plisa. E çara u mbyll. Gruaja kullonte ujë e baltë, por ishte e gëzuar. I vezullonin sytë, tek shihte arën e shpëtuar. Po të mos e kishte mbrojtur me trup, ulluku do ta kishte gërryer e do ta kishte mbuluar me zall e gurë. Pranverën e ardhshme, në ato vende do të rriteshin vetëm këputje e fier. Me trupin e saj, gruaja kishte mbrojtur amësinë e arës...

Era filloi t'i shprishte retë dhe nëpër të çarat e tyre

shpërthyen rrezet e diellit. Mbi Gurajë u nder një ylber i madh: unaza e martesës së qiellit me tokën, shenjë e pajtimit dhe e dashurisë midis tyre. Njëpër fshat dëgjoheshin zëra të hollë fëmijësh:

*Ylber, ylber,
T'marrsha t'kuqtë e t'dhansha t'verdhtë!*

Sa mendjelehtë që ishte treguar atë ditë, kur i ati i kishte folur për martesën! Me heshtjen e tij i kishte lënë të kuptonte se kishte dëshirë të martohej, se pranonte të merrte atë nuse që do t'i gjenin. Së paku, kështu e kishte gjykuar këtë punë i ati. Dhe ai nuk e kishte zgjatur më tej: i kishte zënë një vajzë në një fshat të largët.

Ky lajm i beftë e zgjoi nga topitja, por çka ishte bërë, nuk mund të zhbëhej më. U përpoq ta bindte veten se kështu ishte e thënë dhe ky ishte fati i tij. FATI I TIJ... Ai ishte diçka e pashmangshme dhe e paluftueshme si vdekja, përmytjet dhe thatësira. Po, fati ishte thatësira që i kishte shterur të gjitha burimet dhe rrëketë në qenien e tij. Lulet ishin shkundur para kohe, bari ishte zverdhur, gjethet e drurëve ishin kuqërruar. Tani mosha e tij ishte një stinë zhegu, pa ujëra dhe shira. Dhe qenia e tij, në të gjitha orët e ditës, lëshonte një gumëzhimë të çjerrë gjinkallash: Jeriiinè!

Këtë gumëzhimë e dëgjonte kudo: gjatë netëve pa gjumë në tabanë, gjatë ditëve kur endej nëpër pyjet e livadhet e vetmuara....

Me ardhjen e vjeshtës vetmia u bë më e rëndë, më e prekshme. Vetmi ishte heshtja e thellë e pyjeve të zverdhura, fishkëllima e metaltë e pishave. Vetmi ishte hapësira e shkretë, pa zëra njerëzorë, zhurma monotone

e shiut dhe ulërима ndjellazë e erës vjeshtake. Vetmi ishte luhatja e barit të gjatë të livadheve alpine. Gjithnjë i dukej se nuk ishte bari që lodronte, që lëkundej, por ishin flokët e butë, gërshetat e shthurur të Jerinës, që ai kishte aq dëshirë t'i hidhte mbi fytyrë e të mbulohej me ta...

O, kur e pat shikuar botën përmes atyre flokëve! Gjithçka i dukej e praruar si ata flokë, e larë në rrëzë hëne të një nate maji, kur zogu i verës, gushëfryrë, këndon në gëmushat ku lulëzon kulpra erëmjalte të përjetshmen këngë të zemrës që thërret një zemër, të qenies që ka etje të shumëfishohet; të përjetshmen këngë të përtëritjes e të vazhdimësisë së gjallimit mbi tokë.

Ai e mban mend mirë çdo hollësi, çdo tingull, çdo ngjyrë, çdo kundërmim të asaj mbrëmjeje: ishte mbrëmje kur e puthi për herë të parë rrëzë një trëndafili të egër. Dhe për të dashuria mori fytyrën e asaj mbrëmjeje, dhe për të puthja mori kundërmimin e trëndafilit të egër. Dhe Jerina u bë mishërim i gjithçkaje të ndritshme që kishte ajo mbrëmje maji me hënë, me pemë të çelura e këngë zogjsh që fjetën shumë vonë....

Tani në veshët e tij oshëtinte vetëm fishkëllima e pishave dhe ulërима e erës në gryka. Për t'u hakmarrë ndaj kujtimit të Jerinës që e kishte lënë besën, mendonte për atë vajzën e panjohur, me të cilën e kishte lidhur fati — kur e mendonte këtë gjë, përfytyronte vargonj të ndryshkur që gërvijnë — dhe do të bëhej nusja e tij. Sajonte me mend shtatin, flokët, fytyrën dhe sytë e saj. Por këto shëmbëllime, lodra të fantazisë, davaritëshin menjëherë, treteshin si yjet e borës që shkrijnë në pëllëmbë dhe midis tyre, vegim kryeneç, i pashlyeshëm, shfaqej fytyra e Jerinës dhe ajo mbrëmje maji e larë në dritë hëne, që kundërmonte bar të njomë e lule trëndafili të egër.

Megjithatë edhe atë mbrëmje ndodhi diçka që la në qenien e tij mugullin e një ndjesie që në të ardhmen do të bëhej pemë hidhërimi. Jerina këputi një degë trëndafili të egër, të mbushur me gonxhe të hapura. Pak, se kërcelli i trëndafilit të egër është gjithë pejza

dhe këputet vështirë, pak, se lulet e tij shkunden fare lehtë (edhe po t'i prekë kalimthi një flatër zogu) kur Jerina i zgjati degën e këputur, në të s'kishte mbetur asnjë petale. Ajo provoi disa herë të këpuste një degë pa i rënë petalet, por nuk mundi. Omerit i mbetën në mend ato degë me petale të rrëzuara thjesht si dësh-timi i një lodre të këndshme. Mirëpo pas fejesës së Jerinës, vegimi i atyre degëve u ngjall si një fantazmë dhe i zuri tërë kujtesën. U bë, si të thuash, simbol i dashurisë së tij jetëshkurtër....

Në vetminë e bleshkëve, kujtimet e nanurisë dhi-mbjen, e vishnin me një lëvore të hollë, ashtu siç bëjnë drurët, kur barinjët ngulin gurë në ta. Fejesa e Jerinës dhe zënia e nuses nga i ati ishin dy faqet e një guri të mprehtë që ishte ngulur në trungun e jetës së tij. Ai nuk mund ta shkulte e ta flakte tej këtë gur, por, ashtu si drurët, përpiqej ta vishte me njëfarë lëvozhge e ta quante si pjesë të qenies së vet.

Pas shiut të madh e të rrëmbyer që desh e përmbyti Gurajën, misri lidhi kokërr dhe po piquej nën rrezet e një dielli që ende nxehte, por nuk digjte më. Në kokrrat e kallinjve qumështi ajkëtohej, trashëj e shndërrohej në dyllë të bardhë. Nëse ky shi për më të shumtat e arave që pjellor e shpëtimtar, për Murat Gjokën që mynxyrëmadh. Shiezat që u dyndën nga shpatet e ma-leve, zgavrën e gërryer gjatë një vere e mbushën brenda disa orësh. Ujërat e turbullta dhe gurët e rroku-llisur zhdukën çdo gjurmë të punës së mundimshme të njerëzve. Gërmuesit i vështronin me pikëllim e llah-tia prej lubie e kuçedrës, ksodha¹ e re e Përroit të Thatë, të vdekur qëmoti.

1) darkë vdekjeje

Sikur të mos mjaftonte kjo gjë, një faqe shkëmbi u rrëzua dhe ra në shpëllinë. Oshëtimja e këtij rrëzimi u dëgjua deri në Gurajë.

— Për së shpejti do të vdesë dikush, — thanë pleq-të. — Do të jetë vdekje e rëndë...

Prapëseprapë magjistari i ujërave nuk e dha veten. Gërmuesit që kishin rënë në fshat për të parë të afërmit e për t'i bërë ballë shiut të madh, u ngjitën prapë tek ama e Përroit të Thatë. Kur panë ato që kishte bërë shtrëngata, mbetën të shtangur nga keqardhja dhe lemeria. Madje atyre u shkoi nëpër mend dhe besuan se ajo shtrëngatë e paparë kishte shpërthyer enkas për të mbyllur zgavrën, për të asgjësuar punën e tyre. Në shembjen e shkëmbit të stërmadh që kishte zënë nën vete shpëllinë, ata shihnin dorën e një fuqie të mbinatyrshme. Ishte qesharake dhe e rrezikshme të hahe-she me atë fuqi. Nuk u bënte zemra të preknin kaz-mat me dorë. Ishte rrënuar çdo shpresë për ngjalljen e lumit dhe kishin frikë pikërisht nga fuqia e mbinatyrshme.

Edhe Murat Gjoka e mori me mend këtë frikë, pran-daj tha:

— Zoti i madh që dridh tokën, zoti i madh që vran e kthjell, që fal borë e shi e breshër, që çon erën e gjuan me rrufe, e mbuloi shpëllinë me këtë shkëmb të shkoqur nga shpati i malit, me qëllim që të provojë edhe një herë forcën e vullnetin tonë, vendosmërlinë tonë për ta nxjerrë lumin nga nëntoka...

Gërmuesit e dëgjonin kokulur, me nderim, por pa ngazëllimin dhe ekstazën e pranverës. Atyre u bënte përshtypje rrjedhshmëria, tingëllimi i fjalëve të tij, por jo domethënia. Madje domethënia e tyre ishte e dyshimtë. Tani ato fjalë ishin si guaska tërheqëse, të shumëngjyrshme, që janë të zbrazëta, pa mish, pa jetë.

— Ndoshta zoti i madh është kundër ngjalljes së Përroit të Thatë dhe e dënoi punën tonë, mund të men-dojë dikush. Kjo nuk është e vërtetë, ju them e ju bëhem dorëzanë unë, Murat Gjoka, magjistari i ujërave. Atë që do më shumë, zoti e mundon më shumë, sepse

dashuria e tij është mundim, është dhimbje. Vetëm ai që beson deri në fund, e fiton dashurinë e tij.

Sytë e tij shkrepinë. Fytyra e murrme në të kuqërremtë atë çast dukej me të vërtetë si një copë stralli, e latuar dosido nga një gurgdhendës i lashtë. Ai e ndiente veten në zgrip të disfatës, prandaj i përdori fishekët e fundit...

Me gjysmë zemre, të shtyrë nga përбетimet dhe rrekeja e fjalëve të magjistarit, gërmuesit ia nisën punës prapë, kësaj radhe disa hapa poshtë shpëllinës, ku ishte rroposur shkëmbi i rrëzuar. Për drekë u pre një cjaп, që e futën në hell dhe e poqën. Njeriu që dërgoi Murat Gjoka te prifti i Breglunit, solli një calik me verë të vjetër. Por mishi i pjekur e vera nuk e davaritën zymtinë e gërmuesve. Tek ama e Përroit të Thatë nuk u kthyen më as shakatë, as këngët. Njerëzit rrinin në beft, si në pritë. Ata druhashin edhe të qeshnin me zë të lartë.

Gjendja shpirtërore e gërmuesve u shtri edhe në Gurajë. Fryma e kundërshtimit që më parë ishte si një puhizë e lehtë, u shndërrua në erë të fortë:

— Nuk paguajmë më për të hapur gropa në Përrua të Thatë!

— Atëherë të rrimë duarkryq përpara thatësirës e të vdesim nga uria?!

— Të hapim kanal. Vetëm kanali do ta shpëtojë Gurajën nga thatësira. Ngjallja e Përroit të Thatë është dokërr.

— Edhe puna e kanalit është dokërr. Ka kaq e kaq vjet që flitet e s'është bërë gjë.

— Nuk na kanë lënë luftërat.

— Luftërat s'kanë penguar, por s'kemi mundur të biem në një mendje.

— Tash duhet të biem në një mendje. Edhe shpresa për ngjalljen e Përroit të Thatë vdiq.

— Ngadalë, mos u ngut. Mos ia ngjit emrin pa lerë!

— Pasha bukën, kësaj pune i ka vdekur nëna! Në daç besojë, në daç mos e besojë...

Ndërsa në Gurajë flitej gjithnjë e më me forcë për kanalin, tek ama e Përroit të Thatë heshtja po bëhej më e theksuar, më kërcënuese. Gërmuesit e vështronin vjedhtas njëri-tjetrin, për t'ia blerë mendimin në sy. Duke qëlluar me kazmë baltën dhe gurët, secili bluante në heshtje idenë e ikjes. Dëshira për të ikur që andej po ua pushtonte pak nga pak tërë qenien si një pije e fortë, po kthehej në një ndjenjë padurimi dhe angustie. Kjo ngjiste jo vetëm ngaqë gërmimi u dukej pothuajse një përpjekje shterpë, por edhe ngaqë hukama e vjeshtës, e shtyrë nga ndonjë vrushkull ere, ngjitej deri te shpellina e tyre.

Në fshat kishte rënë buka e re. Po të afroheshe tek oborret e shtëpive, të thyente hundët era e athët e mushtit që vlonte nëpër tinarë. Nesër, nga ai musht, do t'u vlonte gjaku të ftuarve nëpër dasma dhe lëngu i bistakëve të qelibartë do të shndërrohej në dolli, në këngë majekrahu që shëmbëllejné aq fort me jehonat e bjeshkëve, kur dikush sokëllin nëpër gryka.

Kur doli nga tëbana, Murat Gjoka u mpi: gërmuesit nuk bëzanin. Nuk kishin zënë vegël me dorë dhe ishin të tronditur. I numëroi pa zë: mungonin tre vetë. E kuptoi se ata ishin larguar fshehurazi gjatë natës.

«Tre vetë nuk janë gjë,» — tha me mend, për të ngushëlluar veten. Ai e dinte se mund të kishin ikur edhe gjysma, edhe të gjithë, por këtë nuk guxoi t'ia pohonte as vetvetes.

Mori një kazmë dhe nisi të gërmonte. Këtë gjë s'e kishte bërë asnjëherë më parë. Tërë ditën nuk e lëshoi kazmën nga dora. Gishtërinjtë gjatokë iu bënë si gërthapë dhe shuplaka iu mbush me fluska. Në mbrëmje Kurteshi ia mjekoi me pishë të nxehur.

Megjithëse ndenji zgjuar deri vonë dhe gjumi e

Duke ecur nëpër një shteg që kalonte ndanë fshatit, larg shtëpive, magjistari arriti te një kodër, ku rruga kthehej për në Breglum. Aty, mbështetur pas një murane, pa një burrë të ligur e të zbehtë, që iu duk si fytyrë e njohur. Megjithatë nuk arriti ta përcaktonte se kush ishte ai njeri. Tani truri i tij ishte i lodhur, i mjegulluar. Ndryshe nga ç'e kishte zakon, Murati vazhdoi rrugën, pa u ndalur të fliste me udhëtarin e mbështetur te murana, as të çlodhej pak.

Edhe Murat Gjoka s'qenka më ai që ka qenë, mendoj Ibra, i befasuar nga heshtja dhe mospërfillja e magjistarit të ujërave. Ndoshta më mban mëri, se kam qenë kundër puseve të tij, që s'ua shuan etjen as pulave të Gurajës. Madje kur i thosha kështu, magjistarit i vinte shumë inat... Ai i hoqi sytë nga Murat Gjoka që po zbriste kurrizit të kodrës dhe vështroi prapë Gurajën.

Fshati im i shkretë, tha me vete Ibra. Ndoshta kështu do të të gjeja, edhe po të kthehesha mbas njëqind vjetësh!

Në ato pllaja, midis atyre lisave, ishin po ato shtëpi guri, të mbuluara me rrasa ngjyrë hiri, me dërrasa. Vetëm në pjesën e poshtme të fshatit, kishte dy-tri shtëpi me tjegulla të reja ngjyrë gjaku. Ky mozaik çatish, më mirë se çdo gjë tjetër, mishëronte laryshinë e jetës në Gurajë, kamjen dhe forcën e famljeve që flinin e zgjoheshin, ëndërronin, gëzoheshin a pikëlloheshin nën to....

Tashti Murat Gjoka, magjistari i ujërave, kishte kaptuar kodrën dhe nuk dukej më.

PJESA E DYTË

Sa herë që kthehej përballë bajraktarit, nënpre-fektit i shkonin sytë te qosteku i sahatit që i varej në të majtë të kraharorit dhe i mbulonte një pjesë të mirë të jelekut të murrme. Ishte një qostek i argjendtë, me shumë vargonj, që bënte një kontrast të dukshëm me sfondin e errët të jelekut. Që në vështrim të parë ky qostek iu duk si një vazhdë e ndritshme jarge të tharë, që lë prapa kërmilli, kur zvarritet mbi bar a mbi faqet e gurëve. Ai i kishte shumë zët kërmijtë dhe sidomos jargën e tyre. Nuk dinte as vetë ta shpjegonte se për ç'arsye i kishte mbetur ky zakon. Neveria dhe dëshira për të pështryrë po e cytnin edhe tani.

I vinte inat me veten dhe mundohej ta largonte këtë ndjesi të pakëndshme, duke vështruar gjetiu: orenditë e zyrës, drurët përtej dritares. Por, kur fliste me të ftuarin, ishte i detyruar edhe t'ia hidhte sytë ndonjëherë. Dhe për drej sytë i shkonin fill e te qosteku i sahatit, që i dukej si jargë e tharë, e ndritshme kërmilli....

Nëse neveria për kërmijtë dhe jargën e tyre ishte një ndjenjë instinktive, përqasja ndërmjet qostekut e jargës së tharë kishte shpjegimin e vet. Nënprefekti ishte dëshpëruar sa s'bëhet më, kur e kishte marrë vesh se ishte emëruar në këtë krahinë, që për të ishte pjesa më e prapambetur e shtetit. Kur u largua nga kryeqyteti, u tha shokëve që po e përcillnin:

— Po kthehem në shekullin e shtatëmbëdhjetë!

I diplomuar në Evropë, i mësuar me jetën e qyteteve të saj, edhe kthimi në atdhe për të kishte qenë një tjetërsim i pamëshirshëm, që ishte shoqëruar nga një pakënaqësi e limonti brejtëse. Emërimi në viset skajore të shtetit i rriti në kulm këto ndjenja që u shkri- në me njëra-tjetrën dhe morën formën e përshtirosjes.

Qëndrimin në «nënprefekturën e tij» e quante si një syrgjyn, si një ndëshkim të fatit të verbër, që e detyronte të merrej me ata malokë kryelartë e idhnakë, të cilët i sillnin kokëçarje të përditshme. Ai e duronte këtë gjendje, këtë fat për dy arsye: punën e tij në këto vise si zyrtar i mbretit e mbështillte me bre- roren e ndritshme të misionarit, që mundohej të mbill- te në këtë tokë të ashpër e shterpe qytetërimin evrop- ian, të cilin sapo e kishte ngjëruar. Nga ana tjetër e dinte se kjo nënprefekturë ishte për të pikënisja e ka- rrierës politike. Atij i pëlqente shumë një thënie që se ku e kishte parë në libra ose e kishte dëgjuar në biseda:

-- Shkallarja e parë e çdo shkalle është toka.

Po ashtu nëpër letrat që u dërgonte shokëve në krye- qytet, për të cilët fati kishte qenë më ledhatar, mbinte midis rreshtave edhe proverbi latin, i shkruar me germa më të dukshme se të tjerat: «Per aspera, ad astra.»¹⁾

Me këto arsyetime ai ngushëllonte veten dhe i hap- te rrugë ëndërrimit për t'u ngjitur «tek yjet», të cilat nuk ishin asgjë tjetër veçse dritat e kryeqytetit në mbrëmje, takëmet e praruara të zyrave mbretërore, llampadarët e salloneve dhe kukurizmat e zonjushave

1) Përmes vështirësive arrihet tek yjet, d.m.th. te sukcesi.

që fehtonin si fishekjarrë në fantazinë e tij prej beqari. Dita-ditës këto ëndërrime bëheshin më përçartëse e më agresive. Ia gllabëronin tërë qenien, shndërrheshin në krahë dylli, të cilët ende nuk kishin forcën e duhur për ta shkëputur nga nënprefektura e tij e vrazhdë.

Përveç çështjeve shtetërore, një pjesë të kohës ua kushtonte studimeve, duke u përpjekur të shtinte në punë dijet që i kishte dhënë Evropa. E mbante veten si etnograf, megjithëse kishte studiuar për drejtësi. Shpeshherë ftonte në zyrë nga fshatrat e «nënprefekturës së tij» burra të moshuar, pleqnarë të cilët ishin në zë për zgjuarsi. Mblidhte të dhëna për doket e zakonet e lashta, për kanunet, për gjykimet e pleqve, për fiset dhe për ngatërresat midis tyre.

Këtë gjë nuk e bënte thjesht nga pasioni për shkencën, por edhe për qëllime politike, praktike. Për të mposhtur dikë, duhej të gjeje pikat e tij të dobëta. Te ky përfundim erdhi, kur u gjend përballë rebelimeve të pandërprera në nënprefekturë. Tani që mbreti i tij, shpëtimtari i kombit, kishte marrë një titull të ri «mbret reformator», ishte më e udhës të shmangej sa të ishte e mundur kacafytja shtet-fshatarë dhe të nxitej kacafytja fshat me fshat e fis me fis...

Gurajën rebele ai e quante «një çiban në zverkun e shtetit». Rrënja e këtij «çibani» ishte Zog Buzheta. Guximi dhe paturpësia e tij kishin kapërcyer çdo kufi me ngjarjen e javës së shkuar, që mori emrin «ngjarja e gomarit».

Zog Buzheta kishte zënë një nga xhandarët e postës së Gurajës, e kishte çarmatosur, ia kishte lidhur duart në shpinë dhe e kishte çuar në një shpellë, në afërsi të fshatit. Në të ngrysur kishte marrë një gomar e një kalë që po kullotnin në livadhin prapa shtëpisë së kryeplakut dhe ishte nisur drejt nënprefekturës bashkë me xhandarin e lidhur. Kishin ecur tërë natën e natës nëpër një rrugë shkëmbore që rrihej pak dhe ishte më e shkurtër se rruga e zakonshme.

Para se të shkonin te qendra e nënprefekturës, Zog Buzheta ishte ndalur te një grumbull pemësh, ia kishte mbyllur gojën xhandarit me një shami dhe e kishte detyruar të hipte në gomar së prapthi. Ia kishte lidhur të dyja këmbët me njëra-tjetrën dhe e kishte shtrënguar fort, që të mos rrëzohej nga gomari. Në muzg të agullimit, kur arrin kulmin qetësia dhe shkretimi i natës, e kishte marrë gomarin për dore dhe e kishte çuar deri në të hyrë të qytezës së vogël. Ishte kthyer me vrap, kishte hipur në kalë dhe ishte bërë erë.

Sado që ishte i ngarkuar rëndë, gomari kishte zgjatur kokën ndanë rrugës, për të këputur fije bari e gjembaçë. Në mëngjes, kur qyteza gjumërendë kishte filluar të shpërgjumej, të gogësinte, të gjallërohej nga zërat e nga hapat e njerëzve, gomari kishte lëshuar një pallmë të madhe. Kalimtarët e kishin vënë re. Një njeri i kishte dhënë një marroku një monedhë dhe e kishte nxitur ta çonte gomarin para shtëpisë ku flinte nënprefekti.

Njerëzit shihnin xhandarin mbi gomar, së prapthi, u vinte për të qeshur, por edhe nuk u dilte gazi. Ai kalërim i përçudshëm ishte një shëmbëllim i vetë shtetit të tyre, i mbretërisë. I shqetësuar nga zhurma në oborr, nënprefekti kishte nxjerrë kryet në dritare. Fytyra e tij ishte ngërçuar nga inati. Ajo skenë groteske ishte një përdhosje barbare e shtetit që përfaqësonte. Sytë e tij të ftohtë, sy gjarpri, kishin vezulluar si teh thike. Guraja, kishte menduar ai. Një hakmarrje e ashpër, siç ishte edhe ajo vetë: tërë gurë e gërxhe, tërë thatësirë e mllef...

Rebelimin e Gurajës e quante sfidë të hapur jo vetëm ndaj mbretërisë, ndaj sovranit august, por edhe ndaj planeve të tij për të ardhmen, një eklips ogurzi të yjeve që i shihte në ëndërr aq shpesh. Për ta shkulur këtë rebelim, duhej të asgjësohej Zog Buzheta, të asgjësohej miti i tij se kinse qenkësh dragua. Por as kjo gjë nuk mjaftonte. Duhej t'i jepej një goditje e rëndë tërë Gurajës. Kjo goditje duhej të ishte si helmi: tinëzake, kobzezë.

Mu për këtë qëllim nënprefekti kishte ftuar në zyrë Grosh Malotën. Megjithëse nuk e shihte dot me sy këtë «fossil» dhe gosteku i tij i dukej si jargë kërmilli e tharë, — o zot, mezi e përmbante veten të mos i pështynte mbi jelek! — ia kishte nevojën dhe roli i tij nuk do të ishte i vogël në goditjen që do t'i jepte Gurajës.

— Guraja është e nëmur, — tha bajraktari. — Edhe njerëzit e saj janë të nëmur, prandaj janë kaq të egër.

— Por mund të zbuten, — tha nënprefekti.

— Vështirë, zotni! — tha bajraktari. — Ata janë si gurgaci. I bie, nxjerr xixa...

— Ata do të zbuten, po të zbutet Guraja, — tha nënprefekti.

— E ke fjalën për vendin, për tokën? — tha bajraktari, duke u përpjekur të merrte me mend atë që kishte në kokë zyrtari.

— Pikërisht, — tha nënprefekti. — Guraja është rebele, sepse është e varfër, sepse nuk ka ujë. Po të ketë ujë, s'do të ketë varfëri dhe njerëzit e Gurajës do të zbuten.

— Fjalë me vend, zotni, por Guraja s'ka ku ta marrë ujët, — tha bajraktari.

— Përbri Gurajës rrjedh një lumë që ka shumë ujë, — tha nënprefekti.

— Përnjëmend ka shumë ujë, por ai nuk mund të vijë në Gurajë, — tha bajraktari.

— Mund të vijë fare mirë me kanal, — tha nënprefekti. — Kam marrë vesh se në fshatin tuaj është ngritur një komision për hapjen e kanalit.

— Po, — tha bajraktari. — Por unë nuk jam në atë komision, zotni!

— Fort keq, bajraktar! — tha nënprefekti. Atë çast sa s'ia hodhi një gulç pështyme në kraharor.

— Kanali do t'i sjellë të mira të mëdha Gurajës. Fshatarët do ta hapin edhe pa ty. Atëherë autoritetin tënd do ta marrë lumi!

Këto fjalë që s'e priste t'i dëgjonte nga goja e nën-

prefektit, e hutuan Grosh Malotën. I shkuan duart te mustaqet e gjata, të përdredhura si brirë oqiçi, që i lëmoi me gishta. Në Gurajë thoshin se bajraktari i lidhte mustaqet me pe çdo natë, që t'i rrinin ashtu, thikë përpjetë.

— Kanali nuk mund të hapet, zotni, — tha bajraktari. — Shkëmbinjtë që e ndajnë lumin nga Guraja janë rrasë e gjallë dhe ata nuk mund të çahen me duar.

— Do t'ju ndihmojë shteti, — tha nënprefekti. — Ju keni dëgjuar se mbreti po bën reforma për zhvillimin e vendit.

Instinktivisht trupi i tij mori një qëndrim që ishte karakteristik për sovranin august.

— Veç kësaj është edhe një pengesë tjetër... — tha bajraktari.

Nënprefekti po priste t'i dilte në këtë shteg.

— Breglumi thotë se Ujëbardha i përket vetëm atij. Dikur për këtë lumë midis fshatrave tona janë bërë vrasje të mëdha, — shtoi bajraktari.

— Duke pasur ndihmën time, d.m.th. ndihmën e shtetit, nuk mund t'ju pengojë askush, — tha nënprefekti.

Bajraktari i uli sytë mbi tryezën e ngarkuar me letra, shkresa, gazeta dhe libra. Në cep të tryezës, ndanë librave, ishte një revole e veshur me serm. Bajraktari e njohu: ishte revolja e një kryengritësi nga Guraja që e kishin varur në litar para një viti.

Nënprefekti e la bajraktarin të kridhej sa të don-te në mendimet e veta, iu afrua dritares dhe flaku jashtë një pizgë pështyme.

— Pra, ti më këshillon ta përkrah punën e kanalit? — tha bajraktari, duke i hequr sytë nga revolja.

— Bajraktari i Gurajës duhet të jetë në ballë të Gurajës, kur ajo po ndërmer një vepër të rëndësishme, që do të sjellë lulëzimin dhe begatinë e fshatit, pra, të një pjese të mbretërisë, — tha nënprefekti.

Kraharori i bajraktarit u fry nga një frymëmarrje

e thellë: mbreti kishte besim në të, mbreti nuk i mbante mëri. Madje ai u shty më tutje në atë çast ekzaltimi: mbreti dhe Guraja kishin nevojë për të!

Kur mbërritën në Gurajë flokët e parë të borës, gjetën aty një ndryshim me rëndësi: ishte ngritur një postë xhandarmërie e përhershme. Pas borës erdhën ngricat. Fërfillaza ulërinte lugjeve e honeve dhe e fuste borën e imët në zgavrat e lisave e në skutat e shpellave, ku strukeshin zogjtë dhe bishat e malit. Për t'i bërë ballë të ftohtit, çdo natë gurajasit vinin në zjarr cungje të trasha, që digjeshin e lëshonin nxehësi derisa zbardhte drita...

Përmes kindave të tallaganit Zog Buzheta shikonte mbrëmjen që po ulej me mundim mbi rrafshinë. Orl i zi që rri pezull me krahë të shtrirë. Për kë po sharton zi, mori natë-orl? Vdekjen e kujt po ndjell?... Ik tej, orl i zi, se ne jemi të gjallë! Gjaku në damarët tanë është i ngrohtë. Ti s'do të na mbërthesh dot në kthetrat e tua prej akulli. Ik!...

Zog Buzheta u ngrit në këmbë. Ai pa shokun e tij që ishte mbledhur kruspull në mugëtirën e shpellës, ku fishkëllinte fërfillaza.

— Çohu, Memë!

Njeriu i kruspullosur nuk lëvizi.

— Po sheh gjë?

— Jo, por do të ikim prej këndeje.

— E ku të mbytemi?

— Po vemë te vëllami im. Po të rrimë edhe sonte në këtë shpellë, do të prishemi së ftohti.

Kur u çua njeriu i kruspullosur, bora e ngrirë nxori një kërkëllimë të thatë. Ata u ndalën te hyrja e shpellës e mbajtën vesh. Nata, si e ngjyer në verr, po bëhej gjithnjë e më e errët. Veriu i zi shkrofëtinte e çukë-

monte nëpër pllajat e Gurajës, vraç i ndërkryer, i shaluar nga kobi dhe vdekja. Guraja përpiquej t'i mbyste këto shkrofetima ndjellazeza me çfarë të mundej: me përralla dimri, me biseda burrash, me tinguj lahute, me të qara ferishtesh, me ndonjë të qeshur të shkurtër dhe me brambullimën e zjarreve që krijonin në vatër përgje prushi.

Të kërrusur, duke e çarë me mundim erën e fortë, e përshekuan atë hapësirë që ulërinte rreth tyre. Kur arritën në oborr të kullës, qeni që ende s'ishte lëshuar nga zinxhiri, lehu me tërbim. Vëllami që po rrinte bri zjarrit ëndjeprishur dhe i kredhur në mendime, u trëndit nga këto të lehura, u zverdh si t'i kishte ikur tërë gjaku nga trupi. Vajti vetëm te dëra e kullës dhe e hapi duke iu dridhur duart. I picërroi sytë përmes erës dhe i njohu: ishin ata....

Zogu dhe Mema shikuan prapa: vetëm borë dhe errësirë. Ata kaluan pragun dhe hynë brenda. Vëllami mbylli derën me drang.

— Mos pyet për ne, — tha Zogu. — Akull jemi bërë. — Vëllami ua mori armët e tallaganët dhe u priu për te kthina e miqve.

— Po shkojmë te kthina e zjarrit, — tha Zogu. Kështu kishte bërë sa herë që kishte bujtur te vëllami, pasi kishte dalë kaçak.

— Jo, — tha vëllami. — Mund të dalë fjala nga gratë e fëmijët. Nuk duhet ta marrë vesh kush se keni qenë këtu. Do të ishte keq edhe për ju, edhe për mua... Mos u bëni merak, se për dy minuta po jua ndez zjarrin.

Vëllami i la te kthina e miqve dhe u largua.

— Nuk po më pëlqen kjo gjë, — tha Mema.

— Çka? — tha Zogu.

— Që po na veçojnë, — tha Mema.

Zogu ia dha të qeshurit.

— As të qeshurit në këto kushte nuk po më pëlqen! — tha Mema i pezmatuar.

— E di, — tha Zogu, — Rreziku shpeshherë i bën njerëzit frikacakë.

— Nuk është punë frike, — tha Mema. — A e vure re si u pre në fytyrë, kur na hapi derën?

U dëgjuan hapa. Vëllami solli prush dhe ndezi zjarrin. U poqi kafe. Bujtësit u nxeën dhe e morën veten. Cingërima e shpellës u davarit nga damarët e tyre.

Vëllami rrekej të tregohej sa më i pritshëm e më i përzemërt, por muhabeti ngecte herë pas here. Pyetjet ose ngjarjet e zinin në befasi dhe ai vështronte i hutuar, si njeriu që zgjohet trembshëm nga gjumi. E ndiente mbi vete shikimin zhbirues të Memës dhe fjalët e tij bëheshin më të ngathëta.

Vëllami shkoi të sillte bukën. Jashtë ulërinte veriu i zi.

— Kjo bukë do të na mbetet në fyt! — tha Mema.

— Mos fol ashtu, — tha Zogu.

— Ndoshta të kanë lënë sytë dhe je verbuar, — tha Mema. — A nuk e sheh se ai është i turbulluar?!

— Me dyshimin tënd ti po e poshtëron këtë vatër që po të jep zjarr e bukë! — tha Zogu.

— Do të na presin në besë, — tha Mema. — Po ma ndien zemra.

— Hesht! — tha Zogu, që dëgjoji zhurmën e hapave pas dere.

Vëllami shtroi sofrën, solli bukën e gjellët.

Darka kaloi në heshtje, si ksodhë.

Në kthinë vërshonte hove-hove, lumnajë kobi, ulërima e veriut të zi. Pullazi kërkëllinte, gjëmonte. Të thoshte mendja se veriu do ta rrëmbente e të ikte tutje me zë si një hutin që mbërthen në kthetra një zog pule...

Kaçakët u shtrinë për të fjetur. Memën nuk po e zinte gjumi.

— Çohu të ikim! — tha Mema. — Ta jap besën se do të na vrasin.

— Fli, budallë, se vëllami nuk na pret në besë! — tha Zogu. — Po vdes për gjumë...

Mema u drodh nga këto fjalë. Do të na mbytin në gjumë, mendoi ai.

Zogun e mori gjumi.

Mema nuk fjeti. Veriu ulërinte brenda tij. Veriu i zi. Lukuni ujqish. Lukunia e vdekjes. Auuu!... Auuu!... Auuuuuu!....

Mema futi opingat në këmbë e hodhi tallaganin krahëve të dilte jashtë. Sapo e mbylli derën e kthinës, ia vunë dorën gojës dhe e lidhën. Të mbërthyer si fëmija që lidhet lulak, e hoqën zvarrë dhe e lanë në një skutë të mesores.

Xhandari vuri syrin te një plasë e derës. Mema e kishte ngritur fitilin e llambës me vajguri, kështu që në kthinë kishte mjaft dritë.

— Lëre fenerin! — i tha atij që mbante një fener në dorë.

E hapën me ngadalë derën e kthinës së miqve e hynë brenda. Zogu ishte në pikë të gjumit. Gërhiste lehtë. Gjumi është i vëllai i vdekjes, thonë në Gurajë. Zogu ishte gjumërendë. Veç kësaj, kishte disa net që s'kishte mbyllur sy.

Ata e kishin menduar që më parë çdo veprim për kryerjen e vrasjes. E dinin se Zogun nuk mund ta bënin zap e ta lidhnin. Edhe po ta qëllonin me pushkë, veç po t'i binin në zemër, ndryshe s'ishin të sigurt se mund ta vrisnin.

Zogu po flinte brinjas. Xhandari ia largoi pakëz plafin nga qafa. Ngriti hanxharin dhe i mëshoi me tërë fuqinë e krahut. Plasën vrushkujt e gjakut. Zogu u ngrit në këmbë, duke u kolovitur. I çoi duart te qafa. Ato iu plirën¹ me një lëng të ngrohtë. Xhandari dhe burri tjetër u zbrapsën të tmerruar.

Zogu lëvizte duke i mbështetur pëllëmbët në mur. Kërkonte vrasësit. Gjaku ia kishte veshur sytë. Muri u mbush me pllanga gjaku, me gjurmë pëllëmbësh e gishtërinjsh...

Pa u bërë mesditë, këtë ngjarje e mori vesh tërë Guraja. Askush nuk e dinte se si. Thuhej se në mëngjes nga shtëpia e Keqotëve ishin larguar një grua me djem në shpinë e me dy fëmijë për dore. Kaçakët, një-

1) iu mbushën

rin pa kokë, tjetrin të lidhur, i kishin marrë xhandarët e i kishin nisur për në nënprefekturë qysh gjatë natës.

— Keqotët kanë prerë në besë Zog Buzhetën!

Kjo frazë kalonte gojë më gojë si lajm, si nëmë, si thirrje për shpagë. Guraja rrëqethej prej saj më tepër se nga cingërima dhe veriu i zi. Gjëma që përcillte e përhapte ajo frazë, ishte më e akullt, më e zezë.

Auuuu!... Auuuuu!... Ujkonja ulërinte në shpirtin e Gurajës. Pabesia. Llahtara. Vrasja në gjumë. Vrasja me hanxhar. Prerja në besë. Shitja e besës. Shitja e gjakut. Auuuu!... Auuuuu! Ishte tronditúr themelia e jetës së Gurajës: besa,

Ajo i harroi të gjitha: ngricë, uri, shtet, xhandarë. Tani ajo ndodhej përballë dimrit dhe mynxyrës më zimadhe: pabesisë. Ujkonja kishte hyrë në damarë, në gjak: Auuuu!... Auuuuu!... Ajo duhej të nxirrej medemos prej tyre. Me përjashtim të disa shtëpive, tani për Gurajën nuk kishte më ditë e net, mbrëmje e mëngjese: kishte vetëm kohë përbetimi. Kohë ankthi. Kohë pritjeje...

Në mesnatë, përmes ulërimës së veriut të zi, kërcitën dyert e Gurajës. Fqinjët i thoshin njëri-tjetrit, duke iu marrë fryma nga nxitimi:

— Po digjen Keqotët!

Njerëzit shtinin kryet në dritare dhe shikonin flakët e kuqe që hipnin në qiell. Shikonin dhe ngazëlloheshin. Shikonin dhe u shkrihej gjaku. Po digjej ujkonja që kishte ulërirë në damarët e tyre. Veriu i tundte e i harbonte flakët e kreshpëruara.

— Jepi, viran, jepi he të lumtë mushkëria!

Të rriturit i ngrinin fëmijët pezull dhe i afronin te dritaret. Ua tregonin flakët me gisht dhe u thoshin:

— Shihini mirë ato flakë! Si ato flakë do të digjen të gjithë ata që do të turpërojnë Gurajën. Të gjithë ata që do ta shkelin besën.

— Kush ua ka vënë zjarrin Keqotëve? — pyesnin fëmijët.

— Besa! — thoshin gurajasit. — Keqotët i dogji besa, sepse ata e prenë Zog Buzhetën në besë!

Në kujtesën e fëmijëve, në trurin e tyre të njomë, nguleshin ato fjalë dhe ato flakë, që kositnin barin e zi të pabesisë në lëndinat e gjakut të Gurajës.

Kulla e gurtë kumbonte nga vallet dhe këngët e dasmës. Omerit i dukej sikur muret e saj ishin holluar, ishin bërë të tejdukshme nga dritat e pishtarëve që flakërinin gjithkah. Ajo qëndronte në atë pllajë muzgu e qetësie si një ortek që kullonte rreth e rrotull fiskaja drite, currila zërash e tingujsh, thirrjesh e të qeshurash. Shndërrimi që kishte ndodhur në kullën e zymtë, hijerëndë, vihej re edhe te njerëzit, te fytyrat e tyre. Omerit i dukej sikur edhe prapa atyre fytyrave dasma kishte ndezur pishtarët e saj të shumtë, fantastikë.

Kulla rrëzëllinte ngado, xixëllonjë e asaj nate pranvere, që bardhësia e agullimit do ta kthente në gjendjen e saj të zakonshme. Por tani ajo jetonte me çastin, me atë çast të bukur e sublim, që ishte thyerja më e madhe në diagramin monoton të jetës së Gurajës...

*O, moj e mira synin si rrushi,
Bama, zot, nafakë t'i puthi,
sa të dalin bari e dushku...*

Omerit iu kujtuan sytë e Jerinës. Eh, ata sy, ata sy!... Tërë qenia iu mbush me muzgun e tyre. Me muzgun e tyre të spërkatur me yje. Me muzgun e tyre të pikëlluar. Ata këndojnë, kurse unë jam i trishtuar, mendoj Omeri. Do të isha i trishtuar edhe sikur ata të këndonin të gjitha këngët e botës. Unë jam kullë e

gurtë, ku nuk ndizet asnjë pishtar, kullë e gurtë e heshtur, me dyer dhe dritare të mbyllura.

Zëri djaloshtar ngjitej nëpër natë si fije bari, si lastar i gjelbër. Në atë zë ishte pranvera, përtëritja, dashuria. Në atë zë ishte gurgullima e rrëkeve të borës së shkrirë, cicërime e zogjve që ndërtojnë çerdhen e re, shushurima e sythave që çelin, jehona e fjalëve që i thonë njëri-tjetrit të dashuruarit...

Ne nuk do të flasim kurrë më bashkë, Jerinë. Nuk do t'i shoh kurrë më sytë e tu. Nuk do t'i puth sytë e tu si kokrra rrushi. Si ato kokrrat e mëdha të rrushit të zi, që, kur piqen mirë, kanë një ngjyrë blu të thellë. Do të dalin bari e dushku i ri vit për vit, por sytë e tu nuk do t'i shoh, as nuk do t'i puth. Kurrë më, Jerinë!... Le të flakërijnë pishtarët sonte. Le të bien tupanat, të dridhen defat e të rrotullohen tepsitë. Le të mos pushojnë për asnjë çast çiftelitë, fyejt e zërat e këngëtarëve. Le të rrjedhin si Ujëbardha të qeshurat e dasmorëve. Le të hollohen si letër cigareje muret e kullës nga dritat e pishtarëve. Mua nuk më qesh zemra sonte. Nuk më qeshin as sytë, as buzët. Sonte jam kullë e gurtë, pa dritë, e mbështjellë nga heshtja. Kullë e gurtë, e mbushur me muzgëtirë dhe vetmi. Po, Jerinë, po...

Dhe kulla e gurtë, dhe pishtarët, dhe njerëzit fërgëlluan përnjëherësh:

— Erdhi nusja!... Erdhi nusja!...

Pasi zbriti nga kali, nuses i hodhën përsipër grushte me grurë, që ajo të sjellë me vete mbarësi. Ta përtërijë jetën në kullë si fara që bleron arat e Gurajës. Arat e saj pa ujë.

Te dera e kullës Omerit i thanë ta godiste nusen me grusht në kurriz. «Bjeri fort,» — e kishte porositur i ati. «Sa ta godas?» — e kishte pyetur t'ëmën. «Sa të ta thotë zemra, — i kishte thënë ajo. — Kur erdha nuse në këtë kullë, eca gjithë ditën e lume. Baba yt më ra ndërmjet të dy shpatullave, sa m'u duk sikur m'u shkoq zemra prej krahorrit...» Omerit iu kujtuan atë çast pikërisht këto fjalë të nënës. E qëlloi nusen lehtë. Me-

gjithatë ajo u hepua. Ndoshta nga udhëtimi i gjatë e i lodhshëm. Në ditën e parë të nusërisë ajo kishte provuar tri gjëra të hidhura: kalimin nën frerin e kalit, para se ta merrnin krushqit, rraskapitjen dhe grushtin në kurriz. Ç'e priste në ditët e ardhshme?

Nusja hyri në kullë. U shtuan flakët e pishtarëve. U shtuan këngët, vallet, të qeshurat. Ecejaket u bënë më të nxituara, më gazmore. Edhe kulla u bë më e tejdukshme. E tëra u bë një qenie ajri dhe drite.

*Kur ka hy nusja përbrenda
Si me hy një lis me rremba,
Shndriti oda renda-renda...*

Dritë e dallgëzuar që përplasat valë-valë pas natës, pas njerëzve, si Ujëbardha e shkumëzuar që rrjedh midis brigjeve të bleruara, që mbush hapësirën me vezullimet e saj shkrepitmatore. E thith nata këtë ndriçim e dritë-sohet prej tij, e thithin njerëzit e dehen me të. Vetëm tek Omeri thyhen e kthehen mbrapsht këto valë drite. Nuk depërtojnë dot brenda tij. Ai është kullë e gurtë, e errët, e heshtur. Kullë muzgëtire dhe vetmie.

Kjo nuk është dasma jonë, Jerinë. Gjithçka që shoh, që dëgjoj, më kujton ty. Më kujton mungesën tënde. Të dhimbshme. Të përjetshme... O, sonte, në këtë natë dasme, jam Guraja nën një diell përvëlues vere. Nën një diell lëbyrës. Dhe ti je si Ujëbardha që rrjedh e gurgullon bri thatësirës së saj, Jerinë. Dhe kjo nuse që nuk ia kam parë ende fytyrën, është si pusët që ka hapur në Gurajë Murat Gjoka...

Omeri vinte rrotull në atë vorbull zërash, tingujsh, lëvizjesh. Ndiente një marrament të lehtë. Ndiente njëfarë shurdhimi nga zhurmat dhe fjalët e shumta. Ndiente njëfarë veljeje nga ai ngazëllim i tepëruar, i jashtëm, mbase i shtirur. Ai mundohej ta qetësonte veten, duke u shkëputur me mend nga ai mjedis që ishte i huaj për të. E përfytyronte veten si një mysafir të padukshëm,

si një hije që endej midis gjithë atij rrezatimi që e kishte emrin dasmë...

Zërat e hollë që vinin nga kthina e nuses, u derdhën në qenien e tij si kroje të akullta. Mori fund dyzimi i tij i deritanishëm. Mori fund ai marramenth kotullues. Ajo dasmë ishte DASMA E TIJ dhe ai ishte DHËNDRI, i shoqi i nuses që s'ia kishte parë kurrë fytyrën. Kjo gjë ishte po aq e njëmendtë sa edhe kulla, njerëzit, vallet e këngët dhe çdo gjë tjetër rreth tij. Kjo gjë ishte e pashmangshme. Ai duhej të shkonte në qilerin e dhëndërisë. Atje e prishte nusja. Nusja e tij. Ajo kishte ardhur nga një fshat i largët, duke kapërcyer shumë male e qafa, për të lidhur jetën me të.

*Kur shkoi dhandri te qileri,¹
U hoq duvaku, doli ylberi...*

Nusja kishte zbuluar fytyrën. Ai i lëshoi sytë në fytyrën e saj. Ndjeu se po i thahej pështyma në gojë. Po i zihej gryka. Si një burim i tharë. Thatësira po zbriste nga goja, nëpër grykë, në kraharor dhe po ia pushtonte tërë qenien. Thatësira e Gurajës pa lumë, pa kroje. Në qiellin e qenies së tij digjte si prush një diell mizor; dielli i zemërimit, i fyerjes, i dëshpërimit, i zhgënjimit. Dielli i fatit të keq e shpotitës.

Vështrimi i tij vraponte nëpër fytyrën e nuses si një fëmijë i etur që rend krua më krua një ditë zhegu në Gurajë dhe i gjen të gjitha gurrat të shterura. Ai mundohet të gjente diçka të bukur, tërheqëse tek ajo fytyrë e panjohur. Këndet e buzëve të nuses ishin si lëkura e një fruti të fishkur. Rrudha kishte edhe në cep të syve, në faqe, në gushë. Vajzë e plakur, e mbetur pa u martuar, mendoj Omeri. Vajzë pa vashëri e që do të mbetesh edhe pa nusëri. Dikush është fajtor për këtë gjë. Dikush tjetër, por jo unë. Megjithëse i kishte kaluar të tridhjetat, nusja dukej edhe më e moshuar

1 gjerdeku

nga ç'ishte në të vërtetë. Dasma kishte ardhur tepër vonë, pasi kishte ikur rinia, që ishte brejtur nga të priturit pa shpresë, nga të ngujuarit, nga mërzia. Njëpër atë fytyrë, tashmë të rrudhur, sa e sa herë kishin shkarë teposhtë rrëketë e lotëve të kripur... Guraja e plasaritur nga thatësira, e zhuritur nga zhegu, mendoi Omeri. Befas në vetëdijen e muzgëllyer iu ndez një yll i purpurt. Drita e tij u përhap valë-valë në të. Jerina!...

Kur kapërceu pragun e kthinës, e ndjeu veten të kapitur si të kishte ecur ditë të tëra nëpër vapë. Në sytë e t'et u dyndën mjegullat. Mjegullat e një mijë vjesh-tave. Në sytë e s'emës ra shi. U prenë kërcimet e këngët në kthinën e grave. Hënat e defave u rrokullisën nga qielli i dasmës. Tepsitë pushuan së rrotulluari në sofra. Sofrat mbetën të heshtura, të zbrazëta. Në kullë dhe jashtë saj filluan pëshpëritjet. — Nusja është e moshuar. Djali nuk do të hyjë dhëndër. — More, nuk ishte edhe aq e moshuar! — Por njeriu nuk merr nuse për ditë: një herë martohet. — Paj, ky ka qenë risku i tij. — Bukuria nuk është kurrgjë. Bukuria është si prilli e maji. Po a mbahet viti vetëm me prillin e me majin?! — E kanë edhe djalë të vetëm. Ndoshta ajo nuk bën fëmijë se i ka kaluar koha. — Kurrgjë s'do të thotë ajo punë, motro. Të pesëdhjetat i kam pasë lënë prapa, kur e kam bërë djalin. — Po nuses si do t'ja bëjnë? — Do ta kthejnë në gjini. Vëri shenjë, po s'doli fjala ime. — Qyqja ajo! Vetëm një ditë nusëri! Djali ia bëri mirë. Njëmend s'ke çka sheh me sy: Më i mirë duvaku se nusja!

Pëshpëritjet e grave gumëzhinin nëpër kthinat dhe skutat e kullës. Burrat që kishin pirë dhe ishin trullorur ngapak, po hanin me ëndje në sofra.

Me të marrë vesh se Omeri ishte larguar nga qileri, dasmorët nuk ngritën më asnjë doli për dhëndrin e nusen. Ishte një dasmë e rrallë, në të cilën nuk u përdorën urimet e zakonshme: U trashëgofshin! Gëzofshin shoqi-shoqin! Të pastë ardhë nusja me këmbë të mbarë! Ta shtoftë hisen! I lefshin shtatë djem rresht! Megjith-

atë ndonjë dasmor gjente rast ta shtinte në punë gjuhën edhe për të folur. — Njëri zuri një vajzë. I ati i vajzës i tregoi vajzën e një fqinji, që ishte e shëndoshë, e bukur. Kur e mori nusen, ai e pa se nusja ishte sakate, me një dorë. — Edhe punë të pamira kanë ndodhur ndër ne sa të duash. E ka dhënë breglumasi vajzën në Pasbjeshtë. Kur ka rënë në shtrat, dhëndri ka çuar dorën në kraharor të nuses e s'ka gjetur gjë. Vajza ishte shumë e re. «Ai që të ka dhënë ty, as mos të marrtë, as mos dhëntë më!» — ka thënë pasbjeshtësi, është kthyer në krahun tjetër e ia ka krisur gjumit... — Më e mira punë është që djali e vajza ta shohin e ta pëlqejnë shoqi-shoqin, mbasi ata të dy do ta kalojnë jetën bashkë. Njëherë njëri kishte pasë një vajzë të mençme e të hijshme sa s'di goja me kallëzue. Ia kishin pasë lypë atë vajzë shumë vetë, por s'iu kishte pasë mbushë mendja me ia dhanë askujt. Një djalë që niset ta kërkojë atë vajzë, takohet me t'atin e saj në rrugë e kuvend me të derisa shkojnë te shtëpia. Ai e lë djalin në odën e burrave, del në odën e zjarrit e i thotë së bijës: «A e pe atë budallë? Ka ardhur të të lypë ty për nuse!» dhe ia plas gazit. «Ku po e di ti se asht budallë, more babë?» «Kam ecë me të. Kur po i ngjiteshim një të përpjete të madhe, më tha: Cili po e mban shoqin deri në majë të asaj kodre, ti mua a unë ty?» «Po si i the ti?» «Unë i thashë: Jo, more, s'mund ta marrim shoqin-shoqin në shpinë!» «He, more babë, ka qenë puna ndryshe. Ai të ka thënë: Cili po e mban shoqin me muhabet e ta harrojmë të përpjetën.» «Ou, ç'po thua dhe ti!» «Po më, babë?» «Ishte skaj rruge një arë me grurë. Më tha: He, mashalla i qoftë, grurë i bukur qenka! A thua e ka ngrënë këta grurë?» Qysh e ka ngrënë?! — i thashë. — Ti je kah e sheh grurin në arë pa korrë!» «Babë, ai ka thënë: A mos ka mbetur pa bukë dhe ka marrë borxh. Po tjetër, çka të tha?» «Ecëm e mbërritëm te varret. U ndal djali e i këqyri. Shumë varret qenkan! — tha. — A thua është kush i gjallë në to?» «Kush ka me qenë gjallë?! — i thashë. — Këta janë të tërë

të vdekur!» «Eh, babë, ai të ka pyetur ty: A ka burra luftime që s'u harrohet emri? I gjallë është ai që s'i humb emri kurrë. Qenka njeri i mençëm, babë». «E pra, ka ardhur me të lypë ty!» «Unë s'dua tjetër burrë veç atij.» I ati nuk ia prishi dhe e fejoj me të.

Dasmorët e tjerë i tumirnin këto rrëfime me tundjen e kokës poshtë-lart dhe me pasthirrma të shkurtra...

Tani kulla e kishte humbur rrëzëllimin dhe flurorësinë e vet. Muret e saj ishin bërë përsëri të rënda, të heshtura, opake. Fluturës krahëlarme të ngazëllimit i ishin përcëlluar krahët në pishtarët që ishin shuar. Dalldia i kishte lënë vendin ngërçit. Dasmorët e lodhur, të velur nga të ngrënët e nga të pirët e shumë, ishin shpërndarë për të fjetur. I kishte zënë një gjumë i rëndë. Gjumë i mbushur me ëndrra.

Omeri ishte mbështetur pas trungut të një kumbulle të lulëzuar. Degët e saj luhateshin lehtazi nga puhia. Ai vështronte kullën e heshtur e të errët, e cila i ngjiste një peme që një rrebesh i papritur ia ka shkukur të gjitha lulet dhe e ka lënë trung të zhveshur, të përzishëm.

E kotulloi gjumi edhe atë, aty ku ishte. Dhe e pa veten në ëndërr, në një shkëmb, të shtrirë tërthor, buzë një greminë. Jerina ishte pak më tej, edhe ajo në shkëmb. Kur qeshi, iu bënë qukat në faqe. Atë çast shkrepiti dielli, mbuloi malet e pllajatat me një dritë ngjyrë qumështi.

Dikush e tundi dhe ia nxori gjumin. Ishte i ati. Omeri u ngrit në këmbë. I ati e kapi për krahu dhe e tërhoqi drejt kullës. Omeri nuk kundërshtoi, as nuk foli. Ishte tepër i këputur. Ende e kishte mendjen tek ëndrra. Kishte dëgjuar se të bjerë dielli në ëndërr është ogur i bardhë. I erdhi keq që i ati e zgjoi nga gjumi dhe ia la ëndrrën përgjysmë. Edhe në ëndërr më ndajnë prej saj, mendoj Omeri. Edhe në ëndërr midis meje e Jerinës ka shkëmbinj e gremina.

Të nesërmen Demushi e mori nusen me vete dhe u nis për rrugë. Nëpër atë rrugë dje ajo kishte ardhur në kalë, sot po kthehej në këmbë. Nuse fatzezë, me një

ditë nusëri, me një vegulli dasme në sytë e përlotur. Megjithëse i kishin kushtuar shumë shtrenjtë, Demushi nuk i ndali nuses asnjë petk, asnjë stoli. Por tani shkëlqimi dhe ngjyrat e atyre petkave, tingëllimat e vjerrcave të argjendta ishin pa kuptim, të përzishme.

Miku më mashtroi e më fiku, mendonte Demushi, duke llogaritur me vete shpenzimet e dasmës. Por më tepër se për shpenzimet, i vinte inat që e kishte gënjyer. Kur e kishte zënë nusen, miku i kishte treguar në oborr një vajzë të re, që i kishte a s'i kishte të gjashtëmbëdhjetat. Ajo kishte qenë vajza e një kushëriri të mikut. Demushi e kishte parë vajzën vetëm për së largu, nga dritarja e kullës. Kështu ishin zakonet e atëhershme jo vetëm në Gurajë, por edhe në fshatrat e tjera. Në qoftë se kuçedra ia kishte zënë lumin vetëm Gurajës, lumin e dashurisë e kishte zënë gjithkund.

Bashkë me mushkat e ngarkuara rëndë, kryeplaku solli në Gurajë një burrë rreth të dyzetave, me flokë të lyer me briliantinë, me kostum e kravatë. Por ajo që u bëri më shumë përshtypje njerëzve të pashëtitur të Gurajës qenë syzet e mëdha që mbante i porsaardhuri.

— Ka ardhur një njeri me katër sy! — i thoshin njëri-tjetrit. Këto fjalë ata i shoqëronin me një të qeshur të lehtë, duke shprehur shpotinë dhe mosbesimin e tyre. Një njeri që s'do t'i njihte mirë gurajasit dhe humorin e tyre, do t'i merrte këto fjalë vetëm në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, do t'i quante dëshmi të paditurisë së tyre. Në të vërtetë raste të tilla edhe kishin ndodhur, por gurajasve «mendjetrashë» nuk u bëhej vonë për këtë dhe në cep të buzës u lodronte pareshtur currili vezullues i të qeshurës shpotitëse, që s'kishin mundur ta

shternin as thatësirat e verave, as zia e vdekjes, as luftërat e dhuna e shtetit.

Kryeplaku tha se inxhinieri kishte bërë shkollë të madhe në Evropë për ura, për kanale, për rrugë e për gjithfarë ndërtime dhe dinte shtatë gjuhë.

— Për bukë e kripë, si shumë të madh po na e bën këtë njeri!

— Në foltë shtatë gjuhë, ky njeri duhet të hajë edhe sa për shtatë veta!

— Murat Gjoka të paktën ka pasur vetëm një gjuhë!...

— Talluni, talluni ju, por ky gaz që po bëjmë sot, mund ta ketë të hidhëtit mbrapa!

Prapa hokave, shpotive dhe të qeshurave të gurajasve, përgjonte parandjenja e errët, që lëshonte një hije kobi në vetëdijen e tyre, si ajo reja e stërmadhe, e hirtë, e cila zë qiellin një ditë vere e mund të sjellë edhe begati, edhe përmytje. Kjo parandjenjë dhe tundimi i ujit u përfytën me njëri-tjetrin për një kohë të shkurtër. Fitoi tundimi i ujit. Edhe kësaj here doli se njeriu, sado i urtë të jetë, është më i prirur t'i besojë një iluzioni të bukur, sesa së vërtetës së hidhur.

Njeriu me katër sy e me shtatë gjuhë, që kishte sjellë me vete disa vegla për projektimin e kanalit të Gurajës, në të vërtetë ishte vetëm gjeometër. Këtë gjë e dinte edhe kryeplaku, i cili nuk e kishte fare hallin te kanali, por kishte synime të tjera. Ai donte ta frynte kuletën me pare të grabitura, por mbi të gjitha donte të thyente vullnetin e fshatarëve për të luftuar kundër thatësirës. Po të hapej kanali e po të zhdukej thatësira nga Guraja, kryeplaku e dinte se tregtorja e tij, e cila fitonte aq shumë me tregtinë e drithit, do të kishte humbje të mëdha. Ardhja e ujit në fshat do të sillte edhe pasurimin e gurajasve të tjerë, pra, do të cenonte pushtetin e tij ekonomik, autoritetin e tij në Gurajë. Ai ishte gati të bënte çdo poshtërsi, madje edhe krim, me kusht që thatësira të mos largohej kurrë nga Guraja, që ai të mbetej më i kamuri në Gurajë dhe fsha-

tarët t'i ulnin sytë përtokë e t'u merrej goja, kur t'i luteshin për misër ose për mallra të tjera, që do t'ua jepte me fajde...

Disa ditë më radhë «inxhinieri» u njoh me vendin ku do të kalonte kanali i ardhshëm. Ishte agu i pranverës, koha më e mirë në Gurajë. Shëtita në ajër të freskët, nëpër pyjet e dendura ku cicëronin gjithfarë zogjsh, ishte një kënaqësi e rrallë, që Njeriu me katër sy e shtatë gjuhë, i rritur në qytet, nuk e kishte provuar aq shpesh. Por atë e mahniti sidomos Ujëbardha me ujët e saj të kulluar dhe troftat me pikla të kuqe, që kishin një mish aq të shijshëm. Kryeplaku u tregua më dorëlibër se kurrë ndonjëherë, kështu që «inxhinieri» hante ç'i donte goja, pinte ujë të ftohtë në burimet e bregut të Ujëbardhës dhe mandej merrte me vërshëllimë disa melodi të panjohura për gurajasit që e shoqëronin në këto udhëtime.

Të themi atë që është, edhe në punë ishte energjik. Ngjitej nëpër shkëmbinj sikur të kishte lindur e të ishte rritur në Gurajë. E fillonte dhe e linte punën çdo ditë në të njëjtën orë. Ishte i kursyer në fjalë, rrallëherë merrte pjesë në bisedat e fshatarëve. Me këto veprime krijoi përshtypjen se ishte njeri serioz, i zoti dhe autoritar.

Pak nga pak Guraja nisi ta nderonte e ta shihte me një sy tjetër. Shpresat për hapjen e kanalit u shtuan si bari i ri që mbin në faqe të shkëmbinjve, atje ku pranvera gjen vetëm një grusht dhé e disa rrënjë të përcëlluara nga zhegu i verës së ikur e nga ngricat e dimrit. Ndërsa vazhdonte pike timi, komisioni i kanalit grumbulloi pare, bagëti e sende të tjera që gurajasit i dhanë me gjithë zemër, të bindur se uji do të vinte në arat e tyre.

Kjo bindje u formua nga besimi që kishin tek «inxhinieri», te veglat e tij e, fundja, edhe nga besimi te dija, te shkenca. Në qoftë se shkenca nuk njihej në Gurajë, forca e saj ndihej, natyrisht në mënyrë të turbullt, përmes njohurive të pakta dhe lajmeve që vinin

gojë më gojë, të shumtën e herës të vëshura me petkun e mitit...

Kryerja e piketimeve u kremtua me një madhështi të jashtëzakonshme. Në krahasim me këtë gosti, ceremonia që u bë tek ama e Përroit të Thatë ishte si kanagjeçi me dasmën. Kjo gosti ishte dasma e Gurajës, që do ta bënte atë pjellore dhe fatlume.

Aty nga mesi i gostisë inxhinieri u çua në këmbë, me gotë në dorë. Ra një heshtje e menjëhershme. Ato dhjetëra duar që lëviznin gjithandej, u shtangën sikur t'i kishte mbërthyer ngërçi. Të gjithë sytë u përqendruan te syzet e inxhinierit, që lëshonin reflekse të lehta. Bezëzat e fshatarëve u mbushën me rrjedhën vezulluese të Ujëbardhës.

— Ju ftoj të ngremë një dolli... — inxhinieri bëri një ndalesë të shkurtër sa një rrahje qepalle që t'ua ndizte edhe më kërshërinë të pranishëmve, — për martesën e Gurajës me lumin e Ujëbardhës!

Kjo dolli e papritur, që shprehte aq shkurt, por edhe aq qartë e në mënyrë të gjallë dëshirën që regëtinte në shpirtin e gurajasve, e dyfishoi harenë dhe gjallërinë e gostisë. Duar të zgjatura, urime, kupa të zbrazura për shëndetin e inxhinierit që kishte mësuar në Evropë e që po bëhej shpëtimtari i Gurajës dhe Shenjti i Ujit. Edhe ata që e kishin trurin disi të mjegulluar nga të pirët, u bënë esëll menjëherë, si të kishin zhytur kryet në një pellg të ftohtë. Të gjithë ndien mbi trup derdhjen e ujërave të Ujëbardhës, lëmuetsinë dhe flladitjen e tyre. Një fshatar që ishte më i dehur e më i ekzaltuar se të tjerët, u ngrit nga vendi, iu afrua inxhinierit dhe deshi ta përqafonte. Kryeplaku u tha fshatarëve që kishte pranë ta largonin të dehurin nga gostia.

Kopil kopili! — tha me vete kryeplaku, duke e mbajtur me zor gurgullimën e të qeshurave që i llokoçitej nëpër trup e donte të shpërthente përmes buzëve të lyrosura nga mishi i pjekur. I erdhi në mend dasma që ishte bërë para disa kohësh në fshatin e tyre, kthimi i nuses së plakur në gjini. Edhe ti, Gurajë, vejushë

do të mbetesh! — mendoi ai me një gëzim të lig. — Nuk do të martohesh kurrë me lumin e Ujëbardhës. Kurrë... Barku i arave të tua do të mbetet shterpë, dhe qielli do të jetë saç i kuqur mbi to, dhe bimët do të shkulen pa lidhur kokërr. Fshatarët do të rrinë para meje me sy përtokë e do të më luten duke belbëzuar. Përgjithmonë...

Për të hapur kanalën u formuan dy brigada. Shumica prej tyre ishin gurajas, por kishte edhe varfanjakë nga fshatrat e tjera, që kishin fare pak tokë e i mbanin fëmijët me mundin e krahëve të tyre, duke punuar si argatë nëpër dyert e pasura. Inxhinieri tha që puna të fillonte jo tek ama e kanalit, por në gjysmë e mbrapa. Ky mendim i habiti dhe i pezmatoi gurajasit. Disa kundërshtuan haptas, duke thënë se nuk i vihej freri kalit te bishti. Por kundërshtimi i tyre u thye nga fjalët dhe arsyetimet e shumta të inxhinierit, që në dukje nuk ishin aq pa vend.

— Gjysma e përparme e kanalit është shumë e vështirë për t'u hapur, — tha inxhinieri, — ju e dini se vendi është shkëmb i gjallë dhe, për të çarë këtë shkëmb, kemi vetëm kazma e lopata. Pjesa tjetër e kanalit është më e lehtë: kalon nëpër pyje e livadhe. Më mirë ta hapim këtë pjesë, sesa të presim, derisa të gjejmë vegla e lëndë plasëse që duhen për të çarë shkëmbin.

— Po sikur të mos hipë ujët në pjesën e prapme të kanalit? — tha Kingji.

— Matjet e mia janë të përpikta, — tha inxhinieri.

Fjalët dhe siguria e tij peshuan më shumë sesa dyshimi i ndonjë fshatari. Mendimin e inxhinierit e përkrahën të gjithë anëtarët e komisionit të kanalit, ku fjala më me peshë ishte e kryeplakut. Brenda tij gurgullonte

ende e qeshura llokoçitëse e gostisë, e cila, me të ardhur te buza, mekej e strukej prapë në gurmaz.

Fshatarët që ishin mbledhur e po kuvendonin me inxhinierin e me anëtarët e komisionit nën hijen e Blirit të Madh, dëgjuan potkonjtë e një kali që po vinte drejt tyre. Në atë kalë ishte Prruk Moti. Ai i kishte hipur kalit pa shalë, me fytyrë nga bishti dhe mbahej me dorë për jele...

Kaloi dy herë para Blirit të Madh, pa folur. Fshatarët e prenë kuvendin dhe e panë me dhimbje lahtarin e tyre. Qenka çmendur i shkreti! — thanë disa vetmevete.

Herën e tretë Prruku u afrua te Bliri i Madh.

— Kam dëgjuar se do ta nisni kanalin nga fundi, — tha Prruku. — A doni ta dini si është kjo punë?!... Ja, si të hipësh në kalë kështu si unë!

Nuk tha gjë tjetër, as nuk priti përgjigje. U kthye mbarë në kalë, ngau me vrap e ia çoi të zotit...

Megjithatë as urtia e Prruk Motit nuk mundi ta ndryshonte vendimin e inxhinierit e të komisionit. Filluan gërmimet për të hapur gjysmën e prapme të kanalit. Bri Ujëbardhës, te një vend ku lumi thyente qafën, u ngrit një sharrë uji për të çarë dërrasa. Ato do të përdoreshin për të bërë skela pune e lugje uji atje ku kishte shkëmbinj të thiktë e gremina. Tashti vera po afrohej: një verë si gjithë të tjerat, ku nuk do të mungonin thasësira, kënga e gjinkallave, uria dhe ëndrrat për ujë.

Omeri vështroi larën e borës. Tani nuk i ngjallte kënaqësi as ajo larë bore, as ngjitja në bjeshkë. Nuk i ngjallte kënaqësi asgjë midis tokës e qiellit. Ai e ndiente veten si një gur lumi që nuk dihet nga ç'vend është

rrokullisur e ku do të ndalet, por vetëm shkon andej nga ta shtyjë rrjedha e ujit.

Pas disa ditësh lara e borës do të marrë formën e kalit, mendoj ai. Tubat do të ngjiten në bjeshkë, do të verojnë, mandej do të zbresin prapë në vërri. Mandej do të bjerë prapë borë. Pas dimrit do të dalë vera, do të shkrihet bora, do të mbushet vendi me bar, me lule e me dushk të ri. Mandej prapë lara e borës do të marrë formën e kalit, mandej tubat do të ngjiten në bjeshkë... Këto mendime i zhurmonin në kokë si gurët në fund të lumit. Si gurët e bardhë e të lëmuar në shtratin e Ujëbardhës që rrokullisen, rrokullisen. Kështu i duke-shin tashti edhe ditët e tij.

Gjatë kohës së dasmës Omerit ia kishte kullotur tubën Mushaku. Ai nuk i ndau më dhitë prej dhive të tij. Nëse më parë kishte dëshirë të rrinte i vetmuar, tani i druhej vetmisë, siç u druhet humnerave ai që i merrren mendtë. Megjithëse rrallë e hapte gojën për të thënë diçka, Omeri kishte shumë nevojë për praninë e shokut që ishte fjalëtar si një rrëke mali e këndonte tërë ditën si zog. Gjallëria dhe gazmendi i Mushakut sikur ia plotësonin atë pjesë të vetvetes që ishte mpirë, ishte gurëzuar.

— Paj, një këngë do ta këndosh me mua! — i thoshte Mushaku.

— Mos më thuaj... Nuk mundem. Nuk më del zëri.

— Për një këngë mundesh! Vetëm një këngë, s'të them tjetër.

— Ti e di që s'e lë për gjë, por m'u ka shterrë zëri. S'jam i zoti as të këndo, as të thërras...

Mushakut nuk i besohej, por hiqte dorë nga të luturat. Dhe ia niste këngës vetëm. Këndonte një, dy, tri këngë... Këndonte derisa i dhembte fyti.

Dhitë po pushonin në mriz. Mushaku ishte mbësh-tetur pas një trangu dhe po dremiste. I rrëmbyer nga një mall i beftë, Omeri zbriti tek Ujëbardha. Po mbushej viti që s'kishte qenë në breg të saj. Futi duart në rrjedhë, përkëdheli ujët, freskoi fytyrën. Iu ngjall dëshira të kën-

donte. Nga zhurma e fortë e lumit nuk do ta dëgjonte askush. U ul mbi një gur të sheshtë, që zhytej përgjysmë në rrjedhë, dhe ia filloi... Por zë nuk nxori dot. Ishte një britmë e gjërrë, e mbytur, që doli nga gryka e tij. Ç'më ka gjetur?! — sa s'klithi ai. — Kush ma ka marrë zërin?

Ndenji gjatë mbi atë gur, si i kalamendur nga rrokullisja dhe shurukama e ujërave. Në fund të pusit që ishte rrëzë gurit vezulloi një send sa shuplaka e dorës. Pasqyra e floçkës! — mendoi ai dhe u ngrit në këmbë i frikësuar. Në këtë çast dikush lëvizti te kaçubat pranë gurit. I pushtuar nga paniku, nga kjo ndjesi e stërmoçme e njeriut, Omeri u hodh nga guri dhe u turr përpjetë shpatit «si shtatë herë rrufeja».

— Omer, Omer... jam unë! Çka ke?! — bërtiti Mushaku i befasuar.

Por Omeri nuk e ktheu kryet, as nuk u ndal. Edhe pse zëri që i thërriste i ngjiste zërit të shokut, kjo gjë nuk e zvogëloi panikun. Floçka ka marrë zërin e shokut tim për të më mashtruar, mendonte ai. Dhe nuk e ndali vrapin, derisa mbërriti te mrizi. I thirri shokut, por nuk e pa gjëkund. I erdhi turp për atë që kishte ngjarë. U shtri në kurriz, me krahë të hapur. Zemra i gumonte brenda kraharorit që ulej e ngrihej si rrëshek farkëtari.

Kur u ngjit te mrizi, Mushaku e gjeti të qetësuar. Omeri i buzëqeshi, pa folur. Edhe Mushaku buzëqeshi.

— U trembe nga floçka? — tha Mushaku.

— Po, — tha Omeri. — Po shihja një si pasqyrë në ujë, kur krisën kaçubat.

— Floçkat janë të rrezikshme, — tha Mushaku. — Im atë më ka thënë se njëherë një bari i çoi dhinë në hijen e një mrizi, skaj një lumi. Në buzë të ujit pa një pasqyrë e shkoi ta merrte. Kur po e kapte pasqyrën, floçka, që ishte trupgjatë, e shtyu me forcë dhe e hodhi në ujë. Djali u mundua të dilte prej ujit, por floçka e mori me vete. Këtë ndodhi e pa një bari tjetër që ishte më larg.

— Edhe unë kam dëgjuar këso ngjarjesh, — tha Omeri.

— Ah, të më dilte përpara një floçkë! — tha Mushaku. — Do ta mbërtheja nga flokët e do ta çoja në shtëpi. Nuk do të vuante im atë për të më gjetur nuse... — Ai qeshi me gjithë zemër, me një të qeshur si gurgullimë gurre.

Me siguri do ta bënte këtë gjë, mendoi Omeri duke shikuar llërët e përvjela e të fuqishme të shokut, që ishin sa dyfishi i llërëve të tij.

— Më vjen inat, — tha Mushaku, — se kam ndenjur buzë lumenjve e liqeneve me orë të tëra dhe s'më kanë zënë sytë kurrkund as pasqyrë, as floçkë...

E pakuptueshme është kjo botë, mendoi Omeri. Ai ka dëshirë të takohet me floçkat, por ato nuk i dalin përpara. Të tjerëve, që s'kanë asnjë dëshirë t'i shohin me sy, ato u dalin përpara dhe i tërheqin në lumë.

Omeri që dukej sikur ishte në një botë tjetër, i tha papritmas Mushakut:

— Këndoje Këngën e Mallkimit... Për mua...

Shoku e pa me çudi një grimë herë. Deshi të zbulonte diçka më tepër, por bebëzat e Omerit ishin të padepërtueshme, rrasa akulli.

— Këngë e rëndë, — tha Mushaku. — Edhe për t'u kënduar...

— Po, — tha Omeri.

— Por për hatrin tënd po e këndo, — tha Mushaku. E qëroi fytyrën dhe ia nisi këngës. Zëri i tij u ngrit në qiell si një shpend i egërsuar, që klith e përplas krahët me dëshpërim.

*O, erdh një shoqe me folë me mue,
O, m'thotë: «I dashtuni t'u ka martue!»
O, n'qoftë martue, mos e gëzofhtë,
O, iu martoftë grueja ndër shokë,
O, iu daftë toka me konopë,
O, i cofshin dhentë tue u përvjelë,*

O, i cofshin dhinë në shtrungë tue u mjelë,
O, i coftë lopa dy ditë pa pjellë,
O, i coftë kali dy ditë pa u djergë,
O, i cofshin qetë në kular,
O, mos i mbiftë fara n'arë!...

Omeri pati një trazim, një vorbullim të të gjithë genies. I dukej sikur ajo ishte kënga e tij, e krijuar nergut për të. Dhe të gjitha ato mallkime të tmerrshme, ngjethëse i kishte thënë Jerina, kur kishte marrë vesh se ai do të martohet, do të bënte dasmë. Prandaj ajo dasmë kishte marrë fund ashtu: ishte kthyer përmbys. Ishte shndërruar në mynxyrë dhe shpoti.

Por ajo e prishi besën e para! — gati sa s'klithi me zë të lartë. — Ajo u fejuar. Ajo nuk e mbajti fjalën e nuk erdhi atë ditë tek Ujëbardha. Atë ditë kur ai e kishte pritur aq shumë, aq shumë...

Omeri vështron larën e borës, që së shpejti do të marrë formën e një kali. Atij i duket sikur është gjithnjë po ajo ditë e pambaruar, e pandryshueshme. Dhe ai është duke pritur buzë Ujëbardhës që vezullon, rrokulliset tatëpjetë, shamatohet me brigjet, grindet me rrënjët e drurëve që zgjaten në ujërat e saj, miklohet e përdridhet rreth gurëve që i zënë rrugën. Degët e lsave të pasqyruar në rrjedhën e saj të centë, sikur e gicilojnë me gishtërinjtë e tyre të blertë dhe ajo shkrihet në atë gaz valëzash, duke e mbushur hapësirën përçark me të qeshura vezullimesh. Por ajo ditë ka ikur, nuk është më...

Ti nuk erdhe atë ditë, Jerinë, por edhe unë si nuk u bëra i gjallë?! Si nuk bëra asnjë përpjekje për t'u marrë vesh me ty?! Ajo që ndjeva atë ditë që më e fortë se unë. Të urreva. Të urreva e të përbuza, kur mora vesh se ishe fejuar. U mundova me të gjitha forcat e mia të të harroja. Të harroja edhe fytyrën tënde, edhe sytë e tu, edhe zërin tënd. Të harroja edhe emrin tënd. Por sa më me mllëf që luftoja kundër kujtimit tënd,

ai ngulej edhe më thellë në veten time. Ti ishe përndarë rreth meje si vesë, pa mundur të bëheshe Jerina e gjallë, e vërtetë, ashtu si vesa që s'bëhet dot rrëke. Ashtu si vesa e avulluar, ti u bërë mjegull, mjegull e bardhë. Dhe gjithë këtë kohë kam jetuar i zhytur në këtë mjegull.

Omerit i erdhi në mend një krijesë tjetër që e kishte pjellë fantazia e Gurajës: kallukanxha. Ajo ishte një trajtë mjegulle, i dilte njeriut përpara dhe e bënte të humbiste rrugën. Një gurajas betohej se një ditë i kishte dalë kallukanxha përpara. Ai kishte ecur gjithë ditën pa e ditur se nga po shkonte, e së mbrami kishte mbërritur po tek ai vend ku ishte nisur.

O, Jerinë, Jerinë... përse të bënë mjegull për mua?! Mjegull e bardhë. Mjegull...

— Mos ke gjë? — i tha Mushaku që ia kishte ngulur sytë.

— Jo, — tha Omeri.

— A mos don të këndoje ndonjë këngë tjetër?

— Jo, Mushak. Kjo më mjafton...

Mushaku nuk foli më. Mbushi dorën e majtë me gurë të vegjël, mandej zuri të qëllonte me ta një lastar të drejtë shkoze.

— Mushak, — i thirri me një zë të mbytur.

Mushaku u befasua nga pamja e Omerit. Një fytyrë i shkonte e një fytyrë i vinte si ato ndryshimet që ndodhin në ditët e para të pranverës, kur dielli duket e zhduket midis reve, kur shiu e dielli ndërrohen brenda disa çasteve, sikur luajnë kukafshehthi.

— Kam një hall, — tha Omeri. — Më duhet të shkoj në një vend. Dhitë po t'i lë ty.

— Kur do të kthehesh?

Omeri u mendua një hop.

— Nuk e di.

— A do të kthehesh para mbrëmjes? — pyeti Mushaku.

— Si të bëhet puna... — tha Omeri.

Mushaku e vuri re se ai donte t'i shmangej një përgjigjeje të përcaktuar. Megjithatë nuk hoqi dorë nga pyetjet.

— Çka t'u them në shtëpi, në mos u kthefsh deri në mbrëmje?

— Thuaju se do të vonohem pak...

Omeri zbriti nëpër shtegun gjarpërues të pyllit, të shtruar me gjethe ngjyrë kafe të errët. Nuk e kishte mendjen aty e nuk shikonte fare ku shkelte. U ndal menjëherë, kur diçka lëvizi para këmbëve të tij, në një tog me gjethe të thata. Ishte një gjarpër me një zigzag të zi në kurrizin e hirtë. Shlligë! Omeri kapi disa gurë dhe e gjuajti me ta. Shlliga u egërsua. Lëvizjet e saj u bënë të vetëtimshme. Qëllonte anash me kokën që e lëshonte si shigjetë. Gurët i binin në pjesën e përparme të trupit ose para kokës, sepse Omeri synonte ta godiste në kokë. Shlliga u kthye mbrapsht, drejt tij, e shpejtë, e llahtarshme, me gjuajtje të rrufeshme. Omerit i kishte mbetur në dorë vetëm një gur rrasatak. U përpoq të qëllonte me saktësi. Trupi i shlligës u këput në mes. Megjithëse copërat e saj ende lëvrinin, madje edhe zvarriteshin, e kishin humbur burimin e jetës e të forcës. Por koka gjuante andej-këndej tërë llahtar, me egërsi e dëshpërim.

Omeri e dinte se në pjesën e prapme të qiellzës ishin dhëmbët helmues. Mori dy degë të thata, ia bëri zap kokën e ia hapi nofullat. Kur maja e degës takoi pjesën e prapme të qiellzës, doli jashtë një dhëmb i hollë, si gjilpërë qelqi, dhe prej tij teptisi një lëng midis portokalles e së gjelbrës: vredi¹⁾ i gjarpërit. Kur maja e degës takoi dhëmbin tjetër, vrushkulli i helmit doli me kaq forcë, sa ia stërpiku edhe gishtat...

Çasti kur gjarpri, edhe i copëtuar, lëshoi helmin e tij, nuk iu hoq nga mendja derisa arriti te vendi, kur rruga kthehej për në Breglum. Ku po shkoj?!... — men-

1) helmi i gjarpërit.

doi me vete. — Kjo që po bëj unë është marrëzi. Madje një marrëzi e vonuar. Këtë gjë duhej ta kisha bërë qysh vjet. Në vend që të gjeja një mënyrë për të biseduar me të, të merrja vesh si kishte ndodhur puna e fejesës, e quajta të pabesë. U mundova ta urreja e ta përbuzja, që ta harroja. Heshta që t'i bëja keq asaj, por në të vërtetë i bëra keq vetes sime. Ajo s'mund ta marrë me mend se sa kam vuajtur gjatë kësaj kohe... Por ndoshta edhe ajo ka vuajtur. Nuk e ka pasur të lehtë të pajtohet me fatin e saj. Megjithëse është i pasur, ai që e ka zënë, është i moshuar dhe ka një grua tjetër që s'i bën fëmijë.

Këtë gjë Omeri e kishte dëgjuar krejt rastësisht, pak kohë pas prishjes së dasmës. Ato fjalë qenë një erë e fortë që i fryu zjarrit të vjetër të mallit, por edhe një zjarri të ri, keqardhjes. Mbase më tepër se keqardhje, ajo ishte një ndjenjë afërie që të lind për një njeri të njohur, kur me të të lidh një fatkeqësi e njëjtë. Pra, nuk ishte vetëm ai Gurajë e përvëlur, që kërcënohej nga zhegu dhe thatësira.

Edhe ti je Gurajë, Jerinë! Edhe ti je Përrua i Thatë! Po ne çka mund t'i falim njëri-tjetrit?! Thatësirën, zhegun e përvëlimin tonë. Po atëherë ata do të ishin dyfish më të rëndë, më të mundimshëm...

Vuri re se kishte bërë një copë të mirë të rrugës. Larg, përpara tij, midis gjelbërimit të harlisur të kopshteve, të arave e të livadheve, shqoi njollat e kuqërremta të çative të Breglumit.

Deri aty nga mesi i vjeshtës ranë vetëm shira të shkurtra. Shtrati i kanalit u gërmua në një gjatësi bukur të madhe. Por ai i ngjante një rrëshqanori të prerë copë-copë, meqenëse pjesët e hapura nuk ishin bashkuar

me njëra-tjetrën. Ujë të rrëmbyer të Ujëbardhës rrokullisej nëpër lugun e pjerrët, duke vënë në lëvizje sharrën që çante ditë për ditë trupa pishe e bredhi. Dërrasat e reja që binin erë të mirë deri larg, i morën kryeplaku dhe anëtarët e tjerë të komisionit. Ata filluan të rregullonin me to shtëpitë e tyre, të shtronin dysheme e të bënë tavane të reja, të zbukuruara me gdhendje e figura që s'ishin njohur më parë në Gurajë.

Kjo gjë i zemëroi keq fshatarët, të cilët i kërkuan llogari komisionit për dërrasat që duhej të përdorehin vetëm për kanal, për ujë, për bukë. Përdorimi i atyre dërrasave për dysheme e tavane u dukej si përdhosje e një gjëje të shenjtë. Jo vetëm dërrasat, por çdo gjë që lidhej me kanal, në sy të gurajasve kishte fituar njëfarë shenjtërie, një nderim të posaçëm.

Komisioni tha se puna në pjesën shkëmbore do të fillonte pas një ose dy vjetësh, kështu që kishte kohë sa të duash për të çarë dërrasa të reja. Cilido që kishte marrë dërrasa, do t'i paguante një për një dhe këto pare do të shfrytëzoheshin për të hapur kanal, për të blerë mjete të nevojshme. Fshatarëve u ra zemërimi, por dyshimi mbeti brenda tyre, syhapur, veshngrehur.

Tani inxhinieri shkante më të rrallë te kanali. Pjesën më të madhe të kohës e kalonte duke zënë peshk në Ujëbardhë, duke u zbavitur në shtëpinë e kryeplakut. Pëshpëritej se ai «e përdorte si gruan e tij» një nuse të asaj shtëpie.

Kur zunë shirat dhe u shumuan ujërat e lumenjve, fshatarët ngulën këmbë që të bashkoheshin pjesët e gërmuara të kanalit e të bëhej provë e ecte ujët nëpër të. Inxhinieri e kundërshtoi këtë gjë, duke thënë se punimet i drejtonte ai bashkë me komisionin e kanalit, prandaj fshatarët duhej të shikonin punën e tyre. Ai foli me nervozizëm dhe u hoq si i fyer rëndë. Në bebëzat e tij, prapa xhameve, lodronte një e qeshur tinëzare, djallëzore.

Një të diel, kur ishte radha që të shkonin punëtorët

në shtëpi për të ndërruar teshat, disa gurajas u morën vesh të ngjiteshin fshehurazi te kanali. Që pa gdhirë ia behën te pjesa e gërmuar me vegla në krahë. Deri në drekë pastruan gati gjysmën e brezave të dheut.

— Edhe kaq mjafton. Ta bëjmë provë!...

Fshatarët morën ujët e një përroi dhe e lëshuan në kanal. U afruan në të dy brigjet e tij, duke pritur me ankth se ç'do të ngjiste. Dikush mbushte çibukun, dikush dridhte cigare në fletë duhani. Në ajër u përhap era e mirë e eshkës së ndezur. Ai që ndizte çibukun a cigarën e tij, ia kalonte eshkën shokut.

Në kanalën e ri uji eci disa metra përpara si një rrungajë e kuqërremtë. Ato çaste shumë gurajas i breu pendimi dhe u erdhi turp që kishin dyshuar tek inxhinieri, te veglat dhe shkenca e tij. Ata çapiteshin buzë kanalit, rënd-rëndë, krushq që shoqëronin një nuse: nusen më të bukur që kishte shkëlur ndonjëherë në truallin e Gurajës.

Por krushqit shumë shpejt u kthyen në varrtarë. Ujët ngeci, u fry, mandej filloi të ecte së prapthi. Në rrjedhën e turbullt, që dukej sikur po shkumonte nga zori, ranë cigare e bishta cigaresh, që fshatarët i flakën me mllef, për të shfryrë dufin e brendshëm. Prushi i tyre shuhej menjëherë si ëndrrat e gurajasve që po ndiqnin me sy ujët që u kthye mbrapsht.

Duke mos dashur ta besonin këtë gjëmë të re, ata futën ujë në kanal edhe në dy vende të tjera. Kudo po ajo gjë: në vend që të shkonte drejt Gurajës, ujët ikte prej saj...

Lajmi për ujët që ecte mbrapsht arriti në Gurajë si një dridhje toke.

Të nesërmen u mblodh kuvendi te Bliri i Madh. Aty erdhën edhe anëtarët e komisionit. I pari e mori fjalën kryeplaku.

— Inxhinieri paskësh qenë faqezi! — tha ai. — Na preu në besë. Ju qaheni se një pjesë e kanalit qenka qitur gabim dhe uji nuk ecka nëpër të. Por ka ndodhur një

e keqe shumë më e madhe. Inxhinieri është zhdukur nga fshati ynë dhe ka marrë me vete të gjitha paret që ruheshin në arkën e komisionit. Ka thyer arkën...

Nga këto fjalë fshatarët u tronditën sikur atë çast të ishte çarë toka e Gurajës deri në kërthizë të dheut. Edhe një herë ëndrrat e tyre për ujë u rrënuan kulm e themel. Në sytë e tyre të përgjakur nga zemërimi parakalan mijëra vera të thata, të etura; vera të shkuara e vera të ardhshme; vera ankthi dhe urie, të mbështjella me një pluhnajë hiri e me një grafullimë djegieje. Nëpër të çarat e tokës së përtharë nga zhegu do të shpërthenin edhe klithmat e të vdekurve, do të zgjateshin edhe eshtrat e tyre, për t'u bashkuar me britmat e të gjallëve, ndanë arave të shkrumbuara, me duar të ngritura drejt qiellit:

— Ujë!... Ujë!...

Tronditja, dëshpërimi i paskajshëm ia lanë vendin mllëfit, që tani ulërinte brenda qenies së tyre si bishë e plagosur për vdekje. I frikësuar nga ky mllëf, kryeplaku u drodh e u përdrodh, duke u qarë për dëmet e rënda që i kishte bërë inxhinieri. Edhe anëtarët e komisionit thanë se i ikuri u kishte marrë hua shuma të mëdha paresh.

— Ti e solle në fshatin tonë! — i thanë fshatarët kryeplakut. Ai vuri re në sytë e tyre disa shkrepitima që e trembën.

— E solla për të mirën e fshatit! — tha kryeplaku. — Gjithë kohën e mbajta në shtëpinë time e në bukën time. Ai më preu në besë!...

Si u mendua pak, shtoi:

— Do të ankohe mi në qeveri. Qeveria do ta gjejë e do ta detyrojë të na kthejë paret.

Me fjalët e fundit deshi të shuante ato shkrepitima, ato flakë që k'fëshpëroheshin në sytë e gurajasve. Mirëpo kjo gjë nuk mund të bëhej, siç nuk mund të shuhet një pyll i ndezur me disa grushte ujë.

Fshatarët e mallkuan inxhinierin me të gjitha nëmat e tyre.

Edhe pse s'kishin asnjë grimë besim se do t'i shtinin prapë në dorë paret e grabitura, fshatarët çuan dy vetë në nënprefekturë. Ata kërkuan të takoheshin me nën-prefektin, i cili i priti buzagaz, tërë dashmirësi, si zyrtar i kulturuar. U dha nga një cigare të jashtme që gurajasve iu duk si kashtë (kështu thanë më vonë). I dëgjoi me vëmendje e durim, pa i ndërprerë asnjëherë. Ai s'kishte pse ta bënte këtë gjë, sepse fshatarët ndërprisnin njëri-tjetrin, sapo u kujtohej diçka, dhe donin që të mos linin mangut asnjë hollësi. Pasi dëgjoi ankesën e Gurajës, nënprefekti shprehu keqardhjen e tij të thellë për ngjarjen e papëlqyer që kishte ndodhur. I siguroi se do të bënte çmos për të kapur mashtruesin e kusarin, që kishte bërë krim ndaj Gurajës, «ndaj një pjese të mbretërisë».

Ç'është e vërteta, ky premtim ngjalli njëfarë shprese të vakët në Gurajë. Fshatarët i detyronin shokët e tyre që kishin qenë në nënprefekturë ta përsëritnin disa herë bisedën me nënprefektin.

— Po si ishte ky nënprefekti? — pyesnin kuresh-tarët.

— Burrë i ëmbël... si tamblu i dhenve. Veç flokët i kishte si t'ia kishte lëpirë lopa! Thyen qafën miza, po të ulet në petka të tij!...

Ata ishin gurajas dhe natyrisht nuk e dinin se nën-prefekti i tyre i kushtonte një kujdes të posaçëm tualetit të tij, duke psherëtirë për sallonet e Evropës dhe për ballot e kryeqytetit.

Tri ditë para dasmës, Jerina u zhduk nga kulla e vet dhe nga Breglumi.

E ëma e Jerinës kukati mbi pajën e hapur në kthinë,

ashtu siç qaheshin të vdekurit kur nuk u gjendej trupi, ndërsa i ati i çoi fjalë mikut:

— Vajza më ka ikur. Jam koritur me ty, por s'kam ç'të bëj. As unë s'e kam dashur këtë punë!

— Të dielën vij me njëqind krushq, — iu përgjigj miku. — Ka edhe vajza të tjera në Breglum. Pa marrë një nuse nuk dal, ndo pa u vrrarë me gjithë Breglumin!....

Të dielën në drekë njëqind krushq me njëqind pushkë u ndalën në një kodër, kundruall Breglumit. Ata ishin burra të fortë, të zgjedhur pikë e pikë në disa fshatra. Ishte e qartë si drita e diellit se ata nuk do të largohehin pa nuse ose pa luftë.

Breglumasit nuk ishin frikacakë, por edhe të përgjakeshin e të vriteshin për një femër nuk ua merrte mendja. Ata kishin ara pjellore, livadhe e kullota të pasura. Breglumasit nuk e njihnin as thatësirën, as urinën: tërë ujërat e Ujëbardhës rridhnin pranë arave të tyre.

Meqë në shtëpinë e Jerinës nuk kishte ndonjë vajzë tjetër në moshë të martesës, krerët e Breglumit vendosën të gjenin një nuse në fshat, për t'ua dhënë me vete krushqve që po prisnin në kodër me njëqind pushkë të mbushura.

— T'u japim çikën e Sykës! — tha një plak me një qyrk të vjetër, që i kishin rënë qimet si ujçve të uritur në pranverë.

— Fjalën ar e ke, o Çaush, he mos t'u kalbtë ashti kurrë!...

Të kënaqur që e gjetën shtegdaljen, u nisën për te shtëpia e Sykës, duke vrrarë mendjen se ç'do t'i thoshnin për ta bindur. Syka ishte vejushë me shumë fëmijë. Ia kishte vrrarë rrufeja burrin në bjeshkë, duke kullotur delet.

Fëmija më i madh i Sykës ishte vajzë. Ishte pikërisht vajza që Çaushit i vaji në mendje për ta nusëruar që të shpëtohej qetësia e Breglumit. Ajo po u afrohej të tridhjetave, ishte e bëshme, e shëndetshme,

por pa kurrfarë bukurie. Megjithatë shkaku i vërtetë që s'ishte martuar deri tashti, nuk ishte mungesa e bukurisë. Edhe për të kishte pasur kërkesa, por në fillim e ëma nuk kishte dashur ta fejonte. Ajo e kishte të bijën krah të djathtë dhe mendonte ta mbante edhe disa vjet në shtëpi, t'ua shihte vlerën llërëve të saj të forta.

Më vonë kërkesat u rralluan. Në shtëpinë e Sykës trokitën vetëm njerëz dorëhollë, sidomos nga Guraja. Syka më mirë pranonte ta linte të bijën pa martuar, sesa t'ia jepte një derëfikuri, të cilit «s'ka ç'i ha miu pas darke».

Çausi dhe burrat e tjerë të fshatit i treguan Sykës se ç'kishin menduar. Duke kujtuar se ata po e mëshironin, ajo u prek në sedër dhe lëshoi fjalë të rënda. Mirëpo, kur ia mbushën mendjen se kjo gjë do të shpëronte fshatin nga gjakderdhja, se miku ishte derë e mirë e burrë në zë, Syka u pendua për fjalët e rënda dhe pranoi ta niste të bijën nuse. Madje asaj i qeshi maja e hundës, sepse së bijës i kishte ikur kaherë koha e martesës dhe, megjithëse e ke mish e gjak tëndin, «vajza në gjini asht pleh i zi».

Atëherë doli një prapësi tjetër: vajza e Sykës, e pafejuar, s'kishte bërë pajë, s'kishte qepur petka, prandaj s'kishte si të nusëronte. Kjo pengesë u kapërcye më lehtë. I ati i Jerinës tha se do të sillte petkat e së bijës. Kur ishte larguar nga Breglumi, ajo kishte marrë me vete vetëm teshat e vajzërisë veshur në shtat.

Kur u hap arka me petkat e nusërisë, e ëma e Jerinës kukati mbi to, derdhi lot çurg e nuk deshi t'i jepte. I shoqi e shtyu me forcë, ia shkuli petkat nga duart e i çoi në shtëpinë e Sykës.

Ceremoniali i zakonshëm që përdorej për të bërë gati nusen, u gjymtua fare. E heshtur si një kukull druri, e bija e Sykës u vesh nuse, hipi në kalë të alltë dhe u nis për te krushqit. Ajo ishte e hutuar dhe ende i dukej sikur po shihte një nga ato ëndrrat e nusërimit, që i sajonte fantazia e saj në netët e pikëlluara.

Krushqit e morën nusen dhe u hipën kuajve, të cilët pas pak do t'i ngisnin drejt sofrave të dasmës. Buçitën qindra krisma pushkësh nga të dyja palët. Nuk ishte gëzim i paktë të qëlloje retë me ata plumba që mund të ishin ngulur në trupin e tyre...

Breglumi e lau borxhin e tij, por tashti i mbetej të kërkonte borxhin që i kishin të tjerët. «Ku shkon pësh-tjellaku, shkon gjaku!» — thoshte kanuni. Këtë gjë e dinte edhe i ati i Jerinës. Mirëpo ai dinte edhe këtë tjetrën: gjaku lahet me gjak. Ai s'do të nguronte as sa një rrahje qepalle për të derdhur gjakun e tjetrit, me kusht që të mos derdhej gjaku i tij. Por kjo gjë ishte e pamundur. I ati i Jerinës nuk bënte pjesë në radhët e fatlumëve të fshatit dhe fëmijët i kishte të parritur. Një mik i tha të paguante një doras për të vrarë Omerin, por ai nuk pranoi, se edhe kështu gjaku do t'i mbetej atij në derë.

Vajza që iknin dhe martoheshin me ata që donin, kishte pasur në çdo kohë. Madje edhe në Breglum. Por Breglumi nuk kishte derdhur gjak për këtë punë. Ai nuk e kishte bërë këtë gjë ngase ishte më shpirtgjerë e më i njerëzishëm, por ngaqë ishte më dorështrënguar edhe në derdhjen e gjakut...

Gurajasit mbetën me shpresë deri në pranverë se qeveria e mbretit do ta kapte inxhinierin e rremë që i kishte mashtruar e grabitur dhe do t'u kthente florinjte e tyre.

Gjatë kësaj kohe kanali i lënë përgjysmë u sulmua pamëshirshëm nga rrëketë e rrëmbyera që rroku-llisën në të gurë të shkukur, dhera të shembura, drurë të rrëzuar dhe kalbësira pylli. Ujët e lluca që lanë

shirat, qëndruan në të derisa filloi vapa. Kur u avullua ujët, ashtu si në rrëketë dhe në pellgjet e tjëra, në fund të kanalit mbeti lëmashk i gjelbëremë, me erë të rëndë prej gjarpri të ngordhur.

Të dërguarit e fshatit u kthyen nga nënprefektura helm e vrer. Nënprefekti u kishte dhënë prapë cigare si kashtë, u kishte folur buzagaz, por u kishte thënë se mashtruesi e kusari (këtu e kishte ngritur zërin lart), kishte ikur jashtë, në Evropë. Atij i vinte keq sa s'thuhej, por atje nuk arrinte dora e mbretërisë. Megjithatë ai u premtoi se do t'i ndihmonte për të gjetur inxhinierë të vërtetë e të zotë, të cilët do të merrnin përsipër projektimin dhe ndërtimin e kanalit të Gurajës. Për këtë punë do të bisedonte me Grosh Malotën. Kur dëgjoji fjalët e fundit, bajraktarit i vajti dora menjëherë te majat e mustaqeve. Majat e kuqërremta, të përdredhura së tepërmi, u kreshtuan përpjetë si flakëza.

Humbja e pareve përgjithnjë ishte për gurajasit humbja e shumë shpresave. Por ata kishin një këmbëngulje të dëshpëruar. Pas çdo dështimi e zhgënjimi të rëndë, e merrnin veten si bari i shkelur. Kjo ngjau edhe pas propozimit të nënprefektit. Kuvendi i fshatit vendosi që Grosh Malota të nisej që të nesërmen për rrugë. Vegimi i kanalit dhe i ujit të cemtë të Ujëbardhës fektoi përsëri në sytë e të gjithëve.

Megjithatë kësohere zërat mosbesues qenë më të shumtë se më parë. Mendimet e fshatarëve kryqëzoeshin me njëri-tjetrin si rrënjët e gjata të lisave pleq. I ulur rrëzë Blirit të Madh, Prruk Moti i binte lahutës, vëzhgonte brymën, vesën, mjegullat e retë dhe parashikonte ditët me thatësi, ditët me shi, mbarësinë e pemëve e të drithërave. Rreth resë së përhime të kapuçit të tij përdridhej vetëtima e përhershme e shamisë së kuqe.

Grosh Malota erdhi nga kryeqyteti i mbretërisë «me tri palë inxhinierë», siç thanë gurajasit.

— E çuam për një e na solli «tri nuse»! — tha Kingji. — Tash po e shohim sa do të na kushtojë dasma e tyre...

Inxhinierët e panë vendin ku do të kalonte kanali, duke mbajtur shënime e duke bërë secili llogaritjet e veta.

Gjithë Guraja u mblodh te Bliri i Madh.

— Vetëm të vdekurit kanë mbetur pa ardhur! — tha Prruk Moti, duke vënë buzën në gaz, por e qeshura nuk u përhap dot në fytyrën e tij tërë rrudha si lëkurë qarri.

Kur erdhën inxhinierët, fshatarët u bënë të heshtur si shkëmbinjtë e Gurajës në piskun e vapës. Vetëm gjethet e blirit që nuk mund të merrnin pjesë në shqetësimet e njerëzve, vazhdonin pëshpërimat e tyre të shkujdesura.

— Për të projektuar e për të ndërtuar këtë kanal duhen 30 000 napolona flori, — tha inxhinieri shqiptar. Fytyrat e gurajasve u ngurtësuan. Edhe shpirti i tyre u tkurr, u tendos nga dhimbja që u shkaktuan ato fjalë.

— Për projektimin dhe ndërtimin e kanalit që do t'i marrë përsipër një sipërmarrje italiane, ne kërkojmë 35 000 napolona flori, — tha inxhinieri italian.

— Për projektimin dhe ndërtimin e këtij kanali që do t'i bëjë një sipërmarrje angleze, ne kërkojmë 45 000 napolona flori, — tha inxhinieri anglez.

Ata folën shkurt, pa bërë shpjegime e argumentime, pa hyrë në hollësira. Fjalët e tyre i përngjisnin ndivnesës¹⁾ së errët të një orakulli ose dënimit që jep një gjykatë e epërme. Ai që kërkoi shumën më të vogël deshi t'i joshte gurajasit me anë të zemërgjerësisë, ndërsa ai që kërkoi shumën më të madhe, me anë të sigurisë.

1) profeci

Dhe po të kishin pasur mundësi për të paguar, ata do të kishin pranuar pikërisht propozimin e inxhinierit anglez, sepse ai që kërkon më shumë të duket sikur është më i sigurt, bën punë më të mirë.

Grumbulli i monedhave të përfytyruara që do të duheshin për të bërë shumat që kërkonin inxhinierët, u rrokullis mbi gurajasit si një ortek i madh që të merr me vete e të varros të gjallë në borën e ftohtë. Tani shpirti i tyre ishte ngjeshur e ndrydhur kaq shumë, sa nuk e ndiente më goditjen. Por dhimbja i kishte lënë vend një ndjenje më të rrezikshme: humbjes, fatalitetit, zemërimit të ftohtë.

— Zotni, kaq pare nuk mund t'i bëjmë, edhe sikur të shesim pikat e gjakut tonë! — i tha Prruk Moti inxhinierit shqiptar. Fytyra e lahutarit, e rrudhosur si lëkurë qarri, ishte shëmbëllimi më i gjallë i Gurajës së plasarit në gusht.

Të tjerët nuk folën. Ata e ndienin se nuk ishte koha për të kuvenduar, por për të heshtur e për të mbajtur zi për kanalin e tyre, për ëndrrën e ujit, për Gurajën e thatë.

Pasi thanë se ishin gati në çdo kohë ta merrnin përsipër projektimin dhe ndërtimin e kanalit, kur t'u mbushesh mendja gurajasve e të mblidhnin shumën e caktuar të pareve, inxhinierët u hipën kuajve dhe u larguan, të përcjellë nga Grosh Malota...

Atë ditë nuk u dëgjua asnjë këngë në Gurajë. Si ta kishin bërë me fjalë, barinjte i mbushën me bar e me dushk këmborët, cingaret e trokat e bagëtive. Mbi Gurajë peshonte lëmashku i gjelbëremë i heshtjes. Thasësira kishte hyrë në shpirtin e njerëzve.

Vetëm një njeri nuk e la këngën: Prruk Moti. Fillikat — atë ditë e braktisën edhe fëmijët — ai i ra lahutës dhe këndoi për dyluftimin e Gjergj Elez Alisë me Bajlozin e Zi. Askush nuk e di me saktësi pse këndoi pikërisht këtë këngë: e zgjodhi enkas, apo i erdhi rastësisht në mendje. Sidoqoftë Prruk Moti mendonte

se ato ditë në Gurajë kishte ardhur një krijesë e keqe, e errët, që kishte lënë prapa një hije ogurzezë dhe një duhmë të rëndë...

Te shtëpia e Kingjit:

— Tash na ka mbetur vetëm një shtegdalje.

— Cila?

— Të heqim dorë nga kanali e nga ujët...

— Kingj, mos e thuaj atë fjalë, pash bukën!

— Ose t'i futemi punës e ta hapim vetë kanalin, pa inxhinierë e pa shtete të huaja.

— Mirë, po i futemi... Por a mund t'ia dalim mbanë?!

— Mund t'ia dalim, po t'i prijë kësaj pune Ibër Shpata.

— Heu, si s'më shkoi mendja hiç në të!... Por Ibra ka pak kohë që ka dalë prej burgu.

— E çë?

— S'po di a do të pranojë.

— Do t'ia mbushim mendjen ne.

— A thua?

— Atë verë që mësymë Tiranën, në një katund pamë një kanal që kalonte nëpër shkëmb të gjallë. Ibra ishte skaj meje. «Mos vdeksha pa e nxjerrë një kanal si ky edhe në Gurajë!» — më tha.

— Atë verë thamë shumë gjëra. Çelën shumë lule, por nuk lidhën... I shkreti Ibër, u kalb në burg kot! Pasha bukën, këtë nder e ka prej kryeplakut.

— Kryeplakut ia ka parë sherrin shumëkush. Paj, edhe tërë Guraja.... E pres kryet se edhe grabitja e parëve tona, edhe arratisja, po i themi kështu, e atij horrit që na u hoq si inxhinier, nuk është bërë pa dijeninë e tij.

- A thua të ketë gisht në këtë punë?
- Do t'ia dëgjosh krismën më vonë... Por tash të kthehemi aty ku e lamë.
- Ti je i mendjes të shkojmë tek Ibra?
- Po... Dhe pa vonuar.

Te shtëpia e Ibrës:

- Punë e rëndë është...
- E dimë, Ibër. Prandaj e pleqëruam bashkë e thamë se këtë punë mund ta bësh vetëm ti. Askush tjetër në Gurajë nuk mund ta bëjë.
- Por është fort e vështirë, Kingj.
- Vështirë deri në qiell, Ibër. Por dikush duhet t'i dalë për zot kësaj pune. Dhe ai dikush je vetëm ti. A të bie në mend çka më ke thënë njëherë, kur pamë atë kanal in në Dibër?
- Tjetër kohë atëherë. Edhe unë po ndryshe kam qenë.
- Mishi i njeriut plakët, Ibër, por jo shpirti i tij. Ty nuk të është trembur syri kurrë.
- S'është fjala te trembja ime...
- Atëherë?
- Kohët e fundit Guraja është përplasur disa herë. Ka parë me sy prova e dështime. Po kam frikë se mos po ia shtojmë edhe një dështim tjetër. Ndoshta ky do të ishte më i madhi, se do t'i vinte nga njerëzit e vet. Deri tash e kanë mashtruar të tjerët.
- Ne nuk kemi si ta mashtrojmë, sepse ia duam të mirën. Guraja ka nevojë për ujë. Thatësira dhe uria po ia marrin shpirtin. Ne duhet ta sjellim ujët në arat e Gurajës.
- Por kjo punë nuk bëhet as me thonjtë e duarve, as me dy-tre vetë. Duhet pare...

— Do t'i gjejmë.

— Ku?

— Ku të mundemi.

— E njoh gjendjen mirë. Njerëzit shesin bagëtitë për të blerë misër. Ata i shtyjnë martesat, se nuk kanë para.

— Por për kanalin do të kenë. Edhe unë e njoh mirë Gurajën. Ajo është gati t'i shtyjë të gjitha dasmat, të hajë dardha e barishte të ziera, veç të sjellë ujët në arat që i digjen vit për vit... A i dëgjon? Kanë filluar gjinkallat!

— Po i dëgjoj. Pak si shpejt ia kanë filluar sivjet.

— Mua më dhemb kryet kur i dëgjoj... Duhet të vijë ndonjëherë ajo ditë, kur Guraja ta dëgjojë këngën e gjinkallave e të mos i dridhet shtati.

— Ibër, a e beson se mund të vijë kjo ditë?

— Besoj se do ta detyrojmë të vijë...

Te shtëpia e kryeplakut:

— Thonë se kanali e ka marrë përsipër ta hapë Ibër Shpata.

— O zot, sa e madhe qenka marria në Gurajë! Mbase njerëzve këtu u avullohen trutë nga vapa, Kurtesh.

— S'e ke keq.... Po sikur ky Ibra të bëjë diçka?

— Të hapë kanalin?

— Po.

— Mezi po e mbaj gojën pa të sharë dhe ty. Ti i dëgjove fjalët e inxhinierëve. Ky kanal nuk është as për fuqinë e Ibër Shpatës, as për kuletën e Gurajës, — tha kryeplaku duke qeshur me të madhe.

— Ibra është mjeshtër i mirë guri e druri. Ka nxjerrë në lagjen e tij një vijë uji që të habit.

— Vijë me një gisht ujë!

— Por i thonë një fjale: kush bën vedrën, bën edhe bucelën.

— Hiqe nga mendja këtë gjë, Kurtesh. Në Gurajë nuk do të mbërrijë kurrë ujët e Ujëbardhës. A më dëgjon, kurrë!

Ibra e mori përsipër hapjen e kanalit të Gurajës, me kusht që komisionin ta caktonte vetë. Ai zgjodhi disa shokë që i njihte mirë, fshatarë të besës e të ndershëm. Në komision nuk u caktua asnjë pari, megjithëse as ata nuk lakmonin të ishin anëtarë të tij. Ata mendonin se tashti Guraja ishte një lopë shterpë dhe pjesëmarrja në komision nuk do t'ua frynte kuletën. Prapëseprapë rifillimin e kanalit nuk e kundërshtuan haptazi. Ata përdorën një armë tjetër që pati ndikim më të madh në Gurajë: heshtjen, mospërfilljen.

I vetmi që e përkrahu mendimin për t'ia hapur kanalnin me forcat e veta, qe Grosh Malota, i cili e kishte këmborë në qafë porosinë e nënprefektit. Veç kësaj, ai shfrytëzonte çdo rast që i paraqitej për të krijuar njëfarë epërsie mbi krerët e tjerë të Gurajës. Për këtë qëllim thoshte e bënte gjithmonë të kundërtën e asaj që thoshin e bënin ata, kur ia merrte mendja se nga ky kundërshtim do të fitonte kapital politik.

Komisioni caktoi pagesën për një rend uji.¹⁾ Ai fshatar që dëshironte, do të paguante për aq ujë sa kishte nevojë për të ujitur tokën e tij. Ndonëse kundërshtimi e mosbesimi kishin përfshirë në vorbullën e tyre mjaft gurajas, kur erdhi puna për të blerë rendat e ujit, gati nuk mbeti asnjëri pa dhënë bagëti, pare, ç'të kishte.

Ndërsa komisioni po merrej me hartimin e listës së rendatarëve, me grumbullimin e të hollave, të ushqimeve si dhe me gjetjen e punëtorëve, Ibra, bashkë me

1) Sasi uji për të ujitur njëzet e katër orë

dy ndihmës që mbanin shkopinjtë për nivelimin e shtratis të kanalit, ngulte piketat e reja në brigjet ndanë Ujëbardhës. Për të mos humbur kohë, flinin në një shpellë të Kershës i Kuq. Ngriheshin pa u shkimur yjtë në qiell dhe e linin punën kur prishej thumbi i pushkës.

Piketimi u eci mbarë derisa arritën te një faqe shkëmbi. Në atë rrasë të larë ngjiteshin vetëm xhufka bari, shkurre të holla dhe urtha që kacavireshin midis të çarave si rrëshqanorë mijërakëmbësh. Në krye të saj, nëpër guva të vogla, kishin foletë e tyre pëllumba të egër. Ibra i vështronte me lakmi krahët e bardhë të pëllumbave që uleshin e ngriheshin nga shkëmbinjtë.

— Si po ia bëjmë, Ibër?

— Disi do t'ia gjejmë vegëzën kësaj pune...

Fshatari ofshani. Një tufë pëllumbash kaloi mbi kokat e tyre, duke e çarë ajrin me frushullimë. Megjithatë, edhe pa qenë shpendë, duhet ta piketojmë këtë rrasë, mendoi Ibra. Tufa e pëllumbave bëri një hark të gjatë, mandej erdhi e u ul te faqja e shkëmbit.

Ibra i tha njërit prej ndihmësve të shkonte në fshat e të merrte një pushkë.

— Një pushkë?!

— Bash pushkë!... — tha ai dhe buzëqeshi.

Kur ndihmësi solli pushkën e një ballë fishekë, Ibra e mbushi, e vendosi në skaj të rrasës dhe e drejtoi me anë të nivelit. Me kujdes të madh që arma të mos lëvizte as sa qimja e flokut, tërhoqi këmbëzën. Në skajin tjetër të rrasës u ngrit një xhufkë pluhuri. Të trembur nga krisma e papritur, dhjetëra pëllumba brofën fluturimthi nga guvat e shkëmbinjtë. Ibra qëllloi disa herë. Disa herë u ngrit xhufka e pluhurit matanë.

— Atje ku ranë plumbat, do të shkojë edhe ujët — tha Ibra...

Vargani i piketave u zgjat nga buza e Ujëbardhës deri në Gurajë.

— Po sikur ujët të mos ecë as nëpër këtë kanal? — thanë disa fshatarë.

— Do të ecë se s'bën! — tha Ibra. — Çdo ditë, pas

pune, do ta futim ujët në kanal. Ai vetë do të na gjykojë e do të na ndihmojë t'i ndreqim gabimet.

Kjo përgjigje e thjeshtë, por e zgjuar bëri shumë përshtypje në Gurajë...

Ditën që filluan punimet, tek ama e kanalit erdhën vetëm anëtarët e komisionit, punëtorët e disa pleq. Ishte ceremonia më e pabujë që ishte bërë ndonjëherë në Gurajë për sjelljen e ujit.

— Për ta hapur këtë kanal, do të na duhet shumë mund e shumë kohë, — tha Ibra. — Por ju jap besën se ujët e këtij lumi do ta çojmë në arat e Gurajës. Dhe nuk do t'i shikojmë më qiellin e retë, duke na pikuar syri gjak për një bulë shi. Do ta bëjmë në arat tona bukën e fëmijëve...

Pleqtë kishin sjellë me vete një dash të zi, të cilin e therën te vendi ku do të pritej ujët për të hyrë në kanal. Ujët e pastër të Ujëbardhës u lëkuq nga rrëkeja e gjakut të dashit. Pleqtë i thanë Ibrës ta priste ujët e lumit me duar e ta kthente në një copë kanal që e hapën punëtorët në rërë. Pasi hoqi opingat e çorapet, Ibra u përvol e hyri në lumë, buzagaz. Rrjedhja e rrëmbyer u pengua te duart e njeriut, një pjesë e ujit u shmang në të djathtë të lumit dhe e mbushi menjëherë atë gropë të vogël. Rëra e thatë u njom, u mbufat nga ujët, u bë si brumë. Ndërsa gjaku i dashit rridhte në lumë, pleqtë thoshin:

— Siç del gjaku prej këtij dashi, vaftë ujët nëpër këtë kanal!...

Njëzet metra larg buzës së lumit ishte një gur gëlqeror, i bardhë e me damarë të zinj, që ishte rrokullisur nga shpati i malit. Guri ishte gjatarak, kështu që nuk kishin mundësi t'i silleshin rrotull. Ai duhej të copëtohej, të

çahej, por nuk kishin as baromina, as dinamit. Ibra vendosi ta pëlçiste me zjarr. E dinte se kjo mënyrë do t'i merrte shumë kohë, por s'kishte zgjidhje tjetër.

Punëtorët prisnin lisa, i bënin gulumere mbi gur dhe u vinin zjarrin. Kur skuqej guri, hidhnin ujë mbi të. Ai gumëzhinte, nxirrte avull të nxehtë e shkumë dhe plasaritej. Punëtorët futnin daltat nëpër plasa dhe e brenin grima-grima, me një këmbëngulje milingone.

Me mundim e me një durim të jashtëzakonshëm kështhu u çanë edhe gurë të tjerë. Shtrati i kanalit sosi te një brinjë shkëmbore. Aty ishte e pamundur të përdorej plasja me zjarr e me ujë.

— Duhet të përdorim barat, — tha Ibra.

— Ku ta marrim?

— Të mbledhim të gjithë fishekët e fshehur, t'u heqim plumbat e t'u marrim barutin.

— Punë që s'bëhet!

— Pse, Kingj?

— Fishekët na duhen për luftë.

Balli i Ibrës u rrudh.

— Ky barat nuk po priset kot. Edhe kjo është luftë...

— Po, por ajo tjetra është më ndryshe!

— Kur të vijë ajo tjetra, do të gjejmë fishekë të tjerë.

Ndoshta ka të drejtë, mendoi Kingji. Në kohërat e mëparshme, kur jepej kushtrimi, shumë vetë niseshin në luftë pa pushkë e pa fishekë. Sokëllinin, këndonin këngë majekrahu dhe prisnin derisa të merrnin pushkët e shokëve të vrarë, ose u rrëmbenin armët ushtarëve të huaj, lu kujtua Zog Buzheta. Kur kishte ardhur në Gurajë ushtria e kralit, Zogu e kishte thirrur mënjanë. «Shtrëngoji opingat, se do të shkojmë diku sonte, Kingj!» Ai nuk e kishte pyetur se ku. Nëpër një rrugë dhish kishin vajtur natën në Breglum, drejt e te qela e priftit. Zogu kishte marrë vesh se prifti kishte një mitraloz të fshehtë, Ai e kishte lidhur në një tra litarin që e kishte marrë me vete dhe i kishte thënë priftit: «O nxirre mitralozin, o të vara në këtë litar!» Prifti ishte përpëlitur si peshku në

zall, ishte munduar të dredhonte, por Zogu ia kishte prerë shkurt: «E di mirë se e ke mitralozin! Nxirre menjëherë, në qoftë se nuk të ka marrë malli të ngjitesh qysh tash në qiell!...» Prifti i kishte sjellë mitralozin e fishekët. «Po hape gojë e i the kujt se kemi qenë këtu, në zotin e poshtë vend nuk ke», — i kishte thënë Zogu. Ata kishin ecur gjithë natën me mitraloz e fishekë në krah, që t'i zinte drita në Gurajë...

— Mirë e ka Ibra. Çdo luftë i gjen fishekët që duhen për të.

— Sot po e bëjmë barutin miell, po nesër s'do të mundemi kurrqysh ta bëjmë miellin barut!

— Mielli e baruti nuk janë aq larg e larg shoqi-shoqit. — tha Kingji — Njëmend pushka nuk bën bam pa barut, por edhe ai që e mban pushkën në dorë ka nevojë të ngihet me bukë... Po ju kallëzoi një histori.

— A është e gjatë, Kingj? — tha Omeri.

— Është aq sa është. Ti në daç dëgjoje, në daç mbylli veshët.

— Prite kur të na mbajë këtu gjithë ditën me historinë e tij! Ha-ha-ha!...

— Lëmë të flas një herë, mos të lëntë varri brenda, o Ramë!... E patëm fjalën te baruti e te mielli. Njëherë veziri i Shkodrës thirri në saraj disa burra të mençëm. U shtroi gosti e priti me tërë të mirat. «Ju oë jeni të mençëm, a e dini kush është më i fortë?» u tha veziri. Dikush tha se më i fortë ishte sulltani i Stambollit, dikush tha: krali i Nemces. dikush: veziri i Shkodrës. Vetëm një plak nuk foli. «Po ti si thua, kush është më i fortë?» i tha veziri. «Më i fortë është ai që ka një koshiqe drithë më tepër se kundërshtari i tij.» i tha plaku.

— Kjo është historia më e shkurtër e më e bukur që na ke kallëzuar deri sot, Kingj...

Ibra ndiqte bisedën e punëtorëve, por mendia i punonte tietërkund. Në burg kishte dëgjuar të flitej shumë për luftën. Ajo rrinte pezull mbi botë si thatësia mbi Gurajë. Mielli, gjalpi, pyjet, metalet, gjithçka po kthehej në barut e në armë. Guraja po bën ndryshe nga gjithë

bota, — mendonte Ibra. — Po e kthen barutin në miell. Ai seç ndjeu një drithërimë nga ky arsjetim, sepse e dinte që gëzimi, jeta e guarajasve ishte e cunguar jo vetëm për shkak të mungesës së miellit. Por lufta për miell ishte luftë kundër vdekjes, kundër shuarjes... Gurajë e shkretë, më shumë varre kanë hapur te ti zia e bukës e uria, se të gjitha luftërat së bashku!

Askush nuk do ta kishte besuar se në ahuret, pullazet, zgërbonjat dhe shpellat e Gurajës do të gjendeshin aq fishekë të fshehur. Kingji ishte ulur bri grumbullit të tyre, i hiqte plumbat me kujdes dhe e derdhte barutin në një trastë pëlhure. Në shpellë ishte freskët, ishte qetësi. Mezi dëgjohej zhaurima e largët e ujërave të Ujëbardhës. Këta fishekë do t'i kishim shprazur në dasma. Tash po i përdorim që të çojmë ty në Gurajë. E largët është ajo ditë, e di. Por ti mos u mërzit, moj Ujëbardhë, mos u mërzit, bre nusja jonë e mirë, se me lëkurë të duarve tona do të ta shtrojmë rrugën e nuk e lëmë pa të çuar në Gurajë, jo. Edhe për atë ditë do t'i ruajmë disa fishekë... Kështu bisedonte Kingji me lumin dhe e shkundte barutin në trastë. I binte gëzhjojës fort, që të mos mbetej në fund të saj asnjë grimcë baruti. Në këtë mënyrë i shkundnin në magje thasët me miell gratë e Gurajës. Një njeri hyri në shpellë. Ishte Ibra. Sytë e tij takuan sytë e butë e të menduar të Kingjit.

— Çka po mendon, Kingj?

— Për këta fishekë...

— Po të dhimben?

— Paj, pak po. E di se edhe ty të dhimben... Por tash po mendoj për tjetër gjë. A po i sheh këta fishekë?

— Po i shoh.

— A e sheh sa të ndryshëm janë?

Sytë e Kingjit dhe sytë e Ibrës këqyrën një grimë herë grumbullin e fishekëve.

— Ka fishekë të pushkëve të shtatë kralive.

— Po, Kingj... Por unë po mendoj edhe për diçka tjetër.

— Hë?

— Këta plumba janë bërë për t'u ngulur në mishin tonë. Ne mund të ishim vrrarë prej tyre, po të mos ua kishim marrë atyre që i patën sjellë për të na vrrarë me ta.

Sytë e butë e të qashtër të Kingjit u ashpërsuan.

— Por edhe sot, edhe në këto çaste bre, që po flasim bashkë, kralitë bëjnë fishekë të tjerë për të vrrarë njerëz.

Gishtërinjtë e shkathët të Kingjit u ndalën.

— Po atëherë pse na the t'i prishim këta fishekë?

— Sepse ne mendojmë për jetën, kurse ata për vdekjen, Kingj... A e di si m'u duk kur hyra në shpellë e të pashë të ulur bri grumbullit të fishekëve? M'u duk sikur ishe ulur në arë, në lëmë dhe këta fishekë ishin kallinj misri, me kokrra të mëdha e të shndritshme.

— Eh!...

— Pse po ofshan, Kingj?

— Paj, gjithë këta shkëmbinj që kemi përpara e s'po di...

— Me thonj e me dhëmbë do ta brejmë shkëmbin, Kingj, pasha këtë besë! Me thonjë e me dhëmbë e me barutin që po mbledh ti...

Ata e zhbironin shkëmbin me daltë e me majën e kazmës. Në vend të kapsollës e të fitilit të dinamitit që mungonin, Ibra përdorte një leckë të thatë, të përdredhur. Leckën e ndizte me eshkë, brincë e uror. Kjo mënyrë ndezjeje ishte e rrezikshme. Edhe Ibra e dinte. Por në

këtë kanal çdo punë ishte me rrezik, koke. Në radhë të parë, ai kishte hallin e të tjerëve. Ndiente përgjegjësi jo vetëm për jetën e punëtorëve, por edhe për një gisht të dorës së tyre.

— Mos u ngutni, djelm, — u thoshte punëtorëve të rinj, — këqyrni ku e keni mendjen e ku e keni këmbën, mandej filloni punën. Kersh¹⁾ është kersh. Ne do ta thyejmë, por kersh¹⁾ të mos na thyejë ne. Edhe një njeri po të plagoset, është dëm i madh.

Ibra i njihte mirë të gjithë punëtorët. Nuk i linte të punonin bashkë ata që kishin ndonjë grindje a hasmëri sado të vjetër midis tyre. Asnjëri nuk guxonte të thoshte fjalë të rënda, sepse e largonin nga puna menjëherë.

Ata që punonin në kanal ishin në besë të Gurajës. Askush nuk mund t'i vriste për gjak. Këtë gjë Ibra e kishte kërkuar me ngulm, para se të ngulej kazma e parë në zallin e Ujëbardhës. Punëtorët shkonin në shtëpi vetëm krye jave, për të larë ndërresat. Ata flinin në tëbana me dushk, afër vendit të punës. Ibra i kishte ndarë në grupe dhe çdo grup kishte një përgjegjës vullnetar. Puna bëhej bashkërisht nga tërë grupi dhe paga ditore ishte e barabartë për secilin pjesëtar të grupit.

Me ushqimin e punëtorëve merrej Kingji, që ishte edhe arkëtar, Për qumësht e kos u blenë nja dyzet dhi pëlleja. Punëtorët bënë për to një torishtë afër sharrës. Tubën e dhive e ruante një jetim, që Ibra e mori në punë për ta ndihmuar. Bregut të lumit kishte gjithfarë drurësh e shkurresh, barishte e shavar të gjatë, sa humbte njeriu në to. Çdo ditë gjinjtë e dhive fryheshin e vareshen nga qumështi.

Më vonë pranë sharrës u ngritën mulliri e furra e bukës...

Në një fshat të largët ishte një dingë e vjetër. Kohët e fundit mokrat e saj rrotulloheshin shumë rrallë. Aty vinte për të blerë barut vetëm ndonjë gjahtar që kishte

1) shkëmb

çifte. Por mokrat e dingës u gjallëruan, kur në derën e saj erdhën disa gurajas fytyrëpërzhitur, me thasë në krahë.

Duke përdorur barutin e fishekëve dhe barutin e dingës, zhlepi¹⁾ në shkëmb thellohej e zgjatej dita me ditë. Në anë të zhlepit punëtorët bënë vetullën e kanalit me dërrasa pisha. Dhe uji ecte cazë — cazë nëpër udhën e re, drejt Gurajës, ashtu si fëmija motak që hedh hapat e parë. Rridhte e gurgullonte ujët e Ujëbardhës që vezullonte në diell si barku i argjendtë i troftave që kërcejnë mbi rrjedhë në të perënduar të diellit. Ibra bariste bri kanalit pa ia ndarë sytë shiritit të ujit që zgjatej. Në buzë i fektonte një qeshje e druajtur, të cilën mundohej ta ndrydhte, ta fshihte nga të tjerët...

Pjerrësia e shpatit të malit u bë shumë e madhe. Për të qëndruar punëtorët gjatë punës, u ngritën skela me trarë ahu, lisi e mlleze. Trungjet shpoheshin me turjelë e mbërtheheshin me njëri-tjetrin me kunjë thane, sepse nuk kishte gozhdë të gjata. Për t'u siguruar mirë, skelat lidheshin me litar pas shkëmbinjve.

Në ato vende ku ishte e pamundur të ndërtoheshin skela, përdorreshin kosha të thurur me thupra. Punëtori futej në një kosh që lëshohej teposhtë me litar prej lëvoreje bliri. Kur arrinte drejt me tragën e kanalit, litari lidhej në trungun e lësive që rriteshin në shpatmal.

Duhej të kishe trup e zemër të fortë që të punojë me orë të tëra i futur në kosh, i varur midis qiellit e tokës, midis kershit dhe humnerës. Edhe ata që zbrisnin faqes së thepisur të shkëmbit, edhe ata që e lëshonin pak nga pak litarin e ashpër që u vriste gishtat, e dinin se nga çasti në çast mund të ndodhte mynxyra. Por ata nuk mendonin për vdekjen, mendonin për ujin. Nuk shikonin greminën e errët, por lumin e shkumëzuar. Ata e dinin se, duke çarë atë shkëmb, nposhtnin një pjesë të thatësirës së Gurajës.

Megjithatë, rreziku ishte kudo rreth tyre: mbi kokë dhe nën këmbë. Rrokulliseshin gurë nëpër shurlat e orteqeve. Skelat e drunjta nuk ishin krejtësisht të sigurta.

1) e çarë gjatësore

Shkëmbi ishte i pabesë. Për të shmangur rreziqet e fat-keqësitë, Ibra la një rojë të përhershme që vrojtonte shur-
lat dhe shpatin e malit. Skelat i kontrollonte herë pas he-
re dhe dëgjonte me vëmendje zhurmat që vinin prej
tyre...

Ibra vuri re se rrëzë skelës po rridhnin gurë të ve-
gjël e pluhur i bardhë. Njëra anë e skelës ishte larguar
nga faqja e shkëmbit. I kapi veshi një kërkëllimë të tha-
të si zhurma që lëshon një trung kur çahet me sëpatë.
U ngjeth si ta kishin pickuar njëzet nepërka, por u për-
poq ta ruante gjakftohtësinë. Me zë të qetë — o sa e
mundimshme ishte të flisje atë çast me zë të qetë! —
u tha punëtorëve të merrnin veglat e të largoheshin nga
skela. Punëtorët shikonin të habitur herë atë, herë njëri-
tjetrin.

Rrëkeja e gurëve dhe e pluhurit poshtë skelës u shtua.
Tashti kërkëllimat e trarëve dëgjoheshin shkoqur, Ato
kërkëllima u shndërruan në një rropamë që të ngjethte
mishtë, Skela u shemb dhe u rrokullis në humnerë si or-
tek dëbore. Gurët dhe trungjet mbërritën deri tek Ujëbar-
dha. Në luginë u çua përpjetë një mjegullnajë pluhuri,
që mbuloi lumin, drurët, shkëmbinjtë dhe njerëzit. Edhe
qielli u errësua prej saj.

Atë çast disa punëtorëve u ra në mend kallukanxha
dhe u drodhën. Mos ishte kallukanxha me shtat e fytyrë
mjegulle që e kishte rrëzuar skelën e tyre? A mos ishte
edhe ajo kundër kanalit, kundër shuarjes së etjes së
Gurajës?! Apo donte që mbi Gurajë të rrinte pezull për-
jetë si qefin vdekjeje zhegu dhe pluhnaja e verdhë?!...

Fluturimi i pluhurit zgjati pak minuta. Kur u davarit
mjegullnaja, gjethet e drurëve dhe bari ishin mbuluar
me një shtresë të hollë, të bardhemë. Vetëm lumi atje

tej rridhte si gjithmonë i patrazuar, i kthjellët, i mbësh-tjellë me luzma vezullimesh.

Punëtorët rrinin si të mpirë: të rrëqethur nga rreziku i vdekjes dhe të mrekulluar nga shpëtimi i tyre. Kësaj mpirjeje i dha fund zëri i Ibrës, që nisi të kontrollonte punëtorët. Nuk mungonte askush nga ata që ishin në ske-lë. Atë ditë nuk u punua më. Punëtorët shkuan te tëba-nat dhe lanë veglat në vendin e tyre.

Ah, ta kisha Prruk Motin këtu! — mendoi Ibra. — Kam bërë gabim që s'e kam marrë me vete. Qysh nesër do ta çoj Kingjin në Gurajë me një mushkë e ta sjellë këtu.

Shumë kemi hequr në këtë kanal, Jerinë, por ajo që ngjau sot ua kalon të gjithave. Kaq i dërrmuar jam, sa edhe të menduarit më duket i lodhshëm. Megjithatë nuk mund të rri pa menduar për ty dhe për fëmijën. Gjatë kësaj kohe që jemi detyruar të rrimë larg njëri-tjetrit, kjo gjë ka qenë ngushëllimi dhe gëzimi më i madh për mua. E di se edhe ti orë e çast mendjen e ke pasur tek unë, te këta shkëmbinj, te kjo luginë, Më ke pritur me mall, me mendje të ngritur.

Po, Jerinë, puna në kanal është e vështirë dhe e rrezikshme. Unë s'ta kam thënë asnjëherë këtë, por jam i bindur se ti e di dhe shqetësohesh për mua. Ajo që i ngjau sot Rexhës, mund t'i kishte ngjarë secilit prej nesh. Edhe mua, Jerinë. Këtë e mendova edhe përpara Rexhës së vdekur. E më erdhe në mendje ti. Ti: e vetmuar. Ti: e përlotur. Ti: me petka të ngjyera në verr. Ti: duke hedhur grushte me dhé mbi varrin tim. Ti: e përkulur mbi varr, e ngjitur pas tij.

Po, të gjitha këto më kaluan nëpër mend atë çast, duke parë trupin e përgjakur të Rexhës. Fytyrën e tij të

zbehtë, Krahët e tij të mbështetur në dërrasën e kraharorit. Duart e tij të mpira nga një ngërç i fortë, që s'do t'i lëshonte kurrë. Ato duar të ntrashura, të ashpëruara nga daltat e nga çekiqët. Ato duar të mëdha e të fuqishme. E ke dorën si rrëputë ariu! — i thoshin shokët. Rexha vinte buzën në gaz. Kur ta shtrëngonte dorën fort për shaka, të vinte të ulërije. Asnjë punëtor s'kishte mundur t'ia përkulte dorën. Rexha krenohej për këtë gjë, por nuk mbahej në të madh. Nuk i bënte keq asnjëriu. Kur ndokush bënte ndonjë hile a përpiquej të ndizte sherr, e kisha vënë re se duart e Rexhës shtrëngoheshin aq fort, sa që thonjtë i nguleshin në mish. Tash duart e Rexhës janë të shtangura. Ato nuk do të lëvizin më...

Kështu mund të ishin edhe duart e mia, Jerinë. Unë isha pranë Rexhës. I pari shkova tek ai dhe ia hoqa gurët që i kishin rënë përsipër. Rexha ishte ende i ngrohtë. Fytyrën, këmishën e duart i kishte të stërpikura me gjak. Më vinte tmerr, kur e shihja ose kur e prekja trupin e tij. Kur mendoja se ai trup që po ftohej me ngadalë, nuk ndiente më asgjë, Ishte bërë i heshtur, i pandjeshëm, si gurët që kishin rënë mbi të. Si gurët e rëndë e të përgjakur që i largova me duart e mia, ndërsa sytë po më digjnin nga lotët dhe një klithënë më ishte ngujuar në fyt. Po të kisha qenë disa hapa më afër Rexhës, tashti edhe trupi im do të ishte i përgjakur, i shtrirë pranë trupit të tij.

Kur të marrësh vesh vdekjen e Rexhës, edhe ti do të qash, Jerinë, Por e di se edhe kur të vij në shtëpi, ti nuk do të më thuash kurrë të heq dorë nga kanali. Më kujtohet dita që u nisa të punoj në kanal. Ty të erdhi mirë që po shkoja me shokët, për t'i sjellë ujë Gurajës. Më të zorshme e pata t'i mbushja mendjen tim eti. Ai nuk donte që të punoja në kanal. Nuk mund të ndahemi nga shokët, i thashë. Atij i erdhi sikur t'i kisha rënë shuplakë fytyrës. — Ti je ndarë prej kohësh, qyshkur e ke marrë gruan në gjak! — më tha. — Nuk jam i pari as i fundit që e kam marrë gruan në gjak, i thashë. Nuk ia zura ngoje nusen që më kishte sjellë ai. E dija se mund

të thyhesha me të përgjithmonë. Ula kryet. Ai mbushi llullën me duhan dhe e ndezi. Nëna rrinte te dera, në mugëtirë. Nuk foli. Ajo ka qenë gjithmonë kështu: e druajtur dhe e heshtur si hije.

Nuk e di pse po më kujtohen këtë çast të gjitha këto gjëra e sidomos ajo ditë që u nisa për të punuar në kanal. Megjithëse kemi hequr keq, asnjëherë nuk jam penduar, nuk më ka shkuar në mendje të largohem, të ndahem nga kanali e nga shokët. Ndoshta asnjëri prej nesh nuk e ka menduar këtë gjë. Por vdekja e Rexhës na ka prekur thellë. Njeriu është më i fortë se guri, siç thonë, por është edhe si gatarja¹⁾ e llambës. Edhe në mos u theftë, kriset nga tronditja. Dhe tronditje më të madhe, ngjarje më të dhimbshme se vdekja e Rexhës nuk ka!... Një shkëmb që kishte mbetur vjerrët, u shkoq e piku mbi të. Dëgjova zhurmën e gurëve të rrëzuar dhe një klithmë. Ktheva kryet dhe pashë Rexhën të shtrirë. Mbi të kishte gurë. Këmisha e bardhë po i mbulohej me njolla të kuqe gjaku. Me njolla të kuqe që zmadhoheshin. U turra drejt tij dhe nisa t'i hiqja gurët një nga një. Mandej erdhën shokët.

U dëshpëruan të gjithë, por Ibra më fort se kurrkush. Iu përlotën sytë para Rexhës së përgjakur. Atë ditë që u plagos vetë në fytyrë, na jepte zemër e vinte buzën në gaz. Jam gërvishtur pak... S'kam gjë! — na thoshte. — Nuk dua t'ia shoh kujt pikën e lotit në sy. Po të ligësh-tohemi, ne, gëzohen dashakëqijtë tanë. Dhe ju e dini se nuk kemi pak dashakëqij... Kështu na thoshte atë ditë. Por për Rexhën nuk i mbajti lotët as vetë. Ata rridhnin ngadalë nëpër faqen e tij të çarë nga theplat e gurit e të nxirë nga baruti.

Me siguri tashti në fshat ka ardhur fjala për gjëmën që ka ndodhur këtu. Kushedi ç'thuhet e ç'bëhet atje! Nënat dhe nuset e punëtorëve, rrinë me gjak të ngrirë. Edhe ti do të rrish me gjak të ngrirë, Jerinë, derisa të më sho-hësh me sy e të bindesh që s'më ka ndodhur gjë. Por ti

1) qelqi

do të rrish kështu edhe pasi të kthehem prapë te kanali... Megjithatë tashti e ke më të lehtë për të pritur: ke Ujezën që të merresh me të. E di që ty nuk të pëlqen ky emër, por, që para se të martoheshim bashkë, unë kisha menduar t'i vija këtë emër vajzës së parë që do të na lindte... Eh, Jerinë! Ujët nuk ardhka në Gurajë, duke i marrë me të mirë lumin e shkëmbinjtë me gjak dashi të zi. U dashka një fli më e madhe: gjak njeriu! Vetëm kështu do të mundet thatësira dhe do të ujitet toka e Gurajës. Një gjë ta dish, Jerinë: edhe kur të ketë ardhur ujët e këtij kanali në Gurajë, edhe kur të kenë kaluar shumë e shumë vjet, nuk do të më dalë nga mendja kjo ditë, nuk do të mundem ta harroj gjakun e Rexhës mbi gurë...

Punëtorët e çanë tejprtej shpatin e thiktë me dalta e me barut. Traga e hapur në shkëmb nuk ishte aq e gjerë, por ajo do të ishte tabani i kanalit dhe do të zmadhohej me anë të vetullës prej druri.

Tani një pjesë e mirë e kanalit kalonte nëpër tokë tulinë, ku vërtet duhej të shkuleshin shumë gurë e trunje e të gërmohej shumë dhé, por nuk kishte nevojë për skela dhe përdorimi i barutit ishte i kufizuar. Vapa ishte thyer. Kokrrat e trëndafilit të egër ishin bërë bojëgjake. Thelbi i lajthive ishte forcuar. Nëpër degët e shqemeve e të panjave po zverdeshin gjethet e para.

Gjatë atyre javëve u bë një punë më e madhe nga ç'ishte bërë qysh në pranverë. Ujët rridhte nëpër kanalin e sapohapur dhe bri tij Ibra ecte me një xixëllimë të qeshure në sy. Në mbrëmje te tëbanat e punëtorëve dëgjohej zëri i moçëm i Prruk Motit dhe melodia e lahutës së tij me gjarpër e kokë dhie. Këndonin edhe të rinjtë këngë dashurie ose këngë të grunjta, siç i quanin ata,

u binin çiftelive e fyejve që dukej sikur shoqëronin oshëtimën e përjetshme të Ujëbardhës.

Nganjëherë u pëlqente të rrinin rreth zjarrit të ndezur në qiell të hapur, të tregonin bëma të vjetra ose ngjarje për të qeshur. Mbi kokat e tyre shkrepnin yjtë e mëdhenj të vjeshtës, thuase edhe ata yj qeshnin me gjithë zemër si punëtorët, që përpiqeshin ta zbutnin vrazhdësinë e shkëmbinjve e të jetës së tyre me atë gaz njerëzor.

— Kingj, na kallëzo si e shtitë në varr mishin e Çausht Bekës.

— Po e kam kallëzuar, kaq herë, sa...

— S'ka gjë, Kingj. Ne ajo na pëlqen!

— Kishim mbetur keq për bukë. Ramë nja dhjetë vetë të prashitim në Breglum, te Çausht Beka. Haku ishte i vogël: dy okë drithë në ditë për shoq, por zori i fëmijëve ta fut kryet në gërshtë. Ishte zheg i madh, toka ishte bërë hi e tërë pluhuri na futej në mushkëri. Çausht na rrinte te kryet, duke na thënë: jo nguleni shatin më thellë, jo mbusheni bimën më mirë, jo mos e rralloni kaq shumë... me një fjalë, na e solli shpirtin në fytyrë. Mezi duruam sa erdhi dreka. U ulëm në një hije. Rrogëtarin na pruri mish të thatë e fasule. Mishi ishte plot krimba, s'kishte burrë nëne që e shtinte në gojë. Hapëm një gropë dhe e hodhëm mishin me krimba në të. I bëmë gjëmë si të vdekurit, njëri e holloi zërin dhe e vajtoi një copë herë. Na binin lotët curril prej gazit. E mbuluam gropën me dhë si varr dhe ikëm nga Breglumi...

Megjithëse e kishin dëgjuar disa herë këtë ngjarje, gazi i punëtorëve nuk rreshti për disa minuta. Dikush shkërbente «vajatoren» që kishte qarë mishin me krimba, dikush thoshte vargjet për Çaushtin.

— Tash do të kallëzoj një ngjarje tjetër që ka ndodhur në katundin tonë. — tha Kingji, — Para se të vdiste, një plak i tha të birit. «Puno në hije e haje bukën me mjal-të!» Plaku vdiq. Djali filloi të punonte në arë. Priste dushk të bënte hije. Kështu shkante tërë koha, sepse duhej ta mbulonte tërë arën. «Pse po bën kështu?» i thanë njerëzit. Djali u tregoi porosinë e babës.

«Baba nuk të ka thënë të mbulosh arën me dushk, por të çohesh herët, t'ia nisësh punës pa rënë dielli, të pushosh në drekë e në mbrëmje të punosh derisa të bëhet muzg!» i tha një burrë.

— A e dini ku e ka fjalën Kingji?!... Mjaft folëm e qeshëm, tash duhet të flemë, që të çohemi herët.

— Po biem, Ramë, po biem.... Po si ishte ajo puna e porosisë «haje bukën me mjaltë?»

— Pse, nuk e di ti?!

— Ta dija, nuk pyesja.

— Paj, ka dashur t'i thotë: haje bukën me djersën tënde, se, kur ta fitosh bukën me djersë e kur të lodhesh, të duket sikur po e ha me mjaltë?

— Të lumtë goja, Kingji!

Ata i shuan urët që kishin mbetur dhe prushin e mbuluan me hi. Panë qiellin: ishte plot yj. Mendimi se edhe të nesërmen do të ishte kohë e mirë, pa shi, i bëri ta ndienin më pak nënkresën e fortë ku mbështetën kokën.

Kështu kalonin ditët e netët.

Kanali zgjatej me pëllëmbë, me hapa, me pushë. Çdo lajm për zgjatjen e kanalit ishte si një dorë ledhatare për trupin e kreshpëruar të Gurajës, të acaruar nga dëshpërimet dhe hidhërimet e shpeshta. Siç mblidheshin në sofër thërrimet e bukës, aty edhe gëzimet e vogla çmoeshin më tepër se gjetiu.

Këto lajme u shpërndanë edhe në fshatrat fqinje. duke ngjallur atje ndjenja e mendime të ndryshme. Si me të gjitha përpjekjet e mëparshme të fqinjëve të tyre për të gjetur ujë, në fillim breglumasi kishin qeshur nën mustaqe edhe për këtë kanal, duke thënë se Ibër Shpata ishte Murat Gjoka i dytë dhe gurajasi vetëm sa kishin ndërruar vendin e gërmimit. Lajmet se puna në kanal po ecte mbarë, nuk e turbulluan rehatinë e tyre, megjithatë e qeshura nën mustaqe u fik dhe diçka i pickoi në trup. Madje as vllugu i punëve të stinës, korrja e qërimi i misrit, vjelja e pemëve dhe e rrushit, vënia e ushqimit të bagëtive për dimër, nuk e fashiti këtë pickim. Ata nuk i

shijuan ashtu si vitet e tjera as të korrat e begata, as gostitë e pasura të dasmave që filluan në të gjitha lagjet këndeje e andej Ujëbardhës. Mendimi se kanali i Gurajës mund të ishte diçka më tepër se lodër, se trill i njerëzve të marrosur nga thatësira dhe uria, u përhapej nëpër trup si helm grere...

Puna në kanal vazhdoi derisa ra bora e parë. Drurët e zhveshur, shkëmbinjtë, tëbanat me dushk, çdo gjë u vesh me gëzofin e saj. Qëndrimi i mëtejshëm në kanal ishte pa dobi dhe i rrezikshëm. Bora do të zinte borën dhe orteqet do të rrokulliseshin njëri pas tjetrit nëpër faqet e shkëmbinjve. Pasi e mbushën me trungje e me degë ose e mbuluan me dërrasa shtratin e kanalit të hapur në ato vende ku pritej të binin orteqe, punëtorët u përshëndetën me dy shokët që do të qëndronin aty edhe gjatë dimrit, për të ruajtur sharrën, tëbanat e veglat, dhe u nisën drejt Gurajës. Atë dimër ranë gati dy njerëz borë, siç thuhet në Gurajë. Për tre muaj rresht nuk pa kush tokë me sy. Rojat rrinin në tëbanë bënin bucela, gdhendnin furka, boshte, djepa dhe «karkalecë», njëfarë kukulle prej druri me gjymtyrë të lëvizshme që përdorej në vallen e karkalecit. Në mbremje këndonin, luanin cicmic, piqnin në prush gështenja ose patate. Kur ishte kthjellët dhe bora ngrinte nga cingërima, në luginë vërshonin kopetë e ujqve. Ata ulërinin gjithë natën herë në një breg, herë në një breg tjetër, duke futur këmbën në gojë nga uria. Sado të mbrojtur që ta ndieje veten, ishte e vështirë të mbyllje sytë e të flije i qetë, duke dëgjuar atë ulërimë.

Një natë ujqit u afruan deri te tëbana e rojave. Kish-te hënë dhe hijet e tyre të zeza dalloheshin qartë mbi borë. Njëra rojë mori pushkën e vetme që kishin dhe shtiu

— Është si faqja e zezë e tij dhe e atyre që i besojnë!...

Shatri nxehej për disa çaste, por i binte inati shpejt. Nganjëherë tregonte edhe vetë se si ia kishte punuar Kingji. Ishin shokë që nga fëmijëria. I ishin gjetur njëri-tjetrit në të mirë e në të keq. Shakatë e tyre, që më të shumtën e herës bëheshin në kurriz të Shatrit, nuk e kishin cenuar këtë miqësi dhe ishin një nga argëtimet e Gurajës...

Ibra vajti deri tek ama e kanalit dhe mbeti i kënaqur, sepse nuk ishte bërë ndonjë dëmzim i madh as nga rrëketë e shirave, as nga orteqet. Të nesërmen tërë pjesa e hapur u pastrua nga gurët e dherat e rrëzuara, u hoqën trungjet e mbulesat prej dërrase dhe u fut ujët në kanal.

Të çlodhur nga dimri i gjatë, punëtorët e nisën gërmimin me hov të ri. Traga e kanalit në atë vend u zgjat me shpejtësi si ato bisqet e njoma të drurëve, që rriteheshin me pëllëmbë nën diellin e pranverës. Lugina oshë-tinte nga zërat e njerëzve, nga gumëzhima e sharrës, nga zhurma e veglave dhe nga shpërthimet e barutit. Larg, në brigjet e Ujëbardhës tringëllinte cingarja e dhive që milesnin për punëtorët.

Në të sosur të qershorit zërat e njerëzve dhe krismat e kazmave thyen heshtjen e Gyrkës së Zezë. Tani trupi i Gurajës po ndiente përpëlitjet e para të etheve të zhegut. Megjithëse punimet po ecnin më mirë nga ç'e kishte pritur, Ibra ishte i shqetësuar. Shqetësimi i tij lidhej me vendin e tanishëm të punës, me Grykën e Zezë. Sipas pleqve, aty ishte vrarë Omeri i Mujit. Kur e kishte gjetur trupin e të birit të përgjakur e të shpuar nga shigjetat

e çetanikëve të kralit, Muji e kishte mallkuar Grykën e Zezë e kishte thënë:

«Këtu mos këndoftë qyqe as turrec kurrë!»

Me të vërtetë në atë lugajë tërë hije, që nuk e rrihte dielli as në verë, nuk të zinte veshi kurrfarë cicërime zogu. Ngaqë vendi ishte në hije dhe kullonte ujë dimër e verë, shkëmbinjtë ishin të veshur me një shtresë të trashë myshku të murrmë. Heshtja, hija, ngjyra e murrme e myshqeve i jepnin Grykës së Zezë një pamje të përzishme e të frikshme....

Një mbrëmje, jetimi që ruante dhitë e punëtorëve u kthye nga kullota duke qarë me dënësë. Ibra mendoi se mos e kishte zënë gjarpri. E kapi për dore dhe e uli pranë vetes. U mundua ta qetësonte, por djali dëneste dhe vështronte përqark i trembur.

— Çfarë ke? — i tha Ibra. — Fol pa frikë, se mua më ke si babë. Çfarë të ka ndodhur?

— Disa herë gjatë ditës më shtiret përpara një burrë i gjatë, me mjekër deri në tokë e me brirë si të cjamin, — tha djali.

— Kur të ka ndodhur kjo gjë? — tha Ibra.

— Dje dhe sot, — tha bariu, i cili nuk po dëneste më.

Ibra ndjeu njëfarë lehtësimi. Ai mendonte se kjo ishte prapësia, ngjarje e papritur e Grykës së Zezë, që e kishte vënë në ankth. I tha Kingjit të gjente një bari tjetër dhe bariun e vogël e la të lirë të kthehej në fshat. Dhitë i lëshoi në kullotë një punëtor.

Çunaku ecte me hapa të shpejtë, sikur kishte frikë se mos e thërrisnin të kthehej prapa. Megjithëse i vinte keq që e kishte mashtruar Ibrën, s'mbahej nga gëzimi. Atij nuk i ishte shtirur askush, por e kishte marrë malli të shkonte në bjeshkë. I përfytyronte fëmijët duke luajtur guxha, rrasa, duke mbledhur drethëza e qershigla dhe lugina e Ujëbardhës. i dukej si shpellë, si kthinë burgu. Për të shpëtuar prej saj, kishte trilluar ngjarjen me burrin mjekërgjatë e me brirë cjamin.

E dinte se e ëma do të mërzhitej, madje edhe do të

inatosej me të, por rëndësi kishte që ai të dilte në bje-shkë. Do të shkonte të tëbana e dajës, do të rrinte e do të luante me fëmijët e tij. Që tani i dridheshin në sy livadhet e lulëzuara, shilarëset, degët e aheve e të qer-shiglave....

— Po të më kishe peshuar atë çast që pashë kanalën e prishur, s'do të kisha hequr as sa një pupël zogu! M'u prenë të dy këmbët në gju...

Kështu i tha Ibra Kingjit më vonë, kur folën për atë ngjarje që tronditi jo vetëm punëtorët, Gurajën, por edhe fshatrat rreth e rrotull.

Kanali kishte mbërritur në gjysmë të Grykës së Zezë. Me të mbaruar punën në mbrëmje, ujët e kishin lëshuar shpatit. Ibra që dilte i pari te kanali, e dëgjonte çdo mëngjes zhurmën llokoçitëse të ujit dhe e ndiente më pak të përpjetën. Por atë mëngjes ai nuk e dëgjoi zhurmën e ujit. Kaq u befasua e u hutua, sa vështroi qiellin. Ishte i kthjellët, pa asnjë gjurmë reje. Toka ishte e tharë, ngaqë s'kishte rënë shi së paku që prej dy muajsh.

Ibra u ngjit te kanali dhe eci buzë tij. Shërja e ujit ishte një shenjë e keqe. Megjithatë ai mundohej ta qetësonte veten. Mbase do të ishte shembur ndonjë shkëmb, ndonjë breg i vogël në anën e sipërme të kanalit. Epo mirë, për këtë gjë ai s'do të mërziqte fare. Shkëmbi ose bregu i rrëzuar do të pastroheshin brenda ditës.

Priste të shihte rrëkenë e ujit në një shpat tjetër, të dëgjonte zhurmën e tij. Mirëpo padurimi po kthehej në ankth. Ecte dhe mendonte se ujët mund të mos ishte ndaluar nga shkëmbi ose nga bregu i rrëzuar. Po nga se atëherë? As ai nuk e dinte...

Kur shkoi tek ama e kanalit, sytë iu veshën nga një mjegullirë, aq sa nuk i shquante mirë gjërat. I hidhte

hapat sikur ecte në llucë ngjitëse. Në llucën e një ligate me ujë të ndenjtur e barishte të kalbura. Në tre pashë gjatësi kanali ngjante si fyti i një dashi të therur. Edhe ama e kanalit ishte shkatërruar. Nga muri që e kthente ujët e lumit në kanal s'kishte mbetur gur mbi gur.

Ibrës i dukej sikur një dorë me gishtërinj të hekurt po e shtrëngonte në fyt e po ia merrte frymën. Nga dëshpërimi iu tha pështyma e gojës. Madje ndjeu edhe njëfarë maramenthi. U ul mbi një gur. Tani truri i tij ishte një kaos mendimesh e vegullish. A thua guximi i tij, këmbëngulja e tij ishte e marrë, e pakuptimtë?! Në qoftë se ky shkatërrim ishte bërë nga një forcë jonjerëzore, siç mendonte ai në atë çast, a nuk ishte kotësi të çaje e të gërryeje me vite të tëra ata shkëmbinj të pakalueshëm, ato brinja të rrëpirta? Ata mund ta bënëin prapë murin e shembur tek ama, mund ta çanin prapë shkëmbin te pjesa e prishur e kanalit, por kush i siguronte se nuk do të ngjiste ndonjë shkatërrim i ri, i pandreqshëm?! Mund të punoje i varur mbi humnerë, në një kosh thuprash që mbahej nga një litar bliri, por ishte e pamundur të punoje i varur mbi pasigurinë e së nesërme. Vegimi i rrënimit të mynxyrshëm ishte humnera më e errët e më trallisëse. Mund të kacafyteshe me kreshat, me urinë, me shtetin, por kurrsesi nuk mund të mateshe me këtë forcë të mbinatyrshme...

Fshatarët besonin se orët e zanat i shtronin sofrat pranë burimeve, në brigjet e lumenjve. Aty hanin, këndonin e kërcenin deri pas mesit të natës. Po t'i trazonte njeri gjatë kësaj kohe, ato e çmendnin ose e shitonin. Në Gurajë përmendeshin emra barinjsh e shtegtarësh që kishin humbur apo ishin shituar nga Të lumet e natës. Ibra mendonte se shajnia¹⁾ që e kishte trembur bariun e dhive dhe prishja e kanalit ishin dy paralajmërime të orëve e të zanave, që ata të hiqnin dorë nga puna. Po, po... këto shenja ishin të qarta si drita e diellit! Pas këtyre paralajmërimeve do të vinte goditja e tretë, mynxyra.

1) halucinacioni

Mbase Orët e Zanat jo vetëm do të shkatërronin tërë kanalën e hapur, por edhe do të vrisnin të gjithë njerëzit që punonin në të. Me çfarë të drejte do të ngulte këmbë më për të punuar aty, për të rrezikuar jetën e dhjetëra njerëzve?! A nuk do t'i rëndonin si një peshë sflitëse vdekjet e këtyre njerëzve të pafajshëm, që kishin vuajtur me të dhe kishin besuar tek ai?!

Mbështeti duart në gjunjë dhe u ngrit. Ende nuk e dinte se çfarë do të bënte, çfarë do t'u thoshte punëtorëve. Leqet e këmbëve i dridheshin lehtë. E ndiente veten të zbrazët, të flashkët, si kashtë e tharë. Mjegullira që i vishte sytë ishte shpërndarë në tërë qenien e tij: kishte mbushur zgavrën e kraharorit, kockat dhe enët e gjakut...

U ndal te pjesa e prishur e kanalit. Tani vështronte i qetë si ai që sheh kufomën e një njeriu të dashur, pasi është ngirë së qari. Jo, nuk po i bënë sytë; rreth e rrotull shtratit të kanalit kishte penj të zinj, të lidhur nyja-nyja. Si ishte e mundur që nuk i kishte parë që në fillim?! E megjithatë ata kishin qenë aty.

Sado që vuri re në të gjitha anët, përveç penjve të zinj e tërë nyja, Ibra nuk dalloi asnjë gjurmë tjetër. Megjithatë edhe ata penj mjaftonin për t'u bindur se ky shkatërrim nuk ishte bërë nga një forcë jo njerëzore. Mbrëmë aty kishte ndodhur diçka e tmerrshme. Disa duar, njerëzish, me egërsinë e putrave të një bishe, kishin shqyer buzët e kanalit, kishin rrënuar ëndrrën e gurajasve për ujë si të prishnin një fole milingonash, mandej kishin shpërndarë rreth shembëtirës penjtë e zinj tërë nyja. Penj të këtilillë përdroreshin nga shtrigat e magjistarët për të bërë magji. Pra, dikush donte që kanali i tyre të mos mbarohej kurrë, të lidhej nyjë si penjtë e zinj dhe uji i tij të mos arrinte kurrë në Gurajë. E, në fund të fundit, dikush donte që të lidhej nyjë vetë jeta e Gurajës!... Ibra u përku, mblodhi penjtë e zinj, i bëri shuk dhe i futi në xhep, Mjegullira u davarit prej tij. Ligështia, dëshpërimi u shndërruan në mllef.

A do të mundem t'i bind këta? — mendoi ai, duke

parë Kingjin dhe punëtorët e tjerë që po vinin te vendi i shembur. A nuk do të tronditeshin edhe ata, siç ishte tronditur vetë disa çaste më parë?!

Fytyrat e punëtorëve u ngurtësuan dhe u zbehën nga tmerrri. Ibra u përpoq t'i bindte se këtë prishje e kishte bërë dikush që ia donte të keqen Gurajës, që donte t'i pengonte e t'i detyronte të hiqnin dorë nga kanali. Duke vështruar me ankth vendin e shembur, punëtorët e dëgjonin në heshtje, pa i kundërshtuar as pa i tumirur fjalët e tij. Në vetëdijen e tyre të tallazuar nga kjo shembje e mistershme, u shkrodhën nga mugëtira gojëdhëna të moçme e qenie fantastike. Nuk ishte e lehtë t'i dëboje nga kokat e gruajasve ato gojëdhëna e ato qenie, të cilat u gjallëruan si bari i egër që pushton rrënojat e një shtëpie të mbetur shkretë.

Duke vënë re atë shkëlqim të turbullt që lëshonin sytë e tyre, një përqethje e ftohtë, si shtizë akulli, i kaloi nëpër trup. Ai mendoi se punëtorët mund të largoheshin nga kanali ashtu siç ishin larguar edhe nga Përroi i Thatë. Iu kujtua fytyra e shkretuar e Murat Gjokës që e kishte hasur në rrugë, në të hyrë të Gurajës. Për një çast iu duk sikur të gjitha forcat e jetës u tërhoqën prej tij, siç tërhiqen lëngjet nga gjethja e pejzuar. Kjo që dita më e rëndë e më e dëshpëruar që Ibra përjetoi në brigjet e këtij kanali...

Pas një ngurrimi të gjatë punëtorët ia nisën prapë gërmimit. Ibra nuk u largua për asnjë çast nga kanali. Kishte frikë se mos ikte ndonjë punëtor fshehurazi, E merrte me mend se çfarë ndikimi të keq, mbase edhe të kobshëm mund të kishte edhe largimi i një njeriu të vetëm. Ai vinte re se shumë vetë punonin pa zemër. Herë pas here sytë u shkonin nga ana e vendit të shembur. Kushedi çfarë prisnin të ngjiste!

Tërë sy e veshë, Ibra përgjonte edhe zhurmën më të vogël, edhe lëvizjen më të dyshimtë që mund të pikaste në shpatin e malit. Ai e dinte se edhe fatkeqësia më e zakonshme që mund të ndodhte atë ditë, do të lidhej pa-

tjetër me forcën e mistershme, do të shihej si shprehje e zemërimit dhe e hakmarrjes së saj.

Ndryshe nga ditët e tjera, te shtrati i kanalit nuk dëgjoreshin as thirrje, as të qeshura. Edhe hokatarët e kishin qepur gojën. Kjo heshtje e përzishme vazhdoi deri në mbrëmje. Ajo u largua nga lugina vetëm kur Prruk Moti i ra lahutës. Ai këndoi një këngë që Ibra s'mbante mend ta kishte dëgjuar ndonjëherë...

Zana, më zi se korbi, shtangon kurshqit me gjithë kuajt dhe rrëmben nusen e Mujit. Kreshniku ngjitet në Lugje të Verdha, zbulon me ndihmën e nuses se forca e Zanës është te një pëllumb që gjendet në një shpellë të largët. Muji e zë pëllumbin dhe matet t'ia përdredhë qafën. E frikësuar, Zana çgurëzon kurshqit e kuajt, megjithatë kreshniku e shtrëngon pëllumbin në pëllëmbë, derisa e mbyt. Në të njëjtën kohë edhe Zana përpëlitet, dridhet, klith nga dhimbjet dhe vdes. Bashkë me nusen e me kurshqit, Muji kthehet në kullë e vazhdon dasmën e ndërprerë...

Kjo këngë që zgjati gati një orë, e ndryshoi krejtësisht gjendjen shpirtërore të punëtorëve. Të mbushur me frymën e këngës, ata e ndienin veten si kurshqit e Mujit, pasi ishin çliruar nga shtangimi i Zanës së zezë. Në sytë e tyre u fikën flakëritjet e ankthit dhe fytyrat e tyre i ngjanin tokës së ngrirë që zbutet nga rrezet e diellit.

I ulur përballë tij, Ibra vështronte me dashuri e nderim ballin e rrudhur me mjekrën e thinjur të lahtarit, Kurrë nuk i ishte dukur diçka më e vyer sesa iu duk atë mbrëmje ajo lahutë e vjetër me gjarpër e kokë dhie. Në njëfarë mënyre edhe kanali i ri ishte një gjarpër që zvarritej me mundim, lakadredhas, midis kershave, lëndinave e pyjeve. Një gjarpër jetëdhënës, ogurmire si gjarpri i lahutës.

Pas lahtarit kënduan disa punëtorë. Mbrëmja në luginë u gjallërua nga bisedat dhe të qeshurat e zakonshme. Pas darke, kur punëtorët ranë të flinin, Ibra dhe Kingji me nga një revole në brez, u nisën për te kanali. Ata ndenjën gjithë natën duke ruajtur. Të rrethuar nga

heshtja e përgjumur, paqësore e natës dhe nga drita e pruar e një hëne të plotë, secili mendonte për atë që kishte ngjarë një natë më parë. Kush e kishte prishur murin tek ama dhe e kishte çarë shtratin e kanalit? Kush i kishte hedhur penjtë e zinj, të lidhur nyjë? Kush mund ta tregonte të vërtetën?... Shkëmbinjtë e murrme, drurët që tundeshin lehtëzi dhe Ujëbardha shamatore, të vetmit dëshmitarë të ngjarjes së mbrëmshme, nuk kishin gojë të flisnin. Shkëmbinjtë e drurët heshtnin, ndërsa ujërat e shkumëzuara të lumit, të stërpikura me dritë hëne, rrëshqisnin të shkujdesur midis gurëve të bardhë e të lëmuar, sikur s'kishte ndodhur asgjë. Zhaurima e tyre mbushte luginën dhe ngjitej drejt qiellit.

Të nesërmen erdhën nga Guraja disa fshatarë të tmeruar e të brengosur. Ata besonin se kanali ishte prishur nga Zanat. Ai kanal nuk do të hapej kurrë. Uji nuk do të shkonte kurrë në Gurajë. Ende nuk kishte ardhur koha që fshati i nëmur të shpëtonte nga etja dhe thatësira, nga dënimi i lashtë.

— Kush ju tha se është prishur kanali? — pyeti Ibra një nga gurajazit e sapoardhur. — Asnjë punëtor nuk ka qenë në fshat...

Gurajasi tha emrin e një fshatari tjetër, i cili nga ana tij tha se lajmin e kishte marrë vesh nga një fqinj. Edhe fqinji e kishte dëgjuar këtë gjë nga një fqinj tjetër. Vargoi i njerëzve që e kishin shpërndarë këtë lajm u zgjat shumë, por ai që e kishte treguar i pari nuk u gjend dot. Tani Ibra e kishte të qartë se lajmi për shembjen e kanalit nga Zanat ishte hapur në Gurajë pikërisht nga ai «dikushi» që e kishte bërë këtë shembje.

Brenda një kohe të shkurtër ky lajm mori dhenë. Edhe në fshatrat e tjera u sajuan gjithfarë legjendash që ndryshonin mjaft nga njëra-tjetra, por në fund të fundit thelbin e kishin të njëjtë: Guraja ishte e mallkuar! Ujërat nuk do ta njomte kurrë shtatin e saj të zhuritur!...

Ibra vajti menjëherë në fshat, bisedoi me pleqtë e me anëtarët e komisionit. Disa prej tyre iu lutën të hiqte dorë nga kanali, të mos i inatoste perëndinë, zanat e orët,

përndryshe një fatkeqësi e re, shumë e rëndë, mund t'u binte mbi krye edhe Gurajës, edhe punëtorëve. Kur e pa se nuk mund t'i bindte me fjalë sado të arsyeshme që të ishin ato, Ibra nxori nga xhepi shukun e penjve të zinj tërë nyja.

— Ç'janë këta penj? — thanë ata të befasuar.

— Këta penj i gjeta rreth vendit të shembur. Askush nuk ka dëgjuar se perëndia e zanat janë marrë ndonjëherë me magji. Këta penj janë hedhur nga një dorë njeriu. Bash nga ajo dorë që ka prishur tinëzisht kanal in tonë!...

Kur mori vesh legjendën për prishjen e kanalit të Gurajës nga Zanat, nënprefekti u zgërdhi një copë herë. Megjithatë ajo tërheqje e buzëve të tij të holla anash, që zbuloi një palë dhëmbë të rregullt e të bardhë, ishte më tepër skërmitje.

— E hollë, por tepër e vjetër! — mendoi ai. — Tepër e vjetër edhe për Gurajën arkaike...

Kohët e fundit mëria e nënprefektit ndaj Gurajës kishte marrë përpjesëtime të reja. Ky ishte i vetmi fshat në atë pjesë të mbretërisë ku shtrihej pushteti i tij që s'pranonte të paguante taksat dhe vriste herë pas here ndonjë xhandar. Veç kësaj gurajasit ishin ankuar deri te mbreti, duke thënë se zyrtarët silleshin keq dhe nuk canin kryet për hallet e popullit. Edhe për rebelimet, edhe për ankesat e Gurajës, nga kryeqyteti kishin ardhur vërejtje e urdhra të prerë, në vend që të vinte ajo shkresa magjike, e cila do ta largonte përgjithmonë nga ai cep i humbur e i mërziqshëm. Vazhdimisht ëndërronte për atë shkresë, ashtu sic kishte ëndërruar në vogëli për qilimin fluturues. Kur ishte shumë i rënë shpirtërisht ose shumë i galduar, afrohej te dritarja e zyrës dhe vështronte atë

pjesë të qiellit që binte nga ana e kryeqytetit, sikur të priste që të shfaqej shkresa — qilim fluturues. Si për inat të tij në qiell dukeshin vetëm sorra të zeza që gagaritnin me zhurmë nga uria dhe tufa kurrilash që fluturonin lart-lart e iknin drejt veriut («drejt Evropës!» ofshante ai).

Ka të ngjarë që kjo shkresë s'kishte të bënte fare me vërejtjet e zyrove mbretërore, të cilat nuk e pengonin as nuk e shtynin ardhjen e saj. Megjithatë për këtë vonesë nënprefekti fajësonte e mallkonte Gurajën e rreshkur në diell, Gurajën e uritur e rebele.

— Tani është rasti që të hakmerrem si duhet! — tha me vete. — Jo vetëm do t'ia ndaloj ujët, por edhe do t'ia shteroj gjakun e damarëve...

Hakmarrja që kishte menduar ai, ishte vërtet djallëzore dhe mizore. Ajo ishte njëherësh edhe e lashtë, edhe moderne. Skërmitja u shndërrua në një gulç të qeshuri, që nënprefekti s'pati nevojë ta frenonte ose ta përligjte, me që në zyrë nuk kishte njeri.

Në qiell, në afërsi të malit përballë u duk një korb i madh, i vetmuar. Duke e ndjekur me sy fluturimin e tij të ngadalshëm e të rëndë, nënprefekti ndjeu keqardhje për vetminë e tij dhe mendoi se korbi mund të ishte i uritur.

— Mos u mërzit, o mik, — murmuriti ai. — Së shpejti do të shtrojmë për ty një gosti mbretërore...

Provoi kënaqësinë e bishës që lëpin buzët me gjuhë, para se t'ia ngulë dhëmbët presë së vet, mbi të cilën ka mbështetur putrën e fuqishme. Kjo ndjenjë kënaqësie që përzihej edhe me krenarinë për aftësitë e tij si zyrtar i diplomuar që merrej edhe me studime shkencore, e përtëriu si një fllad i freskët.

U afrua te tryeza dhe i hodhi një sy punimit që kishte nisur për gjakmarrjen. Kishte mbledhur shumë lëndë dhe kishte gjetur disa studime që merreshin me këtë çështje. Në fillim puna i kishte ecur mirë, por pas disa muajsh pena sikur ngecte pas çdo fjale e rreshti. Pritja e shndërruar në ankth, ia kishte acaruar nervat dhe e

kishte bërë krejt të pavullnetshëm. Sidoqoftë lëndën që i duhej e kishte gati, mekanizmin e gjakmarrjes e njihte mirë, kështu që punimin do ta mbaronte edhe më vonë, kur të ikte në kryeqytet.

Kryeqyteti më parë, pastaj punimi, tha ai me vete. Dhe më parë nga të gjitha: Guraja!...

Sapo doli nga zyra e nënprefektit, Çaus Beka i hipi kalit dhe e ngau me të katra. Megjithëse vithet e kalit ishin larë me djersë, kryeplakut të Breglumit i dukej sikur po ecte fort ngadalë. Me të mbërritur në fshat, pa u çlodhur fare, shkoi te kullat e krerëve që i kishte miq të ngushtë. Kur u kthye në shtëpi, kishin kaluar disa orë natë. Qentë e mëdhenj e kërleshanë që vërtiteshin rreth kullës, e njohën nga zëri, ulën bishtin dhe e ndoqën derisa mbylli derën e avllisë.

Të nesërmen, aty nga dreka u mblodhën në kuvend të gjithë breglumasit. Folën kryeplaku, bajraktari, krerët dhe fshatarë të tjerë.

— Deri më sot Guraja na ka rrëmbyer vajzat! Tash po na bën edhe më zi, po na rrëmben ujët!

— Ta dini se, po të na marrë ujët Guraja, do të na hyjë në hise të bereqetit. Uji është gjaku i tokës....

Këto fjalë ku bestytnia përzihej me smirën, i ndezën keq breglumasit. Vërtet nuk kishin derdhur asnjë pikë gjaku për vajzat e rrëmbyera, por për ujët ishin gati të vrisnin e të vriteshin. Ata nuk mund ta përfytyronin Gurajën me vija plot ujë e me bereqet. Nuk mund t'i merrnin me mend gurajasit pa thasë të zbrazët në krahë, duke ardhur drejt fshatit të tyre.

Në kuvend fjalët pasonin njëra-tjetrën, duke e ndezur urrejtjen e breglumasve të acaruar, ashtu si drutë e thata që vihen në zjarr e marrin flakë menjëherë.

— Ata po dhunojnë vullnetin e perëndisë, i qofshim falë ditën e natën. Vetë i madhi zot i ka lënë pa ujë. Ai edhe i bëri me dije që të hiqnin dorë nga kanali. Herën e parë u shembi skelën para syve e u tha: Lëreni këtë punë, se nuk do të shpëtoni shëndoshë! Herën e dytë çoi Zanat e malit për të prishur kanalin e u tha: Mos u mundoni kot në këtë kanal, se ujët nuk do të shkojë në Gurajë sa të jetë jeta! Ata prapë rrahën biçak e nuk u larguan nga kanali. Tash do të marrë vesh Guraja se çka do të thotë të grabitësh tjetrin në mes të ditës! Lumë do ta derdhim gjakun, por ujin tonë nuk do ta lëshojmë...

Kur shqiptoi fjalën «gjak», Çausi Beka lëpiu buzët.

— Në arat e Gurajës nuk do të shkojë asnjë pikë ujë prej lumit tonë, pa u mbledhur të gjitha hardhucat e malit e ta pinë tërë lumin pikë-pikë! — tha një breglumas me sy të kërcyer.

Dhjetëra bulçi i frynë me zell e me duf zjarrit të urrejtjes kundër Gurajës. E shkujdesur, pakëz e lodhur nga rruga e gjatë, Ujëbardha kalonte përmes fshatit, duke murmuritur për ato që kishte parë e dëgjuar në udhëtimin e saj të pambaruar. Megjithëse askush s'ia merrte vesh gjuhën, ajo s'lodhej së treguari. Në të dy krahët e rrjedhës së saj zgjateshin mustaqet e misrit, rriteshin mollët në degë, fryheshin kokrrat e rrushit. Lëngu i jetës, si një lumëth i padukshëm, lëvizte e qarkullonte pareshtur nëpër pejzat e bimëve, të drurëve të moshuar e të rinj.

Jehona e kërcënimeve të Breglumit nuk vonoi të ngjitej në Gurajë. Krifa e zemërimit të saj u kërlesh. Duke u ruajtur që të mos binin në sy të njerëzve të qeverisë e të besnikëve të tyre, disa fshatarë morën armë të fshehta, ndonjë armë që e kishin me leje dhe zunë pritë në një qafë, ku kalonte rruga nga Breglumi në kanal.

Të nxitur nga Çausi dhe nga krerët e tjerë, breglumasit morën armët, u hodhën një sy pronave dhe u nisën përpjetë. Ata nuk do të sulmonin Gurajën, por do t'i binin fshatit anash, për të mos u diktuar nga kundërshtarët, e tyre. Ishin të bindur se punëtorët, të kapur në

befasi e pa armë, nuk do të bënin dot kurrfarë qëndrese. Pasi ta mbushnin shtratin e kanalit me kufoma e me gjak, do të shkatërronin gjithçka që ishte ndërtuar nga duart e gurajasve, për të mos mbetur nga kanali as she-një, as dukë. Ujëbardha do të sillte në arat e tyre ujëra të përgjakura, do t'i ushqente e do t'i majmte edhe më tepër tokat pjellore...

Mirëpo rrjedhën e këtyre mendimeve e preu në mes një zë i fortë, i thekshëm, që erdhi nga maja e kodrës që ngrihej përballë tyre:

— Ndaluni aty ku jeni. Po të hidhni një hap më tej, do të kërcasë pushka! Ne nuk duam të vritemi me ju!...

Megjithëse vapa të përvëlonte, breglumasit, u mbuluan me djersë të ftohta. Ata ranë prapa shkëmbinjtë e shkurreve si gurë të shtënë me hobe. Nuk u përgjigj askush. Në kuvend ishte vendosur se me gurajasit do të merreshin vesh vetëm me grykën e pushkës. Cilido që do të hapte gojën të fliste me ta, do të vritej në vend, katundisht. Megjithatë ata nuk shtinë të parët. Prisinin që krismat e para të vinin nga ana e guarajsve.

Cungeli la pushkën te prita që kishin zënë gurajasit dhe u ngjit në majë të kodrës.

— Ku po shkon, t'u thafshin krahët?! Kanë me të vra!
— i thirrën shokët nga prapa, por ai nuk u kthye. U ndal në kodër, kundruall breglumasve.

— Vëllezër, të mos vritemi kot! — tha Cungeli me një zë që edhe ishte i ashpër, edhe kërkonte pajtim. — Lumi nuk është i askujt dhe të gjithë kemi të drejtë të marrim ujë në të. Ai ka ujë sa të duash, edhe për ju edhe për ne...

Fjalët e Cungelit u prenë në mes nga pushka e Çausht Bekës, Mbi gurët e nxehtë pizgëroi gjaku i kuq, të cilin e piu me të shpejtë nëpërka e vapës. Mbi trupin e Cungelit të vlarë filluan të kryqëzoheshin dhjetëra plumba si bletët që lëvizin të egërsuara, kur vrenjtet moti.

Xhandarët e postave të Gurajës e të Breglumit i dë-

gjuan krismat e pushkëve, por nuk u shqetësuan as nuk u tundën nga vendi. Postëkomandantët që folën në telefon me nënprefekturën, morën urdhër të rrinin në pritje...

Kur panë një grua që erdhi te kanali me fytyrë të prishur, të lagur nga lotët e nga djersa, punëtorët i lanë kazmat, daltat e çekiçët dhe u mblodhën rreth saj. Mezi e morën vesh se ç'thoshte, sepse ajo më shumë mallkonte, sesa fliste për vetë ngjarjen. Të gjithë u tronditën nga lajmi i saj.

— Të shkojmë e të ndihmojmë shokët! — tha Omeri.

— Vendi ynë i luftës është këtu, — tha Ibra. — Ne nuk kemi armë.

— Por ata po vriten për ne!

Po vriten për Gurajën. Për ujërat e saj.

— Shtrenjtë po e blejmë këtë ujë: me gjak!

— More, po kam frikë se, edhe në e lafshim me gjak tërë Gurajën, thatësira nuk do të shporret kurrë prej saj!

— Në punë, në punë, djem! — tha Ibra, duke u përpyetur të dukej i qetë.. — S'është hera e parë që Guraja ujitet me gjak.... dhe nuk do të jetë as hera e fundit.

Ndërsa punëtorët u kthyen në vendet e punës, Ibra porositi dy vetë të zinin grykën e ngushtë, e cila ishte i vetmi kapërcyell në atë shpat mali.

— Mirë që kemi vetëm dy pushkë, por edhe fishekë ka pak... — tha njëri nga punëtorët, që gjatë dimrit ruante tëbanën.

— Digjini ata që keni, — tha Ibra. — Do të vijmë edhe ne e do të luftojmë me çka të mundemi.

Kingji vuri buzën në gaz. Edhe Ibra, edhe punëtorët e shikuan me çudi.

— Për fishekë nuk ju lë keq! — tha Kingji.

— E ku do t'i marrësh? — tha Ibra.

— I kam fshehur te shpella, — tha Kingji. — E di se nuk kam bërë mirë, por s'më bënë duart t'i prishja të gjithë...

— Nuk ke bërë edhe aq keq, Kingji! — Ibra buzëqeshi. — Sot ata fishekë na duhen shumë. Janë Roja e Trollit, siç ke thënë ti!

Ata fishekë nuk u përdorën as atë ditë. Fshatrat fqinje erdhën menjëherë te vendi i luftimit dhe hynë në mes. Luftimi u ndërpre, por deri atëherë ishin vrarë nëntë gurajas, dhjetë breglumas dhe ishin plagosur disa të tjerë. Fqinjët kërkuan që të dy palët të ulnin pushkët e të ktheheshin në fshatrat e tyre. Pleqtë do të zgjidhnin ngatërresën e ujit dhe do të bënin pajtimin e gjaqeve të asaj dite. Gjatë kësaj kohe, derisa të bëhej pleqërimi, të dy fshatrat ishin në besë me njëri-tjetrin. Ai fshat që do të thyente besën, do të kishte kundër të gjitha fshatrat e tjera e do të ndëshkohej rëndë.

Të vdekurit u varrosën. Plagët e të shituarve vunë kore.

Ditën që u caktua të bëhej pleqërimi, në një livadh, jo larg bregut të Ujëbardhës, u mbloodhën njerëz nga Guraja, nga Breglumi dhe nga fshatrat fqinje. Në qendër të tyre ishin dy pleqtë që kishin zgjedhur Guraja e Breglumi për të gjykuar çështjet e ujit e të gjaqeve, për të mbrojtur interesat e secilit fshat.

Fshatarët flisnin për gjëra të tjera, për thatësirën dhe për mungesën e drithit. Me çdo fjalë, me çdo të qeshur, me çdo psherëtimë të tyre përzihej kënga e gjinkallave, ajo këngë e trishtuar, e çjerrë, që s'kishte të sosur.

Pleqtë ishin ulur larg njëri-tjetrit dhe rrinin të heshur, hijerëndë. Pikërisht kjo heshtje e bënte më të ndjeshme praninë dhe rëndësinë e tyre. Ato fjalë, shaka e ofshama ishin re të bardha, të hirta, vetëtima të shpejta, bubullima të largëta e të mbytura, pika të rralla shiu në prag të stuhisë. Rrebeshi ishte brenda trurit dhe gojës së dy pleqve, përtej syve të tyre të mjegullt, hetues,

Ndonëse kishin besim të madh te plaku i tyre, gurajasi i druheshin shumë dinakërisë së plakut të Breglumit, që ishte me zë për dredhitë e mastrimet e tij. Për çdo pleqërim që kishte bërë, i kishte dhënë të drejtë atij që kishte paguar ryshfet. Disa vjet më parë dy fshatra ishin zënë për një vijë uji. Ai ua dha ujët atyre që s'u takonte. Ata që ua shkeli të drejtën, shtinë me pushkë në oborr, duke thënë se ia vranë pleqinë. Vrasjet midis të dy fshatrave kishin vazhduar edhe për shumë kohë. Pa dyshim edhe gurajasi do ta vrisnin me pushkë çdo vendim që do t'ua mohonte të drejtën për të marrë ujë në Ujëbardhë. Por atëherë ndërmjetësimi i fshatrave fqinje do të merrte fund. Tërë Guraja do t'i ngjiste një kulle të ngujuar që është në gjak. Varre të reja të vrarësh do të hapeshin për muaj në Breglum e në Gurajë.

Kur u ulën ballë për ballë të dy pleqtë, plakut të Gurajës iu përpëlitën qerpikët. Ai e kaloi mbi fytyrë dorën eshtake e të rreshkur për të fshehur këtë shenjë tronditjeje. Mbi kraharor i rëndonte diçka si rrasë e ftohtë guri.

— Vija e re s'mund ta thajë të vjetrën, — tha plaku i Breglumit. — Vija e vjetër e ka zënë plangun e vet, pra, vija e re s'mund ta thajë.

— Uji është gjaku i tokës, — tha plaku i Gurajës. — Kanali i Gurajës nuk e shter lumin dhe nuk i dëmton breglumasit. Megjithëse këta e mballojnë ujët nëpër livadhe e kopshte ose e lënë të rrjedhë kot bri arave të tyre.

— Kush ka, derdh e shkel, — tha plaku i Breglumit. — Kush s'ka, kafshon buzët me dhëmbë e këqyr retë. Kështu e ka lënë zoti... Ujët është i atij që i del në tokë, ose i atij që i kalon nëpër tokë. Pra, me kanun Ujëbardha është e Breglumit. Ai ka tagër të bëjë çfarë të dojë me lumin e vet.

Në sytë e plakut të Breglumit vezulloi një dritë djallëzore. Ai ndiente epërsinë dhe kënaqësinë e nje-

riut që e ka vënë poshtë kundërshtarin e vet dhe ia ka afruar tehun e shpatës te gafa. Breglumasit vështronin njëri-tjetrin të qetë, me fytyra të qeshura, ku lodronte si një refleks mbi ujë një gaz i brendshëm. Rrasa e ftohtë mbi kraharorin e plakut të Gurajës ishte bërë edhe më e rëndë.

— I kujt është tamblu i lopës? — tha plaku i Gurajës.

— I atij që është edhe i zoti i lopës! — tha plaku i Breglunit.

Tani qenë sytë e plakut të Gurajës që u mbushën me një grumbull xixash të ndritshme.

— Aty rri e mos luaj! — tha plaku i Gurajës. Zëri i tij qe i ulët, por i prerë.

— Ujëbardha del prej bjeshkëve, siç del tamblu prej gjinjve të lopës. Aty derdhen gurrat e burimet e bjeshkëve që u përkasin të dy fshatrave. Pra, lumi u përket të dyve, edhe Gurajës, edhe Breglunit. Guraja nuk po grabit njeri, por po merr gjënë e vet. Deri sot nuk ka qenë e zonja ta çajë kershin e ta sjellë ujët në tokat e saj të shkumbuara. Sot po mundohet me thonj e me dhëmbë ta bëjë këtë gjë...

Një hije e errët ra mbi fytyrat e breglumasve. Vetullat e tyre u mrrolën. Plaku i Breglunit kishte ulur kokën. Kishte rënë me të dy këmbët në kurthin që i kishte ngritur plaku i Gurajës. U përpoq të dilte prej tij, duke u kapur pas gurrave, burimeve e rrëkeve që kishte përmendur kundërshtari, por çdo përpjekje i vajti huq. I mbetej një shpresë për të lënë hapur derën e sherrit, kur të bëhej pajtimi i gjaqeve.

Në thesin që ishte midis të dy pleqve u hodhën tetëmbëdhjetë gurë, duke përmendur me radhë emrat e nëntë gurajasve dhe të nëntë breglumasve të vrarë. Para plakut të Breglunit kishte mbetur edhe një gur: ishte breglumasi i dhjetë i vrarë. Varri i tij do të ishte dera e sherrit. Nëpër të do të vinte prapë gjakmarrja.

Plaku i Breglunit tha emrin e të vرارit të dhjetë, por nuk e lëvizi gurin nga vendi. Plaku i Gurajës zgja-

ti trupin, mori gurin e dhjetë para kundërshtarit dhe e futi në thes.

— Po ti çka do të shtiesh në thes? — tha plaku i Breglunit, me njëfarë zemërimi dhe kërcënimi.

— Po shtie këtë gur që është kërjt si guri yt! — tha plaku i Gurajës, duke marrë një gur aty pranë e duke lëshuar edhe atë në thesin e gjaqeve.

— Ashtu u bëftë! — thanë burrat e fshatrave të tjera, të habitur e të lehtësuar nga ajo zgjidhje e papritur.

Breglumasve sa s'u ra' pika nga ky përfundim i pleqërimit. Ishin tri humbje njëra pas tjetrës: u vranë e u copëtuan me Gurajën, humbën gjatë pleqërimit dhe Guraja fitoi të drejtën të merrte ujë në Ujëbardhë. Sedra e tyre nuk ishte goditur kurrë kaq rëndë. Megjithatë pleqërimin nuk e kundërshtuan, nuk vendosën ta vrisnin me pushkë. Ata e kishin shijuar derdhjen e gjakut dhe e kishin kuptuar se ajo ndryshonte shumë nga derdhja e verës së kuqe nëpër gota. Tani që u kishte dalë dehja dhe ishin bërë esëll, donin të ktheheshin sa më parë te jeta e mëparshme, te pronat e kullat e tyre, të mbylleshin në to si kërmijtë që mpiksin me pështymë guaskat e tyre në vjeshtën e vonë. Veç kësaj ata u bindën se Guraja ishte një asht që nuk mund ta brejë pa thyer dhëmbët. Madje ndonjëri mendonte se po i binin më qafë Gurajës pa të drejtë e po bënë mëkat, prandaj ishte rrezik që t'u ngjiste ndonjë kob...

Kënga e gjinkallave ishte bërë më e çjerrë. Vapa ishte e padurueshme edhe në hije. Fshatarët u ngritën në këmbë. Mbetej për t'u kryer vetëm riti i mbytjes së gjaqeve në lumë. Plaku i Gurajës nuk ia la thesin asnjëri, por e hodhi vetë në kurriz. Gurët përplaseshin në thes si të ishin eshtra të vdekurish.

Në breg të lumit plaku e uli thesin në tokë, u mbush me frymë, e kapi grykën e thesit me të dy duart e tha:

— Ashtu siç po i tret unë këta gurë, u tretshin gjaqet e ngatërresat tona në këtë lumë!

U dëgjua një zhurmë e mbytur, uji u ça, thesi u fundos, duke lënë prapa një shtjellë të vogël, mandej sipërfaqja e pusit u dystua përsëri.

Më brufullon tërë shtati, sa herë që shoh së largu ndonjë njeri duke ardhur rrugës së kanalit. Më duket sikur je ti. Më mpihen sytë së shikuari, derisa rrugëtari u afrohet shtëpive të fshatit. Atëherë e dalloj që nuk je ti dhe më mbushen sytë me lot. Më merr malli për ty. Më merr malli të të shoh, të dëgjoj zërin tënd. Më mjafton ta di se je diku afër, se je në kullë, që të jem e qetë dhe e lumtur.

Pa ty, kulla më duket e huaj. Më duket e ftohtë dhe e zbrazët si shpellë. Eci ngadalë nëpër kthina, që të mos bëj as zhurmën më të vogël. Kur marr ndonjë enë a ndonjë send tjetër, përpiqem ta kap lehtazi, pa zhurmë, të mos e përplas gjëkund. Për inatin tim, ndodh e kundërta: ena përplasat me enët e tjera ose bie përtokë me zhurmë të madhe. Po të jetë në shtëpi yt atë në këso rastesh, nëm e truan sa mundet, por pa iu drejtuar kujt dhe del jashtë i zemëruar. Kurse nëna jote vetëm më këqyr me habi, me dhimbje. Mandej edhe ajo largohet nga kthina. Unë ulem dhe e mbërthej fort me gishta enën e rrëzuar, si të ishte ndonjë gjë e gjallë që të rrëshqet nëpër duar.

Por më keq është kur nuk ndodhet askush në kullë. Zhurma e sendit që më bie nga dora oshëtin e përhapet kthinë më kthinë si një hungërimë e frikshme. Më pri-tet fryma një copë herë. Më bëhet se një hije më avitet ngadalë...

E di se, po të t'i tregoja këto gjëra, edhe do të të vinte për të qeshur, edhe do të të vinte keq për mua. Mbase do të ndieje njëfarë faji. Por ti nuk je aspak fajtor që

unë mërzhitem në vetminë dhe heshtjen e kësaj kulle. Që trembem nga mugëtira e saj. Që më, merr malli për ty. Që më rëndon kaq shumë mungesa jote. Mungesa e jetës, e njerëzve, e rrugëve.

Nga dritaret e kullës vështroj gratë dhe nusët e tjera që lëvizin lirisht nëpër oborre, nëpër rrugët e fshatit. Ato mbjellin perime në kopsht, korrin bar në stomije, përcjellin bagëtitë, ndjellin lopët e viçat, ecin me bucelë në shpinë duke bërë çorape, trembin kaçubetin që vjen rrotull në qiell dhe turret të kapë pulat, ngulin shpifiat në arë që të frikësojnë serrat e trumcakët, u thërrasin fëmijëve që hipin nëpër pemë, bisedojnë me njëra-tjetrën, qeshin, zihen, nganjëherë edhe shahen... Të gjitha këto janë të ndaluara për mua, janë të largëta. Më duket sikur jam në gjumë dhe i shoh në ëndërr. Është si një ëndërr e gjatë, e dhimbshme, që më pikëllon. Nganjëherë më rrëmben dëshira të iki nga dritarja, të zbres shkallët me vrap e të dal në oborr, në rrugë... por një zë tjetër më thotë të mos lëviz, të rri brenda. Jam nuse e marrë në gjak. E di se tim eti nuk do t'i bënte dora të qëllonte mbi mua, por këtë gjë mund ta bëjnë katilët, ata që vrasin me pare...

Me ty pranë harroj muret, frëngjitë, katilët që vrasin me pare, çdo gjë të keqe në botë. Nuk rrokullisen me zhurmë enët kur i prek dhe nuk më shpëtojnë sendet nga dora. Nuk rrëqethem nga macja e zezë, që del nga mugëtira duke u shtritur, as nga vezullimi i syve të saj... Me të ikur ti, gjithçka bëhet si më parë. Çdo ditë afrohem te dritarja dhe vështroj rrugën e kanalit, derisa më mpihen sytë e më mbushen me lot. Këtë gjë e bëj fshehurazi, kur s'janë në kthinë nëna jote dhe yt atë. E di se atyre nuk do t'u pëlqente kjo gjë dhe ndosh-ta do t'u shkonte mendja për keq. Megjithatë ata më duan. Sidomos nëna jote. Në fillim m'u duk e padashur, e ftohtë, por më vonë u binda se nuk ishte ashtu. Ajo është zemërmirë. Nuk më thotë kurrë fjalë të ashpra. Yt atë është më ndryshe. Megjithëse s'më urren, e ndiej se për të jam e huaj. Jam nuse e marrë në gjak. Si-

doqoftë këtë gjë ai nuk e shpreh. Kur nuk i pëlqen ndonjë punë a ndonjë gjellë që bëj unë, i bërtet së shpejti. U shmanget bisedave me mua. Madje as emrin nuk ma zë nga, kur flet për mua me të shoqen. A ka ngrënë ajo? — thotë, kur nuk e ndiej veten mirë dhe nuk ulem në sofër. Kështu më quan gjithmonë: Ajo...

Vetmia dhe heshtja që më rrethojnë kanë një anë të mirë: gjithë kohën kam mundësi të mëndoj për ty pa më penguar kush. Të bisedoj me ty më mend. Për së largu të tregoj çdo gjë. S'të fsheh as hidhërimin, as ankthin, as mërzinë. Kështu çlirohem disi prej tyre. Kur bie në shtrat, fle në anën ku fle ti. E mbështes kryet në atë pjesë të jastëkut ku është mbështetur koka jote. Kështu më zë gjumi më lehtë. Shoh ëndrra të mira. E shoh veten duke ecur përkrah teje nëpër rrugë, në ara, në bjeshkë e në brigjet e Ujëbardhës. Flasim e qeshim me të madhe, pa pasur frikë nga im atë dhe nga katilët që vrasin me pare...

Në kullë është qetësi. Nga jashtë vjen kënga e gjinkallave: e çjerrë, e mërzitshme. Habitem sa shumë gjinkalla paska në Gurajë. Këtu edhe kënga e gjinkallave të trishton më tepër se kudo. Kënga e tyre nuk pushon as kur perëndon dielli. Këtë javë ka qenë të nxehtë i madh. Edhe brenda në shtëpi të shkojnë shtatë palë djersë, të zihet fryma. Tërë Guraja bie erë shkrumb. Mua më rri mendja te ti që punon në shkëmbinj, në pishë të diellit...Një plakë që erdhi dje këtu, tregoi se janë vrarë në kufi dy burra që po vinin këndeje me misër në shpinë. Ushtarët e huaj e kanë rrethuar bokën ku ndodhen të vrarët, madje kanë sjellë edhe qen. Shtien me pushkë tërë natën e natës për të mos lejuar asnjëri që të afrohet. Ata e bëjnë këtë që të vrarët të mbeten pa u varrosur, të prishen në diell, për t'i tmerruar fshatarët e tjerë. Kështu kanë bërë edhe më parë, tha plaka. Nganjëherë trupat e të vrarëve i ngrënë në këmbë dhe i lidhin me tel për lis. Edhe pasi kalben e shpëlahen nga shirat, eshtrat e tyre mbeten të lidhura me tel, tha plaka. Po pse e kapërcejnë kufirin, kur e dinë se ç'i

pret?! — i thashë plakës. Eh, moj bijë, ti je prej Breglumi! Kafshata e bukës i dënon dhe i detyron të kapërcejnë atë kufi të zi... Sytë e plakës u mbushën me lot. Tash edhe sytë e mi po më mjegullohen.

Paret që kishin dhënë rendatarët e ujit, po mbaroheshin. Atë që s'e bënë bestytnitë, djallëzia dhe plumbat e breglumasve, mund ta bënte varfëria. Kanali mund të mbetej përgjysmë. Atëherë edhe ky kanal në sy të gurajasve do të ngjasonte me trupin e një kuçedre. Kjo kuçedër do ta vriste përgjithmonë ëndrrën e Gurajës për ujë.

Guraja e parandiente këtë rrezik, por nuk kishte ç'të bënte. Currili i holluar i qumështit të saj ishte në zgrip të shterimit. Verat e thata sillnin me vete zi buke dhe uri. Tubat e bagëtive ishin pakësuar. Tashiti Guraja e varfër s'kishte ç'të jepte më për kanalin, përveç jetës së njerëzve të saj. Megjithatë punimet nuk duhej të ndërpriteshin kurrsesi. Për të shmangur këtë fatkeqësi që po i kërcënonte, gurajasit vendosën të kërkonin ndihmë nga fshatrat e tjera...

Kingji s'do ta harrojë kurrë ditën që shkuan në fshatin e parë. Në fillim takuan disa burra të mirë që u ecte fjala në fshat. Ata lajmëruan të gjithë fshatarët që të mblihdeshin në kuvend.

— E kemi nisur kanalin me fuqinë tonë, — tha Kingji para kuvendit. — Paret që patëm grumbulluar, po na sosen. Kemi ardhur te ju, që të na ndihmoni e të mos na mbetet kanali përgjysmë...

Ndërsa fliste, e ndalte vështrimin herë te një fshatar, herë te një tjetër. Ata dëgjonin në heshtje, me fytyra të menduara. Përse po mendonin atë çast: për hallet e veta, apo për hallin e Gurajës që vuante e

zhuritej nga thatësira?! A thua do ta njomnin dorën që po u zgjatej, apo Kingji me shokë do të largoheshin që andej duarthatë, me sy përdhe?!

Këto pyetje shqetësuese si dhe heshtja që ra, pasi u ul Kingji, nuk vazhduan gjatë. Në logun e kuvendit buisën zëra të shumtë, me të cilët fliste më sepër bujaria e zemrës sesa kamja.

— Ta ndihmojmë Gurajën!

— Kur ta qesë kanalën e vet e të ketë ujë, do të bëjë shumë drithë. Po të mbetemi ne pa bukë, do të na ndihmojë Guraja!...

Kingjit i fluturonte zemra në kraharor nga këto fjalë. Kanali nuk do të mbetej përgjysmë. Ai sillte në mend Ibrën dhe shokët e tjerë që copëtonin kershin me dalta e me barut në luginën e Ujëbardhës. Po aq sa bujaria e fshatarëve, atë e gëzonte besimi i tyre se Guraja do ta mbaronte kanalën dhe do të bënte drithë për vete e për t'u dhënë fshatrave fqinje.

Kështu ngjau në çdo fshat që vajtën për të kërkuar ndihmë. Kingji dhe shokët e tij i ranë kryq e tërthor tërë krahinës. Vetëm në Breglum nuk shkelën. U mblodhën aq ndihma, sa nuk shpresonte as njeriu më ndjellmirë. Bujaria e fshatrave fqinje i preku, u dha zemër edhe gurajasve, edhe punëtorëve që rropateshin me shkëmbinjë e hirtë e të pasosur.

Tani Ibra kishte një tjetër hall të madh: shtrati i kanalit kalonte nëpër një tokë gurishtore, nëpër rrëgalle, ku kishte dhé të paktë. Uji që vinte deri aty duke lloçoçitur, duke shkumëzuar, duke lëpirë buzët e përthara të shkëmbit të çarë, apo të baltës së ngjeshur, humbiste menjëherë nën tokë, pa bërë asnjë çap përpara. Ibra e dinte se ishte e domosdoshme që fundi i

kanalit të shtrohej me çimento. Por të mendoje për çimento në Gurajë, ishte njëlloj si të mendoje për qumësht zogu. Madje Guraja ende nuk e kishte nxënë këtë fjalë të re dhe nuk e dinte ç'ishte çimentoja.

Duke vështruar ujët që e thëhinte babëzisht kershri me fyrla, i cili tani i ngjante një shoshe, Ibrës iu kujtua myshku. Iu duk sikur në duar po e guduliste diçka. Me myshk kishte mbuluar çatinë e «kasolles» kur luante me shokët dhe asnjë pikë shi s'kishte rënë brenda... O lodra të çuditëshme të fëmijërisë, kur njeriu ëndërron të bëjë aq shumë gjëra dhe beson se mund të bëjë gjithçka që ëndërron! Njeriu mendon se tërë bota është një lodër e stërmadhe, të cilës nuk do t'i shterin kurrë as të fshehtat, as të papriturat, ashtu siç nuk do të shterin kënaqësitë që vijnë prej tyre.

I ati qeshte me «vijat», «urat» dhe «mullinjte» e Ibrës. Madje nganjëherë u thoshte të afërmve: «Po më bëhet djali mjeshtër! Pasha bukën, po e lë rrugën e gjyshërve...»

Të parët e Ibrës kishin qenë trima të përmendur për kalë e për shpatë. Shumë kohë më parë një kalorës i huaj i kishte kërkuar dyluftim kalorësit më të fortë të krahinës. Stërgjyshi i Ibrës i kishte hipur kalit dhe kishte vendosur të ndeshej me të. Kur kishte shkuar në Fushë të Mejdanit, ku zhvilloheshin dyluftimet, stërgjyshi i Ibrës kishte nxjerrë shpatën nga milli dhe kishte qëlluar me të një degë lisi. Atë degë e kishte këputur edhe tri herë, para se të binte në tokë. Kalorësi i huaj e kishte vënë re këtë gjë dhe kishte hequr dorë nga dyluftimi. Qysh atëherë shtëpisë së tij i kishte mbetur mbiemri Shpata...

Ibra mori një thes e' u zhduk në pyll. Pas një ore u kthye me të në kurriz dhe e zbrazi në breg të kanalit: u bë një grumbull i vogël me myshk trungjesh e gurësh. Punëtorët që ishin aty afër, vështronin me kurreshtje dhe mendonin se për çfarë do të hynte në punë ai myshk i murrëmë, me fije të praruara nëpër të.

Pasi e ktheu poshtë ujët e kanalit, Ibra kapi me

kujdes palat e myshkut dhe zuri t'i vinte njëra mbi tjetrën si rrasat ose tjegullat e çatisë, në drejtim të rrjedhës së ujit. Mbi shtresat e myshkut hodhi rërë të imët, kurse mbi shtresën e sipërme shpërndau zhavorr të trashë. Në këtë mënyrë u vesh shtrati i kanalit në rreth dy pashë gjatësi.

Kur ujët rrëshqiti pa u pakësuar deri aty ku mbaronte shtroja me myshk, Ibrës i vezulluan sytë dhe iu kujtuan prapë lodrat e gëzimet e fëmijërisë. Megjithatë ai e ndjeu se ato gëzime të kthjellëta nuk do të ngjallehin kurrë më. Ato kishin humbur në një tokë gurishtore që s'mund ta vishte e ta bënte të papërshkueshme as tërë myshku dhe çimentoja e botës.

U caktuan disa punëtorë për të mbledhur myshk. Ibra dhe punëtorë të tjerë vishnin shtratin e kanalit me myshk, rërë të imët dhe zhavorr. Ata punonin pothuajse tërë ditën, duke ngrënë inat me shirat dhe të ftohtët. Nga bjeshkët po uleshin kopetë e Gurajës e të fshatrave të tjera. Kope të hirta resh, me këmborë, bubullimash në qafë, po grumbulloheshin në qiellin e ngushtë të luginës së Ujëbardhës.

Aty nga mesi i pranverës nënprefektit i kërceu një trill i çuditshëm: vendosi të bënte një vizitë te kanali i Gurajës. Prapa këtij trilli fshihej kërsëria për të parë nga afër atë fshat që i kishte sjellë aq telashe, por edhe një prapamendim që e kishte përbluar gjatë këto kohët e fundit. Si mori me vete një aparat fotografik e disa xhandarë, i hipi kalit qimekuq dhe u nis drejt Gurajës, i ndjekur nga vështrimet e habitura të nëpunësve dhe banorëve të qytezës që ndodheshin në rrugë a në oborret e shtëpive të tyre.

Atë natë nënprefekti fjeti në një fshat tjetër. Të

nesërmen mbërriti herët në Gurajë ku u ndal vetëm sa për të pushuar ndanë fshatit, në hijen e një korijeje me lisa. Të befasuar nga ajo vizitë e papritur, Grosh Malota e kryeplaku vrapuan për t'u takuar me të e për t'i uruar mirëseardhjen në fshatin e tyre. Kur vështruan njëri-tjetrin në sy, u bindën se asnjëri nuk dinte gjë më parë për këtë vizitë. Të dy të mëdhenjtë e Gurajës e ndien veten të lehtësuar. Mirëpo kryeplaku krijoi një epërsi të menjëhershme mbi kundërshtarin e vet politik. Pas disa minutash te korija e lisave një shërbëtor solli qumësht me ajkë, kos delesh dhe djathë të njomë. Nënprefekti hëngri disa feta djathë dhe piu vetëm kos, ndërsa qumështin me ajkë e pinë xhandarët. Kur nënprefekti, Grosh Malota dhe kryeplaku u hipën kuajve për të shkuar te kanali, lajmi u përhap anembanë Gurajës. Fshatarët i harruan përnjëherësh hallet e tyre dhe tërë qenia e tyre u pushtua nga një shqetësim i ri.

Edhe punëtorët u prenë, kur panë varganin e xhandarëve dhe kur njohën zyrtarin e rëndësishëm që qëndronte midis Grosh Malotës e kryeplakut. Ata nuk dinin si ta shpjegonin, as si ta quanin atë vizitë të njeriut të qeverisë, që asnjëherë nuk kishte qenë dashamirës me ta. Prej tij nuk mund të prisje asnjë të mirë, megjithatë fytyra e qeshur e nënprefektit të linte të nënkuptoje se ai nuk kishte ardhur për të keq. Punëtorëve nuk u pëlqeu as kjo përzemërsi e pazakontë, sepse në Gurajë nuk u besonin kurrë qenve që s'lehnin dhe zyrtarëve që buzëqeshnin, të cilët mund të kafshonin tinëzisht. Madje për këtë gjë fshatarët përdornin edhe një fjalë të urtë...

Atë ditë te lugina e Ujëbardhës, nënprefekti provoi ndjenja të ndryshme, të kundërta, po që në fund të fundit nuk ndikuan në qëllimin e vizitës së tij. Ai u mahnit nga bukuria dhe egërsia e peizazhit, nga trajtat e maleve me kreshta të kaltëreme apo ngjyrë lule mullage, ku ende kishte lara bore. Pishat blu që dukeshin si zogj që rrinin pezull mbi tymnajën e hirtë

të shkëmbinjve dhe livadhet e bjeshkëve rrzëzë tyre ia shpuzitën mallin për Alpet e Zvicrës ku kishte kaluar pushimet gjatë studimeve dhe kishte provuar disa dashuri kalimtare. Ujëbardha i pëlqeu pa masë dhe tha se nuk kishte parë lumë kaq të bukur, kaq piktoresk as në Evropë. Me mendje të tij shtoi se ky lumë ishte si një perlë para një të verbri. Këtë mendim e shoqëroi me një nënqeshje të lehtë.

Nënprefekti nguli këmbë të ngjitej edhe te shtrati i kanalit. E vërteta është se i bëri përshtypje puna që ishte kryer në një truall aq të vështirë, me vegla e mjete si të mesjetës. Po të mos e kishte parë me sytë e tij, këtë gjë nuk do ta kishte besuar kurrë. Mirëpo ky admirim nuk ndryshonte nga admirimi që ka njeriu për një milingonë që tërheq një copë kashtë, duke u rrëzuar e duke u ngritur me dhjetëra herë. Ai mendonte se nga ana intelektuale dhe teknike, puna e atyre fshatarëve me fytyra të ligura, të mbuluara me dhë e me pluhur guri, ndryshonte fare pak nga puna e milingonave. Përsëri në kujtesën e tij u gjallëruan përfytyrime të tjera, madhështore si Kulla Eifel, tunelet që përshkonin alpet zvicerane, veprat e ujitjes që kishte parë në Vendet e Ulëta... Dhe kjo vijëz e gjorë uji iu duk si shëmbëlltyrë e kombat të vet. Ndjeu njëfarë dobësie dhe fataliteti, që ishte i detyruar të shtynte ditët në skajin më të prapambetur të vendit të tij.

U tha fshatarëve se vepra e tyre (nënqeshja i shkrepiti në cep të buzës) do të ndihmonte në lulëzimin e mëtejshëm të mbretërisë, që ishte edhe dëshira kryesore e sovranit të tyre august, e mbretit reformator. Pas fjalimit të shkurtër nxori në fotografi kanalën e hapur dhe punëtorët duke çarë shkëmbin me dalta. Kur nënprefekti vinte syrin në objektiv, gurajasve u dukej sikur po i merrte në shenjë me një armë të panjohur. Mosbesimi u davarit vetëm kur nënprefekti ia dha aparatit një xhandari të ri që e kishte mësuar se si ta përdorte, dhe u ngjit në kanal. Ai qëndroi në mes të punëtorëve, në një vend shkëm-

bor, ndërsa xhandari i ri e shkrepri aparatën disa herë.

Natyrisht ky gjest i preku zemrat e atyre malësorëve të munduar nga jeta e ashpër dhe nga pashpirtësia e zyrtarëve të çdo regjimi. Po aq sa për ujë, ata ishin të etur edhe për mirëdashje. E kishin të nevojshme që t'i nderonte dikush dhe ta vlerësonte punën e tyre. Gjatë atyre minutave midis nënprefektit dhe gurajasve u krijua njëfarë afërie e vetvetishme. Ata i thanë njeriut të qeverisë që t'i përkrahte, të ndërhynte te mbreti, për t'u dhënë ndonjë ndihmë.

— Fol për hallin tonë me mbretin, se ty të ecën fjala më shumë se ne, — i thanë.

— Po të na japë mbreti ndonjë ndihmë të vogël, do ta mbarojmë më shpejt këtë kanal...

Duke dëgjuar këto fjalë, nënprefekti mezi e mbajti të qeshurit. Sa naivë që janë! — mendoi ai. — Pandejin se mund të takohem e të flas me mbretin kur të dua... Sidoqoftë ai u premtoi se, sapo të shkonte në kryeqytet, do të fliste me mbretin për kanalin e Gurajës dhe do të bënte çmos t'u siguronte njëfarë ndihme. U dha dorën disa punëtorëve (sikur të gërvishtnin, të kafshonin ato duart e tyre të ashpra e të çara!) dhe u largua nga kanali.

Si shpenzoi të gjitha pozat e filmit që kishte në aparat, duke fotografuar rrjedhën vezulluese të Ujëbardhës, ujëvarat që ushqeheshin nga bora e shkrirë e majave, shkëmbinj me forma interesante, drurë të mëdhenj e të bukur, nënprefekti i hipi kalit qimekuq dhe u kthye në nënprefekturë.

Nga gjithë sa kishte parë, ishte bindur se gurajasit nuk do të gjunjëzoheshin kurrë, edhe sikur të burgoste, të vriste e të varte në litar gjysmën e tyre. Duke përdorur kundër tyre vetëm dhunën, nuk do të merrnin fund as rebelimet, as vërejtjet dhe urdhrat që vinin nga lart...

Disa ditë më vonë nënprefekti mori udhën e kryeqytetit. Ai arriti në zemër të mbretërisë i lodhur nga udhëtimi i gjatë, por me një synim të qartë e me një

plan të menduar mirë. Ndryshe nga herët e tjera, kësaj radhe takimin e parë e bëri me një shok që punonte në njërën prej gazetave qendrore të mbretërisë. Nënprefekti i foli për kanalën e Gurajës dhe për vizitën e tij. I tha t'u hidhte një sy edhe fotografive që kishte bërë atë ditë në luginën e Ujëbardhës. Gazetari qeshi dhe i shkeli syrin me nënkuptim.

— Do ta qaj! — i tha.

Nënprefekti e falënderoi dhe u shtriq në kolltukun e rehatshëm, pa ia ndarë sytë një nudoje që ndodhej mbi një etazher, përtej shpinës së gazetarit. Ata kujtuan ndonjë ngjarje të kohës së studimeve, folën për politikën, për femrat, për gradimet e shokëve të tjerë dhe për skandalet më të reja të shtresës mondane të kryeqytetit. Kur u ndanë, gazetari mbajti disa fotografi, ia shtrëngoï dorën fort dhe i tha prapë:

— Ki besim tek unë. Do të jetë diçka që do të bëjë bujë!...

Dhe kur nënprefekti ndodhej dy-treqind kilometra larg, në gazetën e lartpërmendur u botua shkrimi me titull: SHËMBËLLTYRË E MBRETËRISË. Në të flitej për Gurajën e humbur diku midis maleve, për natyrën e saj piktoreske, për thatësirën e saj të tmerrshme, për Ujëbardhën me ujë të kthjellët e trofta pikëlore si dhe për kanalën e ri që po ndërtohej nga fshatarët në ditët fatlume të mbretërimit të sovranit reformator. Një vend të veçantë në këtë shkrim zinte figura e nënprefektit populldashës (neologjizëm i gazetarit), i cili, krahas detyrave shtetërore, përpiquej për përparimin dhe qytetërimin e tërë nënprefekturës së tij, interesohej për problemin e ujitjes, për hapjen e kanalit të Gurajës fatkeqe dhe merrej me studime etnografike. Shkrimi shoqërohej me tri fotografi, ku paraqiteshin Ujëbardha, një pjesë e shtratit të kanalit që kalonte nëpër shkëmb dhe nënprefekti në mes të punëtorëve.

Megjithëse nga ky shkrim me stil të përfryrë nuk dilte qartë se kush ishte shëmbëlltyra e mbretërisë: Guraja e munduar nga thatësira, apo nënprefekti popull-

dashës, jehona e tij në kryeqytet që e menjëhershme, madje edhe më e madhe nga ç'shpresonte autori i tij.

Duke e krahasuar me shkrimet e tjera bajate që botoheshin ditë për ditë, ky shkrim ishte një risi, një zbulim gazetaresk, në qoftë se mund të thuhet kështu. Ai hidhte një dritë të trëndafiltë mbi tërë mbretërinë dhe zyrtarët e saj, në një kohë kur nuk mungonin as trazirat, pakënaqësitë e vegjëlisë, as kalbëzimi i zyrtarëve dhe moskokëçarja e tyre e plotë për shtetasit që i qeverisnin në emër të sovranit august.

I mbyllur në zyrën e vet, heroi i shkrimit e lexoi gazetën disa herë, ashtu si i eturi që fut kokën në burim dhe s'ngihet së piri. Më vonë nga kryeqyteti erdhi edhe jehona e shkrimit në formë letrash, telegramesh, urimesh me telefon. Ishte një breshër lëvdafash e përgëzimesh nga të njohur e simpatizues, midis të cilëve nuk munguan as zyrtarë të lartë.

I bindur se kali në të cilin kishte hipur do ta çonte pa vonuar në kryeqytet, i grahu me të katra. Nisi menjëherë një kërkesë të fshatarëve të Gurajës për ndihmë financiare. I shkroi një letër një zonjushje që ishte e përmendur në kryeqytet për hijeshinë dhe pasurinë e saj. Ajo kishte deklaruar se në tërë mbretërinë nuk kishte burrë të denjë për t'u martuar me të. Nënprefekti e kishte parë rastësisht në një sallon. Me anë të kësaj letre i lutej zonjushës në fjalë të mblidhete disa ndihma për Gurajën, nëpërmjet shoqërisë bamirëse që kryesonte ajo.

Duke marrë parasysh përshtypjen e mirë që kishite lënë shkrimi i botuar në gazetë dhe atmosferën e krijuar me rastin e një përvjetori të rrumbullakët të shpalljes së mbretërisë, shpresonte të dilte diçka nga këto përçapje dhe të siguronte ndonjë thërrime për gurajasit. Parashikimet e tij u tejkaluan në të dy drejtimet: në kohën e ardhjes dhe në sasinë e ndihmave. Zakonisht për shkresat që niste me firmën e tij, merrte përgjigje shumë vonë, ose nuk merrte kurrë. Kësaj here ngjau një mrekulli: përgjigjja erdhi shumë shpejt.

Mbreti reformator e bujar u dhuroi gurajasve dy mijë napolona flori. Edhe shoqëria bamirëse dërgoi një ndihmë të vogël në të holla e dhurata për fëmijët e Gurajës.

Natyrisht, për të gjitha këto u shkrua gjerë e gjatë në gazetatat qendrore të mbretërisë. Kudo vihej theksi te shpirtmadhësia e sovranit, te dashuria e tij për popullin e përparimin.

Nënprefektit populldashës e etnograf nuk i mbeti qejfi që emri i tij nuk u përmend në këto shkrime. Tani ai priste diçka më tepër, më të rëndësishme e më të prekshme. Dritat e lampadarëve të kryeqytetit u bënë lëbyrëse në fantazinë e tij.

Nga kjo pritje e ethshme humbi dy gjëra: gjumin dhe qetësinë. Mezi flinte disa orë gjatë natës. Nuk rrinte dot disa minuta në një vend. Të shumtën e herës mbështetej në parvazin e dritares, vështronte atë anë të horizontit ku kalonte rruga për në kryeqytet dhe ëndërronte...

Kingji po pastronte bishtin e llullës me një fije kashte.

— Paj, as unë nuk po them se mbreti është burrë i mirë... Por, ama, për të na ndihmuar na ndihmoi!

— Na mashtroi me një thërrime, thuaj!

— Një thërrime, po, por, kur je në ditë të hallit, edhe një thërrime vlen sa të thuash!

— Kjo thërrime s'duhet të na mashtrojë, Kingj. Zogu që mashtrohet prej thërrimes, bie në grackë.

— E di, Ibër... Edhe unë kam zënë zogj kështu dikur. Por çka të bëjmë?... Ato pare s'kemi si të mos i marrim.

— Unë i kam në trup shenjat e kamxhikëve të

xhandarëve të tij, Kingj. Po a vetëm unë?... Janë disa gjëra që duhet t'i kujtojmë prore.

— Aih, sot qenke pezëm, Ibër, e thua çka të duash! Ti e di se unë s'i kam rëndë fjalët e tua...

Heshtje bukur e gjatë.

— Tash do të të them diçka që ti s'e ke dëgjuar, Kingj, e ndoshta nuk të besohet...

— Fjalës që del nga goja jote unë i kam zënë besë gjithmonë, Ibër.

— Guraja jonë po vdes për bukë dhe mezi i ka mbetur një pikë qumësht... Në burg kam dëgjuar se të motrat e mbretit laheshin me qumësht në vend të ujit, që t'u zdritej lëkura e të dukeshin të bukura. Si të duket kjo punë, Kingj?

— Mos pyet, Ibër! Nuk mund t'i vë emër...

— Por e ka një emër, Kingj.

— Cilin?!

— Kuçedër!... Mbreti, farefisi dhe zyrtarët e tij janë një kuçedër me një mijë krerë. Kuçedra që ka zënë Perroin e Thatë s'është kurrgjë në krahasim me këtë! Prapë heshtje e gjatë.

— Pra, ti thua të mos i marrim ato pare?

— Po, Kingj. Dua që në këtë kanal të jetë vetëm djersa dhe gjaku i Gurajës.

— Veç po e përbuzëm ndihmën e mbretit, ata mund të na bëjnë ndonjë të keqe. Nuk do të na japin dinamit e kapsolla...

Ibra psherëtiu.

— Po, Kingj, nuk do të na japin.

— Dhe pa dinamit e kapsolla, kanali mund të na mbetet përgjysmë.

— E di.

— Atëherë duhet të zgjedhim të keqen më të vogël, Ibër.

— Ndoshta ke të drejtë, Kingj... Por, sido që të bëhet, një gjë e kërkoj prej teje: të mos shkosh t'i marrësh ato pare!

— He, atë hall ke ti!.. Kryeplaku e Grosh Malota janë nisur ka dy-tri ditë për të marrë ndihmat në kryeqytet...

Dera u hap ngadalë dhe nënprefekti pa gurajasit që hynë në zyrën e tij. Kingji e falënderoi nënprefektin për përkrahjen e tij dhe për ndihmat që po u jepte mbreti.

— Ti e ke parë vetë me çfarë mjetesh punojmë, — tha Kingji. — Siç na ke premtuar, kemi ardhur të na jepni dinamit, kapsolla, fitil e disa vegla pune.

— Këtu nuk kemi as dinamit, as kapsolla, as fitil, — tha nënprefekti duke buzëqeshur.

— Në mos pastë këtu, do të ketë në magazinat e prefekturës, — tha Kingji. — Po të duash, ti mund të na lëshosh një shkresë, që të na i japin këto sende që na duhen shumë...

Sytë e gurajasve ishin ngulur mbi të. Nënprefekti u luhat një copë herë midis mendimeve të kundërta: t'ua jepte a të mos ua jepte atë shkresë? Një zë brenda tij i bërtiti «Jo!», por ai nuk e dëgjoi këtë zë. Vërtet «dashamirësia» e tij për gurajasit po i kalonte kufijtë, mirëpo shkresa me sigël mbretërore ende nuk ishte dukur. Kur nisi të shkruante mbi letrën e bardhë, iu drodhën gishtërinjtë. Sidoqoftë e mbaroi shkresën, e firmosi, e vulosi dhe ia dha Kingjit në dorë. Gurajasit e falënderuan me ato shprehjet e tyre ku përmen-deshin orët e zanat dhe dolën nga zyra, duke lënë prapa erë djerse e toke të djegur.

Tashmë në Gurajë nuk flitej për ardhjen e ujit si për një shpresë që mund të përmbushet, por si për një gjë që askush nuk e vë në dyshim. Ujët mund të vononej edhe një vit, edhe dy, madje edhe më shumë se kaq... Punë e madhe! Guraja kishte pritur qindra vjet, kishte thurur legjenda, kishte ëndërruar, ishte mbështjellë me mirazhin e ujit, ishte zhgënjyer aq herë dhe s'ishte lodhur. E si do të lodhej tani nga një, dy a tre vjet pritjeje kur e dinte se ardhja e ujit ishte e sigurt?!

Nga lugina e Ujëbardhës vinte buçima e minave dhe e shkëmbinjve të rrëzuar. Ishte një buçimë ogurmirë që bëhej përditë më e qartë, më e fortë. Kësso buçimash Gurajës i kishin jehuar në veshë vetëm në vitet e luftërave të mëdha e të kryengritjeve, kur topat e huaj qëllonin për të shembur kullat e për të tmerruar njerëzit. Kur gjëmonte moti në mars, gurajasi thoshin: Po hyn dimri nën tokë! Duke dëgjuar buçimat e minave, ata besonin se po futej nën tokë thatësira e të gjitha verave të kaluara e të ardhshme. Tani e kishin më të lehtë t'i duronin urinë, arat e shkullura, dasmat e shtyra dhe këngën e çjerrë të gjinkallave...

Mushkat e kuajt që ngarkoheshin me lëndë plasëse në prefekturë, udhëtonin katër-pesë ditë për të arritur në vendin e punës. Po lënda plasëse e kishte lehtësuar dhe e kishte shpejtuar shumë çarjen e shkëmbit. Shtrati i lakadredhur i kanalit, vetëtimë e stërgjatur, e priste mepërmes Kershin e Kuq.

Mirëpo Kershin i Kuq ende nuk ishte mposhtur. Mbetej për t'u çarë një shkëmb i dalë si turi ujku, tepër i thepisur e i rrezikshëm. Për të shmangur fatkeqësitë gjatë punës me mina, Ibra kishte zgjedhur disa punëtorë të shkathët, të cilëve u kishte mësuar të gjitha ato që dinte vetë për përdorimin e minave. Megjithatë edhe tani minat nuk i ndizte askush tjetër përveç tij.

Qëkurse ishte plagosur, kishte bërë njëfarë mbu-

roje prej të kuqit të pishës, për të mbrojtur kokën e kraharorin, kur futej në guvat e vogla pas ndezjes së minave. Theplat e gurëve që kishin mbetur në mish, pasi ishin mbyllur plagët, e shqetësonin herë pas here. Madje kishte raste kur i shkaktonin dhimbje të padurueshme. Ai shtrëngonte nofullat dhe ia ngul-te sytë malit të çarë. Atë çast zhvillohej një dialog i shkurtër, pa zë, midis njeriut dhe malit. Ti nuk duhej të më prekje, thoshte mali. Si dënim për paurtinë tënde, për guximin tënd të tepruar, unë të shitova dhe të gjakosa. Kurrë nuk do të shërohesh nga varrët e mia dhe nuk do të shpëtosh nga dhimbjet që të shkaktojnë gurët e mi, që mbetën brenda mishit tënd. — Ti më gjakose, i thoshte njeriu malit. Edhe Rexhën e vrave. Mund të vrasësh edhe ndonjë tjetër. Por kanali ynë do të kalojë përmes trupit tënd të çarë nga duart tona...

Një ditë shkëmbi hapi nofullat e gurta dhe ia kafshoi krahun e djathtë në bërryl e poshtë. Gurët e nxehtë u stërpikën me gjak.

Për të ndaluar gjakun që rridhte rrëke, punëtorët vunë mbi cungun e krahut tërë duhanin e kutive. Omeri grisi këmishën, e bëri fasha-fasha dhe lidhi me to krahun e Ibrës. Rrjedhja e atij lëngu të ngrohtë, të kuq vazhdonte në mënyrë të pandërprerë e të pamëshirshme. Punëtorët e vështronin me dhimbje të thellë... Gjaku nisi të ndalej disi vetëm kur Kingji solli djathë të kripur, e preu feta-feta dhe e mbështolli me to cungun e përgjakur.

— Ta çojmë në fshat! — tha Kingji.

— Po, po... ta nisim menjëherë!...

Meqenëse vendi ishte i rrëpirët, punëtorët deshën ta merrnin në shpinë, por Ibra nuk pranoi. Plaga ishte ende e nxehtë dhe ai nuk kishte dhimbje të mëdha. Vetëm i vinte si të fikët, ndiente një këputje të përgjithshme, njëfarë përhumbjeje që po shtrihej në tërë qenien e tij si borë e ftohtë që bie papritmas dhe mbulon çdo gjë. Bora e vdekjes, mendoi ai, bora

e vdekjes. U mundua ta largonte këtë mendim, ta dëbonte nga truri, por ishte i pafuqishëm ta bënte këtë gjë. Shtresa e borës po bëhej gjithnjë e më e dendur rreth tij. Mezi i lëvizte hapat nëpër të, mezi, mezi...

Pas një copë rruge, Ibrës i dukej sikur po ecnin nëpër atë shteg të pjerrët e me gurë që prej vitesh, pushimet u bënë gjithnjë e më të shpeshta, derisa më në fund ai nuk u ngrit më nga guri ku ishte ulur. Fytyra iu zbardh si gëlqere dhe balli iu vesh me djerse të ftohta. Kingji dhe dy punëtorë e morën në prehër, ndërsa shokët e tjerë, me sy të përlotur, bënë shpejt e shpejt një vig me degë e gjethe ahu, e vunë të plagosurin në të dhe zbritën nëpër shtegun e pjerrët.

Ibrën po e rrethonte një mjegullnajë e ftohtë dhe e hirtë, që dyndej në tërë qenien e tij. Tani ai ishte si një tokë gurishtore, nga e cila po largohej tërë uji dhe po pushtohej nga shkretimi, nga shtangimi i gurëve pa jetë.

Të ulurat e të ngriturat e shtegut ishin të panumërta. Vigu luhatej. Mjegullnaja që e mbështillte Ibrën, herë dendësohej e errësohej, herë lëvizte e çapej. Vazhdimisht përmes masës së saj të pakapshme e të pafortë zgjatej një rrëshqanor i madh, i akullt, me sy ngjyrë prushi, por të qelqtë, me një gojë pa dhëmbë, me buzë të forta e ngjitëse që ia kapte cungun e krahut e ia thëthinte babëzisht. Ishte kuçedra që po ia vidhte lumin e jetës së tij, gjakun e kuq e të ngrohtë. Cila kuçedër ishte kjo? A mos ishte kuçedra që kishte shteruar ujët e Përroit të Thatë. Apo ishte një kuçedër tjetër, ajo që ruante lumin e Ujëbardhës? Ajo po hakmerrej kundër tij, ngaqë kishte dashur ta çonte në Gurajë ujët e këtij lumi.

Gjithçka në trurin e tij ishte e mjegullt, e errët. Vetëm kuçedra dallohej në atë masë pa formë që mbushte botën përreth dhe qenien e tij. Ajo ia mbërthente cungun e krahut me buzët e akullta dhe ia thëthinte gjakun, Pa ndërprerje. Që prej qindra vjetësh...

Vigu luhatej. Ai mundohej të hapte sytë, të gjente diçka për të qëlluar kuçedrën e babëzitur, por nuk i lëvizte dot as qepallat. Kuçedra vazhdonte t'ia ndukte cungun e krahut si një sisë të shterur, t'ia pinte gjakun që i kishte mbetur. Kingji ia fshinte djersën me një beze të thatë. Mirëpo djersa ia mbulonte prapë fytyrën, sikur të ishte duke rënë shi. Përpiqej të hapte sytë. Nuk mundte. Përpiqej ta dëbonte kuçedrën e babëzitur, të ngjitur pas cungut të krahut të tij. Nuk mundte. Vigu luhatej. Mjegulla herë çahëj, herë dendësohej...

Mekanizmi shtetëror, i verbër si statuja e fatit, zgjati dorën dhe e tërhoqi nënprefektin në kryeqytet. Si bisha që e tërheq prenë në strofkën e vet për ta ngrënë me nge, larg syve të botës, nënprefekti e shprehu gëzimin që ndjeu nga ky lajm vetëm në zyrën e mbyllur me kyç. Para nëpunësve ndenji hijerëndë e i heshtur si më parë. Me këtë sjellje donte t'ua mbushte mendjen se ngritja e tij ishte e merituar, pra, krejt e natyrshme...

Duke ecur drejt kryeqytetit, më i qetë se asnjëherë tjetër, mendoi për një paradoks të çuditshëm: Guraja rebele që e kishte urreyer aq shumë dhe ishte përpjekur t'ia bënte të zezën, ishte bërë kalë luftime për të pushtuar një kolltuk në zyrat mbretërore të kryeqytetit. Ktheu kokën, vështroi malet ku binte Guraja dhe nënqeshi.

Pas disa orësh malet e mëdha mbetën prapa. Në vend të tyre në të dy krahët e rrugës shfaqeshin male të ulëta dhe kodra të rrumbullakëta. Përtej tyre, në largësi, ishte rrafshina. Nënprefektit i erdhi në mendje fytyra e hijshme, ndonëse pakëz e fishkur, e zonju-

shës së pasur e të pamartuar. Këtë fytyrë e mbajti gjatë në ëndërrimet që thureshin e shtureshin në fantazinë e tij.

Te shtëpia e Ibrës ia behën menjëherë fshatarë nga të gjitha lagjet e Gurajës. Ngaqë nuk i zinte kthina, ata rrinin në shkallë, në oborr dhe prisnin me ankth se çdo t'i ndodhte të plagosurit. Kur Ibra erdhi në vete dhe hapi sytë, Prruk Moti i tha:

— Për hair të goftë edhe kjo varrë, Ibër Shpata!

Kështu ishte zakon të uroheshin ata që plagoseshin në luftë. Ibra u mundua të vinte buzën në gaz.

Prruku me dy-tre fshatarë ndenjën te kryet e Ibrës gjithë natën. Të nesërmen, aty nga dreka, Kingji erdhi nga nënprefektura me një infermier, njeriu i vetëm që merrej me mbrojtjen e shëndetit të shtetasve në atë pjesë të mbretërisë ku ende s'kishte shkelur këmba e mjekut. Kur e pa të plagosurin, fytyra e infermierit mori një pamje të pashpresë, si të ndodhej para një njeriu që është duke hequr shpirt.

— S'i kanë mbetur as tri pika gjak! — tha ai me një zë të ftohtë, ku nuk regëtinte asnjë ndjesi njerëzore.

Ato fjalë, trumba korbash të zinj, e mbushën kthinën me parandjenjën e vdekjes. Supet e njerëzve u kërrusën, si të mbanin përsipër vigun e të vdekurit, rrasa të rënda varri. Ishte një çast kur njerëzit nuk dinin çfarë të thoshin, ku t'i mbanin sytë. I shmangeshin fytyrës së Ibrës, që verdhësia, humbja e gjakut e kishte shndërruar në një shuk dylli, ku mbresat e plagëve të mbyllura ngjanin si gërvishtje.

Befas në atë shuk dylli vezulluan dy pika të ndritshme: sytë e Ibrës.

— Tri pika gjak nuk janë pak! — tha ai me një buzagaz të përdhunë që mezi dallohej. — Edhe po të më kishte mbetur vetëm një pikë gjak, unë prapë do të jetoja...

Infermierit nuk i erdhi mirë nga këto fjalë, por nuk i ktheu përgjigje. Me lëvizje prej njeriu që do t'i japë rëndësi vetes, hapi çantën, ia shpëlau krahun e cun-guar me një lëng të tejdukshëm që lëshoi shkumë dhe ia lidhi me fashë.

— Nuk kam ç'ti bëj tjetër, — i tha Kingjit me një ton asnjanes, si fytyra e tij e bardhë dhe pa shprehje.

Hurbi kafen që i sollën, por nuk pranoi të hante bukë. Futi nën sqetull çantën prej saftjani që ishte lëmuar nga përdorimi i gjatë, tundi kokën, murmuriti disa fjalë që askush s'i mori vesh dhe doli jashtë. Në oborr i kërkoi Kingjit paret për mjekimin. Ngaqë ishte i lodhur e i tronditur, Kingjit i kishte dalë nga mend-ja kjo gjë. Nxori kuletën e i dha aq pare sa kërkoi, megjithëse shuma ishte mjaft e madhe.

— Për këtë njeri mos më thërritni më! — tha infermieri.

Kingji vështroi sytë e tij të kuqërruar, që dilnin edhe më tepër në pah për shkak të fytyrës së tultë e të bardhë. Sy bishe, mendoi Kingji, jo sy njeriu!... Trokëllima e kalit të infermierit humbi në zhurmën e pafundme të këngës së gjinkallave që po pëlqisnin për ujë...

Plagosja dhe gjymtimi i rëndë i Ibrës i pikëlloi jo vetëm gurajasit, por edhe shumë njerëz të tjerë në fshatrat fqinje (natyrisht duke përjashtuar Breglumini). Malësorë të njohur e të panjohur, por që ia kishin dëgjuar zërin si burrë i mirë e si mjeshtër, erdhën ta shihnin, të pinin një cigare duhan me të.

Çdo e keqe paska një të mirë, mendoi Ibra me vete, duke ndier një kënaqësi e krenari që s'e kishte provuar më parë. Ai nuk e merrte me mend se njerëzit e vlerësonin aq shumë punën e tij. Këto ndjenja

i dhanë zemër t'u bënte ballë edhe dhimbjeve, edhe vdekjes.

Të gjithë ata që vinin për ta parë, i uronin shërim të shpejtë, por të paktë ishin ata që besonin se i gjymtuari do të ngrihej prapë në këmbë të veta. Miqve e dashamirësve u vinte keq po aq sa për Ibrën, edhe për kanalën e Gurajës që ishte rrezik të mbetej pa u mbaruar.

Nga gjymtimi i Ibrës u ngjallën përsëri dyshimet e vjetra, bestytnitë dhe parashikimet ndjellazeza. Pas kësaj fatkeqësie, kundërshtarët e kanalit dhe armiqtë e Gurajës vunë në lëvizje lypës, falltarë, dijës e der-vishë, të cilët kalonin fshat më fshat duke thënë:

— Ibër Shtatën e shituan zanat për së dyti! Ato nuk do të lejojnë kurrë që të hapet ai kanal, sepse punëtorët nuk i lënë të lahen lirisht në Ujëbardhë.

— Dy ditë para se të shitohej Ibër Shpata, e kanë parë flockën me dy fëmijë për dore në afërsi të Kershit të Kuq. Ajo kërcëlliti dhëmbët dhe iku duke qeshur si e çmendur drejt një gremine të thellë...

Këto fjalë përvidheshin e pëshpëriteshin edhe nëpër oborret e kthinat e Gurajës. Megjithëse nuk i kishte rënë gjë në vesh, Ibra e dinte se edhe gjymtimi i tij i tanishëm do të përdorej për të penguar përfundimin e kanalit. Kërkoi të mbetej vetëm për vetëm me Kingjin.

— Kingj, nuk kam ndër mend të vdes!

— E di, Ibër... Po pse po m'i thua këto fjalë.

— Që të jesh i bindur për këtë gjë, Kingj. E të mos hidhërohesh për mua.

— Të tërë kemi besim se do të shërohesh pa vonuar.

— Pa vonuar nuk do të shërohem, Kingj. Por ta dish se nuk do të iki pa e çarë atë shkëmb e pa e sjellë ujin në Gurajë... A thonë se Ibër Shtatën e shituan prapë zanat?

Kingji nuk mundi t'i dredhonte kësaj pyetjeje, as nuk deshi të gënjente.

— Paj, ti e di se gojët nuk mbyllen...

— Por ne duhet t'i mbyllim, Kingj.

— Hehe!... Ato s'mbyllen, edhe po të përdorim tërë gurët e bjeshkës.

— Ne do t'i mbyllim duke çarë shkëmbin e duke sjellë ujët në Gurajë. Qysh nesër duhet t'ia nisni pra-pë punës në kanal.

Ibra vështroi fytyrën e hequr dhe sytë e pikëlluar të Kingjit. Do ta ketë të vështirë, mendoi ai me vete. Por, sido që të jetë, puna në kanal nuk duhet të lihet në mes. Ujët duhet të vijë në Gurajë, edhe sikur të mos shërohem kurrë...

E ndërpreu rrjedhën e mendimeve dhe iu drejtua Kingjit:

— Mblidhi punëtorët e folu në emrin tim, Kingj. Kemi dhënë besën ta qesim kanalin, thuaju. Askush nuk duhet ta thyejë këtë besë. Edhe unë do të shërohem e do të vij te kanali. Do të vij, se kam dhënë besën... Këto janë fjalët e Ibrës, thuaju.

— Të gjitha do t'ua them, Ibër.

— Edhe një amanet tjetër, Kingj: kujdesu që në kanal të mos ngjasë asnjë fatkeqësi. Të punohet sa të punohet, por të mos derdhet pikë gjaku tjetër.

— Kë mendon të caktojme për të ndezur minat?

— Omerin. Është djalë i shkathët dhe i pëlqente kjo punë. E ka mësuar mirë.

— Mirë, Ibër.

— E tash tumirëmbetsh, Kingj!... Afrohu të të marr ngrykë.

Kingji u përkul mbi të plagosurin. Tëmthat e tyre u puqën. Kingji e ndrydhi me vështirësi një valë ngashërimi që i gufoi nga thellësia e kraharorit. Sytë i shkuan te cungu i fashuar. Sa herë e kishte shtrënguar atë dorë që tani nuk ekzistonte më! Atij iu kujtuan gishtërinjtë e mëdhenj dhe ngrohtësia e asaj dore, me të cilën ishte besatuar se do ta binte ujët në Gurajë.

Ajo dorë ishte këputur nga mina, por besa e saj kishte mbetur gjallë, ashtu siç mbeten në tokë rrënjët e lisit që i pritet trungu.

Në kthinë vinte një erë e rëndë kalbjeje. Këtë erë të mishit të prishur nuk mund ta përzinte as kundërmimi i tufave me lisën, me trumzë dhe me lulevjeshtë, që sillte djali i vogël i Ibrës. Shëruesi popullor i Gurajës e shpështillte cungun e krahut dhe e këqyrte me çudi, me dëshpërim. Me melhemet e tij kishte shëruar varrë shpate e pushke, kishte mjekuar njerëz që i kishte kafshuar gjarpri dhe gjer më sot asnjëherë nuk i kishte ndodhur kështu.

Sa niste të mbyllej e të zinte kore, varra hapej prapë dhe kullonte. Kjo gjë u përsërit disa herë. Fytyra e zverdhur e Ibrës ngjante si më parë me një shuk dylli të nxehur që e shtrembëronin, e shformonin orë e çast dhimbje sfilitëse. Si një tenjë që bren zemrën e drurit, vdekja po e brente me ngadalë, por me një këmbëngulje mizore...

Tani shëruesi ishte i bindur se kocka e krahut jo vetëm ishte këputur, por edhe ishte çarë, ishte krisur për së gjati. Spirrat e kockës së thyer, të futura në mish, e pezmatonin tërë krahun. Edhe po t'i vinte melhemet më çudibërëse, varra nuk do të mbyllej kurrë. Ai thirri Kingjin e i tha:

— Duhet ta çojmë në spital, për t'ia këputur krahun. Pa e bërë këtë, ai nuk shërohet kurrë.

Kingjit iu duk sikur i hodhi dikush ujë të valë përsipër. Për shumë arsye kjo gjë ishte tepër e vështirë. Mirëpo nga fjalët e shëruesit e kuptoi se nga ky operim i domosdoshëm varej jeta e Ibrës. Vështroi heshturazi drurët në oborr, që ishin zhveshur nga erë-

rat e ftohta të vjeshtës. Degët e tyre tundeshin e lëshonin një gjëzim të mbytur. Në qiell kalonin re të hirta. Re bore, mendoi ai. E megjithatë duhej të bënin diçka për të shpëtuar jetën e Ibrës. Duhej të niseshin sa më parë për ta çuar në spital.

— Jo, — kundërshtoi Ibra prerazi. — Është rrugë e largët e dimri po vjen. Më mirë të vuaj unë, se ju...

Kur shëruesi u detyrua t'i thoshte se prajtja¹ kishte hyrë në thellësi të kockës, Ibra iu lut që t'ia priste krahun me një sharrë dore.

— Atë punë s'e kam bërë kurrë, — tha shëruesi.

Kingji me shokë vendosën ta çonin në spital.

Ibrën e nxorën nga shtëpia dhe e vunë në vig. Ai pa majat e maleve të zbardhura nga bora. Përsëri nguli këmbë që të hiqej dorë nga ai udhëtim, ose të shtyhej për në pranverë.

— Në pranverë ti na duhesh i shëruar! — i tha Kingji. — Verën që vjen ujët e kanalit do të mbërrijë në arat e Gurajës.

Vigtarët i përcollën deri në kufi të fshatit burra, pleq, gra e fëmijë. Megjithëse mundoheshin të bënin hoka e të qeshnin, atyre u dukej sikur po përcillnin një njeri, që s'do ta shihnin më të gjallë.

Udhëtimi i gurajasve për në qytet që i gjatë e i mundimshëm. Me vig në krahë, të pangrënë e të veshur keq, ata ecën nëntë ditë rresht, nga mëngjesi në mbrëmje, duke kaluar nëpër fshatra, mbi lumenj me ura të prishura nga shirat, buzë greminash të frikshme, nëpër gryka e qafa malesh që dukej sikur s'do të soseshin kurrë...

Natën e nëntë trokitën në derën e një hani të vjetër e të ftohtë, në të hyrë të qytetit. E ulën vigun në një skutë të errët. Ibra ishte në kllapi. Herë pas here fliste ndonjë fjalë përçart, ose lëshonte ndonjë klithmë.

Të shtrirë mbi rrogoza të vjetër e të mykur, vig-

1 infeksioni

tarët bënë një gjumë të rëndë, plot ëndrra të këqija. Në mëngjes e ngritën prapë vigun në supet e tyre të nxira dhe shkuan te dera e spitalit. Kërkuan të flisnin me mjekët. Iu desh të prisnin më se një orë, gjersa të vinte një mjek i moshuar, me një gushë të madhe dhe me fytyrë si prej shkumësi. Ai kaloi pranë gurajasve pa u folur, pa ua hedhur sytë, si të ishin hije, dhe u ndal te kryet e të sëmurit. Pasi i këqyri të bardhët e syve, cungun e krahut dhe i mati pulsën, tha:

— I kanë mbetur vetëm kockat nën lëkurë. Nuk mund ta shtrojmë, le më ta operojmë.

Mjeku ktheu shpinën dhe u largua. Për një çast gurajasit mbetën si të shtangur. Ata pyesnin veten me habi se cila zanë i kishte gurëzuar. Kush ishte gurëzuar: ata apo mjekët?! Apo gjithë bota?!

Te gurajasit e nemitur, që u vinte të ulërinin nga dhimbja, që s'dinin nga t'ia mbanin, u afrua një grua e moshuar, me bluzë të bardhë. Ajo vështroi të sëmurin, mandej fshatarët që rrinin në këmbë pranë tij.

— Nga jeni?

— Nga Guraja.

— Ku bie Guraja?

— Prapa maleve. Kemi ecur nëntë ditë me vig në krahë për të ardhur këtu.

— Mos u largoni pa e shtruar të sëmurin.

— Po si t'ia bëjmë? Ata nuk pranojnë...

— Qëndroni te dera e spitalit, derisa ta shtrojnë. Dikush prej jush të shkojë në prefekturë.

Ajo i përshëndeti me kokë dhe u largua me hap të shpejtë. Ngaqë ishin të hutuar, gurajasve nuk u ra në mend ta falënderonin. Megjithatë ata ndien një mirënjohje të thellë për të. Akulli rreth tyre u kris. A thua ishte zanë ajo grua që i çgurëzoi?!...

Vigtarët e dinin se, po të mos shtrohej në spital, Ibra nuk do të kthehej më i gjallë në shtëpinë e tij. Edhe sikur të mos ishte fare qelbëzimi i kockës, nëntë ditë të tjera nëpër borë e cingërimë do t'ia merrnin shpirtin. Duke e ditur se luftonin për jetën e Ibrës, vend-

sën të shkronin deri në kryeqytet, por të mos e kthenin të sëmurin në Gurajë.

Kingji dhe dy gurajas të tjerë shkuan në prefekturë. Pritën një kohë të gjatë para zyrave, folën me njerëz të panjohur, i përsëritën me dhjetëra herë shpjegimet e tyre. Zyrtarët i përcollën nga një derë te tjera, derisa arritën te zyra e prefektit.

— A keni të paguani? — tha prefekti, pa u zgjatur shumë.

— Kemi! — tha Kingji.

Ai nxori nga gjiri një qese të vogël. U dëgjua një tringëllimë e lehtë.

— Shkoni te spitali. Unë do të flas me drejtorin e spitalit në telefon.

Buzë përrenjve, në livadhe e në shpatet e kodrave kishte dalë bari i ri. Cungjet e hardhive të krasitura lotonin musht të bardhë dhe kumbullat e lulëzuara fërgëllonin nga era e vagët pranverore si shtati i vashës së saponusëruar. Mbi hullitë e arave që lëshonin avull, pikonte jarga e trashë e qeve dhe faratoret me kokë të mënjanuar e me dorën e djathtë të zgjatur përpara ngjanin sikur po turrnin një fill të çuditshëm. Në ballë të kecape e të qengjave po forcoheshin gungat e buta, që më vonë do të shndërroheshin në brirë. Kurse brirët e deshve e të cjepve kishin në rrëzë të tyre një pjesë të trëndafiltë, e cila dallohej nga pjesa tjetër e bririt që ishte më e errët.

Nga maja e kalit që ecte pa u ngutur, Ibra sodiste vërshimin e pranverës në çdo cep të kësaj toke të njo-hur, për të cilën kishte menduar, kur ishte shtruar në spital, se nuk do ta shihte më me sy. Ai po kthehej në Gurajë me krahun e këputur rrëzë supit, por i

shëruar. Varra ishte mbyllur. I vajtën sytë te një rrëke që gurgullonte midis barit e shkurreve. Ndanë saj dy djem shtatë-tetë vjeç po hapnin një «kanal», pikërisht ashtu si kishte bërë edhe ai në fëmijëri. E mbajti kalin me dorën e majtë dhe i kundroi një copë herë. Një ngashërim i fuqishëm ia pushtoi tërë qenien. Madje deshi t'u thërriste e t'i pyeste të kujt ishin, por hoqi dorë. Me siguri do të jenë fëmijë të punëtorëve që punojnë në brigjet e Ujëbardhës, mendoj ai dhe i grahu kalit.

Edhe pse njerëzit ishin të zënë me punët e pranverës, që kishte ardhur më shpejt se çdo vit tjetër, gurajazit shkuan tek Ibra, që ta uronin për shërimin e për kthimin në shtëpi...

Pas tri ditësh Ibra shkoi te kanali. Kingji po e priste te sharra e ujit, në breg të Ujëbardhës. Tashti vendi ku punohej ishte shumë larg prej andej. Ibra deshi të ngjitej së pari te Kershia i Kuq. Duke ecur të përpjetave e leqeve të shumta, ndiente t'i këputeshin gjunjët e t'i therte mesi, por nuk e jepte veten. Vështronte me mall lulet midis shkurreve, kajzit e lajthive, drurë e shkrepa që i dukeshin të afërm si njerëz të njohur.

U kënaq nga puna që ishte bërë pas plagosjes së tij. Shkëmbi si turi ujku ishte çarë tejprtej nga një varrë e madhe. Shtrati i kanalit ishte i thellë e i gjerë.

— Punë mjeshtri! — tha Ibra. I xixëlluan sytë nga gëzimi.

— Na doli punë me Omerin! — tha Kingji. — Do t'ia marrim gjakun Ibrës, thoshte. Do t'ia shqyejmë barkun këtij shkëmbi të pabesë... Po ta kishim lënë, do të na e kishte harxhuar tërë dinamitin, për ta bërë këtë shkëmb copë e thërrime.

Në një rrasë të lëmuar, në mes të Kershit të Kuq, Ibrës i zunë sytë disa shkronja të gdhendura në gur: ishte emri i tij.

— E ka shkruar Omeri, — tha Kingji.

Duke ecur nëpër shtratin e kanalit, Ibra ndiqte me

sy fluturimin e pëllumbave të bardhë që i kishin foletë në të çarat dhe guvat e shkëmbinjve. Atë çast ai mendoi se vitet që kishte kaluar në atë luginë nuk do të treteshin, por do të mbeteshin aty përjetë si ata pëllumba të bardhë, që s'i braktisnin kurrë ata shkëmbinj dhe foletë e tyre...

Tani shtrati i kanalit përshkonte bregore të buta, lëndina, lirishta e koriye të vogla. Rrasat e gurët që duhej të copëtoheshin me mina ishin të rralla. Një muaj më vonë gërmimet arritën në një lartësi prej ku mund të vije re shtëpitë e epërme të Gurajës.

Kingji e gjeti Ibrën të ulur në një gur. Zuri vend pranë tij, ndezi një cigare dhe ia dha. Mandej drodhi një cigare për vete. Sapo kishte rënë hëna. Ishte një hënë e plotë, gjak e kuqe. Drita e saj u jepte majave e pllajave një shkëlqim të kuqërremtë, që të irritonte. Tërë Guraja ishte zhytur në këtë dritë të pazakontë si në një pëllg gjaku.

Ibra dhe Kingji shikonin fshatin e tyre të mbështjellë me atë cipë bojë gjaku dhe në kokë u vinin gjithfarë mendimesh.

Që nga lashtësia, kur kuqej hëna kësodore, njerëzit qëllonin me armë dhe sokëllinin, për të trembur kuqedrën që kacafytej me hënë. Besohej se ngjyra e kuqe ishte gjaku i hënës, që rridhte nga plagët që i kishte hapur kuqedra. Ky ogur paralajmëronte fatkeqësi të mëdha, luftëra, epidemi, zi buke e thatësi...

Ibra s'ia ndante sytë asaj drite të alltë, refleksi i një zjarri të padukshëm.

— Njerëzit kanë mijëra vjet që vringëlljnë shpatat ose shtien me pushkë drejt qiellit, duke sokëllirë, por nuk kanë mundur t'i ndalin...

— Kë s'kanë mundur të ndalin? — tha Kingji që s'e mori vesh përse ishte fjala.

Ibra u drodh nga kjo pyetje. E kuptoi se kishte folur me zë.

— Nuk kanë mundur t'i ndalin të këqijat, Kingj. Të gjitha të këqijat: luftërat, epidemitë, zinë e bukës, thatësitrat.

— Paj, kot e kanë që shtien pushkë përpyetë. Të këqijat janë në tokë, Ibër. Të këqijat e tokës do të mjaftonin edhe për hënën, edhe për tërë yjtë e qiellit.

Shumë i mërzhitur qenka Kingji sonte, mendoi Ibra. Befas i erdhi diçka në mendje.

— Si është qesja, Kingj.

— Është rrudhur krejt, Ibër. Ka vetëm edhe një javë bukë për punëtorët...

Ibra heshti.

Në Gurajë vigmat dhe të shtënat drejt hënës vazhdonin ende.

— Mos u mërzhit, Kingj. Do të bëjmë diçka...

— Paj, nuk po e di se çka mund të bëjmë!... Ndihma s'kemi ku të kërkojmë më. Njerëzit na kanë dhënë atë që kanë mundur të japin. Tash edhe Guraja s'ka çka jep, veç në dhëntë shpirtin!

— Të thashë, Kingj, se do të bëjmë diçka. Burri nuk ligështohet kurrë...

Ibra zgjati dorën e tij të vetme dhe e mbështeti në supin e shokut. Ai e kuptoi se trupi i Kingjit po dridhej. Ibra e shtrëngoi edhe më supin e tij, por nuk tha gjë. Pas pak Kingji u qetësua.

Të nesërmen Ibra vajti në shtëpi dhe shiti te kryeplaku ato dele e dhi që i kishin mbetur. Këmborët e cingaret i vari në tra. Të gjitha paret që mori, ia dha Kingjit.

Megjithëse nuk i tha asnjëri, nuk mbeti fshatar pa e marrë vesh këtë gjë. Fill pas tij Prruk Moti shiti bagëtitë, tokën e shtëpinë — ishte shtëpia e parë që shitej në Gurajë — dhe paret e tyre ia dorëzoi Kingjit. E prekur thellë nga këto ngjarje, Guraja e shtrydhi prapë varfërinë e saj, siç shtrydh një nënë gjirin e shterur, për t'i dhënë fëmijës që këlthet nga uria edhe një pikë qumësht. Nuk mbeti rendatar pa shitur diçka për kanalin. Por sakrificën më të madhe e bëjnë nuset dhe gratë e Gurajës: ato hoqën vathët, unazat dhe stolitë e tyre, të cilat i shitën për të ardhur uji në ara, për ta përzënë thatësirën nga fshati i tyre fatkeq...

Gurajë, Gurajë... u bëra kaq dhe s'të paskam njuhur! — mendonte Kingji. Guraja ime e thatë, Guraja ime e mirë!... Monedhat tringëllinin midis gishtave të tij dhe ai përfytyronte këmborë të varura në trarë, duar pa unaza, nuse pa vathë e pa stolira, por në të njëjtën kohë përfytyronte ara të blerta, kopshte plot pemë dhe bistakë me kokrra të ndritshme, stolitë e Gurajës me ujë.

Tërë shtëpia binte erë finjë. Nga oborri dëgjoheshin goditjet ritmike të lasës, me të cilën rrihnin teshat për t'u nxjerrë djersën, pluhurin e gurëve dhe ngjyrën e kuqërremtë të baltës, njollat e barit e të frutave. Kur pushonte lasa, Omeri e merrte me mend se në këtë kohë e ëma dhe Jerina shpëlanin e shtrydhnin teshat, duke i futur në një lug të madh druri. Ai kishte disa çaste që ishte zgjuar, por nuk i bëhej të çohet nga shtrati. Ajo kohë plogështie dhe ëndërrimi ishte jo vetëm zgjatim i gjumit e i çlodhjes, por edhe rikthim i shkurter i rinisë së ikur. Nëpër frëngji hynte ajri i freskët

i mëngjesit, ajër që kundërmonte fruta që kanë nisur të piqen. Omeri e thithte atë ajër me ëndje. Ishte i qetë. Ngaqë ishte larë në mbrëmje, me të ardhur nga kanali, e ndiente trupin të lehtësuar, të pastër. I dukej vetja si një rrobë e larë, e bardhë, që valëvitet në gardh nga flladi.

Ujeza flinte në djep, pranë shtratit. Ai u ngrit në bërryla dhe e vështroi një copë herë. Zgjati dorën dhe ia preku flokët me majat e gishtërinjve, të cilët i largoi menjëherë nga frika se mos e zgjonte. Nga obo- rri erdhi prapë zhurma e lasës.

Një vrushkull drite e përshkoi kthinën mespërmes dhe ra te këmbët e shtratit. Ajo mori grimcash të pra- ruara e të lëvizshme, që hynte përmes frëngjisë, e gja- llëronte mugëtirën e kthinës si një rrjedhë uji që der- dhet në një arë të ngurtësuar nga vapa. Rrëkeja e dritës e bëri edhe më ëndërrues. Ti, dritë e bardhë që vjen nga larg, nga qielli i pafundmë, për të ndriçuar këtë skutë të errët, sa e mrekullueshme je! Ti je si e qeshura që shkrep në buzët e fëmijës. Ti je si gëzi- mi që ndizet papritmas në shpirtin e njeriut. Ti je si një dorë e dashur, e ngrohtë...

Rrjedhën e mendimeve të tij e ndërpreu një vër- shëllimë. Në atë vërshëllimë ai njohu melodinë e një kënge që e këndonin xhandarët e postës. Ishte një këngë dashurie, ku përmendeshin pare që dashnori do t'i jep- te dashnores për të blerë stolira. Në të flitej për dash- noren me sy të ngjyer, për takime natën, për thyerje kurore, për shfrime epshi dhe kënaqësi lapërdhare. Për- sëri në fund të këngës thuhej se dashnori do t'i pa- guante me pare ballin, gjinjtë, gushën dhe sytë e dash- nores. Madje përcaktohej edhe çmimi i veçantë për sy- të e zinj, për sytë e bardhë e për sytë e shkruar. Këta të fundit cilësoheshin si sytë që kushtonin më shtrenj- të. Duke e dëgjuar këtë këngë, ndieje pështirosje, ne- veri. Të dukej sikur në të përziheshin mjaullimat e ma- ceve në shkurt, thirrjet e shitësve në një treg dhe duh-

ma e ujërave të një kënete. Në njëfarë mënyre, ajo ishte duhmë e mbretërisë që po kalbëzohej.

Ishte kënga e pllakës që vihej më shpesh në gramafonin e kryeplakut. Në mbrëmjet e ngrohta burrat, nusët dhe vajzat e shtëpisë, bashkë me mysafirët, uleshin në qilimat e shtruar në pemëtore ose nën tendat e rrushit, kur ishte rrezik të binte vesë. Ata bisedonin, lëshonin gramafonin, të cilin e dëgjonin në heshtje, ose e shoqëronin me zë. Për orë të tëra rrethina oshëtinte nga të qeshurat dhe thirrjet e shfrenuara që shpërthenin si gjëmbaçë në qetësinë e Gurajës...

Përveç kësaj kënge, xhandarët e postës këndonin edhe këngë të tjera, të mbushura me përgjërime e me mallkime dashnorësh të tradhtuar, me lëngim shpirtëror oriental a melankoli sllave. Xhandarët këndonin edhe ndonjë këngë folklorike, ku bëhej fjalë për një dashuri që s'njihte gjë tjetër veç kënaqësive të mishit. Të tilla këngë gurajasit i quanin «këngë të fëlliqta» dhe nuk i pranonin kurrë në dasma, as në gëzime të tjera.

I veshur me po ato tesha të grisura me të cilat ishte shtrirë në shtrat, Omeri doli në krevetin¹⁾ e drunjtë. E ëma dhe Jerina po shtrydhnin teshat e lara e po i ndernin në gardh. Ai mendonte se, kur t'i afroheshin shtëpisë, xhandarët do ta pushonin vërshëllimën...

— Futuni brenda!

Të dy gratë u drodhën nga kjo britmë e beftë dhe e egër. Mbetën si të mpira, me duar të kredhura në ujët e lugut që nuk lloçoçitej më. Vetëm atëherë e dëgjuan vërshëllimën dhe u nisën drejt shkallës. Xhandarët ia shkrepën të qeshurit. Ai nuk i njohu as nga zëri, as nga fytyra. Qëkurse punonte në kanal, rrallëherë i kishte qëlluar të takonte në rrugë ndonjë xhandar.

Të qeshurat e forta të xhandarëve, si hingëllimat e një hamshori që ndjek pelat, lloçoçiteshin në heshtjen

1) ballkon në kullat malësore.

e atij mëngjesi. Omerit i kishte hipur gjaku në kokë dhe e ndiente që po i dridhej tërë trupi.

— A kanë kaluar ndonjëherë tjetër pranë shtëpisë sonë duke vërshëlyer?

E ëma e vështrroi pa nxjerrë zë. Jerina rrinte kokulur dhe heshtte. Omerin e xhindoste kjo heshtje, po aq sa fishkëllima dhe të qeshurat e xhandarëve. E kapi Jerinën nga krahu dhe e tundi fort.

— Ty po të pyes! Apo s'ke gojë të flasësh?!

Omeri vuri re në sytë e Jerinës një shkëlqim të ashpër prej metali. E kuptoi se një gjemb i helmët, si ato nevestrat e verdhemta të livadheve, ishte ngulur në mishin e butë të marrëdhënieve të tyre. Në vend që ta zbuste, ky mendim e xhindosi edhe më keq. Ai e dinte se ashpërsia e tij do ta ftohte me Jerinën dhe në këtë çast dëshironte që kjo ftohje të ishte sa më e madhe, sepse në këtë mënyrë dënonte vetveten.

— Po, kanë kaluar dhe kanë fishkëlluar! — tha Jerina, duke provuar të njëjtat ndjenja si dhe Omeri.

Sytë e Omerit u zmadhuan kaq shumë, sa gati u shqyen. Ai u soll rreth vetes pa ditur ç'të bënte a ç'të thoshte. Deshi të pyeste t'ëmën: «Po im atë a i ka parë, a i ka dëgjuar?!», por i përtypi fjalët, para se të dilnin nga goja. Kjo pyetje do ta poshtëronte në sy të grave jo vetëm Demushin, por edhe atë vetë.

Nuk hëngri asnjë kafshatë bukë. Vërtitej nëpër oborr, duke pritur me padurim që teshat të thaheshin e t'i vishte. Ujeza erdhi të luante me të. I tha ta hidhte hopa-hopa, siç bënte gjithmonë, por ai i foli ashpër dhe e shtyu tutje. Vajza e vogël ia plasi të qarit. Ai u pendua, që u soll ashtu me vajzën, megjithatë nuk u përkul ta merrte me të mirë, as ta përkëdhelte.

Ecte midis pemëve të oborrit si një njeri i kri-sur. O, sa e brishtë qenka lumturia e njeriut, sa jetë-shkurtër! — mendonte ai. — Mjaftuaka një gjë e vogël, e papërfillshme për ta prishur, ashtu siç mjafton një re kalimtare për t'i penguar rrezet e diellit. Ato çaste të ëmbla, të këndshme që kishte kaluar në mën-

gjes, tani i dukeshin si të pajetuara kurrë, vesë e avulluar nga një diell përvëlues...

Ishte qetësuar mjaft dhe gati ishte penduar për atë rrëmbim të paarsyeshëm. Po vinte dreka. Ndërsa mendonte të futej brenda e të hante pak bukë, fishkëllima që imitonte melodinë e këngës së ndyrë, u dëgjua përsëri. I zënë në befasi, nuk diti ç'të bënte. Sikur të mos mjaftonte ajo fishkëllimë, xhandarët u ndalën te trungu i një molle e zunë të qëllonin me gurë.

— Ç'mollë të mira paska kjo shtëpi! — tha një xhandar.

— Eeni rrugës, qena! — thirri Omeri që iu errën sytë. Deshi të kapte një hu e të turrej drejt tyre, por kjo gjë do të ishte marrëzi, sepse ata kishin revole me vete. Zgjidhi qenin që po kuiste e po tërhiqte zinxhirët dhe e ndërseu kundër xhandarëve. Të befusuar nga guximi dhe sjellja e fshatarit, ata e gjuajtën qenin me gurët që kishin në dorë e ia dhanë vrapit. Megjithatë qeni e arriti njërin dhe ia shqeu bythcin e pantallonave. Me sa duket dhëmbët e qenit u ngulën edhe në mish, sepse xhandari lëshoi një britmë të mprehtë.

Omeri e ndolli qenin që erdhi duke dihat, me dhëmbë të nxjerrë e me sy që i xixëllonin. Mezi e urtoi duke i bërtitur, e çoi te hekurat dhe e lidhi prapë.

Pasi i lau duart, kërkoi që t'i sillnin bukën. Hëngri ngadalë. Tani ishte krejt i qetë. Përtypej dhe mendonte jo për atë që kishte bërë, por për atë që do të ngjiste më vonë. Xhandarët do t'i vinin prangat. Duhet të dal në mal, mendoi. Mirëpo, po të ikte në mal, do të ndahej nga kanali, nga shokët. Mund të ndodhte një e keqe edhe më e madhe: në vend të tij xhandarët do të lidhnin Demushin!...

Ishte edhe një mundësi tjetër: mbase s'do të ngjiste asgjë. Shumë-shumë, xhandarët do ta thërrisnin deri në postë, do t'i flisnin ashpër e do ta paralajmëronin. Vërtet, a s'do të ishte marrëzi, a s'do të ishte për të qeshur, po ta burgosnin, për arsye se qeni i tij kishte shqyer pantallonat e një xhandari?!

Në të ngrysur kasneci erdhi te shtëpia e Omerit dhe i tha se të nesërmen duhej të shkonte te kryeplaku. Ky lajm ia largoi gati të gjitha dyshimet e parandjenjat e këqija. Megjithatë ato gjallëroheshin, sa herë që ndeshte sytë e s'ëmës ose sytë e Jerinës. Krahthatë, ti ke bërë një të pabërë! — thoshin ata sy. — Ata do të të kalbin në burg...

Sa hyri në oborrin e kryeplakut, tre xhandarë e kapën, i vunë prangat dhe e nisën drejt postës. Kapteri kishte folur në telefon me nënprefektin e ri, i cili e kishte urdhëruar t'ia çonin menjëherë gurajasin rebel, që kishte sharë naltmadhninë.

— Ti ke bërë një faj tepër të rëndë, — tha kapteri, duke u mëshuar fjalëve. — Dje ke kërcënuar xhandarët e mbretit, ke ndërsyer qenin kundër tyre dhe ke sharë naltmadhninë!

Omeri shtrëngoi dhëmbët, që të mos fliste, sepse, po të fliste, e dinte se do të thërriste, do të shante jo vetëm xhandarët e kapterin, por edhe zyrtarët e mëdhenj e, ndoshta, edhe... Uli kokën. Atë çast po aq sa ç'e shqetësonte fati i tij, e shqetësonte edhe kjo pyetje që s'i hiqej nga mendja: Si është e mundur që njeriu të jetë kaq i lig?! Si është e mundur të kryejë një poshtërsi me një gjakftohtësi kaq të madhe?!...

Këto pyetje dhe etja e munduan shumë atë ditë duke udhëtuar për në nënprefekturë. Ishte zheg. Pluhur dhe këngë gjinçkallash. Omerit po i pëlçiste buza për një pikë ujë. Disa herë u afrua te krojet që ndodheshin bri rrugës, por xhandari që e shoqëronte e shtynte me

pushkë dhe nuk e linte t'i vinte buzët te gurra. Ishte pikërisht shoku i xhandarit të kafshuar prej qenit.

— Derisa të të varet gjuha si qenit, nuk do të të lë të pish ujë! — i tha xhandari.

E kishin bërë gjysmën e rrugës, ku u doli përpara një gurrë e madhe. Që së largu të përplasej në fytyrë filladi që vinte prej saj. Omeri vrapoi drejt gurrës, por xhandari e shtyu me forcë. Omerit i shkau këmba në një gur të mbuluar me lëmashk e ra në rrëkenë e ujit që rridhte poshtë gurrës. Petkat iu lagën në disa vende dhe ujët i hyri në trup. I kënaqur që e shihte të shtrirë përdhe e të pafuqishëm, xhandari qeshi vesh më vesh.

— Deshe ujë?! Ja ku e ke: pi sa të duash!

Omeri vështroi rrëkenë ku ishte rrëzuar. Në të kishte bajga, kakërdhi dhe boça misri të kalbura. Xhandari e kapi vështrimin e tij.

— Po të duket i papastër, ë?! Po të më dëgjosh mua, nuk i bën naze! Nuk do të kesh rast tjetër të pish ujë të ftohtë, ujë bjeshke...

Ai vuri pushkën te muri që mbante gurrën, hoqi kapelen, xhakëtën dhe zuri të freskohej. Mbushte grushtet me ujë dhe i hidhte në fytyrë me zhurmë. Nga kënaqësia lëshonte pasthirrma e shfrynte si kalë që turfullon.

Omeri e ndiqte me sy, pa lëvizur nga rrëkeja. Papatritmas tërë truri iu mjegullua. Në mes të kësaj mjegullire, xixëllonte vetëm një mendim: të vriste. Mblo-dhi gjunjët me shpejtësi, duke u mbështetur në majat e këmbëve, u ngrit në bisht, mbërtheu një gur dhe e vërviti në pjesën e prapme të kokës së xhandarit...

Më vonë atij i kujtohej se kishte dëgjuar një klithmë të çjerrë, si klithma e kafshës që e therin. Të gjitha veprimet e tjera i kishte kryer si në jerm. Kishte gjetur çelësin e prangave në xhepin e xhakëtës, kishte zgjidhur prangat duke e rrotulluar çelësin me dhëmbë,

kishte marrë pushkën, fishekët, revolen dhe ishte zhdukur në ahishtë, pa e lëvizur fare të vrrarin, mbi trupin e të cilit binte currili i flohtë i gurrës...

Pasi kishte bërë një udhë të gjatë nëpër shkëmbinj, nëpër brinja e koriye, nëpër toka gurishtore e baltishte, gurgullima e ujit të lumit po u afrohej dita-ditës arave të Gurajës.

Omeri ngjitej në ndonjë kodër, hipte në ndonjë lis të lartë kundruall vendit të punës dhe vështronte shokët e tij. Ndiante një mall që mezi e mposhte, një ngashërim të fortë, kur dallonte së largu trupin e përkulur të Ibrës me një krah të vetëm.

Edhe punëtorët mendonin për Omerin, u vinte keq për të. Ndërsa Ibra e shikonte këtë ngjarje në një kënd tjetër. Ne u përgjakëm prapë me ta, mendonte ai. Kjo është gjë e mirë. Sa kohë që gjakosemi me ta, s'do të ketë pajtim midis nesh. Urrejtja mund të shugatet sadopak, por nuk do të tretet. Ajo do të jetë si një varrë e pambyllur që i çahet dregëza. Si një hon mbi të cilin s'mund të ndërtohet asnjë urë e qëndrueshme me anë të mashtrimit ose të lëmoshës.

Ndonëse edhe vetë ishte i bindur se ky ishte veprim i paurtë, Omeri nuk i bëri ballë tundimit për të shkuar te kanali. Punëtorët nuk mund ta kundërshtonin, t'ia hiqnin lopatën nga dora. Ato çaste të shkurtra që punonte me ta, ishin si disa pika uji për një njeri që digjet nga etja. Kjo gjë e ndihmonte për të duruar atë dëbim të menjëhershëm nga jeta e mëparshme dhe atë vetmi, ku në çdo kohë dëgjohej fishkëllima e rrezikut.

Në fillim, kur mori vesh për vajtjen e Omerit në kanal, kapteri u bë si i tërbuar nga ky guxim i paturp-

shëm, siç e quajti ai. Në gjaknxehtësi e sipër deshi të mblidhte të gjithë xhandarët e të rrethonte kanalin, por, kur i ra inati, hoqi dorë nga ky mendim. E dinte se në këtë mënyrë s'do ta shtinte në dorë as të gjallë, as të vdekur.

Shpella ku flinte Omeri ishte në një shpat shkëmbor, të veshur me shkoza, blire e lajthi. Hjekësi që ishte paguar mirë nga kapteri, i ra në gjurmë. Omeri e kishte zakon të largohej nga shpella në të zbardhëlluar. Sapo bëri disa hapa në pyll, plumbat fishkëlluan rreth tij. U shtri përtokë. Kush do të jetë ai qen që më ka hjekësuar? — tha me vete. Nuk i erdhi në mendje asnjë fytyrë e veçantë. Plumbat thyenin copëra degësh e përplasheshin pas gurëve. — Nuk do ta shtien lehtë në dorë lëkurën time, — mendoi Omeri. — Tashti vë-tëm kjo gjë ka rëndësi... Rrethi i plumbave herë afrohej, herë largohej. Ai zgjidhi brezin e gjatë, të thurur nga duart e Jerinës, e lidhi njëren anë të tij në një lajthi, mandej u hoq zvarrë midis trungjeve e gurëve, derisa zuri vend midis dy shkëmbinjve të mprehtë e të lartë. Që andej e kishte më mbarë të vinte re lëvizjet e xhandarëve dhe të qëllonte mbi ta.

Herë pas here tërhiqte brezin me forcë. Me të parë lajthinë që tundej e shkundej, ata shtinin drejt saj, të bindur se Omeri ishte rrëzë asaj shkurreje të dendur. Kur lajthia pushonte së lëvizuri, rrethuesit pandehnin se kaçaku ishte vrarë dhe afroheshin. Pikërisht gjatë këtyre manovrimeve Omeri vrau një xhandar e shitoi dy të tjerë. Meqenëse e njihte gati çdo kaçubë e çdo lugajë të atij shpati, mundi të çante rrethimin e të ikte në një krahinë tjetër, ku kishte një të njohur. Për disa kohë nuk u kthye në Gurajë...

Omerit i mbeti peng në zemër për tërë jetën, që nuk u ndodh aty atë ditë, kur arriti ujët tek ara e parë e fshatit. Më vonë ai i pyeti gjerë e gjatë Ibrën, Kingjin e disa shokë të tjerë për ngjarjet e asaj dite të pazakonshme për Gurajën, por prapëseprapë fjalët e tyre nuk e mbushën atë zbrazëtirë të krijuar nga dëshira e paplotësuar...

Guraja oshëtinte nga thirrjet, nga këngët majekrahu, nga tupanat që binin në të katër anët e saj. Po ta dëgjonte këtë potere ndonjë udhëtar i largët, do të mendonte se aty do të kishte plasur kushtrimi për luftë, ose po bëheshin disa dasma njëherësh. Po t'i shihte në fytyrë gurajazit, ai do të bindej se nuk ishte fjala për luftë, por për ngadhënjimin e një lufte të gjatë. Ishte fjala për një dasmë, ku për disa çaste e ndien veten dhëndër të gjithë banorët e fshatit.

Në këtë kremtim erdhën njerëz edhe nga fshatrat fqinje, të cilat e kishin ndihmuar Gurajën për ta mbaruar kanalën. Në turmën e të ardhurve kishte lahutarë, këngëtarë me sharki, dervishë, falltarë e gjithfarë kurreshtarësh të tjerë. Ibra ndjeu një kënaqësi të madhe, kur midis tyre nuk i zuri syri asnjë zyrtar nga nën-prefektura.

Pleqtë i thanë Ibrës ta kthente ujët nga kanali në arë me dorën e tij, sepse kjo gjë do të sillte mbarësi. Ai u mat të thoshte diçka, por e la. Cila fjalë njerëzore mund të hahej me gurgullimën e atij uji të ftohtë që vinte nga Ujëbardha? Hoqi plisat në bregun e kanalit dhe ujët vërshoi drejt arës që lëshoi një gumëzhimë si gëlqerja kur shuhet. Ibra mori revolen që ia zgjati një gurajas dhe shtiu me të përpjetë.

— E gëzofshim këtë ujë dhe i sjellte bukë e mbarësi Gurajës! — tha ai.

Qëlluan me armë vendës e të ardhur. Disa pleq ranë në gjunjë buzë kanalit dhe mbushën grushtet me ujë. E ndienin në shuplaka freskinë e atij uji, e shikonin si currilonte midis gishtërinjve dhe mezi u besonin syve të tyre të mjegulluar nga mosha. Nga buzët që

dridheshin, shkëputeshin copëra urimesh, sikur po i faleshin një hyjnie. Fëmijët futeshin në kanal, qeshnin e lagnin njëri-tjetrin.

— Idhtë si zana qenke, Kingj... Çka të ka gjetë këstu?!

— Si të mos jem idhshëm, more Demush?!... Mozomakeq për ne e për këtë tokë! Ti e di çka po flitet...

— Ku e ke fjalën, Kingj?... Çka po bëhet?!

— Ti e ke marrë vesh çka ka thënë Ora e Majës së Diellit, Demush...

— Për kryet e atij djali, s'di kurrgjë!

— Eh, Demush, Demush... «Do të hyjë dushmani e do ta marrë vendin.» Të gjitha bjeshkët i ka mbuluar gjama e piskama.

— E kush e paska ndier, bre?

— Një burrë kishte dalë në bjeshkë të priste lëndë pishë. Ishte vonuar e kishte fjetur në një shpellë mali. I kishte dalë gjumi nga zërat e orëve dhe i kishte dëgjuar fjalët e tyre, siç po të dëgjoj unë ty.

— Aiiih, cok mozomakeq për ne, Kingj!... E mbaj mend mirë se kështu ka pasë thënë ora e Majës së Diellit dy ditë para se të hynte shkau në Kosovë e në Malësi...

Në ditët e para të atij prilli, nëpër kulla flitej vetëm për këtë ngjarje që e tronditi kulm e themel jetën e Gurajës, së cilës asnjëherë s'i kishin munguar shqetësimet, të papriturat dhe kobi. Megjithëse për ta ishte tepër e dhimbshme të besonin në parashikimin e orës së Majës së Diellit, lajmet që erdhën gojë në gojë nga nënprefektura dhe disa shenja të tjera, i bindën fshatarët se ai prill nuk do të ishte një prill i zakonshëm. Pasi u çliruan disi nga ankthi dhe hutimi i parë,

filluan të vrisnin mendjen për t'i bërë ballë së keqes. Sado e madhe që të ishte ajo, kurrsesi s'mund ta prisnin duarkryq. Tani në mendjen e tyre shkrepnin këto fjalë: Na duhen armë dhe fishekë! Po ku t'i gjenin?! Të kërkonin armë nga qeveria që kishte bërë disa operatione ndëshkimore për t'i çarmatosur, do të ishte kulmi i marrëzisë. Nga ana tjetër e dinin se ai qiell me cukla resh të bardha, të cilin e vështronin me pikëllim, nuk do t'u hidhte asnjë pushkë.

Ata e pritën pushtimin e huaj, siç do të prisnin ardhjen e një murtaje: me ankth e stoicizëm, duke besuar se çfarëdo që të ndodhte, Guraja do të mbetej Gurajë. Një tufë aeroplanësh kaloi nëpër qiellin që u drodh nga zhurma e tyre. Njëri nga këta aeroplanë lëshoi dy bomba, që, për fat të mirë, ranë në një livadh, duke hapur dy gropa të mëdha sa dy lëmenj.

Kur morën vesh se Italia kishte pushtuar kryeqytetin, provuan dy ndjenja të kundërta: u gëzuan që mbreti kishte thyer qafën, duke ikur me turp, por u hidhëruan, duke menduar se tani do t'i sundonin njerëz të huaj, me gjuhë dhe zakone të tjera. Pushtimi i huaj nuk do të ishte më pak i kobshëm se rrëgjimi dhe vdekja e ngadaltë që u kishte sjellë monarku vendës.

Shumë gurajas — midis tyre pati edhe gra që u ishin vrarë djemtë e burrat nga mbreti — shkuan te posta e xhandarmërisë me sëpata e kmesa. U bënë vrer që nuk gjetën në të asnjë xhandar. Duke e parandier hakmarrjen e Gurajës, ata ishin larguar natën nga posta.

— Kaçubeti na shpëtoi. T'i djegim çufrogun! — tha Omeri që erdhi nga mali me kaçakë të tjerë.

Posta vazhdoi të digjej deri në darkë. Prej saj mbetën vetëm mure të nxira, grumbuj hiri e thëngjijsh.

Megjithëse ishte pushtuar tërë vendi, gurajasit (me përjashtim të kryeplakut, të Grosh Malotës e të miqve të tyre), vendosën të mos e linin të huajin të shkelte në Gurajë pa derdhur gjak. Ata i mbajtën pritrat di-

sa ditë, por më në fund u detyruan të tërhiqeshin. Nismëtarët e qëndresës u fshehën në male, ndërsa fshatarët e tjerë u ngujuan në shtëpitë e tyre...

Edhe pushtuesit e rinj Breglumi i priti ashtu siç i kishte pritur pushtuesit e mëparshëm: pa pushkë. Për këtë gjë ndikuan edhe klerikët e feve të ndryshme, të cilët s'kishin qenë kurrë më të bashkuar sesa ato ditë prilli.

Duke përsëritur mendimet e eprorëve të vet, prifti tha se kombi i vogël shqiptar, i shtrënguar ndërmjet dy racave të mëdha, ndërmjet racës latine dhe racës sllave, do të tërhiqej fatalisht prej njërës ose prej tjetrës. Pasi u përpoq të argumentonte se nga ana e Romës kombin tonë e shtynte karakteri, temperamenti dhe interesi i vet, zgjati duart drejt Perëndimit dhe i dha fund predikimit me fjalët:

— Po vijnë pëllumbat e Krishtit!

Në anën tjetër të fshatit, hoxha u tha besimtarëve të tij të rënë në gjunjë:

— Edhe Muhameti e ka pasur këmishën të zezë si fashistët! Fashizmi është më i ëmbël se mjalti...

Roma, sado larg që ishte, i dëgjoji këto fjalë dhe e çmoi qëndrimin e Breglumit. Për të shprehur nderimin dhe dashurinë e saj për breglumasit, pa kaluar shumë kohë, ajo dërgoi një kabanë të madhe për kishën, kurse përbri xhamisë u ngrit një minare e re dy herë më e lartë se e vjetra.

Roma nuk e përjashtoi nga hiri dhe bujaria e saj as Gurajën kryethyer, që i kishte pritur me plumba «pëllumbat e Krishtit». Ajo çoi atje thasë me makarona e pushkë, të cilat i ndau kryeplaku. Me ato pushkë vetëm brenda atij viti u bënë shtatëmbëdhjetë vrasje për gjakmarrje. Kur u shpall amnistia e përgjithshme, Omeri mbeti në mal vetëm me dy-tre shokë. Por me të filluar marrja e ushtarëve, numri i kaçakëve u shtua prapë.

Në të thinjur të agimit, në hapësirën e Gurajës vërshoi një lumnajë zërash njerëzorë e blegërimash. Tinguj këmborësh e cingaresh, si të varura diku në qiell, qëndronin mbi këtë lumnajë si valë shushurite e shkumëzuese.

Guraja po del në bjeshkë, mendoj Ibra. Megjithatë nuk ndieu kurrfarë gëzimi. Ai e dinte se shumë gurajas nuk do të dilnin në bjeshkë atë verë. Ata i kishin shkrirë tubat e tyre gjatë viteve të kaluara për të blerë misër e për të hapur kanal. Këmborë, troka e cingare të varura nëpër trarë, të mbështjella me cerga merimangash. Ishte e kobshme palëvizshmëria dhe heshtja e atyre këmborëve për të zotët e tyre e sidomos për barinjët që ngrinin sytë e i shikonin me pikëllim, duke përfytyruar deshtë e cjeptë që i kishin mbajtur në qafë dhe tubat që s'ishin më.

Mirëpo që nga koha që kishte ardhur ujët e kanalit, kishin ndodhur gjëra të tjera, më të hidhura, që i kishin hedhur në harresë andrallat e mëparshme. Shteti i ri, qeveria e huaj i kërkonte Gurajës një taksë shumë të rëndë. Në qoftë se qeveria e mbretit ikanak donte t'i merrte currilin e qumështit, qeveria e tanishme kërkonte gjakun e saj, djemtë. Ajo përpiquej t'u vishte një uniformë, t'u jepte një pushkë e t'i conte diku në dherra të largëta, për t'i martuar me vdekjen. Si të shpuzitura nga një dorë e mbrapshtë, kishin marrë hov trazirat, ngatërresat dhe vrasjet...

Ibrën e pikëllonte shumë një mendim i ri që nuk ia shprehte askujt, që e gërryente dita me ditë, ashtu siç gërryen shkëmbin currili i ujit që godet vazhdimisht mbi të. Ai kishte mbajtur shpresë se ardhja e ujit në Gurajë do ta përmirësonte jetën e njerëzve, por ishte zhgënjyer.

Ujët e kanalit, sado që nuk e shoi krejtësisht etjen e arave të Gurajës, e pakësoi forcën shkatërruese të thatësirës. Tani ishin të rralla ato ara që mbeteshin pa u ujitur fare, që shkuleshin e viheshin në mullar.

Megjithëse në Gurajë nuk erdhi begatia, blirimi,¹ shumë fshatarë e siguronin bukën për pjesën më të madhe të vitit. Këngët përbuzëse për Gurajën e thatë dëgjoheshin më rrallë dhe fshatrat fqinje nuk ngurronin t'i jepnin vajzat e tyre për djemtë e këtij fshati që tani kishte ujë.

Gjendja e gurajasve do të ishte edhe më e mirë, sikur uji të ishte ndarë me drejtësi, siç kishte menduar Ibra. Për habinë e tij, ai kishte vënë re se shtimi i ujit kishte sjellë edhe shtimin e padrejtësisë. Kryeplaku dhe fshatarët e pasur, të cilët për një kohë të gjatë e kishin kundërshtuar dhe e kishin penguar tërthorazi hapjen e kanalit, më vonë kishin ndërruar mendje dhe ishin orvatur të vinin në vend gabimin e tyre. Pa mbaruar ende kanali kishin filluar të blinin ujë te varfanjakët, që, për të mos vdekur nga uria, kishin shitur një pjesë të ujit që do t'u takonte të merrnin. Pas disa vjetësh ata zotëronin më shumë renda uji sesa fshatarët që kishin punuar në kanal apo kishin dhënë të gjitha bagëtitë për hapjen e tij. Etja e tyre, e ngjashme me etjen e tokës në korrik, nuk ishte shuar ende. Pasi prishën paret që morën nga shitja e ujit, gjendja e skamnorëve u bë më tragjike se kurrë: ata mbetën jo vetëm pa qumësht, por edhe pa ujë e pa bukë...

Ajo që e helmonte dhe e pezmatonte Ibrën më tepër se çdo gjë, ishte ndryshimi që po ngjiste në Gurajë, përpara syve të tij. Thatësira që më parë përcëllonte tokën, tani po strukej në shpirtin e njerëzve. Nëse më parë vyshkeshin e zverdeshin arat, tani njerëzit po përçudnoheshin, po tëhuajeshin nga njëri-tjetri, po bëheshin të verdhë, siç thonë gurajasit. Në sytë e tyre po ndizej lakmia dhe po vezullonte smira. Kuçedra që kishte zënë qëmoti Përroin e Thatë, lumin e Gurajës, po zinte diçka më të vyer e më jetike: burimin e

1) bollëku

ndjenjave fisnike, lumin e dashurisë së njeriut për njeriun.

Sa më tepër që gjelbëronin arat, sa më të mëdha që bëheshin kokrrat e mollëve e të kumbullave, sa më të rëndë që bëheshin bistakët e rrrushit, sa më të gjerë që bëheshin lëmenjtë gjatë të korrave, aq më i ngushtë bëhej shpirti i mjaft gurajasve, aq më tepër po zgëlohej zemra e tyre. Ishte një metamorfozë e dhimbshme, e keqe që s'mund ta pengonte askush. Natyrisht kishte raste kur ndonjë fshatar vështonte për-qark si ai që vjen në vete pas një trulllosjeje ose si ai që zgjohet i trembur nga një ëndërr e ligë dhe pyeste: «Çka po ndodh kështu me ne?! A thua na ka bërë kush magji, apo na ka prishur syri i keq?!...» Këto çaste kthjellimi ishin të shkurtra dhe këto pyetje mbe-teshin pa përgjigje, sepse gurajasit e kishin të vështirë të paditnin vetveten.

Ndoshta e ka fajin ujët e Ujëbardhës, mendonte Ibra. Mund të jetë ujë i nëmur. Mund ta kenë mallkuar zanat ose floçka që thonë se e kanë parë disa herë në brigjet e kanalit me fëmijët e saj për dore... Mos vallë, duke sjellë këtë ujë në Gurajë, sollëm të keqen?!

Atë ditë që ia bëri vetes këtë pyetje, u drodh, provoi ndjenjën e pendimit, të fajësisë. U pendua që kishte ngulmuar për hapjen e kanalit, e quajti veten fajtor për të këqijat që po ndodhnin dhe u llahtaris, kur përfytyroi Gurajën e disa viteve më vonë, të tjetërsuar krejtësisht. Madje pati një çast, kur kanali i ngjau me një kuçedër keqbërëse dhe e urreu me gjithë shpirt. Por ky çast, që lëshoi në vetëdijen e tij një dritë trallisëse, kaloi edhe mendja e tij e lëbyrur prej saj, zuri t'i shihte gjërat më me qartësi. Nuk e ka fajin as kanali, as ujët, tha Ibra me vete dhe qeshi hidhur. Po kush e ka atëherë?! Përse atje ku shkon uji, nuk shkon begatia për të gjithë, nuk shkon lumturia dhe mirëdashja midis njerëzve?! Përse ky kanal që e ndërtoam me aq vuajtje, me djersë e gjak,

shton pasurinë e kryeplakut e të parisë?!... Ai nuk dinte t'u kthente përgjigje këtyre pyetjeve që u shuan në vetëdijen e tij si zërat që humbasin në humnerë.

Pas hapjes së kanalit pakkush interesohej për Ibrën e gjymtuar. Në fillim shkonin për ta parë herë pas here Kingji dhe punëtorët, por lufta, që Gurajës i pruri trazirat, atij i solli vetminë. Kingji, Omeri dhe shokë të tjerë ishin në çeta dhe rrallëherë u binte rru-ga të vinin në Gurajë.

Megjithëse ishte vetëm me një dorë, Ibrës i duhej të merrej me punët e shtëpisë, për të ndihmuar të shoqen dhe fëmijët që s'ishin burrëruar ende. Familjes së tij i ranë në pjesë mjerimi, hallet e vështirësitë, por nuk ia shtriu dorën asnjëri. Atë e shqetësonte shëndeti që i kishte marrë të tatëpjetën dhe po i keqësohej dita-ditës. Puna në kanal e kishte rrëgjuar, e kishte plakur sa për njëzet vjet.

Kishte disa muaj që ndiente therje të pandërprera në zemër dhe nuk flinte dot përmbys. I dukej sikur po i shtypej kraharori e po i çahej zemra nga rrahjet e rënda e të çrregullta. Ibrën nuk e trembte as mendimi i vdekjes, as gropa e zezë e varrit. Për atje jemi nisur të gjithë që kur kemi lindur, thuhej në Gurajë. Ai ishte gatuar me moralin e saj stoik, megjithatë ndiente të dyndej në qenien e tij një mjegull e hirtë tri-shtimi, kur mendonte se mund të ndahej nga ato vise ku kishte lodruar e kishte ëndërruar në fëmijëri, ku kishte hequr e kishte luftuar, ku ishte përpjekur të bënte diçka që do të mbetej si gjurmë e jetës së tij. Sa gjëra do të ndodhnin në Gurajë dhe ai nuk do të shihte, nuk do të dëgjonte asgjë!...

— Breglumi kërkon pare për ujët që marrim në Ujëbardhë! — i tha Omeri Kingjit, pasi u largua Rama, që kishte ardhur me një frymë në mal për të sjellë këtë lajm.

— Përnjëmend e ke?!

— E di si kishin thënë: «Deri tash jua kemi lënë falas ujët e lumit tonë, që të dilni prej skamjes. Tash e mbrapa, në mos e blefshi me pare, nëpër kanalën tuaj s'do të kalojë as edhe një pikë ujë!»

— Cok, vonë u paska dalë gjumi për këtë punë!... Ajo varrë ka kohë që është mbyllur.

— Është mbyllur, por dikujt i intereson ta gërvishtë, Kingj... Ta gërvishtë që të rrjedhë gjak.

Kingji e këqyri me vëmendje, duke pritur që Omeri ta sqaronte më tej këtë mendim.

— A nuk të bie në sy një gjë, Kingj?

— Çka?

— Koha kur u bë kjo kërkesë e papritur...

Kingji rrudhi krahët.

— Para dy javësh në Gurajë u krijua këshilli nacionalçlirimtar, ndërsa disa ditë më vonë në Breglum u vendos një batalion i Divizionit të Vdekjes.

— Atëherë, në pastë lidhje midis këtyre ngjarjeve dhe kërkesës së Breglunit, ata e paskan përnjëmend.

— Përnjëmend e kanë pasur gjithmonë, Kingj, por s'u ka dalë ashtu siç kanë menduar. As kësaj herë nuk do t'u dalë...

Omeri e Kingji zbritën që atë ditë në Gurajë. Ata morën vesh se Grosh Malota e kryeplaku e quanin kërkesën e Breglunit si shenjë bujarie, si dëshirë për pajtim të përhershëm.

— Po të paguajmë ne sot, nesër fëmijët tanë s'do të kenë më ngatërresa për punë të ujit, — thoshte bajraktari. — Po ta blejmë ujët, kanali ynë do të zërë plangun e vet për sa të jetë toka tokë...

Fshatarët i joshnin këto fjalë që u dukeshin të urta e të mençura, sepse, sipas mendësisë së tyre, vetëm gjërat e blera shndërroheshin në pronë të vërtetë e të

papërfolshme... Dhe me siguri ata do t'i kishin grumbulluar paret që kërkoreshin, po të mos ndërhyshin Omeri, Kingji e Rama. Ata i bindën gurajasit se ky veprim jo vetëm do t'i varfëronte, por edhe do t'i zhburrëronte. Duke e ditur se kërkesa e Breglumit në të vërtetë ishte kërkesa e krerëve ballistë e zogistë të këtij fshati, pranimi i kësaj kërkesë dhe pagimi i pareve do të ishte një humbje politike, meqenëse shumica e gurajasve ishte lidhur me Lëvizjen...

— Ne nuk kemi flori t'ju paguajmë, por, po deshët plumb, ejani kur të doni! — u kthyen përgjigje gurajasit krerëve të Breglumit në ditën e caktuar.

Në Breglum ishin të bindur se vetëm një përgjigje e tillë mund të vinte nga Guraja. Ata i kishin marrë masat për një kundërpërgjigje që kundërshtarët e tyre do ta mbanin mend deri në shtatë breza. Trupat fashiste dhe mercenarët e sulmuan Gurajën natën, në dy drejtime. Ata nuk e gjetën as në gjumë, as me pushkë të zbrazëta. Megjithatë njëra kolonë e çau pritën që kishin zënë fshatarët dhe arriti deri te shtëpitë e para të lagjes së poshtme. Ata u vunë zjarrin tri shtëpive, por kundërsulmi i shpejtë i partizanëve i detyroi të tërhiqeshin, duke lënë prapa disa të vrarë e të plagosur.

Mbi Gurajë rrëkëlleheshin rrezet e pingulta të diellit të verës dhe isoja e gjinkallave të fshehura nëpër koret e drurëve shoqëronte gurgullimën e vijave të ujit. Nga arat me misër përhapej kundërmimi i kallëzave të xhufkuara dhe i mustaqeve ngjyrë vishnje që vareshin në majë të kallinjve që po lidhnin kokërr. Kur i tundte filladi i pasdites apo i prekte kalimthi krahu i zogjve, nga kallëzat shkundej pjalmi i verdhë si plu-

hur ari. I ulur nën hijen e pemëve të oborrit, Ibra thithte atë ajër të nxehtë që kundërmonte pjalm misri e fruta të pjekura dhe mezi ngihej me frymë.

Mesdita rrinte pezull mbi fshat si një kaçubet që përgjon pranë e vet, para se të vërsulet mbi të. Papritmas ajo zuri të klithte e të çukiste me sqep hapësirën e përdiellur.

Dikush po grindet për ujët, tha me vete Ibra. Kalluan disa minuta, mirëpo në vend që të pushonin, britmat po bëheshin më të forta. U dëgjuan edhe kukatje grash. Ai u ngrit në këmbë dhe u afrua te gardhi i oborrit. Pa fshatarë që vraponin me sëpata e pushkë në duar. Në fytyrat e tyre të egërsuara pa etjen për gjak. Iu ngjeth mishtë.

Mori shkopin që e kishte lënë pranë postajës, rrëzë pemës dhe nxitoi sa mundi andej nga po vinte poterja. Askush nuk e vuri re, derisa shkoi afër fshatarëve që ishin ndarë në dy grupe. Ata po përlësheshin, duke sharë, duke kërcënuar e duke qëlluar njëri-tjetrin me shkopinj e me gurë. Gratë e fëmijët qanin e bërtisnin pak më tej. Pushkët ende nuk ishin përdorur, por ky çast nuk ishte larg.

— Të mallkuar, ndaluni!... Mos qëlloni!... Mos bërtisni!...

Megjithëse vikati aq sa iu duk sikur po i shqyhej gurmazi, zëri i Ibrës nuk u dëgjua menjëherë në atë zallamahi. Ai u fut midis fshatarëve duke sokëllirë e duke tundur shkopin lart e poshtë si shpatë. Të përmendur nga zëri dhe prania e Ibrës, fshatarët u shkëputën nga njëri-tjetri dhe u larguan në të dy brinjët e kanalit.

Ngaqë ishte turbulluar gjatë zënies, ujët e kanalit ishte bërë i kuqërremtë, si gjak. Disa fshatarë ishin ndragur me baltë në tesha e në fytyrë. Te vendi i kacafytjes kishte kapuça të bardhë, të zhyer me dhe. Buzë kanalit, në presë shtrihej një burrë kokëzbuluar, që e kishte kafkën të çarë me shat. Flokët e verdhemë i ishin ngjitur nga gjaku që i kishte rrjedhur edhe

në qafë e në këmishë. Ibrës iu fanit kafka e Rexhës, e çarë nga gurët.

— Vëllezër, nuk ma merrte mendja kurrë se do të ndodhte kjo që po më shohin sytë! — tha ai, duke folur me vështirësi, sepse i ishte tharë pështyma në gojë. — Ne nuk e shkrimë jetën dhe pasurinë tonë, nuk i lamë kershat me djersë e me gjak, që ju të kafatyeni e të vrisni njëri-tjetrin për ujin. Ne luftuam për këta ujë, duke menduar, se do të sillnim mirësinë, por mjerisht paskemi sjellë gverren'... Sot e mbrapa, cilido që do të grindet me shokun për ujët, qoftë i mallkuar ai dhe fara e tij! Ferrat i mbifshin në vatrë dhe arat e tij u mbulofshin me lule qeni!...

Fshatarët e dëgjonin të nemitur, si njeriu që i ka dalë dehja. Disa rrinin kokulur, disa e vështrojnë të penduar e të përhumbur. Ata e ndienin veten të poshtëruar, mosmirënjohës para atij njeriu me një dorë, të ligur, të sëmurë, me fytyrë të çarë nga gurët, me flokë të thinjur para kohe, që ishte gjymtuar për të sjellë ujët në Gurajë.

Pa u përsëndetur me asnjeri, Ibra u ktheu kurrizin dhe u nis drejt shtëpisë. Fshatarët u larguan grupe-grupe, të heshtur. Të afërmit e të vrarit e morën trupin e tij dhe ikën me të, të ndjekur nga kukatjet e graas dhe të qarat e fëmijëve të vegjël...

Para se të hynte brenda, Ibra i ra kryq e tërthor arës që ishte në derë të shtëpisë. I qëllonte me shkop bimët e harlisura që zgjateshin një krah burri mbi të dhe shumë prej tyre kishin nga dy kallinj. Pjalmi i verdhë, erëmirë shpërndahej në ajër, i binte në fytyrë, i futej në zverk, e gicilonte në trup. Jetë, o jetë! — pëshpëriste Ibra, i dehur nga kundërmimi i fortë i pjalmi të verdhë, nga ai gjelbërim i ndezur i bimëve të shëndosha, në trupin e të cilave qarkullonte lëngu jetëdhënës i tokës.

1) grindje e madhe

Në darkë hëngri fare pak dhe u shtri për të fjetur. Nuk e zuri gjumi. Në kokën e tij mendimet rrokulliseshin e gjëmonin si ujërat e Përroit të Thatë gjatë shirave të vjeshtës. Kafka e çarë e fshatarit të shtrirë në kanal nuk i hiqej nga sytë...

Para se të vinte ujët, kur thatësira na digjte arat e mushkëritë, ishim të mjerë, por ishim të bashkuar; ishim të varfër, por ishim më zemërgjerë. Tashti ujët na ka ndarë, na ka egërsuar. Na ka bërë lakmitarë e shpirtngushtë. Na ka hyrë zia në zemër. A mos e ka fajin uji?!...

Jo, kjo gjë do të ishte marrëzi. Uji është jeta. Uji është njomësi e begati. Uji është bereqet. Po pse, pra, uji nuk i bëri më të lumtur gurajasit?! Vallë, çka duhet që Guraja të jetë edhe e bashkuar e bujare si më parë, por edhe me vija plot ujë e me ara plot bereqet!...

Këtë rrokullimë pyetjesh e ndërprejnë disa dhimbje therëse në zemër. Ibra e ndjeu se do të vdiste. I erdhi keq që do të vdiste kështu i vetëm dhe i pikëlluar. Megjithatë ishte i vetëdijshëm se kishte bërë diçka në jetën e tij, diçka më me rëndësi se çarja e Kershit të Kuq dhe e shkëmbinjeve të tjerë. Duke mposhtur bestytinitë dhe vështirësitë e mëdha, duke sjellë ujët e kanalit në Gurajë, ata e kishin gjakosur rëndë kuçedrën e thatësirës, kishin provuar forcën e besimit dhe të këmbënguljes së tyre. Brezat e mëvonshëm do ta vazhdonin luftën kundër së keqes. Patjetër ata do të sillnin në Gurajë më shumë ujë dhe ndoshta do të dinin ta përdornin më mirë, që të mos mbetej asnjë arë e pa-ujitur. Atëherë askush s'do të grindej e s'do të vritej për ujë...

Një rëndim i beftë, një shembje e tmerrshme që ndodhi s'di se ku, u rropos mbi të. Ai deshi të thërri-ste, të kërkonte ndihmë, për t'ia hequr atë peshë të përbindshme, por zëri nuk iu bind. Iu kujtua se nën jastëk kishte revolen, por dora e tij nuk arriti dot deri atje. Poshtë trupit të tij sikur u hap një greminë e thellë, e errët, pa fund e pa anë. Ai u lëshua në atë

greminë si gjethja që këputet nga dega dhe sillet e sillet derisa bie në tokë. Një rrjedhë uji që ndrit e gurgullon, qe vegimi i fundit që u shua në vetëdijen e tij.

Në mëngjes dy fshatarë erdhën te kulla e Ibrës që të rrinin e të kuvendonin me të. Ata i bënë zë nga oborri, por nuk morën përgjigje. Hapën derën dhe hynë brenda. Nuk pipëtinte asgjë. I thirrën Ibrës prapë. Heshjtja e gjatë që pasoi thirrjet e tyre, i ngjethi. Kur hynë në kthinën ku flinte Ibra, e kuptuan se ai kishte vdekur.

Ibra e kishte kthyer kryet kah dritarja e çelur, nëpër të cilën futej drita dhe ajri i freskët i mëngjesit. Ata ia drejtuan kokën dhe ia mbyllën sytë. U bëri shumë përshtypje fytyra e ngërthyer e Ibrës, që shprehte angështi e pikëllim të thellë, por as ata, as gurajastit e tjerë nuk e morën vesh pse kishte vdekur aq i hidhëruar ai që ishte munduar aq shumë për lumturinë e njerëzve. Në anë të jastëkut vezullonte tyta e një naganti të vjetër.

Ata lajmëruan fshatarët e tjerë dhe gruan e Ibrës, që kishte vajtur tek e ëma. Një fshatar u nis të merrte fëmijët, të cilët kishin dalë në bjeshkë me një emtë të tyre...

Në varrimin e Ibrës u mblodhën kaq shumë njerëz, nga Guraja e nga fshatrat fqinje, sa nuk mbahej mend të ishin mbledhur në varrimin e ndonjë njeriu tjetër. Te varrezat erdhi edhe Omeri me disa shokë. Kur vunë te kryet e varrit një tas me ujë, siç ishte zakoni, ai s'e mbajti dot veten dhe foli me mllef:

— Ai nuk vdiq i etur për ujë!... Ai vdiq i vetmuar!...

E shkrehu armën në erë ashtu siç veprohej, kur varroseshin partizanët e vrrarë, mandej iku me shokët drejt malit...

Gverrën që kishte hyrë në shpirtin e gurajasve e acaronte dita-ditës edhe lufta, e cila i kishte ndarë njerëzit me kufij të rinj. Fatkeqësitë e gëzimet, punët e përditshme dhe ngjarjet e reja i bënë të harronin shumë gjëra. Pak nga pak ata harruan edhe njeriun që flijoi aq shumë për ujët dhe bukën e tyre. Megjithatë mjegulla e hirtë e harrimit çahet herë pas here dhe midis saj, si dielli që duket e zhduket midis reve dimërore të shqyera nga era, fektonte fytyra e ngërthyer e Ibrës së vdekur.

Kundërshtari më i vendosur dhe më i rreptë i këtij harrimi ishte Prruk Moti. Ai ulej te rrënjët e Blirit të Madh, mbërthente kularin e thantë me gishtërinjtë eshtakë dhe i mëshonte me të lahutës së vjetër që kishte në bisht një gjarpër të lakadredhur e një kokë dhie të egër. Me atë zë të plakur, që dukej sikur vinte nga koha e legjendave, këndonte më shpesh se çdo këngë tjetër rapsodinë për ndërtimin e kanalit dhe për ardhjen e ujit në Gurajë. Atë këngë e kishte bërë që me gjallje të Ibrës, atje buzë Ujëbardhës, duke dëgjuar oshëtimën e ujërave dhe shpërthimet e minave. Aty thuhej se Ibër Shpata e çante shkëmbin me sokëllimën e tij. Kur plagosej nga gurët, gjaku i tij e turbullonte gjithë lumin dhe bari e lulet në brigjet e Ujëbardhës rriteshin të kuqe si gjaku. Në këtë rapsodi kishte edhe elemente të tjera të lashta të ciklit të kreshnikëve: punëtorët e kanalit me Ibrën në krye vrisnin kuçedra, mundeshin me zanat, që donin të pengonin ardhjen e ujit në Gurajë. Përdorej dendur numri shtatë: ndër-

timi i kanalit vazhdonte shtatë vjet, Ibra plagosej shtatë herë, ardhja e ujit në fshat kremtohej shtatë ditë e net... Edhe melodia ishte po ajo që shoqëronte këngët e kreshnikëve. Megjithëse njerëzit i kishin jetuar vetë ngjarjet dhe i kishin parë me sy ata që kishin punuar në kanal, këto ndryshime, këto zbukurime nuk ua vrisnin veshin, madje u dukeshin të natyrshme. Kurse fëmijët që dëgjonin në heshtje, besonin se ato bëma që paraqiste kënga ishin të njëmendëta.

Do të vijë dita që edhe unë të mos jem më, mendonte lahutari. Por kjo këngë do t'u mbetet brezave që do të vijnë, ashtu si kanali, ujët dhe toka e Gurajës... E treste vështrimin në largësi dhe i mëshonte kullarit të thantë mbi lahutë, nën degët e Blirit të Madh që shushurinte nga erërat e bjeshkëve, i rrethuar, si nga një kurorë lulësh, prej fëmijëve me flokë të verdhë, të kuq, gështenjë a të zinj, me sy të kthjellët si rrjedha e qashtër e vezullimtare e Ujëbardhës.

PJESA E TRETË

Omeri i hoqi sytë nga lumi dhe vështrroi përpara, në largësi, atje ku shkëlqenin nën një diell të fortë vere malet e kaltëruara të Gurajës, të mbuluara me lara të ndritshme bore. Kërkoj me sy larën në formë kali, por ajo ishte zhdukur. Është vonë, mendoi ai. Tash tubat janë ngjitur në bjeshkë... Si qëndroi disa çaste pa lëvizur, u nis prapë për rrugë, i shoqëruar nga zhurma e guralecëve që kërcisnin nën këpucët e rënda. Duke zbritur teposhtë, Ujëbardha i humbi nga sytë, por tashmë tërë qenia e tij ishte një lumë që gurgullon e feks nën diell, një lumë i kulluar ku pasqyrohet të rimitit e qiellit dhe blerimi i ndezur i brigjeve...

La rrugën dhe vajti buzë lumit. Vuri automatikun mbi një gur të sheshtë, u ul në gjunjë dhe zhyti fytyrën në rrjedhë. Në trupin e tij iu çelën disa dyer të fshehta, nëpër të cilat hyri flladi i borës dhe freskia e bjeshkëve. Ndenji ashtu një grimë herë, duke ndier një prehje e një përtëritje të menjëhershme... Dhe i kaluan vegimthi në mendje male e fusha, pllaja e lugina, ku kishte rrav-

guar brigada e tyre, duke çarë borën e trashë apo bal-
tën ngjitëse, duke duruar erën e acartë apo diellin për-
vëlues. Të pashlyeshme ishin sidomos vegimet e dimrit
të kaluar. Ortekë që rroposeshin nëpër shpatet e ma-
leve. Lukuni ujqish të tërbuar nga uria. Kolona nazis-
tësh. Çetnikë. Krisma mitralozash e mortajash. Cingëri-
më. Mungesë buke. Tifo. Marshime shumëditëshe. Sulme
e kundërsulme... Ata mendonin vetëm për një gjë: të
shkonin deri në Berlin e të ngulnin atje flamurin kuqezi
përkrah flamurëve të shteteve të tjera, që luftonin kun-
dër nazizmit.

Omeri shikonte këpucët e tij të ngrëna, të brejtura
nga gurët, të llangosura me një baltë që ndryshonte nga
balta e Gurajës. Kur të shkonte në shtëpi, ato këpucë
do t'i lanin e do t'i fërkonin me kujdes duart e Jerinës,
me gishta të gjatë e të hollë. S'ishte e vështirë ta për-
fytyroje sa shumë do të gëzohej ajo, duke i parë ato
këpucë prapa dere. Një pjesë të këtij gëzimi ajo do ta
shprehte edhe duke hequr prej tyre gjurmët e baltës
dhe pluhurin e udhëve të largëta të Ballkanit. S'është
çudi që, kur të mbaronte së pastruari e së fshiri çdo
gjurmë balte e çdo kokrrizë pluhuri, t'u thoshte: «Kë-
pucë të mira, mos u largoni më nga Guraja! Mjaft ke-
ni ecur, tani pushoni, çlodhuni! Mos e lini tim shoq të
shkojë larg...»

Omeri i mbathi këpucët dhe i lidhi me kujdes, sepse
lidhëset e tyre të holluara ishin këputur disa herë, dhe
u nis prapë për udhë. Në këtë zabullimë vere që të
zinte frymën e të përvëlonte mushkëritë, lëndimeve e
therjeve në këmbë, të cilat hera-herës i shkonin deri në
zemër, u shtojte edhe një tundim sfilitës: hijet e drurë-
ve. Të palëvizshëm, të ngrirë midis asaj nxehtësie to-
pitëse, drurët ngjanin si enë gjatoshe, barkiçe, të shtre-
mbra, dhe hija që kishin pranë ishte si një lëng i tra-
shë, blu apo i gjelbër, i derdhur prej tyre. Hije. Kudo
hije. Vapë dhe këngë gjinkallash. Erë dheu të zhuritur
dhe sherbele të fishkur.

Hë, ulu këtu, çlodhu një copë herë, more rrugëtar! — i pëshpërisnin hijet nga të gjitha anët, me zërin e tyre joshës. — Mos na përbuz. Ne e dimë se ti i ke këmbët të vrara, të flluskuara. Mezi po i përpjek në tokë. Çfarë të nxiton?! Të gjithë rrugëtarët që kanë kaluar bri nesh, janë ulur nëpër këto hije, janë freskuar, e kanë ndier veten më mirë për ta vazhduar rrugën më tej.

Omeri ndiente një trullosje të lehtë nga vapa dhe sytë i digjnin nga drita e fortë e diellit që thyhej mbi gurë. Këtë rrugë e kishte rrahur në stinë të ndryshme të vitit, i gëzuar a i hidhëruar, por atij nuk i dilte nga mendja sidomos një udhëtim që kishte bërë me t'atin, shumë vera më parë. Disa gurajas kishin shkuar në nën-prefekturë për të blerë misër. Çmimi ishte i shtrenjtë, por askush nuk bëri fjalë për këtë gjë. Kur pa dy thasët me misër që bleu i ati, Omeri u kënaq shumë. Iu duk vetja burrë, meqë po bënte një punë burri. Thesi i tij ishte gati sa thesi i t'et. E ngarkoi në kurriz dhe u nis i pari. Një copë rrugë eci në krye të varganit. Mandej fshatarët e kaluan një nga një, derisa mbeti fare në fund. I dhembnin këmbët e kurrizi. I dukej sikur një sharrë po ia priste më dysh trupin e tij të hajthëm prej katërmbëdhjetëvjeçari. Herë pas here e ngrinte qafën me mundim, për të shikuar përpara. Ia ngulte sytë hapësirës, siç ia ngul dhëmbët i urituri copës së bukës. Priste të shquante në atë tymnajë drite, pluhuri dhe ajri të dridhshëm pemët dhe shtëpitë e Gurajës. Sa hidhërohej, kur dilte në ndonjë kodër a në ndonjë qafë dhe Gurajën nuk ia zinte syri askund!...

Ja, pikërisht te kjo përpjetëz Omeri kishte dëgjuar prapa tij atë trokëllimë kuajsh që i oshëtinte në veshë edhe sot. Bajraktari po kthehej nga kryeqyteti bashkë me të birin, që mësonte në një shkollë të atjeshme. Megjithëse po i thyheshin gjunjët, Omeri e kishte ngjitur atë përpjetëzë pa bërë asnjë pushim. Kalorësit gati e kishin cikur me këmbë dhe ishin larguar pa ia hedhur sytë. Ata ishin zhdukur matanë qafës, duke lënë prapa xhuf-

ka pluhuri dhe trokëllimën e mbytur të potkonjve që vetëtinin në diell si gjysmëhëna argjendi. Tani djali i bajraktarit, Zabit Malota, fshihej në pyjet dhe shpellat e Gurajës. Një nga detyrat e Omerit ishte të asgjësonte atë dhe bandën e tij, që ishte një kërcënim jo i vogël për pushtetin e ri në këtë krahinë.

Omeri vështronte drurët e moçëm, të gungëzuar, ku uleshin udhëtarët për të pushuar. Në zgavrat, në bigëzimet e degëve, madje edhe mbi degët e këtyre drurëve kishte gurë të hirtë e të mprehtë. Gurët e vënë që prej motesh ishin mbështjellë nga lëvorja e drurëve, ishin ngulur thellë në mishin e tyre. Pse i vënë këta gurë nëpër drurë? — kishte pyetur Omeri, kur kishte qenë i vogël. I vënë që t'ua lënë drurëve lodhjen e tyre, — i kishin thënë. — I vënë që ta kenë më të lehtë për t'i marrë dragonjtë, kur të luftojnë me kuçedrën, — i kishin thënë disa të tjerë. Sidoqoftë gurët e vënë në këta drurë shtoheshin nga viti në vit. Të ngarkuar me gurë, ata ngjanin si pemë të jashtëzakonshme, me fruta të gurtë.

Në rripat me bar e në lëndinat buzë rrugës kishte me shumicë lule shurdhe. Ato ishin një lodër, një zë i fëmijërisë së Omerit. Fijet e holla e të lehta, me fara të imëta, që i ngrinte në ajri fryma e tij, i merrte me vete puhia e i shpërndante në hapësirë. I bëhej sikur me atë push fluturonte edhe vetë në qiell, shtegtonte në hapësirën e pafundme. Po për ku?! Drejt së panjohurës që ishte njëherësh edhe Guraja, edhe gjithë bota që e rrethonte. Tani që ishte rritur dhe kishte parë vise të tjera, Guraja nuk i kishte më përmasat e dikurshme, por vendi që ajo zinte në zemrën e tij, mbetej po ai. Shkëmbinjtë e zhveshur, drurët me rrënjë të dala, shtretërit e përrenjve që zbardhonin së largu, i dukeshin si fytyra njerëzish të njohur, për të cilët e kishte marrë malli. Po të ishte e mundur, do t'i përqafonte, do të mbështeste një çast mollëzën pas tyre, që të ndiente në lëkurë preken e vendit që e kishte lin-

dur. Omerit i erdhi për të qeshur me këtë mendim fëmijëror. Mbase vetë vendi ku ke lindur të bën si fëmijë, mendoj ai, si për të shfaqësuar veten. . .

Në të pruar të diellit shkeli në pllajën e Gurajës. Pamja e saj ia topiti atë gëzim fëmijë që po i llokoçiste në damarë. Bari i fishkur kishte marrë një ngjyrë të verdhë, të zbërdhylet prej kashte të thatë. Mbi këtë qilim të përcëlluar zgjateshin gjembaçë me gjilpërëza si të qelqta dhe disa lule të rimta, me kërcej të fortë e gjethe të mishta si luspa. Ata ishin e vetmja stoli e kësaj krahine në stinën e nxehtë.

Omeri vështronte si në ëndërr ngjyrën e veçantë të këtyre luleve. Ngjyrë e rime si Ujëbardha kur rrjedh e qetë apo si qielli i verës mbi male, kur është i qash-tër, pa asnjë gjurmë reje. Dhe papritmas i erdhi në mendje diçka tjetër e ngjashme me këto kupëza të rimta: sytë e Jerinës. Ai u befasua nga kjo ngjashmëri. Sytë e Jerinës, të shndërruar në lule, e shikonin nga të gjitha anët. Këtë shëmbëllim e bënte më të plotë jo vetëm rime, por edhe forma e petaleve që hapeshin anash si qerpikë. Sytë e Jerinës, mendoj Omeri. Nëpër trup i kaloi një drithërimë e lehtë. Ata sy e kishin shoqëruar gjatë gjithë kohës, kudo që kishte vajtur, me butësinë dhe pikëllimin e tyre.

Te Sofra e Shtegtarëve — një rrasë ngjyrë hiri në të kaltër, me madhësinë e një sofre të zakonshme, — një trumbë zogjsh po çukiste thërrimet e fundit që kishin mbetur në të. Me krahë të hapur e kaçiruba të kreshpëruara, ata çurlikonin me zhurmë dhe shtynin njëri-tjetrin, duke u përpjekur të rrëmbenin thërrimet e verdha të bukës së misrit. Në atë sofër guri ndaleshin e hanin bukë udhëtarët e lodhur që kishin bërë një rrugë

të gjatë me misër ose me kripë në shpinë. Edhe më i urituri e më varfanjaku e ndante një kafshatë nga buka e tij dhe e grimconte mbi gur, që ta hanin zogjtë.

Megjithëse nuk u ndal për të ngrënë, Omeri e uli çantën e shpinës mbi rrasë, theu një copë simite dhe e bëri thërrime-thërrime. Ja ku u takova me gjallesat e para të Gurajës, — mendoj ai me hidhërim. — Me zogjtë e saj të uritur...

Me urinë e vërtetë të Gurajës Omeri u ndesh pas një copë here dhe ky takim qe më tronditës. Në rrugën me pluhur po ecnin njëri pas tjetrit disa burra dhe gra, që mbanin në kurriz thasë të zbrazët ose me dy-tri kile misër. E ndjeu se po e humbiste një pjesë të gëzimit që po kthehej në vendin ku kishte lindur me mendime të reja dhe ëndrra të bukura, për të ndryshuar jo vetëm jetën e vet, por edhe jetën e Gurajës.

Guraja është e vuajtur, mendoj ai me hidhërim. Por, duke hyrë në fshat, duke kaluar midis kopshteve dhe arave me misër, u çlirua nga përshtypjet e pakëndshme dhe mendimet e hidhura. Shumë pemë ishin rënduar nga kokrrat. Bimët e harlisura të misrit kishin një gjelbërsi të ndezur, gati të shndritshme. Megjithatë aty-këtu të zinte syri edhe ara me bimë të rrëgjua, që i kishin gjethet të rrudhura e gjysmë të fishkura. Me siguri në këto ara nuk është futur ujë sivjet, mendoj Omeri. Dhe i pa me njëfarë mllefi arat e harlisura, të cilat kishin marrë edhe ujët që u takonte arave të tjera. Prapa arave të Gurajës iu shfaqën fytyrat e të zotërve të tyre. Disa fytyra ishin të majme, të kënaqura, me mustaqe të dendura që zgjateshin krenisht si mustaqet e mirave të harlisur. Fytyrat e tjera ishin të ligura e të rrudhura si arat e tyre pa ujë, të zhuritura nga zhegu. Kështu, të ndryshme kishin qenë arat dhe fytyrat e njerëzve jetë e mot. Pas hapjes së kanalit dhe ardhjes së ujit në Gurajë, ky ndryshim ishte bërë edhe më i theksuar.

Fajin nuk e ka vetëm thatësira, por edhe ndarja e ujit, — murmuriti Omeri me zë të ulët. Ndjeu se mlle-

fi, një mllef i ftohtë e këmbëngulës, po grumbullohej brenda tij. Aq më mirë! Ai nuk po kthehej në Gurajë për t'u prehur, as për të shijuar atë ëndje që të jep pajtimi me gjendjen, me rendin e gjërave. Përkundrazi, bashkë me të tjerët do të përpiquej ta ndryshonte këtë gjendje, të përmbyste ato ligje e zakone që rëndonin mbi Gurajë si një zheg i përjetshëm.

Një nga punët më të ngutshme ishte ndryshimi i ndarjes së ujit. Edhe ujët e kanalit, edhe ujët e burimeve të vogla do të ndaheshin me drejtësi, duke marrë parasysh tokën e mbjellë që kishte çdo fshatar. Nuk do të mbetej pa u ujitur asnjë arë, edhe në qoftë se i zoti i saj s'do të kishte pasur kurrë rend uji. Omeri e kishte të qartë se kjo ndarje e re nuk do të bëhej lehtë. Ata që zotëronin shumë renda uji do të kundërshtonin me tërbim çfarëdo vendimi që do të prekte pronën e tyre. Veç kësaj kishte edhe një vështirësi tjetër: ujët e kanalit ishte i pamjaftueshëm për të përballuar etjen e të gjitha arave e kopshteve të Gurajës. Ishte e domosdoshme të shtohet ujët...

Në vetëdijën e Omerit u shfaqën dy fytyra: Murat Gjoka dhe Ibër Shpata. Jeta dhe kujtimi i këtyre dy njerëzve ishin lidhur aq ngushtë me ujin. I pari ishte larguar fshehurazi nga Guraja, i mundur, i braktisur, i përbuzur. Tani edhe në biseda rrallëherë zihej ngoje emri i tij. Për të rinjtë dhe sidomos për fëmijët Murat Gjoka ishte si ato personazhet e përrallave që, ndonëse nuk janë keqdashës, u sjellin njerëzve vetëm prapësira dhe zhgënjime. Puset e errëta, të zbrazëta, që mbusheshin vetëm nga ujërat e shirave, fëmijët i quanin «sytë e Murat Gjokës». Ata ndaleshin shpesh pranë këtyre puseve dhe hidhnin gurë në to duke thirrur me të madhe:

*Murat Gjokë, o Murat Gjokë,
Nxirr ujë, o të bëmë copë!*

Nga fundi i errët i pusit ngjitej vetëm një oshëtimë e mbytur, që ngjante edhe si rënkim, edhe si kërcënim

i plakut të panjohur. Pasi lodheshin së thirruri, fëmijët hidhnin prapë një breshër gurësh që zhyteshin me zhurmë në ujët e turbullt e në llucën e trashë.

Megjithëse e kishte sjellë ujët e lumit në Gurajë, edhe Ibër Shpata kishte vdekur fatkeq. Nëpër dasma njerëzit u thoshin këngëtarëve: Këndona edhe këngën e Ibër Shpatës! Derisa mbaronte kënga, në kthinë nuk dëgjohej asnjë pipëtimë, Në këto çaste fytyrat e këngëtarëve dhe të dëgjuesve kishin një pamje ku përziheshin solemniteti, krenaria e dhimbja. Sidoqoftë nuk mungonin as ata fshatarë që e shikonin kanalën me pikëllim. Uji që gurgullonte bri arave të tyre të shkrumbuara, të cilat dukeshin si të gjunjëzuara për mëshirë para qiellit të prushtë, ishte një torturë dhe një tundim i përhershëm... Ah, Ibër Shpata, Ibër Shpata! Si shpatë po na ngulet në zemër kanali yt! Gjaku yt po majmat e kryeplakut e të Grosh Malotës me shokë...

Kur dalloj kullën e tij midis pemëve, Omerit i fërgëllloi tërë trupi. Kjo ndjesi nuk zgjati shumë: në veshë i erdhi një jehonë e shurdhër, e zyrtë. Kjo jehonë të kujtonte ulërimën e llavës në dimër, rënkimin e erës së ftohtë në mes të natës, shpërthimin e ujërave të një përroi në errësirë. Omeri e kuptoi se ajo zhurmë e mbytur, e përvajshme që dilte nga kraharorë njerëzorë, nga mushkëritë e tyre, ishte gjëmë. Do të kishte vdekur dikush.

Edhe pse nuk ishte i bestytnishëm, kjo gjëmë i shkaktoi njëfarë turbullimi shpirtëror. Në këtë ditë gëzimi kur po kthehej në shtëpi, i dolën përpara zhegu përvëlues, thatësira, lypësit dhe uria e Gurajës, ndërsa tani edhe vdekja. Një parandjenjë e keqe, mjegull e hirtë, ia mbështolli të gjitha mendimet. A thua në fund të asaj copë rruge që e ndante nga shtëpia, i mbe tej për të provuar ndonjë hidhërim më të thellë, ndonjë kob më të zi?!... U përpoq ta flakte tutje këtë pyetje ogurkeqe, siç flakim një urë zjarri që nxjerr tym e të zë frymën.

Kur hyri në oborr të shtëpisë ku po bëhej gjëma,

njerëzit u befasuan nga ardhja e Omerit. Për një çast edhe kuja u shugat. Ai u dha dorën njerëzve të shtëpisë dhe i ngushëlloi. Vuri re se të moshuarit e shikonin me nderim.

Radhët e grave që e kishin rrethuar dërrasën e të vdekurit në të dy anët, si një kor i lashtë, e kishin ndërprerë vajtimin dhe po hapeshin për t'ua lëshuar vendin burrave, gjëmëtarëve. Përmes kësaj zie që nisi të lëvizte, të shpërndahej, Omeri pa dërrasën e të vdekurit. U ngjeth. Aty kishte petka të shtrira: tirq, xhamadanë, shokë të larme, plis të bardhë e një fyell. Ai e njohu fyellin e bariut, me të cilin kishte lodruar dhe ishte ngjitur në male me tubat e dhive.

Ishte takuar disa herë me të gjatë viteve të luftës dhe kishte dashur ta merrte me vete. Shoku kishte pasur dëshirë të madhe, por nuk e kishte lënë i ati, të cilit nuk ia mbushte syrin një luftë ku nuk merrte pjesë as bajraktari, as kryeplaku. Si hakmarrje për një sulm që kishin bërë partizanët, nazistët ishin vërsulur nëpër rrugët e qytetit, kishin rrëmbyer në treg disa burra e djem, midis tyre edhe disa gurajas, të cilët i kishin nisur në kampet e përqendrimit. Ata që kishin mbetur gjallë dhe ishin kthyer në vendlindje, kishin sjellë me vete edhe lajmin për të vdekurit...

Gurajasit i qanin njerëzit e humbur, duke shtrirë mbi dërrasë petkat dhe sendet e tyre. Kjo ceremoni mortore ishte më ngjethëse se gjëma që bëhej mbi trupin e njeriut të vdekur. Kishte diçka edhe të kobshme, edhe të frikshme në atë vajtim rreth disa petkave të zbrazëta, të shtrira, sikur të kishte qëndruar mbi të vdekurin një plloçë e rëndë e padukshme. Në këtë rast vdekja nuk kishte fytyrë njeriu, por një pamje të vagëlluar fantazme.

Ndryshe, krejt ndryshe ishte puna me shokët e vrarë në luftë. Omeri mbante mend jo vetëm fytyrën e secilit, por edhe plagët e tyre, vendet ku ishin varrosur, lisin apo shkëmbin që kishin pranë dhe disa hollësi të tjera, që mbase nuk do t'i harronte kurrë. Këta shokë

ishin përcjellë në varr vetëm me lot të heshtur e me të shtëna pushkësh, pa britma gjëmëtarësh e pa vajatore. Edhe kur e kishin marrë vesh të afërmit, askush s'kishte bërë gjëmë mbi petkat e tyre.

Krisma të drunjta, të mbytura, të rënda. Jerina e kuptoi se ato krisma në derë ishin nga një dorë burri. Qenia e saj rënkoi si kabanë nga ato goditje. U ngjeth nga tronditja. Ishte një refleks që i kishte mbetur qysh nga kohët e para të ngujimit. Ah, ajo kohë!... Çdo hije që lëvizte në oborr netëve me hënë, krismat e rrasave të çatisë apo të degëve kur frynte erë, e linin orë të tëra pa gjumë. Mendja e saj që gjatë ditës rrinte si e mpirë, në ato çaste vihej në lëvizje nga një forcë që nuk i bindej vullnetit të saj dhe trillonte ngjarjet më të pabesueshme dhe hamendjet më të llahtarta. Sikur të mos mjaftonin këto çaste pagjumësie dhe ankthi, hijet kërcënuese, hijet e gjakut e ndiqnin edhe në gjumë. Shpeshherë i dilte gjumi trembshëm në mes të ëndrrës, ia ngulte sytë errësirës për të dalluar ata që kishin qëlluar me pushkë mbi të dhe instinktivisht prekte trupin me dorë për t'u bindur se nuk ishte plagosur dhe nuk po i rridhte gjak...

Goditjet në derë u përsëritën. Nuk ishte vjehrrri. Ai do t'i thërriste të nipit, siç bënte gjithmonë. Vjehrra sapo ishte nisur për në mulli.... Po sikur të jenë «ata»?! Ajo i kishte pritur me vite. I ati nuk kishte pranuar të pajtohej me atë që «i kishte grabitur vajzën». Ai i kishte kthyer mbrapsht dy herë njerëzit që i kishin shkuar për pajtim. «Ai më ka marrë fytyrën! — kishte thënë i ati i Jerinës. — Dhe fytyrën time nuk mund ta lajë as ujët e detit. Atë e lan vetëm gjaku!»

Ajo priste të dëgjonte zhurmën e drangut të thyer

dhe të derës së rrëzuar. Priste të dëgjonte zhurmat e hapave nëpër shkallët e brendshme. Me ata hapa do të vinte vdekja. Ajo vdekje që e kishte përgjuar dhe e kishte trembur për vite me radhë. Që e kishte detyruar ta kalonte rininë në ngujim, midis katër mureve të gurta. Që ia kishte ngrirë gjakun aq herë dhe ia kishte prerë gazin në buzë. Mendja i vajti te fëmijët, që do të mbeteshin jetimë. Kjo gjë ishte më e tmerrshme se çdo lloj ankthi që e kishte munduar gjatë këtyre viteve. Ajo përfytyroi se si ata do të zgjoheshin nga gjumi, do t'i thërrisnin e do t'i thërrisnin, mandej do t'ia shkrepnin të qarit.

Omeri është larg, në dhé të huaj, — mendoj Jerina. — Kushedi a do të kthehet. Duhet të bëj diçka për t'u mbrojtur. Po me se të mbrohem?... Deshi të lëvizte, por ngriu në vend: «Jerinë!... Jerinë!...» Sa kohë po bëhej që s'e kishte dëgjuar emrin e saj?... Pandeju se do t'i kishin bërë veshët nga tronditja e madhe. Se edhe ai zë i njohur, i ngrohtë, do të ishte thjesht trillim i fantazisë së saj. Mirëpo ai zë i thirri prapë në emër. Jo, nuk ishte thirrje e trilluar. Ishte një thirrje e qartë, e vërtetë. Jerina nuk e zotëroi më veten. Nuk pa as nga frëngjia mbi derën e kullës, as nëpër të çarat e derës së moçme prej pishe. E tërhoqi me vull drangun e nxirë që u përplas me forcë në mur, hapi derën dhe u gjend përballë Omerit. Tërë qenia e saj u mbush me një ngazëllim të ndritshëm. Mbeti si e shtangur. U mundua të buzëqeshte, por muskujt e fytyrës iu tendosën nga dhimbja. Ishte gati t'ia plaste edhe vajit, edhe gazit...

Omeri e kapi nga krahu siç kapet një fëmijë dhe hyri brenda bashkë me të. Në mes të shkallëve ajo u ndal dhe vështroi derën që kishte mbetur e hapur. Përmes saj futej drita e diellit. Omeri e mori me mend domethënien e vështrimit të saj.

— Nuk është nevoja... — tha ai, duke e shtrënguar kurmin e ngrohtë të Jerinës pas trupit të tij. Ai ndiente

se si vakësia e saj vërshonte në tërë qenien e tij të kapitur.

Pasi vari automatikun te gozhdët e armëve dhe uli përtokë çantën e shpinës, Omeri e kapi përsëri Jerinën për krahu dhe shkoi te kthina e gjumit. Në dritarën e saj ishte varur një pëlhurë e bardhë për të penguar mizat dhe grerëzat. Kthina ishte kredhur në mugëtirë. Omeri u afrua te shtrati ku flinin fëmijët dhe i kundroi disa çaste, duke ndier se si në fyt diçka po i lidhej nyjë. Brenda tij po rritej një dëshirë e përpëmbajtshme që t'i zgjonte, t'i merrte në krahë e t'i puthte.

— A t'i çoj? — tha Jerina.

— Jo... — tha Omeri. — Ata nuk më njohin dhe do të tremben. Më mirë le të zgjohen vetë.

U larguan në majë të gishtave dhe shkuan në kthinën tjetër. Omeri u ul mbi cergë, duke e tërhequr edhe Jerinën pranë tij. Ajo rrinte kokulur dhe e druajtur si një vajzë. Megjithëse e kishte pritur me padurim dhe e kishte ëndërruar aq shumë këtë çast, një ndjenjë e pashpjegueshme e pengonte t'i hidhej në qafë. Omeri ia hoqi shaminë e bardhë nga koka si të hiqte një mjegull që rri pezull mbi një pyll të dendur. Kur kishte kaluar nëpër pyje të largëta, i kishin ardhur në mend shpeshherë edhe këta flokë që tani po i përkëdhelte, po i krihte me gishta. Prej tyre dilte një kundërmim i veçantë i njohur, i ngjashëm me kundërmimin e pyllit në maj.

Omeri e la të qante derisa ajo u qetësua vetë. Përmes atyre dënësave që ia tronditnin tërë kurmin, po dilte jashtë angështia e shumë ditëve e netëve. Tani ajo ishte kulla me derë të hapur, përmes së cilës largoheshin ajri i ndenjtur, mugëtira dhe futeshin brenda rrëke drite.

Omeri ia kapi kokën midis dy pëllëmbëve dhe e vështroi në sy. Ata ishin të kthjellët të ndritshëm si qielli pas një rrebeshi të shkurtër, me një ngjyrë midis së zezës e blusë si rrushi i zi, i pjekur mirë. Kurse

fytyra, si e mbujtur prej drite, frëzëllinte nga lum-turia. Ai u përkul mbi fytyrën e saj dhe ia puthi sytë si dikur te kaçuba e trëndafilin të egër.

— A do të ikësh prapë? — tha Jerina.

— Ku të iki? — tha Omeri duke vënë buzën në gaz.

— Ku e di unë e mjera! — tha Jerina. — Ta dish se nuk mund ta duroj një ndarje tjetër si kjo...

— Kurse unë s'kam qenë asnjëherë i ndarë prej teje, Jerinë!

— A ke qenë fort larg?

— Shumë...

Omeri drejtoi këmbët që po i mpiheshin. Jerinës i shkuan sytë te këpucët e tij të ngrëna e të brejtura nga gurët, u çlirua nga krahët e tij, u ul në gjunjë dhe filloi t'ia zgjidhte lidhëset e këpucëve. Kur ia hoqi çorapet e grisura, ajo kafshoi buzët me dhëmbë. Këmbët e tij ishin dy copëra të kuqërruara, të mbushura me fluska dhe plagë. Ajo deshi t'i lëmonte me pëllëmbë ato shputa të vrara, por pati frikë se mos ia lëndonte.

— Do të sjell ujë të vakët me kripë, — tha ajo.

Mori me vetë këpucët e çorapet dhe doli nga kthina. Omeri u shtri në cergë, duke vënë pëllëmbët nën kokë. Përsëri në shtëpi, mendoi ai. Viset e largëta ku kishte ecur dhe kishte luftuar tani i dukej sikur i kishte parë vetëm në ëndërr. Valë-valë, nga ana tjetër e fshatit vinin jehonat e përmortshme të gjëmës, por Omeri as që i dëgjonte. Vëmendjen e tij e kishte pushuar diçka tjetër: e nesërmja. Nga do t'ia fillonte? A do të dilte faqebardhë edhe në këtë luftë të re? Me kë do ta kishte më të vështirë: me kundërshtarët e hapur, të arratisur nëpër male, apo me kundërshtarët e fshehtë, me të cilët do të kishte të bënte çdo ditë?...

Kur hyri në kthinë disa minuta më vonë, Jerina pa se Omerin e kishte mbërthyer gjumi. Ndjeu një dëshirë të zjarrtë të shtrihej pranë tij, ta shtrëngonte në krahët e saj, por e përmbajti veten, duke menduar se mund t'ia nxirrte gjumin dhe fëmijët mund të zgjoheshin nga

çasti në çast. Një copë herë të madhe qëndroi në këmbë pranë Omerit që flinte. Nuk ngopej së shikuari. I bëhej sikur ajo pamje ishte thjesht një vegim ëndrrë që do të zhdukej, sapo të kthente shpinën. Ajo do të mbetej prapë vetëm për vetëm me mallin dhe dritërimën e saj.

Mendimet e Jerinës i ndërprejnë goditje të tjera në derën e kullës, të cilën e kishte mbyllur, pasi lau çorapet dhe këpucët e Omerit. Ishte vjehrra. Asaj i ra në sy menjëherë ai rrëzëllim i veçantë që dilte nga fytyra e Jerinës.

— A ka ardhur kush, bijo?

— Po, nënë... Ka ardhur Ai!

Trupi i nënës u mbështoll nga një avull i ngrohtë dhe shpirti i saj sikur u lëbyr nga ato fjalë të thjeshta, që për të kishin brenda të gjitha rrezet e diellit. Ndjeu njëfarë zilie që s'kishte qenë në shtëpi, kur kishte ardhur i biri, po, kur pa dy rruzuj të ndritshëm që u rrokullisën nëpër faqet e Jerinës, ajo ndjenjë u shua në çast.

— Ku është? — tha nëna.

— Në kthinën e burrave... E ka zënë gjumi.

Ato hynë në kthinë në majë të gishtave. Omeri po flinte ijazi. Në fytyrën e tij të përgjumur dukeshin gjurmë lodhjeje. E ëma pa këmbët e ënjtura e të flluskuara dhe iu bë trupi ferrë nga dhimbja. I miri im, — mendoi ajo, — kushedi sa do të ketë ecur, nëpër sa rreziqe do të jetë përbiruar! Kushedi sa ka hequr gjatë këtyre viteve dhe unë s'kam mundur as t'i laj e t'i arnoj këmishën... Atë çast pati dëshirë që i biri të ishte i vogël, i vogël dhe ta merrte në dorë e ta shtrëngonte në gjë si ferishte.

Sytë e nënës kishin një vezullim të veçantë që Jerina s'e kishte vënë re më parë.

— Si të ma kishte ndier zemra se një ditë do të ikte kaq larg, kur ishte i vogël, i këndoja te kryet e djepit:

*Në tri udhëkryqe fjettë,
Kurrgjë e ligë mos e gjettë!*

A e sheh që s'ma gjeti kurrgjë. Më erdhi shëndoshë e mirë...

Një valë dhembshurie gufoi në kraharorin e Jerinës. E kapi vjehrrën për qafe si ta kishte nënën e saj. Edhe vjehrra e përqafoi dhe e puthi. Ishte e para herë që e ndienin njëra-tjetrën kaq të afërta. Qysh në fillim vjehrra i kishte qëndruar larg Jerinës. Shkaku i këtij qëndrimi të ftohtë ishte edhe natyra e saj e druajtur, edhe mendimi se Jerina ishte nuse e marrë në gjak, pra, që s'do të sillte mbarësi, por kob në këtë shtëpi. Më vonë, kur Omeri u arratis në mal dhe ndiqej nga xhandarët e mbretit, ajo fajësonte vetëm Jerinën. Sipas gjykimit të saj, të gjitha këto fatkeqësi kishin ndodhur për shkak të nuses që ishte marrë në gjak. Këtë ftohësi nuk e ngrohën dot as fëmijët e vegjël. Madje kur e shihte ndonjëherë të renë duke përkëdhelur djalin e vajzën, vjehrra ndiente një mëri të heshtur ndaj saj.

Që të errësohej kthina, zunë dritaret me jastëkë dhe dolën jashtë, duke e mbyllur derën me ngadalë. Të dyja ia nisën punës për të bërë gati darkën...

Me të dëgjuar thirrjet dhe të qeshurat e fëmijëve, ato u ngritën në këmbë përnjëherësh. Kaluan si hije nëpër kthinën ku flinte Omeri. I morën fëmijët me të mirë, duke i puthur e duke u pëshpëritur që të mos bënin poterë. Kjo sjellje e pazakontë e ngacmoi edhe më tepër kureshtjen e fëmijëve, të cilët bënin pyetje pas pyetjesh.

Omeri i kishte hequr jastëkët nga dritarja dhe po shtriquej, kur ato erdhën te kthina. Ai zgjati duart t'i përqafonte djalin e vajzën, por fëmijët iu shmangën duke mbuluar fytyrën me krahë. Ky njeri i panjohur, i veshur ndryshe nga njerëzit e shtëpisë e nga fshatarët e tjerë, i frikësonte.

— Epo mirë, këta le të shkojnë te nëna e vet, unë po marr ngrykë nënën time, — tha Omeri me të qeshur.

Kur e shtrëngoi në krahët e mëdhenj e të fuqishëm trupin e hequr të nënës, ndjeu një ngashërimë të thellë, të përzier me mall e trishtim. Trupi i saj, që gjithnjë kishte qenë i paktë, sikur ishte zvogëluar edhe më nga vitet e brengat. Iu kujtua fëmijëria kur e ëma, për ta provuar se sa ishte rritur, e maste me trupin e saj. Sa ishte gëzuar atë ditë që koka e tij i kishte arritur deri te mjekra!

I tha Jerinës t'i sille çantën e shpinës dhe u ul në cergë, duke e tërhequr edhe t'ëmën pranë tij. Fëmijët e vështronin nga larg me habi, me druajtje. Omeri nxori nga çanta dy simite të bardha për djalin e vajzën, një shami koke ngjyrë të mbyllët me katrorë të vegjël të bardhë për nënën dhe një sapun fytyre për të shoqen.

— I kam blerë edhe babës një çibuk, — tha ai. — Do t'ia çoj në bjeshkë, kur të ngjitem këto ditë.

— Besa, ai nuk është në bjeshkë! — tha e ëma. — Na ka gjetur e zeza me dhitë, u ka rënë një sëmundje e keqe. Ai është mbërthyer me to në një shpat mali, që ia ka caktuar katundi.

Fëmijët që kishin filluar të kafshonin me ëndje simitet e bardha iu afruan Omerit dhe iu ulën në prehër. Ai ua lëmonte flokët me dorë dhe i puthte. Kur ia vuri kapelen me yll në kokë, djali vrapoi duke qeshur drejt sëmës.

Ai sy gjumë, sado i shkurtër që kishte qenë, e kishte çlodhur e freskuar. Omeri ndiente ato çaste një nga ato lumturi të rralla që njeriu nuk e di se nga vijnë, nga se janë krijuar. Megjithatë e kishte të qartë se në lumturinë e tij bënë pjesë një mori gjërash të vogla e të rëndësishme që e rrethonin, e mbështillnin me fluromën e tyre. Atë gjëra ishin era e shtëpisë ku kishte lindur, nëna, fëmijët, të qeshurat e tyre të kristalta, Jerina që po bëhej copë për darkën dhe herë pas here i hidhte ndonjë vështrim përmes derës së hapur. Thithte me tërë gjerësinë e mushkërive atë ajër mbrëmjeje, që kundërmonte fruta të pjekura, perime të freskëta e bukë të ngrohtë, të saponxjerrë nga çerepi.

Mirëpo edhe më vonë, i ulur në sofër me njerëzit më të dashur rreth e qark, duke ngrënë me shije ato ushqime të thjeshta, por të gatuar me aq përkujdesje, ai e kuptonte vagëllimthi se lumturia e tij nuk mund të ishte as sa ajo sofër, as sa shtëpia e tij. Ajo do të ishte e plotë vetëm kur të ishte sa të gjitha sofrat e Gurajës, sa gjithë hapësira e saj.

Për ta gjetur t'atin, Omeri e pati fare të lehtë: sapo u afrua te kullota, dëgjoi cingaren e dhive, mandej vuri re një fjollë tymi që ngjitej lart midis drurëve. E mori me mend se i ati do të kishte ndezur zjarr dhe kjo gjë e çuditi. Ishte zheg përvëlues. Grafullima e tij e rëndë ndihej edhe në pyll. Ç'i duhej zjarri t'et? Qumështi i dhive të sëmura nuk pihet. Edhe po të kishte për të vluar qumësht, këtë gjë do ta bënte në mëngjes, kur ende ishte njëfarë fresku, e jo në mes të ditës. Shpati i malit kundërmonthe bar të përcëlluar e çaj të egër të tharë. Ishte një duhmë që të ngacmonte mushkëritë e të binte në kokë.

Omeri i mbajti këmbët dhe s'lëvizi një grimë herë. Nja njëqind hapa më tej, Demushi ishte ulur mbi një gur pranë zjarrit, ku po vlonte një kusi. Ishte kokëzbuluar, pa këmishë, me një fanellë të leshtë, pa mëngë. Në dorë mbante një shkop ku përdridhej një gjarpër.

Demushi e ndjeu se po vinte dikush dhe çoi sytë. U befasua, madje u ngashërye, por nuk e dha veten. Bëri të ngrihej nga guri ku ishte ulur, por Omeri i mbështeti pëllëmbën në sup që të mos lëvizte. Demushi kishte futur në majën e një shkopi të çarë qafën e një nepërke. Omeri e njohu nga ngjyra e hirtë dhe nga zigzagu i errët që shtrihej në tërë gjatësinë e ku-

rrizit. Pasi u përshëndetën, Omeri i tha t'et të merrej me gjarprin. I dukej sikur nuk mund të fliste lirisht, për sa kohë shihte atë gjarpër që vërtitej rreth shkopit.

Ndryshe nga i biri, Demushi nuk ndiente asnjë neveri nga zvarraniku. E mbante në dorë, siç do të mbante çdo krijesë tjetër që fluturon a që zvarritet. Pasi e shtrëngoi shkopin me forcë, e vuri gjarprin mbi kusinë me qumësht. Kur iu përcëllua bishti nga flakët, nepërka u xhindos, hapi gojën dhe fiskajet e helmit ranë në kusi.

— Më kanë thënë se vredi i gjarprit është ilaçi më i mirë për këtë sëmundje, — tha Demushi.

Vëmendja e Omerit ishte përqendruar tek i ati, te pamja dhe gjestet e tij si të gurta, ku s'dallohej asnjë shenjë ankthi, asnjë drithërimë. Për herë të parë e pa t'atin në një dritë të re. Ky njeri që kishte ecur tërë jetën bërriyl për bërriyl me vdekjen, me urinë, me të keqen, me mynxyra të vjetra e të reja, ishte i qetë si një fëmijë që nuk e di çështë dëshpërimi, ligështia. E vështronte botën sy në sy, sikur i thoshte: Ti je, por edhe unë jam! Ti je e madhe, e egër, por edhe unë jam dikushi e ta dish se kurrë, sado ngushtë që të më zësh, nuk do të dëgjosh nga goja ime fjalët: U dorëzova! Në besën tënde!...»

Me këtë stoicizëm përballë dhimbjeve dhe me këtë qëndrim sfidues ndaj fatkeqësive të shumta të jetës ishte mburrur tërë brezi i Demushit. Mirëpo shpeshherë papërkulshmëria shndërrohej në njëfarë pandjeshmërie, ndërsa nevoja për të mbajtur secili barrën e halleve të tij e mbyllte njeriun në vetvete, e bënte individualist. Ashtu si mungesa e ujit, një thatësi të tjetër që e kishte emrin vuajtje, varfëri, vetmi, e kishte përtharë dhe e kishte tkurrur pak nga pak, për një kohë të gjatë shpirtin e njeriut.

— Së paku tash po shpëtoj nga këta shkrepë e nga këto shpate! — tha Demushi. Omeri e dinte se ai mendonte të kundërtën e asaj që thoshte. Po pse e bënte

këtë gjë?! Për ta ngacmuar a për ta qortuar?! Ishte vështirë të zbuloje qëllimin e tij të fshehtë.

— Ti e di, babë, si ka thënë një malësor motit: «Shtatë dhi nuk më lanë të bëhem burrë!»

Omeri vuri buzën në gaz.

— Pra, e paske ndarë mendjen t'i lësh dhitë e tua e të bëhesh «burrë»... Të merresh me «dhitë» e botës!

— Dikush duhet ta bëjë këtë gjë, babë.

— Mirë, more bir, po a ke qafë për këmborë?!

— E di se ti ke menduar gjithmonë që këmborën e Gurajës duhen ta tundin vetëm Grosh Malota e kryeplaku. Koha e tyre e pat, babë. Për këtë tash duhet të jesh i bindur edhe ti.

— Por lisiin e madh e merr era, djalo!

— E merr era e ndoshta ia thyen degët, babë, por dikush duhet të rrijë përballë erës.

I ati e vështroi një copë herë pa folur, sikur po e maste, po e peshonte. Vinte re në tiparet dhe fjalët e tij një gjë të re që s'arrinte dot t'i gjente një emër. Kjo gjë e turbullonte dhe sikur e largonte prej të birit. I dukej sikur ai ishte dhe s'ishte i biri...

Ishte pika e ditës. Dhitë ishin mbledhur nën mrip. Ato kruheshin tërë kohën pas gurëve, rrënjëve të dala e dheut të bardhemë. Demushi shkoi pranë një dhie që ishte shumë e sëmurë, nxori nga xhepi një pendël pule të gjatë, të cilin e zhyti në qumështin e përzier me lëng gjarpri dhe zuri ta spërkaste me të. Kështu veproi edhe me dhitë e tjera. Kjo punë kërkonte durim të madh. Duhej të rrije disa orë pa e lëshuar pendlën e pulës nga dora, duke përsëritur të njëjtat lëvizje. Omeri vështronte bulat e mëdha të djersës që rrëzoheshin nga balli i t'et, zbrisnin nëpër faqet e tij të ashpra e të parruara dhe thoshte me vete: Ah, sikur të kisha durimin, këmbënguljen e tij!...

Jerina hapi arkën ku mbante petkat e nusërisë dhe në kthinë u përhap një erë e fortë mollësh të ruajtura. Ajo nuk e mbante mend kur i kishte veshur për herë të fundit këto petka. Sidoqoftë kishte kaluar një kohë mjaft e gjatë. Në palët e tyre ishte strukur nusëria e Jerinës së ngujuar në kullë. Kishte një ngjashmëri të madhe midis këtyre petkave dhe jetës së saj...

Ajo thuri gërshetat, u vesh dhe u pa përsëri në pasqyrë. Fytyra që u shfaq përpara saj, iu duk një fytyrë tjetër, aq sa preku faqet, ballin e flokët me gishta. Doli nga kthina me drujtje dhe u ndal në krye të shkallëve. Një ndjesi e papritur ia shtangoi gjymtyrët. U mat të futej prapë në kthinë, të hiqte petkat e reja e të vishte petkat e zbërdhlyura. Në këtë çast dëgjo i zërin e Omerit që e thirri në emër. Ky zë u dha fund mëdyshjeve të saj. Zbriti shkallët dhe doli në oborr. Omeri dhe i ati ishin ulur në një trung. Të dy u befasuan, kur e panë. Jerina i ngjante një luleje që e kanë mbajtur brenda, në errësirë, larg ajrit të freskët e rrezeve të diellit dhe, me ta nxjerrë jashtë, gjallërohet e përtërihet.

— Ku do të shkojë kjo nuse që është veshur kë-shtu?

— Do të vijë me ne në mbledhje.

— Me ty le të vijë, por në një rrugë me mua jo!

Demushi shkundi çibukun dhe e mbushi prapë me duhan.

— Por në këtë mbledhje do të marrin pjesë të gjithë burrat e gratë e Gurajës.

— Atëherë aty nuk është vendi im!

Omeri u përpoq një copë herë ta bindte, duke i thënë se në këtë mbledhje do të flitej për ujët, do të bëhej një ndarje e re e tij. Ai duhej të vinte në mbledhje që ta ndihmonte. Demushit iu bë qejfi nga ky vlerësim i të birit, megjithatë nguli këmbë në të tijën: o ai, o e reja! Të dy nuk mund të shkonin bashkë në kuvend.

Në fytin e Jerinës u grumbullua një lëmsh dënesash. Që të mos shpërthente në të qara aty në mes të oborrit,

u kthye të futej në shtëpi. Sa bëri dy-tre hapa, zëri i Omerit e ndali në vend:

— Eja, Jerinë, se po bëhemi vonë.

Zëri i Omerit ishte krejt i qetë. Ai e kishte marrë me mend se kështu do të ngjiste.

Jerina shkoi pranë tij. Ajo nuk ia ndante sytë plakut të ulur mbi trung, që godiste me nervozizëm gurgacin që mbante midis gishtave. E ndiente veten fajto-re për këtë acarim midis Omerit dhe t'et. Padashur, ajo po futej prapë midis tyre si një mjegull e ftohtë dimri. E kuptonte se kjo gjë ishte edhe në dëm të saj.

— Po të mos marr unë me vete gruan time, nuk kam gojë t'u them të tjerëve, — tha Omeri.

I ati nuk i ktheu përgjigje. Ata kaluan bri tij dhe u larguan. Demushit iu mpi dora që mbante urorin, si ta kishte zënë ngërçi. S'ishte hera e parë që i biri po vepronte në kokë të tij, pa e pyetur atë...

Pasi i ra zemërimi, Demushi e ndjeu veten tepër të vetmuar. Vetmia rreth tij po bëhej e madhe, më e ftohtë, si një shtresë e ngrirë bore që mbështjell tokën në dimër. Për herë të parë në jetë dyshoi në mençurinë, në drejtësinë e gjykimeve të veta. E ka fajin koha, — tha me vete, duke ua lëshuar sytë maleve që rrethonin Gurajën. Atë çast edhe ato i dukën më të vjetruara e më të vetmuara, si vetë ai.

Kur arritën te Bliri i Madh, Omeri vuri re se aty nuk kishte ardhur asnjë grua e re. Midis burrave ishin disa plaka që pinin duhan e silleshin si meshkuj. Ishin gra të vetme, të mbetura vejake në moshë të re, që kishin humbur disa tipare prej femre. Ato kishin marrë pjesë gjithmonë në kuvendet e Gurajës dhe, megjithë-

se nuk u dëgjohej fjala, askush nuk e quante të tepërt praninë e tyre...

E mësuar me heshtjen, vetminë dhe mugëtirën e kullës, Jerina e ndiente veten si ai zogu që ka ndenjur për një kohë të gjatë në kuvli dhe, kur e lënë të lirë, ngjitet në një degë peme e vështron rreth e qark si i hutuar. Ajo i vidhte me cep të syrit ato fytyra, ku nuk shquante asnjë shenjë dashamirësie. Ato ishin të ftohta e të ashpra si gurët e palatuar të kullës. Edhe sytë e picërruar ngjanin me ato frëngjitë e ngushta e tinëzake të kullave, apo me vrimat e errëta që hapnin zvarranikët në tokë. I bëhej sikur nga çasti në çast prej këtyre vrimave të errëta do të nxirrte kryet ndonjë gjarpër e do ta çokaste në fytyrë.

Omeri e kuptonte gjendjen e rëndë të Jerinës, por nuk kishte si ta ndihmonte. Këto minuta që ajo po kalonte midis heshtjes e ftohtësisë, ishin të pashmangshme. Më vonë, pas dy-tre vjetësh, prania e grave në mbledhje do të bëhej diçka e zakonshme, që s'do të habiste dhe s'do të nervozonte asnjëri...

Fill pas Omerit te Bliri i Madh erdhën Kingji, Rama, anëtarët e këshillit e komunistët bashkë me gratë e tyre. Si Jerina, edhe ato ecnin në heshtje, me kokë të ulur, sikur po shkonin në ndonjë varrim, ose po kalonin përmes një fushe të minuar. Në vetëdijen e tyre logu i kuvendit kishte qenë gjithmonë një vend i ndaluar e tmerrues si log zanash. Ato u ulën pranë Jerinës dhe ndenjën një copë herë si të shtangura, mandej zunë të shikonin shoqja-shoqen herë me bisht të syrit, herë nën shaminë që u varej mbi ballë. Pak nga pak filloi t'u dilte druajtja, të çliroheshin nga ajo mpirje e pavullnetshme e çasteve të para. Prania e njera-tjetrës i ngrohte, u jepte siguri. Madje tashti u dukej sikur ishin bashkuar pranë një kroi, ose nën hijen e një lisi, ndanë një livadhi ku kishin mbledhur bar të prerë. Ato nisën të pëshpëritnin ndonjë fjalë me gjysmë zëri.

Të afërmit e krerëve të mëparshëm dhe fshatarët që e mbanin veten si dhjami i Gurajës, erdhën të fun-

dit. Ata zunë vend pranë e pranë, të heshtur, hije-rëndë, të gatshëm për të pritur çdo sulm që do t'u bëhej autoritetit dhe pronave të tyre. E kishin marrë vesh se do të flitej për ujët, por gjë të saktë nuk dinin. Çfarëdo udhe që do të merrte kuvendi, ata e kishin bërë me fjalë të mos lëshonin asnjë pikë ujë nga rendat e tyre.

Mbledhjen e hapi Omeri, si kryetar këshilli që sapo ishte zgjedhur. Kur përmendi fjalën «ujë», sytë e të gjithë fshatarëve u përqendruan te goja e tij. Për të kamurit ajo gojë e hapur u shndërrua befas në grykën e një kuçedre. Prej saj nuk dilnin fjalë të zakonshme, që i përdornin çdo ditë në bisedat e tyre, por flakë të nxehta që u zhuritnin arat, pemët e vreshtat, që u përcëllonin lëkurën e u digjnin mushkëritë... Omeri tha se ndarja e re e ujit duhej të ishte bërë qysh në pranverë, por edhe tashti nuk ishte aq vonë. Ishte mesi i korrikut. Me sa dukej, vera do të ishte e thatë dhe kushedi a do të binte shi deri në shtator.

— Dikush i ka ujitur arat e tij sa herë ka dashur, madje e ka lëshuar ujët edhe në pemëtore e livadhe, sepse e ka me të tepërt; dikush tjetër nuk ka shti në arën e vet asnjë pikë ujë. Kësaj padrejtësie do t'i japim fund. Uji do të ndahet sipas tokës së bukës që ka secili.

Këto fjalë e trazuan kuvendin si shtrëngata që vër-sulet mbi një pyll, duke fshikulluar gjethet, duke shqyer degët, duke përplasur kurmet e drurëve. Nga-do që hidhte sytë, Omeri haste në balle të vrenjtura, në vetulla të ngërthyera, në sy që lëshonin vetëtima zemërimi. Ishte një mlllef i grumbulluar nëpër shumë mote me thatësi e uri. Kishte rrezik që kuvendi të acarohet aq shumë, sa të niste përleshja. Mirëpo toka e tharë tani kishte nevojë për ujë, jo për gjak. Atij i shkuan sytë te Jerina dhe vuri re se ajo ishte zbehur.

Omeri kërkoi që të zbuteshin gjakrat, të shuhej shamata e të flisnin me radhë, pa të bërtitura, por zëri

i tij u tret në atë rrëmuje fjalësh e gjestesh kërcënuese si floku i borës që bie në zjarr. Folën edhe Kingji, Rama e disa komunistë, megjithatë zallamahia nuk u platit. Omeri ndjeu se si një shkulm gjaku i vërshoi në fytyrë. Në atë çast të rëndë mori automatikun në dorë dhe shtiu në erë. Në ajër u shpërnda duhma e athët e barutit të djegur dhe rrëmuja u shugat menjëherë, sikur tërë atë mori zërash ta kishte thithur toka e tharë dhe e plasaritur.

Sytë e Omerit takuan sytë e butë e të qashtër të Kingjit, të cilët nuk e kishin humbur kthjelltësinë as nga ethet e gjata të tifos, që e kishte zënë kur marshonin nëpër pyjet e Bosnjës.

— Mirë ia bëre, — tha Kingji, duke vënë buzën në gaz. Zgjati dorën dhe preku me gishtat e rreshkur automatikun që Omeri e kishte vënë para tyre.

Nga turma u ngrit Kurteshi trupmadh e me nofulla tepër të gjera. Të dukej sikur tërë ai njeri si lis mali ishte krijuar enkas për të vënë në lëvizje ato nofulla si mokra e për të bluar çdo gjë me to. Nga jaka e këmishës prej pëlhere të trashë vërshonin tufa qimesh të zeza e të dendura, që ngjiteshin deri poshtë mjekrës. Pikërisht për shkak të këtyre qimeve fshatarët e thërrisnin Kurtesh Arusha.

— A mos po don me na trembë me këto krisma?! — tha Kurteshi me një zë të mbytur, tamam si hungërimë.

— Nuk kam ndër mend të tremb askënd, — tha Omeri. — Vetëm dua t'ia sjell ndër mend atij që mund t'i ketë harruar krismat tona!

— Kanuni e ndalon të shtiesh me armë në log të kuvendit, — tha Kurteshi.

— Kanuni thotë se në kuvend flitet me radhë. Ja, po e nisim me ty, Kurtesh.

— Unë mendoj se, t'i marrësh tjetrit ujët e tij, kësaj i thonë grabitje ditën për diell!

— Por t'ia marrësh ujët atij që e ka grabitur, kësaj si i thonë?!

— Ata që kanë ujë, nuk e kanë grabitur, por e kanë blerë.

— E kanë blerë për një copë bukë, kur ndonjë fshatari po i vdisnin fëmijët urie.

— Ti mund të thuash çka të duash, por kjo është grabitje. Tjetër emër nuk ka.

— Kurse unë mendoj se kjo që do të vendoset sot në këtë kuvend do t'i japë fund edhe grabitjes, edhe padrejtësisë.

Kurteshi lëvizi nofullat si mokra dhe vështroi përreth duke kërkuar mbështetje, mandej u ul në vend.

Kaluan disa minuta pa folur askush. Omeri priste që të ngriheshin e të flisnin sidomos ata fshatarë që vuanin për ujë. Ai vinte re në sytë e tyre dhimbje dhe etje. Ata ishin gati të kacafyteshin, të vriteshin e të priteshin me kusarët e ujit, siç i thërrisnin në biseda me njëri-tjetrin, mirëpo, kur ishte puna të flisnin me gjakftohtësi për çështjen e ndarjes së ujit, për të drejtën e tyre, stepeshin menjëherë. Çfarë i ndrydhte?! Ç'ish-te ajo forcë që nuk i linte të ngriheshin?! Çfarë luhatej prapa atyre vështrimeve ku dridhej tërë gjegji i verave të Gurajës?...

Kjo gjë e tronditi Omerin. Në ndërgjegjen e fshatarëve ai ujë, për të cilin u pikonte zemra gjak, ishte pronë, trashëgimi, diçka e paprekshme. Ata ende nuk mund ta përfytyronin se ishin zotër të vendit, zotër të çdo gjëje. Duke qenë e pakapshme, kjo ide ishte për ta e pabesueshme, diçka e përgjithshme, pa ndonjë forcë vepruese në jetën e përditshme. Për ta ndryshimet e mëdha politike deri më sot kishin qenë vetëm ndërrime krerësh, nënprefektësh, prefektësh e qeverish...

Nga rrënjët e përdredhura të Blirit të Madh u ngrit një plak i moshuar që ngjante më tepër si një grumbull eshtrash. Ishte Prruk Moti.

— Kjo tokë është nëna jonë, — tha ai. — Buri-met dhe lumenjtë janë gjinjtë e saj. Qumështi i këtyre gjinjve u përket të gjithëve. Kështu e kuptoj unë punën e ujit.

— Tash je në breg të varrit! — tha Kurteshi. — Pse përzihesh në këto punë ti?!

— Në breg të varrit janë lakmitarët. Ia mbërrita kësaj dite t'i shoh kah u errën sytë e kah u dridhën buzët. Më vjen keq që nuk është gjallë edhe Ibër Shpata... Ju e latë të vdesë në skamje e në dëshpërim atë njeri që shkriu jetën e vet për të mirën e Gurajës, për ujët e arave tona.

Përmendja e emrit të Ibrës shkaktoi një trazim në vetëdijen e fshatarëve. Omerit iu përhi në kujtesë fytyra e tij e plagosur nga gurët. Lufta për ndarjen e drejtë të ujit iu duk edhe si nderim që i bëhej vetëmohimit të tij, përpjekjes së tij mbinjerëzore për të shpëtuar Gurajën nga thatësira dhe uria....

Folën disa të rinj, moshatarë të Omerit. Të gjithë kërkuan me ngulm që ujët të ndahej sipas tokës «nën ka» që kishte çdo fshatar. Kundërshtarët e këtij mendimi thanë se kjo gjë ishte kundër kanunit të vendit.

— Vërtet është kundër kanunit të vjetër, por pajtohet më së miri me drejtësinë tonë, — tha Kingji.

— Për cilën drejtësi e ke fjalën? — tha Kurteshi që s'e zinte vendi dhe i vinte ta gërvishte tokën me thonj si bisha që ka rënë në lak.

— Për drejtësinë e këtij! — tha Kingji duke goditur me shuplakë automatikun. — Me këtë viran e fituam drejtësinë tonë dhe po me këtë do t'i dalim zot.

E morën fjalën edhe fshatarë të tjerë. Disa i ngatërronin mendimet aq shumë, sa ishte e vështirë të kuptoje se çfarë donin të thoshin. Kishte edhe fshatarë të këputur, që po ua përcëllonte zhegu arat e prapëseprapë u dilnin për zot të pasurve. Omerit i vinte të hante veten me dhëmbë, kur i dëgjonte fjalët e tyre. Atë çast gati ndiente një urrejtje më të madhe për këta, sesa për të pasurit që e kundërshtonin me ashpërsi ndarjen e re të ujit, kufizimin e pronës së tyre.

Duke i ndjekur me vëmendje të gjithë ata që flisnin, Omeri u bind se kundër ndarjes së re të ujit do të ishin mjaft fshatarë. Po të hidhej poshtë kjo ndarje,

do të dëmtoheshin varfanjakët dhe pushteti i ri. Ndërsa luhatej midis mendimeve të ndryshme, sytë i vajtën prapë te Jerina. Nuk ishte aq e frikësuar, e nemitur si më parë. Diçka foli me një shoqe, buzëqeshi dhe në faqe iu formuan ato gropëzat e vogla si e futura në majë të mollëve të pjekura.

Jo, nuk duhet të druhem, — tha me vete Omeri. — Ato do të votojnë për ndarjen e re të ujit. Jam i bindur për këtë si vdekja!....

Të parët që ngritën dorën për ndarjen e ujit qenë Prruk Motti, gurajasit që kishin punuar në kanal dhe gratë. Fshatarët e tjerë vështronin rreth tyre, mandej e ngrinin dorën me ngurrim, sikur po qëllonin dikë. Dhe vërtet ato duar të ngritura Omerit i dukeshin si thika që po godisnin në zemër padrejtësinë e të keqen, thatësirën dhe urinë e fshatarëve pa ujë. Të pasurit rrinin kokulur, me duar të mbështetura mbi gjunjë, me gishta të kapërthyer nga ngërçi i mllefrit dhe i lakmisë.

Omeri nxori nga xhepi listën e të gjithë kryefamiljarëve të fshatit, ku ishin shënuar toka e punueshme dhe sasia e ujit që i takonte secilit. Gjatë leximit të kësaj liste nuk pati as pipëtimën më të vogël. Ajo mbledhje e zakonshme nën degët e Blirit të Madh i ngjante më tepër një seance gjyqësore, ku po dënohej me vdekje një pjesë e të kaluarës së Gurajës.

Për të zbatuar këtë vendim, u caktua një komision ku bënë pjesë tre burra e dy gra. Është e vërtetë se ato ishin gra vejane e të plakura, por sidoqoftë ishte e para herë që femra merre pjesë në një komision. Kjo gjë e shtoi edhe më shumë acarimin e parisë, e cila e ndiente veten të cënuar dyfish: në pronën e në se-drën e saj.

Kur u miratua komisioni i ujit dhe Omeri deshi ta mbyllte mbledhjen, u ngrit në këmbë Keqa, me këmi-shën tërë arna. Omeri e dinte se ai ishte ndër fshatarët më të vuajtur e më të varfër të Gurajës. I bëri përshtypje që ai votoi edhe kundër ndarjes së re të ujit, edhe kundër komisionit.

— Kjo punë që keni ndër mend të bëni, do të na marrë në qafë! — tha Keqa me një zë të thekshëm. — Pse do të na marrë në qafë? do të thotë ndokush. Ja, po jua them unë psenë.... Duke marrë ujë të gjithë, asnjëri s'do të ketë ujë të mjaftueshëm. Ne që s'e kemi bërë kurrë bukën në arat tona, nuk do të kemi asnjë fitim nga kjo punë. Ata që bënin drithë për vete e për të shitur, mezi do të plotësojnë nevojat e tyre. Deri tash ne, skamnorët që mbeteshim keq, shkonim për të blerë ose për të lypur tek ata që kishin. Tash e mbas s'do të ketë kurrkush. Të gjithë do të vuajnë për bukë. Ja, pra, cila është «leverdia» e ndarjes së re të ujit!...

Fjalët e fundit i tha me shpoti e duke u skërmitur. Omeri e shikonte me përbuzje dhe keqardhje njëherësh. I paguar, — mendonte ai. — I shitur krejt lirë, për disa kile drithë. Për ato kile drithë ishte gati të shiste të ardhmen e tij e të fëmijëve. Po mendonte se si t'i përgjigjej pa e fyer, por u ngrit në këmbë një nga gratë që ishte caktuar në komision.

— Në qoftë se ky ujë i duket harram, le të mos e marrë. Keqa është mësuar të lypë e, pasha bukën, po t'ia heqim lypën, nuk i vjen mirë!

Shumë vetë qeshën me këto fjalë, mirëpo Omeri nuk qeshi. Tashti jetën e fshatit dhe vetë fshatarët, të cilët i dukej se i njihte mirë, po mësohej t'i shihte me një sy tjetër. Papritmas po zbulonte gjëra që më parë as që i kishin shkuar në mendje.

Ai kishte besim se do të vinte një ditë kur në Gurajë do të harroheshin edhe zia e bukës, edhe thatësira. Sigurisht deri tek ajo ditë ishte një rrugë e gjatë dhe e vështirë, që do të çante jo vetëm përmes urrejtjes së Kurteshit, por edhe përmes mosbesimit të Keqës...

Ndarja e re e ujit i bëri Omerit shumë armiç. Në sytë e krerëve të mëparshëm, që deri dje bënin ligjin në Gurajë, po shtoheshin xixëllimat e mërisë e të

zemërimin si xixat që shkrepin nga një copë stralli, kur e godet me mllef një dorë nervoze. Por tamam këto xixëllima ishin për të shenja më e sigurt se po ecte në rrugë të drejtë.

Megjithëse ujët nuk ishte i mjaftueshëm, duke ujitur ditën e natën, duke përdorur me kujdes të madh çdo pikë ujë, atë vit nuk u shkul asnjë arë në Gurajë. Prodhimi i atyre që kishin pasur shumë renda uji, u pakësua, por ata që i shkullnin misrat pa lidhur kokërr ose mernin prej tyre disa kallinj me kokrra të rralla, arritën të bënin bukën e disa muajve. Thatësira që po largohej këmbë-këmbë nga arat e Gurajës, po strukej në sytë e mrrolur të Kurteshit e të shokëve të tij. Omeri e dinte se edhe në këto vise thatësire mund të binte zjarr.

Gjatë gushtit retë u grumbulluan disa herë në qielin e Gurajës, të shoqëruara nga vetëtimat të largëta e nga bubullimat të shurdhëta, që humbisnin në skaj të horizontit si zhapij të verdhë. Ato nxiheshin, kacafyteshin me njëra-tjetrën, uleshin aq poshtë, sa gati ciknin çatitë e nxehura të fshatit, mandej largoheshin drejt lindjes si të rrëmbyera nga një trill i çuditshëm dhe e derdhnin shiun e tyre mbi arat, livadhet e djezrrinat e Breglumit që s'kishte fare nevojë për të.

Këtë lojë të reve disa fshatarë e lidhnin me ndarjen e re të ujit. Ata e quanin si një ndëshkim të zotit, për shkak se Guraja kishte prishur kanunin e lashtë të ujit dhe kishte nxjerrë ligje të reja. Kishte fshatarë që bënin bé e rrufe se kishin parë te mali përtej fshatit një kuçedër me shtatë krerë që hurbte retë, ua merrte shiun dhe e derdhte mbi Breglum...

Sytë e fshatarëve ishin mbërthyer te një pikë: tek ujët e kanalit që vinte nga Ujëbardha. Kanali ishte bërë strumbullari i kësaj bote të vogël e të shqetësuar. Urëve të ankthit e të sherreve u frynin me tërë bulçitë kundërshtarët e ndryshimeve të reja që po ndodhnin edhe në Gurajën e mënjanuar e të harruar nga qielli e toka, siç kishte qenë deri tani. Më të pezmatuarit ishin ata që kishin humbur renda uji. Ata e shikonin kanalin si bisha e varruar rëndë, që sheh currilin e gjakut jetëdhënës duke rrjedhur nga trupi i saj. Kishte diçka jonjerëzore në ata sy të kuqërruar, ku përpilitej lakmia. Sado që komisioni e shpërndante ujët me përpikëri, siç ishte vendosur më parë, ngatërresat ishin të shpeshta.

Kishte kaluar dreka dhe Kurteshi nuk kishte dalë ende nga ara për të ngrënë bukë. Djemtë i kishin thënë diça herë të hante e të pushonte pak. Ai mezi po mbahej në këmbë dhe herë pas here mbështetej në bisht të shatit për t'u mbushur me frymë... Kur e pa se s'mund të qëndronte më pa ngrënë, ua la ujët të bijve dhe doli në stom të arës. Që andej dukej ara e fqinjit të tij, me të cilin e kishte ujët atë ditë.

Prej kohësh ajo arë ia acaronte nervat dhe ia prishte gjakun. Nuk e linte të qetë as në gjumë. Një natë kishte parë një ëndërr të ligë me këtë arë të mallkuar. Ai po ecte ndanë saj për të vajtur tek ara e vet, kur papritur ajo lëvizi nga vendi e u turr drejt tij, duke tundur kërcënueshëm shpatat e gjelbra e të mprehta të bimëve të misrit. Ishte si një bishë me qime të kërcleshura që e ndiqte këmba-këmbës. Ai përpiquej të bërtiste, të kërkonte ndihmë, por nuk nxirrite dot asnjë fjalë të vetme nga goja. Kështu vrapoi gjatë-gjatë nëpër një tokë gurishtore, që ia digjte shpu-

tat e këmbëve dhe ia gjakoste pulpat e kërcinjtë me ca gjemba të tharë e të fortë, si të ishin prej kocke. Kishte frikë ta kthente kokën prapa, sepse ishte i bindur që majat e gjetheve — shpata do t'ia çanin bebëzat e mishrat. Gojën e kishte të hidhur e të thatë, si të kishte gëlltitur hi të nxehtë. Më në fund kupat e gjunjëve iu thyen dhe ai u plandos përtokë, në një hurdhë tërë llurbë...

I doli gjumi idhshëm. Ishte djersitur. Nuk fjeti më. Vajti në oborr, ku ishte disi më freskët, dhe ndënjë aty, derisa u zbardh, duke i ndezur cigaret te bishti i njëra-tjetrës. Këtë ëndërr nuk ia tregoi asnjëriu. U mundua ta harronte edhe vetë, por kjo gjë ishte e pamundur. Madje sa më fort që ngulmonte ta hiqte nga mendja, ajo rrasej më thellë në vetëdijen e tij. Eh, ç'kohë që kishin ardhur! Kohë të zeza, kohë që të marrësnin!...

Kurteshi ishte betuar me vete të mos i hidhte sytë nga ajo arë që ishte bërë hasmi i tij më i keq, pika e tij e dobët. E megjithatë nuk i bëri dot ballë tundimit. Në fillim e pa me cep të syrit, mandej e humbi zotërimin e vetes: u kthye i tëri nga ara e fqinjët me fytyrë të zbehur e me vetulla të mrrolorura. Iu duk sikur këto ditët e fundit bimët e saj ishin ngjitur në qiell. More edhe te dielli do të arrinin, po të rriteshin ashtu siç ia kishin nisur! Do t'ia zinin diellin arës së tij dhe atij vetë! Kësaj are pa të korra, ku drapri përdorej vetëm në vitet me shira të shpeshta, i ndërrohej fara vit për vit. Një natë me hënë, i zoti i saj «i kishte lënë mushkëritë» në kodrat me dëllinja të kufirit, me një thes plot misër në shpinë. Nuk dihej me siguri nga kush ishte vrarë: nga ushtarët e mbretërisë së andejme, apo të këndejme. Atë vit kjo arë ishte mbjellë me farë të lypur derë më derë nëpër Gurajë.

Kurteshi ishte i bindur se Gecin e priste vdekja te kodrat me dëllinja të kufirit, ashtu si babanë e tij, kështu që ara do t'i mbetej atij. Kjo ëndërr u shndërrua në një dëshirë të zjarrtë, që e mundonte vazhdimisht. Ai edhe mund ta vriste Gecin, — kjo ide kishte

shkreptirë disa herë në vetëdijen e tij si vetëtima në një natë stuhie, — por trembej mos i dilte krimi në shesh dhe atëherë do të humbiste edhe ato prona që kishte: fisi do ta digjte e do ta dëbonte nga Guraja. Ai priste që këtë punë ta bënin plumbat e mbretërive — për të s'kishte rëndësi se cila! — ose uria, ose ndonjë sëmundje që herë pas here vërsulej në Gurajë dhe hapte dhjetëra varre përnjëherësh.

Mirëpo kjo pritje kishte një kufi: ky kufi nuk ishte aspak vdekja e Kurteshit, jo, jo, ishte diçka më e tmerrshme: martesë e Gecit! Megjithëse po vdisnin për bukë e u kishin mbetur pak dhi e një lopë, e ëma e Gecit kishte shitur lopën dhe petkat e veta të nusërisë për t'i zënë një nuse të birit. Përgatitja e pajës do të kushtonte shumë më tepër...

Kurteshi që rrinte në përgjim si merimanga në qendër të rrjetës së saj, kishte menduar se tani ishte rasti më i volitshëm, për të përmbushur dëshirën e vjetër. Ishte orvatur ta blinte arën me një çmim të ulët. Mirëpo, edhe kur e kishte rritur mjaft këtë çmim e ëma e Gecit — Kurteshi nuk mund ta harronte shkëlqimin e syve të saj prej ujkonje! — i kishte thënë se më parë do të shiste sytë e ballit, mandej arën e djalit.

Atij i ishte kujtuar atë çast shtrëngata e madhe që kishte ndodhur para disa vjetëve. Ajo grua thatime që të dukej sikur atë grimë shpirt, ashtu si palcën, e kishte diku në fyellin e kockave, ishte shtrirë ndanë kanalit të çarë, për të mos e lënë arën të gërryhej nga ujërat e të mbulohej me zall. Ajo nuk do të ma shiste arën, edhe po t'i jepja tërë paret e botës! — kishte shfryrë me vete Kurteshi.

Megjithëse vajza ishte zënë prej vitesh, dita e dasmës nuk ishte caktuar asnjëherë. Kurteshi kishte shpresë se ajo ditë nuk do të vinte kurrë. Kjo arë pranë tokës së tij do t'u përkiste djemve të Kurteshit. Apo s'i kishte Kurteshi tre djem si tre ujq që i kishte frikë edhe toka, kur e shkelnin me këmbë!

Ndërsa Kurteshi ëndërronte për vdekjen e Gecit dhe shuarjen e zjarrit të tij, në këtë botë ndërruan shumë

gjëra. Djali i madh i Kurteshit u vesh milic dhe për pak sa nuk hëngri plumb kokës nga partizanët. Me të nuhatur se pushtuesve po u vinte fundi, iku nga nënprefektura dhe erdhi në Gurajë, duke u betuar se ishte mashtruar nga propaganda e fashistëve...

Geci jo vetëm nuk vdiq, por mësoi të lëronte, të prashiste e të ujiste. Asnjë vit nuk e la djerrë arën e tij, sado që mbillte misër e korrote kashtë, si i ati. Tani, me pushtetin e ri, koha filloi të punonte për Gëcin e për shokët e tij. Para një jave Kurteshi hasi në rrugë nënën e Gecit. Deshi t'i bënte lak e të futej pas gardhit me kulpra e kulumbri, por ajo e thirri në emër.

— M'u rrit djali, — i tha. — Këto ditë m'i mbushi të gjashtëmbëdhjetë vjetët. Në vjeshtë, në qofsha gjallë, do t'ia sjell nusen te shtëpia.

O, se si qeshnin ata sytë e saj! Kurteshit iu duk sikur ato bebëza ishin grumbuj prushi, ku po digjej e venitej ëndrra e tij për t'u bërë zot i arës që e kishte tunduar një jetë të tërë e do ta sfiliste edhe pas vdekjes, në jetë të jetëve. Nuk mundi t'i thoshte një fjalë të mirë, ta uronte atë grua të gjorë, që ndoshta e kishte pikasur lakminë e tij.

— Paj, sikur s'po më duket kohë dasmash! — i tha Kurteshi.

— Besa, për ne kjo kohë është dasmë e përtej dasme, more Kurtesh! — i tha ajo, duke tundur kryet e duke qeshur. — Sivjet arën e kam më të mirë se kurrë e me ujët që më dha pushteti, nga dy kallinj për bimë do të bëjë. Edhe rrushi ka më shumë kalaveshë se gjethe. Më mban shpresa se në këtë dasmë do të ha bukën time e do të pihet rakia ime!...

Heu, të preftë ujku rrugën, të preftë! — tha me vete Kurteshi kur u nda prej saj. Ku më dole përpara, dreq i mallkuar!... Iu fry delli në ballë e gati iu zu fryma nga mllefi.

Ky mllef i ri grumbullohej brenda tij dita-ditës, siç grumbullohet qelbi në çibanin e enjtur. Pa u kup-

tuar po afrohej çasti i shpërthimit: ai do të ndodhte vetvetiu, ose nga një shkak fare i rastit...

Duke vështruar ngultas arën e Gecit, nën atë diell zharitës e lëbyrës ndjeu një marramenth të lehtë. Në ajër tundeshin si shtiza kallëzat e bimëve, ku po ujitin Geci dhe e ëma. Kurteshi mati me sy pjesën e ujitur të arës së fqinjit dhe të arës së tij. Një mendim i vetëm iu ngul në kokë: «Te presa!»

Meqë nuk kishte shat me vete, shkuli me duar gurë, plisa, rrënjë e ç'i doli përpara dhe e ktheu tërë ujët nga ara e tij. Që të mos rridhte asnjë pikë e vetme për tek ara e Gecit, i ngjeshi baltën e plisat me shkelma. U bë një grumbull dheu që i ngjante një varri fëmije. Duke e ngjeshur me këmbët e mëdha si rrëputa¹ ariu, Kurteshit i bëhej sikur po ngjeshte pikërisht dheun e varrit të Gecit. Nuk do të kishte më dasmë, s'do të kishte klithma fëmije në shtëpinë e tij dhe ajo arë që e kishte lakmuar vite me radhë, do të merrte emrin e të zotit të ri: ara e Kurteshit!

Vija që shkonte në arën e fqinjit mbeti krejt e thatë. Ai u ul nën një frashër, disa hapa larg presës. Tashti e ndiente veten më të lehtësuar, më të shtendosur dhe koka i dhimbte më pak...

Geci u ngjit te presa gati pa frymë. Mbeti i habitur, kur pa se tërë ujët ishte kthyer nga ana e arës së fqinjit. Shikoi rreth e rrotull dhe vuri re Kurteshin në hije të frashrit.

— Kush e ka kthyer ujin andej?

— I zoti i ujit!

Geci e çau sfracin me shat dhe e ktheu gjysmën e ujit në vijën e tij. U nis poshtë. Kurteshi erdhi te

1) putra

presa dhe e mbushi prapë sfracin e çarë me gurë e me plisa. Edhe Geci u ngjit prapë te presa. Ata u panë sy ndër sy. Shikimet e tyre të ashpra u përplasën si stralli me urorin. Kur Geci e qëlloi sfracin me shatë, sytë e Kurteshit u vërtitën brenda zgavrave si dy merimanga të shqetësuar.

— Kopil!... Farë e keqel!... Lypës!...

Sharjet dilnin nga buzët e Kurteshit si shuk gël-baze. Ai thërriste sa i punonte zëri.

— Ti na ke vjedhur ujët dhe na ke pirë gjakun! Të ka vënë qafa dhjamë si thiut!

— Nuk është burrëri të rëndoni njëri-tjetrin me fjalë! Burrat kanë nder e nuk shajnë si gra të këqija, — tha Demushi që po kalonte atypari.

I xhindosur nga fjalët e Gecit, tamam si një gjar-për që e ngacmon dikush, Kurteshi rrëmbeu një gur me thepa dhe e gjuajti me të. Geci e ndjeu fishkëllimin e gurit në ajër dhe u shmang nga presa. Guri u rropos në kanal, duke hedhur rreth e rrotull stërkala uji e zllapa lluce. Ngaqë i dha gurit me tërë forcën që kishte, Kurteshit i shkau këmba e ra prap-tazi. Geci iu afrua me shat në dorë. Fytyra po i digjej flakë. Qëndroi një hap mbi Kurteshin që shkumëzonte si ujk i tërbuar. Edhe qimet e zeza e të dendura rreth qafës dukeshin si një shkumë e zezë që i dilte nga trupi.

— Qëllo, o lypës, se të erdhi dita!

Geci e largoi shatin.

— Jo, nuk do të vdesësh nga unë, por do të të lë të ngordhësh vetë, — i tha. Shkoi te presa dhe e ndau ujët përgjysmë.

Kurteshi zbriti te kanali, eci disa hapa buzë tij, gjeti një vend ku bregu i kanalit ishte i hollë dhe nisi ta shembte me këmbë e ta shqyente me thonj. Nga gishtat i rridhte gjak, por ai nuk ndiente dhimbje...

Thirrjet dhe sharjet e Kurteshit i dëgjoi tërë lagj-ja. Megjithëse ishte zheg i madh e secili ishte i zënë me punë, brenda pak kohe te presa u mblodhën disa

fshatarë: dikush për të ndalur sherrin, dikush për të parë ndoshta edhe gjak.

Demushi e kishte kapur Kurteshin për krahu dhe po mundohej ta zbuste. I dha kutinë e duhanit. Kurteshi drodhi një cigare me gishtat që i dridheshin, e ndezi në bishtin e cigares së Demushit e sikur u qetësua.

Djemtë e Kurteshit e rregulluan buzën e she-mbur të kanalit. Rama, kryetari i komisionit, lëshoi në kanal një gjethe lisi, të cilën rryma e mori me vete dhe e çoi te guri që ndante ujët përgjysmë.

— Pse grindesh, Kurtesh? — i tha Rama. — Ka ujë për të dy.

— Unë kam pasur tre renda ujë, ky s'ka pasur asgjë! Sot ka marrë ujë më shumë e ka ujitur më shumë se unë. Po të kishte qenë kohë tjetër, s'do të kishte futur pikë ujë në arën e tij!

— Besa, kur s'kishte ç'ta bënte ujët, Kurteshi e pikëtonte në livadh e nuk ia jepte kujt!

— Sa të jem unë gjallë, nuk jua lë ujët, veç kur të ma marrë me zor ai brinoçi, që ka këmborën në dorë e nxjerr kanune të reja...

Fshatarët u kthyen në punët e tyre. Demushi e përcolli Kurteshin deri në shtëpi. E dinte se kjo gjë do ta zemëronte të birin, por atij i dukej sikur pikërisht për hir të tij duhej të vepronte kështu. Duke u munduar që ta qetësonte Kurteshin, pandehte se ia largonte të birit një rrezik, ia zbuste një kundërshtar.

Gurajasi mbanin shpresë se në të ndërruar të hënës do të ndërronte edhe moti e do të binte shi. Por hëna e kuqërremtë shfaqej në qiellin e rimitë si një potkua i skuqur në prushin e një farke të ndezur diku prapa vargmaleve. Pas netëve me zabullimë, vinin ditët përvëluese me një diell të fortë, që dukej sikur nuk derdhte hapësirave rreze, por kallaj të shkrirë.

Megjithatë arat e Gurajës nuk e humbën ngjyrën e gjelbër dhe qumështi i kokrrave filloi të trashej e të miellzohej. Kanali që vinte nga Ujëbardha, ishte

kërthiza që i mbante gjallë arat e fshatit, ku përhapej, si gjak i nënës në trupin e fëmijës, uji i kulluar e i ftohtë i bjeshkëve. Sytë e Gurajës ishin të qetë. Buka po bëhej...

Ata që kishin radhën për të ujitur, kujdeseshin që të mos humbiste gjatë rrugës asnjë pikë uji. Ai që ruante kanalin, hidhte ndonjë plis tek ama, mbyllte ndonjë vrimë që mund ta kishte çarë ujët në atë stomaq të gjatë, ose nxirrte ndonjë gurë të rrokullisur nga shpatet e malit.

Kur zbriste në Breglum, Ujëbardha i ngjante një gruaje që ka lindur disa herë, i janë zgjeruar këllqet dhe i janë trashur gjymtyrët, kështu që e ka humbur hajthmërinë dhe zhdërvjelltësinë vajzërore. Gjatë rrjedhës së gjerë e të ngadaltë kishte va të shumtë, ku fëmijët ndërtonin me gurë prita në formë koni. Në majë të këtij «koni» vendoseshin kosha të dyfishtë ku futeshin peshqit e trembur me shkopinj nga fëmijët.

Trumba e fëmijëve që u turr drejt vaut me shkopinj në dorë mbajti këmbët pranë sfracit me gurë të bardhë. Në pellg, ndanë lumit pluskonte një trup i gjatë. Ata pandehën se mos ishte ndonjë kryemadhë¹⁾ e vrarë me dinamit ose me pushkë, që e kishte marrë rrjedha e rrëmbyer dhe e kishte sjellë në atë vend. Ata nuk i ndienin as shpimet e guralecave, as stërkalat e ftohta që u ngjiteshin deri në supe: rendnin kush e kush të arrinte i pari te peshku gjatosh, që ishte sa një trup njeriu.

Rrëmuja e zërave dhe rrokopuja e ujit pushoi papritmas. Fëmijët u stepën në mes të pellgut. Ata vunë re flokët e verdhë që luhateshin nga rryma dhe e kup-

1) lloj peshku

tuan se aty ishte një njeri i mbytur. Trupi i të mbyturit ishte thuajse lakuriq, sepse e kishin zhveshur dallgët e rrëmbyera të lumit.

Me po atë vrull që kishin ardhur drejt pellgut, fëmijët rendën në fshat. Brenda disa çastesh tërë Breglumi e mori vesh se një i mbytur gjendej në një pellg, në mes të fshatit të tyre...

Të shtyrë nga kërshtëria, por edhe nga keqardhja, te pellgu ia behën shumë vetë. Dy burra e nxorën të mbyturin nga uji dhe e shtrinë në rërë. Një grua që e kishte shtëpinë afër lumit, solli një plaf e ia mbuloi trupin me të.

Megjithëse ishte mbufatur nga ujët dhe ishte goditur nëpër gurë, tiparet e të mbyturit dalloheshin mirë. Një burrë që e njohu, tha se ishte nga Guraja dhe përmendi emrin e babait të tij. Fytyrat e breglumasve u mrrolën menjëherë si të kishin dëgjuar ndonjë lajm kobzi për fshatin e tyre. I larguan që andej fëmijët e gratë. Mbetën vetëm burrat. Ata shikonin herë njëri-tjetrin, herë të mbyturin.

— I mbyturi u gjet në mes të katundit tonë. Si t'ia bëjmë?

— Kur të marrë vesh Guraja, ta dini se fajin do t'ia ngjithë katundit tonë!

— Ta hedhim prapë në lumë që ta marrë ujët me vete.

— Po gratë e fëmijët që e kanë parë?!

— Lumi ka sjellë gjithmonë në katundin tonë njerëz të mbytur.

— Por ky nuk është i mbytur: është i vrarë!

— Ku e di ti?

— Ia pashë kokën prapa. E ka të çarë rrashtën. Në kraharor ka disa varrë thike.

— Edhe mua më shkoi në mend se atë e ka vrarë dikush.

— E si thoni t'ia bëjmë, pra?

— S'na mbetet shtegdalje tjetër, veç t'i çojmë fjalë t'et. Kjo është puna më e mirë, më e arsyeshme.

— Ashtu është, por ta mbani mend se kjo kufomë do të na kushtojë shtrenjtë. Shpejt do t'ia shohim sherrin...

Atë ditë që Shpendi u gjet i vrarë në Breglum, në një pellg të Ujëbardhës, u mor vesh se ishte shembur muri që e kthente ujët e lumit në kanal. Këto ngjarje e malcuan përsëri mërinë e vjetër midis të dy fshatrave. Një urrejtje e furishme, si flaka që përfshin një çati të vjetër me dërrasa pishe, u ndez në parzmin e gurajasve që besonin se Breglumi kishte gisht në dy krimet e tanishme.

Përplasja midis Gurajës e Breglumi dukej e pashmangshme si rënia e frutit të pjekur në tokë. Por fruti i kësaj armiqësie të re do të ishte i përgjakshëm. Këtë gjë e kishin të qartë të dyja palët. Sapo muzgej, breglumasit i lëshonin qentë e hekurave, mbyllnin dyert me shula të trashë dhe përgjonin te frëngjitë e kullave.

Disa gurajas kishin vendosur të hakmerreshin pa u vonuar. Ata kishin blerë vajguri, kishin grumbulluar pisha e lecka që do t'i përdornin për t'u vënë zjarrin shtëpive, pojatave të bagëtive, mullarëve të sanës e të jonxhës. Madje ata do të merrnin me vete edhe sëpata për të prerë pemë e hardhi, kur breglumasit të përpiqeshin për të shuar shtëpitë e ndezura flakë.

Këto përgatitje kryheshin me fshehtësinë më të madhe. Njerëzit e pushtetit dhe komunistët nuk kishin dijeni për to. Ata ishin të zënë me ndjekjen e bandave që vërtiteshin nëpër male dhe me punë të tjera. Hakmarrësit ishin njerëz të rrëmbyer, mllëftarë, që e kishin në gjak kanunin. Ideja e shpagimit i kishte dehur, i kishte bërë si të ndërkyer. Ata u ruheshin Omerit, ko-

munistëve dhe anëtarëve të këshillit po aq sa breglumave. Ishin betuar të merrnin hak, t'ia përcëllonin minjtë Breglumit, mandej le të bëhej ç'të bëhej!...

Omeri kishte shkuar në qendër të rrethit, në një mbledhje. Gurajasit e përbetuar e kishin të qartë se ky ishte rasti më i mirë për të kryer sulmin e tyre. Ata vendosën që qysh atë natë qiellin e Breglumit ta përcëllonin flakët e zjarrit. Pasi i tregoi se çfarë kishin ndër mend të bënin, një kushëri e ftoi Gecin të bashkohej me grupin e hakmarrësve.

— Do të mendohem, — tha Geci, i zbehur në fytyrë. — Nuk është punë me luejtë...

— Harrova se ti je djalë nëne, jo djalë babe! — i tha kushëriri për ta prekur në sedër.

Geci nuk iu përgjigj. Ai përbluante mendime të tjera. Vështroi diellin. Po, duhej të bënte diçka pa humbur kohë! U nda nga kushëriri dhe vajti te Kingji, të cilit ia kallëzoi një për një fjalët që i kishte thënë kushëriri. Edhe Kingji u trondit nga ky lajm. Ai i gjeti Gecin një kalë edhe e nisi menjëherë të lajmëronte Omerin.

Derisa kaptoi shtëpitë e fundit të Gurajës, Geci e ngau kalin nëpër një shteg që kalonte midis luginave të vogla e prozhmeve. Vështroi diellin me shqetësim. O, sa shpejt po rrokullisej nëpër fushëtirën e kaltër të qiellit rrotullaku i tij i skuqur! Ai e godiste me thembra në ije kalin e ri që i vezullonte qimja nga djersa...

Breglumasit që përgjonin te frëngjitë e kullave, u tronditën nga troku i papritur që trupoi fshatin e tyre në mes të natës. Ata e dalluan se kalorësi nuk vinte nga Guraja dhe u qetësuan.

Omeri vështroi hënën që dukej e zhdukej midis

degëve të drurëve, sikur po ia bënte me sy. Qëkurse ishte nisur nga qendra e rrethit, ai e dinte se ishte në garë pikërisht me këtë hënë të kuqërremtë. Me të perënduar hëna, mund të fillonte përleshja midis gurajasve e breglumasve, në errësirën e natës, nën dritën e pishtarëve e të flakadanëve. Omeri i la prapa shtëpitë e Breglunit dhe u nis rrugës që të çonte në Gurajë. Ai nuk e goditi më kalin me shpore, por e la të ecte me hap. Hëna kishte edhe dy pushkë të gjata pa rënë prapa maleve.

Tani që Omeri po ecte me ngadalë, diçka tjetër ngiste linkthi: mendimet. Filloi ta brente ndërgjegjja që s'ia kishte thënë tërë të vërtetën një shoku të tij që punonte në SMP¹. Ai e kishte këshilluar të mernte dikë me vete, por Omeri nuk kishte pranuar. Ç'kishte qenë ai mendim që e kishte penguar: Të mos i dalë zëri i zi Gurajës!

Nëse ai nuk do ta shmangë dot të keqen — hakmarrësit mund të kenë edhe armë, — a nuk do të poshtërohet Guraja njëqind herë më tepër?! Mandej vetë ky kujdes për të ruajtur namin e Gurajës, a nuk ishte një ndienjë e sëmurë për t'i veshur fshatit të tij atë që s'e kishte, për t'ia hedhur gunën së vërtetës?! Në fund të fundit Guraja ishte Gurajë! Në të kishte njerëz të mirë, por kishte edhe ngatërrestarë. Madje kishte edhe armiq, si në çdo fshat tjetër. Kjo e vërtetë as nuk e njolloste, as nuk e poshtëronte...

Edhe pse këto mendime i luzmonin në kokë, Omeri ishte tërë sy e veshë. Përgjonte për të dalluar ndonjë hije a zhurmë sado të vogël te kuçubat buzë rrugës.

Sa kaptoi një bregore të mbuluar me dëllinja, i ra në vesh një krismë metalike. Krisma erdhi nga një shkurnajë që nxinte në të djathtë të rrugës. Ishte krisma e një teneqeje me vajguri, që ishte përplasur pas gurëve...

Omerit i hipi gjaku në kokë. Pa menduar se ç'do

1) Seksioni i Mbrojtjes së Popullit

të bënte më tej e ç'do të thoshte, ngau drejt shkurnajës. Hakmarrësit u stepën pas gurëve e trungjeve, ose u strukën në gëmusha.

— Ngruhuni në këmbë, se e di kush jeni dhe ç'keni ndër mend të bëni! — thirri Omeri. Zëri i tij ishte i ashpër. Hakmarrësit i zuri në befasi edhe ardhja e Omerit, edhe tërsëllëmi i tij. Disa prej tyre u ngritën në këmbë.

— Ti s'ke të drejtë të na dalësh përpara dhe të na pengosh!

— Ata janë ballistë e zogistë! T'i djegim në zjarr ata dhe minjtë e tyre!

— Ata na vranë Shpendin dhe na prishën kalinin!

— More, ata na kanë vënë zjarrin gjatë Luftës!...

Omerit i oshëtinte koka nga britmat e tyre. I zbriti kalit dhe u afrua. Sytë e fshatarëve të etur për hakmarrje gacullonin si urë të ndezura që i tund dikush së largu... Le të flasin, mendonte ai. Kështu do të shfryjnë në një pjesë të mllefrit dhe mynxyra do të shmanget.

— Ata na kanë përbuzur tërë jetën!

— Harrove se ata të kanë përbuzur edhe ty?! I ati i gruas sate s'ka pranuar të pajtohet me ty, s'të ka lënë t'ia shkelësh pragun e derës!

— Po Shpendi, çka u pati bërë Shpendi që ia çanë kokën, e therën me thika dhe e mbytën në lumë?!...

Në Breglum kishte plasur poterja. Dëgjoheshin thirrje e të lehura qensh. Nëpër rrugët e fshatit lëviznin njerëz me pishtarë në duar.

— A keni gjë tjetër për të thënë? — pyeti Omeri me një gjakftohtësi që e befasoje edhe atë vetë. — I dëgjova të gjitha ato që thatë deri tash. Sido që të jetë puna, ajo që donit të bënit ju sonte, do të ishte pabesi e turp i madh për Gurajën. Sa për Shpendin, po ju them se atë nuk e kanë vranë breglumasit: atë e ka vranë dikush tjetër që nuk ia do të mirën as Gurajës, as Breglumin. Me dashje ose pa dashje, ju jeni bërë masha e tij.

— Të mos humbasim kohë! Ata na kanë hetuar... Të bëjmë tonën! — vikati një hakmarrës prapa shkurreve, duke ia prerë fjalën Omerit. Fshatarët filluan të lëviznin.

Omeri uli automatikun nga krahu dhe i hoqi si- guresën.

— Kthehuni prapa dhe mos guxoni të bëni edhe një hap tjetër drejt Breglumit!

Ai zë i shpërfytyruar që i doli nga gurmazi dhe çau mugëtirën, iu duk krejt i huaj. E mbuluan djersë të ftohta. E kuptoi se kishte bërë një gabim të rëndë e të pandreqshëm. Ai ndoshta do të vriste dy-tre hakmarrës, por përleshjen nuk do ta pengonte dot. I erdhi si të fikët.

Atë çast nga krahu i djathtë dëgjoi një zë të njohur: zëri i Kingjit. Në fillim iu duk sikur po i bënin veshët. Jo, nuk mund të besonte se ai ishte zëri i vërtetë i Kingjit. Vështroi andej nga kishte ardhur zëri. Vuri re siluetat që po afroreshin drejt tij. Njohu trupin e Kingjit, të Ramës dhe të disa shokëve të tjerë. Djersët e ftohta pushuan së rrjedhuri dhe tërë qenia iu mbush me një ngrohtësi të ëmbël si dielli i ditëve të para të pranverës...

Hëna ra prapa malit, por Omeri i dallonte fytyrat e shokëve në dritën e pishtarëve. Ai nuk pati kohë të fliste as edhe një fjalë me ta, sepse nga ana e Gurajës u dëgjuan të shtëna pushkësh e sokëllima.

— A i dëgjoni këto pushkë që po bien në Gurajë? — u tha Kingji hakmarrësve të fshehur nëpër gëmusha. — Banda e Zabit Malotës paska dalë në anët tona. Ju mendonit t'i vinit zjarrin Breglumit dhe harruat se armiku përpiqet të djegë shtëpitë tuaja...

Të shtënat dhe sokëllimat që vinin nga Guraja nuk po reshtnin. Nxitësit e sulmit kundër Breglumit e panë se plani i tyre kishte dështuar, ndërsa hakmarrësit e tjerë po e kuptonin se kishin shkarë në një greminë. Ata u kthyen mbrapsht dhe u nisën me të shpejtë drejt fshatit të tyre.

Omeri shkoi te kali që po këpuste fije të rralla bari, të mbira midis shkurreve, ia përkëdheli kokën me duar, mandej hipi në të dhe ngau me të katra.

Banditët e dinin se çfarë do të ndodhte atë natë midis gurajasve e breglumasve dhe ishin të bindur se, me të përënduar hëna, ashtu siç e kishin bërë me fjalë, qiellin e errët do ta lëpinin flakët e të dy fshatrave. Për nisjen e hakmarrësve nga Guraja kishin marrë të dhëna të sigurta, prandaj u çuditën, kur njeriu i tyre që vrojtonte në një kodër kundruall Breglumis, nuk pa asnjë flakë, asnjë shenjë zjarri. Kjo gjë i bëri nervozë. Iu afruan tinëzisht shtëpive të fshatit, duke ecur ndanë livadheve e gjerdheve të larta. Nata ishte e qetë, e butë si ninulla e një nëne që vë fëmijën në gjumë. Tërë hapësirën e fshatit e mbulonte një muzikë e vetme, muzikë vere dhe të korrash që piquen: kënga e bulkthave. Zërat e tyre spërkatin errësirën me një luzmë tingujsh të kristaltë.

Me t'u avitur te kulla e parë, një hungërimë qensh të egërsuar kreshpëroi pushin e butë të natës që po nanuritej nga kënga e pandërprerë e bulkthave. Banditët u platitën pas gardhit, megjithatë hungërima nuk reshti. Madje një qen u vërsul drejt tyre. I zoti i kullës e kuptoi se qeni nuk lehte kot dhe aty afër do të ishte dikush.

— Kush është aty?! — thirri ai nga dera e kullës.

Nuk iu përgjigj njeri. Qeni iu hodh përsipër një banditi, i cili i nguli thikën. I zoti i shtëpisë e dëgjoi angullimën e qenit, u fut në kullë të merrte pushkën e të lajmëronte njerëzit e tjerë. Meqenëse u mbeti fare pak kohë për të vepruar, banditët hodhën disa bomba drejt kullës, mandej u larguan. Kulla mori flakë. I zoti

i shtëpisë vrapoi në oborr dhe qëlloi nga ana ku ishin banditët. U zgjua tërë lagjja. Dikush me kovë, dikush me bucelë u turrën te kulla që po digjej. Të tjerët morën pushkë e sëpata për të ndjekur bandën...

Kur arriti Omeri në Gurajë, banditët kishin ikur pa lënë gjurmë. Nga t'i ndiqje?! Ku t'i kërkoje?! Ata i mbronte errësira e natës dhe vendi ku kishte aq shumë pyje, lugina, shpella e limere për t'u fshehur.

Korrieri lajmëroi tërë fshatin për t'u mbledhur te Bleri i Madh.

Brenda një kohe të shkurtër lëndina u mbush me njerëz. Atë ditë Omeri nuk kishte asnjë dëshirë të fliste. Mezi i nxirrte fjalët nga goja. Në ato fraza të copëzuara përziheshin zemërimi dhe ironia. Zëri i tij ishte i ulët, pakëz i ngjirur, por i nderë.

— Nata e mbrëmshme do të kishte qenë nata më e turpshme në historinë e Gurajës, po të bëhej ajo që kishin në kokë disa... — deshi t'i quante armiq, deshi t'i quante kokëshkretë, por asnjëra fjalë nuk i pëlqeu.

Ai u ndal gjatë sidomos te një gjë: mbase Guraja i kishte dhënë Luftës më shumë se Breglumi ose ndonjë fshat tjetër, por kjo arsye nuk i jepte të drejtë as të lavdërohej, as ta mbante veten mbi të tjerët. Ajo nuk kishte derdhur gjak për të fituar nam e privilegje të veçanta.

Disa shpagimtarë që folën pas Omerit, i përsëritën aq shumë tërë të këqijat që Breglumi i kishte bërë Gurajës, sa që atij nisi t'i dhembte koka. Siç ndodh në raste mërish e grindjesh, mjaft gjëra u shtuan e u zmadhuan. Kurteshi tha se kohët e fundit, «si të ishim në kohë të mbretit», breglumasit kishin vrarë Shpendin dhe kishin prishur amën e kanalit.

— Kjo nuk është e vërtetë! — e ndërpreu Omeri. — As vrasja e Shpendit, as prishja e kanalit nuk është bërë nga breglumasit.

— Po kush e ka bërë atëherë?

— Këtë do ta marrim vesh më vonë...

— Aha! U del në mbrojtje se i ka «miq», — tha Kurteshi duke u ngërdheshur.

Omeri shtrëngoi dhëmbët dhe heshti. Kur mbaruan së foluri të gjithë ata që deshën të shprehnin mendimet e veta, u ngrit në këmbë prapë. Ai nuk u përpoq të bindte njeri se po i mbronte breglumasi, ngaqë i kishte «miq». Foli për bandat që endeshin nëpër male, për rrezikshmërinë e tyre, për kurset që do të hapeshin për të mësuar shkrim e këndim dhe për nisjen e një brigade me djem e vajza të Gurajës për në hekurudhë.

— Shteti, — tha Omeri, — pushteti ynë na ka dhënë fonde për të rregulluar e për të zgjeruar kanalën tonë. Mot në verë do të kemi dyfishin e ujit...

Natyrisht lajmi i fundit i gëzoi gurajasi, mirëpo ata ishin të brengosur nga lajmet e tjera, të cilat u dukeshin si mite që mund t'i përfytyrosh, veç jo t'i shohësh të njëmendësuar.

Bandat? Ato do të shfarosen, he i preftë uju, i preftë, por «ata të përjashtmit» do të çojnë prapë. Ne do t'i vrasim e ata do të çojnë prapë e prapë. Ata çò, ne vraj; ata çò, ne vraj... Fundi i kësaj punë dihej dhe nuk i shqetësonte gurajasi.

Burrat e gratë në kurse?!... Besa, kjo ishte për të qeshur sa s'ka! Paj, kjo gjë ishte njëqind herë më e zorshme se të lidhje me magji mizat, pleshtat, çimkat, krimbat, urithët, ujqit, shtrigat e furtunën që shtrin arat përtokë... Aiih, t'i kuptosh ato pikla të zeza! Jo, more, kjo s'është punë për ne. Kujt do t'i ketë shkuar në mend kjo punë, he i ardhhtë dreqit çudi në shpellë të vet...

Deri këtu lejohej edhe gazi, edhe shpotia. Dhe gurajasi nuk i kursyen as shpotitë, as të qeshurat, Më tutje shtrihej një tokë e ndaluar për bisedat e përditshme, zinte fill kobi. Largimi i vajzave të rritura dhe i nuseve nga fshati, vajtja e tyre në hekurudhë: kjo ishte diçka e pangjarë, e padëgjuar as në përrallat, as në gojëdhënat e pleqve.

Duke menduar për këtë, nifullat shtrëngoheshin vet-

vetiu, gojët mbylleshin, ballët rrudheshin dhe nëpër sy binte një mjegull e hirtë. Niste një monolog i hesh-tur, sfilitës... Atje, në hekurudhë (O zot, ç'ishte kjo hekurudhë)? Pyllnajë? Shkretëtirë? Qytet prej heku-ri?) vajzat e nusët e tyre do të përcudnoheshin, do të... do të... Dhe truri i mësuar me hapësirën e ngushtë të maleve e të neneve të kanunit, i ngjante një urithi të kacavarur papritmas në qiellin e një mesdite me diell, në një fije të padukshme. Dhe ky tru-urith përpëlitej, tendosej i tëri, lakmonte vrimën e ngushtë e të errët, ajrin e rëndë, verbërinë e qëmotshme...

Më tepër se cilitdo, Omerit iu desh të ndeshej me këtë «urith».

Gjatë kësaj kohe Omeri e ndjeu veten më të lidhur se kurrë me Jerinën. Ajo shkoi në kursin për të mësuar shkrim e këndim dhe doli vullnetare për të punuar në hekurudhë. Në pranverë u bë zgjerimi i kanalit që e kishte hapur Ibër Shpata. Vendet gurishtore, ku toka e pinte ujët, u veshën me çimento. Të gjithë shkëmbinj-të e thepisur, ku ishin vënë lugje druri, u çanë me mina. Në pjesën e shtruar gratë pastruan dherat e grumbulluara nga rrëketë e shiut, e zgjeruan dhe e the-lluan shtratin e kanalit aq mirë e aq shpejt, sa edhe burrat u çuditën.

— He, more bir, gruaja është si merimanga. Gjithë ditën e lume sillet e sillet nëpër shtëpi e nuk i ka duk puna. Po të matej mundimi ynë e mundimi i bu-rrave, ndoshta, more bir, mundimi ynë do të peshonte edhe më rëndë...

Omeri e këqyrte me vëmendje atë fytyrë tërë rru-dha, të rrethuar me xhufka thinjash, krahnezë dimri që mbështjell degët e zhveshura të drurëve. Kësaj plake

i kishin vdekur të dy djemtë. Pa e thirrur kush, ajo kishte ardhur të punonte në kanal. Omeri vinte re se tani fytyra e saj ishte më e çelët, sikur përpjekja për t'i sjellë ujë Gurajës ta kishte përtërirë edhe atë.

— Ndokush mund të thotë: «E çka i duhët ujët kë-saj kërcune pa njeri, që ndoshta nuk e zë gjallë vera!» Unë s'kam dert për këso fjalësh. Le të ngrihet Guraja me ujë. Po të ketë Guraja ujë, do të ketë bar të njomë mbi varrin tim. He, mor bir, më dukej sikur edhe të vdekurit atje në varr shkumboheshin për ujë. U përcëlloheshin eshtrat nga toka e ndezur flakë. Tash Guraja po njomet. Po i mbushen damarët me gjak...

Po, diçka ka ndryshuar të njerëzit, — tha me vete Omeri kur u nda nga plaka. Ai e dallonte këtë gjë në sytë, në fytyrat, në fjalët dhe në të qeshurat e tyre. Tani këto të qeshura i tingëllonin në vesh më të shpen-guara e më të çiltra. Natyrisht ai nuk mendonte aq përciptazi sa ta lidhte këtë ndryshim vetëm me ndarjen e re të ujit, me shtimin e tij.

Një shëmbëllim i Gurajës së tanishme ishte edhe Jerina. Një ditë, më tepër për ta ngacmuar, i tha:

— Po lodhesh shumë, Jerinë! Më duket se të gjitha këto ti i bën për mua, sepse gruaja e kryetarit të këshillit duhet të japë shembullin e para.

Ajo e vështroi ngultas. (Po ajo ngjyrë e thellë e pa-depërtueshme e syve të saj, që e kishte munduar kur e priste në brigjet e Ujëbardhës!) Qukat në faqe mungonin. Pra, ajo e kishte marrë fjalën e tij me gjithë mend.

— Të them të drejtën, lodhem, por kjo lodhje nuk më rëndet. Atë që bëj, e bëj edhe për ty, por në radhë të parë e bëj për...

Ajo heshti dhe vështroi nga dritarja.

— Fol, Jerinë: për kë?

— Për veten time. Më duket sikur vetëm tash po jetoj. E ndiej veten njeri... He, ato vite ngujimi. Kurrkush nuk mund ta besojë sa të rënda kanë qenë për mua ato vite.

Vërtet kurrkush nuk mund ta besojë, — përsëriti

Omeri me mend. Përveç keqardhjes, ndjeu edhe njëfarë fajësie. Ai e kishte ndihmuar fare pak për ta përballuar vetminë e saj si grua e marrë në gjak dhe e ngujuar brenda. Jo se nuk kishte dashur. Atëherë ai nuk kishte mundur ta kuptonte gjendjen e saj, as ta ndiente këtë vetmi. Veç kësaj atyre u takonte të rrinin pak së bashku.

Po të kishte vazhduar edhe shumë kohë të tjera ky ngujim, Jerina do të ishte mësuar me të, ose shpirti i saj do të ishte venitur si ato bimët me kërcell hollak e me gjethe të zverdhura që lëngojnë në hije. Tani ajo jepej pas punëve me tërë qenien e saj. I dukej sikur çdo gjë e bënte edhe për atë vashën e ngujuar në hesh-tjen dhe mugëtirën e kullës së zyrtë. Jerina ishte një burim i zënë që kishte shpërthyer prapë, një Përrua i Thatë, i ringjallur, që del me vrull nga nëntoka. Si Jerina ishte edhe vajza e Kingjit, motra e Ramës e disa gra komunistësh. Sot për sot ende ishin pak, por u ngjanin luleve të para që ndjellin pranverën....

Mushaku i pamartuar, që ëndërronte për floçkat dhe priste më kot t'i shfaqeshin në brigjet e lumit, kishte hipur në një kodër dhe po i binte fyellit. Nëpër vrimat e atij fyelli dilnin psherëtimat e një rinie të ikur, klithmat e një zemre të djegur.

Shkurret dhe barishtet në bregun e përtejme të Ujëbardhës lëvizën, u hapën dhe prej tyre doli një nuse e bukur. Buzët e Mushakut u mpinë, duart iu shtangën. Tani bariu s'e kishte mendjen te fyelli, as te ndonjë gjë tjetër e kësaj bote. Për të ekzistonin vetëm ai breg lumi, ai zall i bardhë, ku ecte një nuse e bukur si qeniet e gojëdhënave.

Ajo hoqi shaminë nga koka. Mbi fustanin e saj të zi

u derdh, ujëvarë e praruar, një floknajë e dendur, e gjatë që i arrinte deri në mes. Mushaku u trullos nga ai vezullim i artë, si të kishte rrëkëllyer një damixhanë me verë të vjetër. U kapërdi, sepse iu duk sikur po i zihej fryma.

Floçka! — mendoi ai. — Ja ku është floçka që ke dëshiruar aq shumë ta takosh. Ajo erdhi atëherë kur ti nuk e prisje më. Pse po dridhesh? Pse nuk po çohesh nga vendi?! Ku shkoi trimëria jote e dikurshme?!... E trimëroi veten disi me këto fjalë, u ngrit në këmbë dhe u turr drejt lumit.

Ajo freskoi fytyrën, duke hedhur ujë me grushte, mandej hoqi çorapet dhe futi këmbët në rrjedhën e ftohtë. Mushaku vështroi një copë herë ato këmbë të bardha, që nuk ngjanin me gjymtyrë njerëzore prej mishi dhe eshtrash. Këtë iluzion ia shkaktonte jo vetëm bardhësia e tyre, por edhe pasqyrimi i tyre në ujë: rrjedha e kulluar i luhaste, prandaj ato dukeshin si të palëndëta. Ajo e pikasi bariun që po e përpinte me sy, por as nuk i foli, as nuk e vështroi.

Kur doli Mushaku në bregun tjetër, ajo nuk ishte më buzë ujit. Ai e përfshiu tërë bregun me sy. Sapo dalloi majat e shkurreve që lëviznin, rendi si i dalldisur drejt tyre. E arriti nusen e panjohur dhe, pa i thënë asnjë fjalë, e mbërtheu me shtatin që i dridhej nga emocioni.

— Ti je floçka ime! — i tha me një zë të mbytur. — Mos u përpiq të ikësh, nuk të lëshoj i gjallë. Ka vite që po pres në brigjet e këtij lumi të më dalë përpara një floçkë!...

Herën e parë, kur e thirri floçkë, asaj iu duk sikur i bënë veshët. Kur e thirri për herë të dytë me këtë emër, ajo mendoi se bariu e quajti kështu për hir të bukurisë së saj. Të përqaftuar, u shtrinë në barishtet e gjelbra e të mishtorme, të cilat u shtypën nën peshën e trupit të tyre...

Pasi kaloi ajo valë marrosjeje, Mushaku e mori vesh se nusja e bukur, që e kishte magjepsur me floknajën

e praruar dhe me bardhësinë e këmbëve të saj të kre-
dhura në rrjedhën e kthjellët të lumit, nuk ishte floçkë,
por ishte Zebaja, e bija e Çausht Bekës, nusja e djalit të
një bajraktari. Zhgënjimi i tij qe i dyfishtë: kaq shumë
i ishte rrënjosur në kokë mendimi për të kapur një
floçkë, një vashë lumi, për ta marrë për grua e për të
bërë fëmijë me të, saqë kishte hequr dorë nga martesat
me një vajzë të zakonshme. Megjithëse bukuria e Zebajës
nuk binte më poshtë se bukuria e floçkave, ashtu siç
i përfytyronte ai, hidhërohej kur mendonte se ajo ishte
njeri si gjithë të tjerët. Por më e keqja ishte se nuk
mund ta çonte në shtëpi, siç do të kishte vepruar me
floçkën e lumit. Edhe sikur ai të dëshironte e t'i përg-
jërohej për këtë gjë, Zebaja nuk do të pranonte, ma-
dhe do të qeshte me të madhe me marrëzinë e tij.

Ajo nuk kishte nevojë për burrë (i shoqi ishte diku
në Evropë), por kishte nevojë për një mashkull. Rasti
e solli që ky mashkull të ishte Mushaku, një bari pakëz
i lajthitur, por i shëndetshëm, i djegur për dashuri.

Shtrëngata nuk kishte ndër mend të pushonte. Frynte
e buçiste ditë e natë, duke sjellë re të zeza mbi kullën
e Çausht Bekës dhe mbi kullat e shokëve të tij. Re-
forma i mori Çaushtit një pjesë të mirë të tokës e të
bagëtive, që shteti ua dha breglumave të skamur. Duke
parë bagëtitë që po i nxirrnin nga vatha, për t'i çuar
në vatha të tjera, i ra të fikët dhe u shemb në mes
të oborrit. Gratë e ngritën nga toka për të vdekur dhe
e ngritën në kthinën e miqve. Me sa duket i kishte
rënë pika, sepse, kur erdhi në vete, nuk mundi as të
ngrihej në këmbë, as të fliste. Herë pas here në sytë
e tij të turbullt shfaqej një flakë e gjelbëreme, e ftoh-

të. Gratë me të zeza silleshin rreth tij duke pëshpëritur.

Ato mbanin zi për burrat, djemtë dhe të afërmit e tyre që ishin vrarë gjatë luftës në përpjekje me partizanët. Ata që u kishin shpëtuar plumbave, pas Çlirimit ishin dënuar nga gjyqi i popullit dhe ndodheshin në burg...

Çaushi vdiq. Tuba u zvogëlua shumë. Tani Zebaja shkonte rrallë me fëmijët për të kullotur dhitë që u kishin mbetur. Me këmbënguljen e saj, shpesh Mushaku vinte natën në kullë dhe largohej pa bërë ag drita. Hyj e dal si cub, — mendonte dhe e ndiente veten të poshtëruar. Ia acaronin nervat këto udhëtime në errësirë, të lehurat e qenve që nuk e njihnin dhe vetë kulla e gurtë, e errët si varr. Ç'donte ai në kullën e Çaush Bekës, në atë kullë ku pluskonin zia dhe vdekja, ku vërtiteshin gra të veshura me të zeza që herë pas here klithnin si kukuvajka?! Po sikur ta merrnin vesh bashkëfshatarët e tij e sidomos Omeri? Çfarë do t'u thoshte?! Si do të shfajësohej?

Mushaku betohej se nuk do të shkelte më te «kulla e kukuvajkave», por, sapo vinte nata e takimit, betimet këputeshin si litarë të kalbur. Të nesërmen, duke u kthyer i pagjumë nga Breglumi, zemërvrarë dhe përherë e më i zhgënjyer, betohej prapë se do të hiqte dorë nga Zebaja...

Kur e hoqi fyellin nga buza, Omeri i thirri në emër. Mushaku ktheu kryet, e pa me habi, mandej zbriti nga guri.

— Kam disa minuta që po të dëgjoj, — i tha Omeri, duke vënë buzën në gaz.

— Kujtova se i kishe harruar këto sende...

Njëri nga banditët ishte Zabit Malota. Ai i zgjati Mushakut një paketë cigaresh.

— Nuk e pi, — tha bariu. Ende s'e kishte marrë veten nga ky takim që e kishte hutuar krejt.

I thanë të ulej në shtrat, pranë tyre. Nuk pranoi.

— Unë nuk kam punë me ju! — tha Mushaku.

— Por kemi ne një punë të vogël me ty! — i tha Zabiti. — Besoj se Omerin e njeh, apo jo? Ti duhet ta vrasësh këtë njeri që po ia sheh sherrin gjithë Guraja.

— Unë nuk ia kam parë sherrin dhe nuk kam pse

... — tha Mushaku.

— Por të themi ne ta vrasësh! — tha Zabiti duke u ngritur në këmbë.

Pabesi, ndyrësi... Këto fjalë kaluan si vetëtima nëpër trupin e Mushakut.

— Këtë gjë nuk do ta bëj kurrë! — tha ai me një mllef që s'mundi ta përmbante.

— Atëherë të pret kjo... — tha Zabiti, duke skërmitur dhëmbët e duke i treguar tytën e një naganti. Vështrimet e tyre u përplasën si rrufeja në shkëmb.

— Hiqe atë send! — i tha Zebaja. — Mushaku nuk tutet. Ai do ta bëjë këtë gjë për hatrin tim. Po t'i them unë, ai është gati t'i vërë zjarrin gjithë Gurajës.

Ajo buzëqeshi. Mushaku ktheu sytë drejt saj. U zbeh. Floçka! — mendoi ai. — Floçka e vërtetë!

Me një shpejtësi të rrufeshme ia kapi krahun Zabiti dhe ia përdrodi, derisa arma ra në tokë. U dëgjua një kërkëllimë eshtrash. Zabiti u plandos në dysheme.

Banditi tjetër u afrua me kamë në dorë. Edhe Mushaku nxori thikën që e mbante gjithmonë në brez. U bë gati të qëllonte me tërë fuqinë e krahut e të trupit të tij, por nuk mundi: një ndenjësë e drunjtë e goditi të prapa kokës. Ai e kuptoi se ajo goditje i erdhi nga Zebaja. Floçka! — murmuriti ai. Atij iu duk sikur një

krah i fuqishëm po e tërhiqte në ujërat e një pusi të thellë, në pallatin e fshehtë të floçkave, ku do të ngujohej përgjithmonë.

Barinj të e gjetën setrën e Mushakut dhe thikën që kishte në dorëz emrin e tij në breg të Ujëbardhës, pranë një pusi të thellë. Në Gurajë u përhap fjala se atë e kishin rrëmbyer floçkat dhe e kishin marrë me vetë në lumë. Plakat i porositën djemtë që të mos laheshin në puse të thella.

I zoti i shtëpisë vuri xhezven në zjarr. Ishte vjeshtë. Jashtë ishte mot i lagësht, i ftohtë. Kjo gjë ndihej edhe në kthinë. Zabit Malota ishte ulur ndanë vatrës me kapotë krahëve. Me një degë të thatë bënte kryqe në hi. Krahu i përdredhur nuk i dhembte më.

— Bukur të mërzitur po të shoh sot... — i tha i zoti i shtëpisë, duke dashur të pohonte e të pyeste njëherësh.

Zabiti e dystoi shtresën e hirit, mandej nisi të bënte kryqe të reja.

— Kam parë një ëndërr mbrëmë... Si të them, një ëndërr për çudë...

— E mbarë qoftë!

— S'ka si të jetë e mbarë... E pashë veten hipur në një kalë. Ky kalë ishte mbi një kalë tjetër që po ecte mbi akull.

— I zoti i shtëpisë uli kryet.

— Me sa duket, lufta jonë është e humbur, — tha Zabiti me një zë ku nuk kishte as pikëllim, as nervozizëm. — Inglizi nuk ka ndër mend t'i djegë duart për ne.

I zoti i shtëpisë e vështroi ngultas, por nuk e hapi gojën. Megjithatë Zabiti e vuri re se në sytë e tij të shqetësuar po përpëliteshin shumë pyetje.

— Ti do të thuash: E pse lufton atëherë, mbasi e di që lufta jonë është e humbur?!... Unë luftoj për histori!

I zoti i shtëpisë tundi kokën. Një e përqethur e ftohtë si hell akulli i kaloi nëpër peshkun e kurrizit e iu ngjit në zverk.

«Mirë, ti dashke të hysh në histori, more Zabiti Malota, të këndohen këngë për ty e për trimëritë e tua, po unë ku në birë të dreqit të hyj?! Ndoshta emri yt do të përmendet djalë mbas djali e historia do të thotë se dikur ka qenë një Zabiti Malota që ishte trim mbi trima, që luante me lirat e inglizit si me guraleca, po mua ç'më çoi të futem në këtë valle?! Unë nuk dua të hyj në histori, jo! Dua vetëm të kem gjë e mall e të jem zot në kullën time e në tokat e mia...»

Ujët në xhezve ishte nxehur e po zhuzhëllinte. Ai hodhi kafën dhe e trazoi me lugë.

Në kthinë u fut një bandit me fytyrë të shqetësuar, i cili tha se në fshat kishin ardhur forcat e ndjekjes. Vetullat e Zabiti u kaladredhuan si trupi i një gjarpri, para se të çokatë.

— Ta pi këtë kafe njëherë... Më pritni në oborr.

Banditi doli jashtë. Zabiti e gjerbte kafën qetë-qetë, duke vështruar flakët e zjarrit. Kjo sjellje e befasoi dhe e turbulloi të zotin e shtëpisë.

«Përse m'i tha ato fjalë qëparë?! Ndoshta deshi të provonte se si do t'i prisja fjalët e tij. Dhëlpër me dy bishta është, krejt si i ati!... Po a hedh inglizi lira prej qielli për një luftë të humbur?! Besa jo, kurrë! Ec e

merri vesh njerëzit sot, po munde: ndryshe thonë e ndryshe bëjnë!...»

Zabiti la filxhanin në tabaka. Mbi urët e zjarrit kishte një plaf të bardhë hiri.

— Sivjet do të kemi dimër të madh — tha ai, — Shihe hirin.

— Pa kaluar java, prite borën në tokë, — tha i zoti i shtëpisë.

Zabiti u ngrit në këmbë dhe veshi kapotën. Shtiu dorën në xhep, mori një grusht monedha dhe i lëshoi në vatër. I zoti i shtëpisë u hoq sikur nuk donte t'i merrete, por sytë i kishte bërë gapërr dhe mezi fiiste nga lakmia.

— Merri se të duhen, — i tha Zabiti ftohtë e pre- razi.

Luftë e vështirë, — mendoi ai duke mbërthyer ka- potën ushtarake. — Kundërshtarët duhet t'i mundim me plumb; përkrahësit tanë, me flori...

Në oborr gjoku i bardhë ishte gati. Kur iu afrua Zabiti për të hipur në të, gjoku turfulloi lehtë. Ban- ditët e morën me vete të zotin e shtëpisë, derisa hynë thellë në pyll...

Poshtë tyre, mbi fshatin prej ku sapo ishin lar- guar, rrinte pezull një mjegull e hirtë, e palëvizshme. Sipër brezit me mjegull kishte diell. Banditët ecnin njëri pas tjetrit, pa folur. Zabiti ishte i zymtë e ner- voz. Atë e shqetësonte ngjyra e gjetheve të aheve e të panjave. Ishte një përflakje, një zjarrnajë e vërtetë. Një imazh i ferrit, — mendoi ai. Iu kujtuan Italia dhe stu- dimet që kishte bërë atje... — Budallallëqe! — sa s'thi- rri me zë të lartë. — Të gjitha janë budallallëqe në këto male. Edhe vetë jeta është një marrëzi. Një lojë kukafshehthi me fatin. Një udhëtim dantesk, por pa purgator dhe pa parajsë. Vetëm ferri i përflakur...

Nga drurët këputeshin gjethe të arta, të purpurta dhe i binin mbi supe, mbi trup. I ngjante sikur ato gjethe ishin shkulma flake, grumbuj prushi. Iu kujtuan prapë

fjalë, ku shihte jo thjesht një kujdes prej burri, por edhe një kujdes prej shoku...

Të nesërmen u bë me një burrë e me një grua nga Guraja, që kishin qenë në qytet për të vizituar një fëmijë të sëmurë. Gjatë udhëtimit, me ta u bashkuan edhe dy gra të moshuara që i gjetën duke pushuar te një krua. Të dyja gratë kishin në shpinë nga një çerap të ri. Rruga ishte me të përpjeta e të teposhta të lodhshme. Gjatë natës kishte rënë shumë vesë. Nga rrezet e diellit, ajo po avullohej e po shndërrohej në fjolla mëndafshi që kacavareshin nëpër degët e drurëve, ku kishte mugulluar gjelbërimi i ri. Të dukej sikur nuk ishin drurë, por mijëra furka, që i mbanin në brez gra të padukshme për të tjerrë me to pajën e stinës së re.

Në mbledhjen e djeshme Jerina kishte folur për përpjekjet që po bënin gratë e Gurajës për të mësuar shkrim e këndim, për ndihmën që jepnin për të zbuluar armiqtë e pushtetit popullor. Megjithëse ato merrnin pjesë në mbledhje dhe burrat nuk guxonin t'i rrihnin si më parë edhe për një fjalë goje, ajo e dinte se sa e vështirë ishte jeta e tyre. I dilnin para sysh fytyra grash që rriheshin nga burrat, fytyra nusesh që mbaheshin të mbyllura në dry, fytyra vajzash të fejuara që në djep me burra të moshuar ose me gjymtime trupore. Sa dhibje e poshtërimi kishte në sytë e atyre grave kokulura e të pikëlluara që rrinin në këmbë me pishë në dorë, kur meshkujt hanin bukë, mandej mblidhnin e mblaçisnin copërat e bukës që mbeteshin në sofër! A mund të kishte gjë më të bukur e më fisnike, sesa të luftoje për të pakësuar mundimet, brengat dhe lotët e tyre?!...

Rrëkeja e mendimeve të Jerinës gurgullonte, rridhte drejt së ardhmes. Ajo ndiqte me sy zogjtë me flatra të larme që uleshin e ngriheshin pa pushim nëpër kaçuba e nëpër drurë, duke cicëruar e duke u përkujdesur për foletë. Zemra i rrihte me forcë, i trokiste në brinjë si zogthi që çukit lëvozhgën e vezës, që të dalë prej saj e të fluturojë në hapësirën e larë me diell.

Nga shkurret sipër rrugës u dëgjua një zhurmë dhe që andej doli një njeri i armatosur, me fytyrë të parruar. Sytë e Jerinës u ndeshën me sytë e tij. Ajo e kuptoi se i panjohuri po priste pikërisht atë. Rrëkeja e mendimeve pushoi së gurgulluari: u ngri, u bë akull i blertë. Vetëm një ide regëtinte në vetëdijen e saj: të vraponte! Ajo ia dha vrapit...

Banditi kapërceu shkurret e dendura dhe e ndoqi prapa. Gurajasi që ishte me Jerinën nuk kishte armë. Ai kapi një gur dhe u turr pas banditit. Kur iu afrua, e qëlloi me të në mes të shpatullave. Banditi klithi, por nuk u rrëzua. Fshatari iu hodh sipër për t'i rrëmbyer pushkën. Banditi iu shmang duke u rrokullisur dhe tërhoqi këmbëzën. Përbri fshatarit që u rrëzua përtokë, u zgjat një curril gjaku. Së largu dëgjoheshin britmat e grave, të cilat vraponin duke gulçuar.

Megjithëse përpjekja e fshatarit nuk e shpëtoi Jerinën nga rreziku, e shtoi largësinë midis saj dhe banditit. Ajo ecte pa e kthyer kokën prapa. Nuk mendonte as për jetën, as për vdekjen... Në kokën e saj vërtitej vetëm ky mendim: Të eci, të eci, të eci! Vetëm të mos më prekë dora e tij! Plumbi le të më arrijë. Plumbi s'ka gjë!

Tani nuk shihte mirë. E pengonte djersa. E pengonte një avull i kuqërremtë që i mbushte sytë. Herë pas here dallonte përmes atij avulli ndonjë lëndinë, shkëmb a dru të njohur dhe kështu e merrte me mend se në ç'vend gjendej.

Në sytë e saj vërshoi një shkulum i bardhë. Ishin bregore të mbuluara me kulumbri të lulëzuara. O, sa të bardha, sa të merme ishin ato lule të porsaçelura! Gjithmonë ishte ngazëllyer nga bardhësia e tyre. Dikur ato kulumbri të lulëzuara i dukeshin si nuse të veshura me të bardha. Një drithmë ia përshkoi tërë trupin: përtej atyre bregoreve ishte Breglumi. Ishte fëmijëria e saj.

Ajo ecte dhe gulçonte. Përpara i shfaqeshin vetëtimthi fëmijëria, nusëria e mjerë dhe ngujimi, Omeri dhe fëmijët. Mendja e saj mbërthehej te këto fytyra

të dashura për të harruar lodhjen. Për të harruar banditin. Për të mos rënë. Për t'u mbajtur edhe pak, se ja ku po dukeshin çatitë e kuqe, çatitë e para...

Banditi donte ta zinte të gjallë, ta përdhunonte, t'i bënte ndonjë gjymtim të shëmtuar e ta linte gjallë. Kështu e kishte urdhëruar Zabiti. Mirëpo Jerina largohej gjithnjë e më tepër prej tij, sikur fluturonte. Dhe vërtet hera-herës, kur e shihte midis drurëve, atij i bëhej sikur ajo ishte shndërruar në shpend, në një shpend të bardhë si ata pëllumbat e egër që ngriheshin nga bregoret, duke përplasur flatrat me vrull.

Kur pa çatitë e Breglunit, banditi u mbështet pas një shkëmbi, u mbush me frymë, mandej mori shenjë. Shtiu disa herë. Fluturimi i Jerinës mori fund. Ai e vuri re harkun që bëri trupi i saj duke rënë përtokë: tamam si shpend i vvarë.

Sapo dëgjuan të shtënat që erdhën nga ana e sipërme e fshatit, disa breglumas morën pushkët dhe shkuan me vrap te vendi ku ndodhej Jerina. Ata u befasuan kur panë nga larg trupin e njeriut që kishte rënë përmbys mbi bar. Megjithëse e morën me mend se atë e kishin vvarë, atyre nuk u bëri përshtypje vrasja, vdekja, por diçka tjetër: njeriu i vvarë ishte grua. Kanuni e dënonte dhe e quante turp të madh vrasjen e një gruaje ose të një fëmije. Cilado që të ishte ajo grua që shtrihet në bar përpara tyre, ajo vrasje ishte e shëmtuar.

Sekretari i këshillit të Breglunit u përkul mbi trupin e së vvarës dhe e ktheu mbarë. Jerina! Kjo gjë e shtoi edhe më tepër habinë e fshatarëve. Ata panë sy ndër sy njëri-tjetrin. Dikush kishte vvarë Jerinën, që para disa vjetësh kishte lënë të fejuarin dhe ishte martuar me dashuri, në gjak. A mos e kishin vvarë

pikërisht për të marrë gjakun e vjetër, për të larë turpin e dikurshëm?! A mos kishte gisht në këtë vrasje babai i Jerinës?!... Sekretari i këshillit vuri re se ai nuk ndodhej midis fshatarëve që kishin ardhur te vendi i vrasjes.

Nuk ishte koha për t'u marrë me pyetjet dhe hamendjet rreth kësaj vrasjeje. Ata bënë një vig dhe e çuan Jerinën në fshat. E ëma e saj erdhi duke qarë me kuje e duke gërvishtur faqet. Ajo ra mbi trupin e së vdekurës, e përqafoi si një fëmijë dhe zuri ta puthte në ballë, në flokë, në faqet dhe në duart e ftohta. E ledhatonte me gishta dhe i thoshte fjalë mikluese e të dhembshura, aq sa i ngjethi gjithë të pranishmit. Më shpesh ajo e thërriste «nusezeza e nënës!».

Pas një copë herë te vendi ku ishte ulur vigu, u duk edhe i ati i Jerinës, duke ecur me hapa të mëdhenj e të ngadalshëm. Ai nuk u afrua ta prekte me dorë, nuk tha asnjë fjalë. Qëndroi përballë së vdekurës hijerëndë dhe i heshtur si një shtatore e gurtë. Megjithatë, kur ktheu kryet mënjanë, fshatarët e panë duke fshirë lotët me bulat e gishtave...

Ndonëse ishte bijë Breglumi, Jerina duhej të futej në dhé në Gurajë. E ëma çau e u kacavar me duar pas vigut, por burrat e ngritën vigun në supe dhe u nisën për udhë. Për të përcjellë të vdekurën, shkuan shumë breglumas, burra e gra.

As të vdekur nuk po më lënë ta shtrëngoje në krahët e mi e të çmallem me bimën e zemrës sime, — mendoj e ëma e Jerinës. — Ata nuk e përcollën atë ditë që duhej ta përcillnin si krushq. Sot po e përcjellin të vdekur e të përgjakur. Ata janë krushqit e vdekjes. Ata po e çojnë vajzën time te varri.

Iu duk sikur po i çahej zemra nga hidhërimi e malli për të bijën. Pa folur fare me të shoqin, ajo u shkëput nga gratë që po mundoheshin ta ngushëllonin dhe u turr pas varganit që ndiqte vigun, duke murmuritur me vete: Ata janë krushqit e vdekjes! Ata janë krushqit e vdekjes...

Lajmi për vrasjen e Jerinës kishte mbërritur edhe

në Gurajë. Disa burra ishin nisur menjëherë për të marrë trupin e së vvarës. Kur u takuan në mes të rrugës, breglumasit ua lanë vigun, por nuk u kthyen prapa. Ata do të merrnin pjesë edhe në varrimin e Jerinës.

Në gjëmat dhe dasmat e derisotme kishte ardhur vetëm ndonjë breglumas i rrallë. Ishte hera e parë që në tokën e Gurajës shkelnin së bashku kaq breglumas, të cilët vinin të shtyrë nga një ndjenjë fisnike. Vetëm e ëma e Jerinës murmuriste dhe i quante me vete ata që shkonin pas vigut «krushqit e vdekjes».

Megjithëse përcjellin një të vdekur, ata nuk janë «krushqit e vdekjes», — mendonte Kingji që ecte përbri nënës së Jerinës. Por ky pajtim dukej të kishte një shkak tjetër: jo vdekjen e Jerinës. Megjithatë edhe kjo gjë ka një të mirë. Vdekja e saj do të mbahet mend për mirë. Gjithmonë...

Kingji pa Omerin që kishte dalë te shtegu i obo-rrit. Fytyra e tij ishte e hirtë, e ngurtësuar. Kingji u afrua dhe i shtrëngoi dorën. Brenda gishtave të tij dhimbja e shokut u përpëliti si një shqarsh i plagosur, që përpiket të shpëtojë nga dhëmbët e hekurt të kurthit. Kingji nuk ia lëshoi dorën, derisa vigu i mbuluar me pëlhurë të bardhë u rrethua nga vorbulla e errët e grave dhe e vajtimit të tyre...

Banda e Zabit Malotës sillej andej-këndej si një lukuni ujqish. Ajo vriste njerëz, digjite shtëpi e vatha bagëtish, thyente e plaçkiste tregtore, mashtronte fshatarë të lëkundur, që i detyronte të arratiseshin përtej kufirit. Njerëzit që kishin lidhje me Zabitin, thoshin se ai kishte gjetur kokrrën e rrufesë, të cilën e mbante të varur në qafë, prandaj nuk e merrte plumbi dhe nuk mund ta vriste askush në botë.

Edhe pse nuk e jepte veten, Omeri ishte i hidhëruar e i pezmatuar. Duhej të vritej sa më parë Zabit Malota, që të vriteshin legjendat për të, që të zhdukej kjo bandë, e cila përhapte nëpër fshatra tmerr e frymë të helmatisur.

Të besojë se Zabiti mbante të varur në qafë gurin e rrufesë, prandaj ishte i paprekshëm e i pakapshëm, ishte qesharake. Po atëherë pse nuk po kapej, pse dilte nga rrethimi si për mrekulli?! Kjo pyetje shqetësonte shumë vetë në Gurajë...

Një mbrëmje një bari erdhi të fliste me Omerin...

— Mendja ma thotë se të ka marrë malli për Zabit Malotën! — tha bariu.

— Bukur shumë! — tha Omeri.

— A mund të durosh deri nesër? — tha bariu duke vënë buzën në gaz.

— Deri atëherë po duroj, por kam frikë se do të vish prapë për të më thënë këto fjalë.

Edhe Omeri buzëqeshi. Ai kishte besim te njeriu që qëndronte pranë tij, por xhunga në fyt e shtrëngonte si gjithnjë...

Kur kënduan gjelat e dytë, Omeri, Rama, bariu e dy burra të tjerë dolën nga fshati. Ata lanë shtratin e përroit dhe u ngjitën në një shpat mali, ku kishte livadhe, pyje me lirishta dhe shkëmbinj të çarë. Omeri e bariu u ulën në një bigë guri dhe u mbështetën shpinë për shpinë. Të tjerët zunë pritë në një grykë në krah të majtë.

Te livadhi pranë bigës së gurit erdhi një tubë dëllesh. Me to ishin një plakë dhe një vajzë e rritur. Omeri i njihte të dyja. Aty nga mesdita dhentë ranë në mritz. Vajza hoqi çorapet dhe nisi të ecte nëpër barin e livadhit që i guduliste pulpat e kolme. Në pyllin ngjitur me livadhin dikush fishkëlloi si zog. Vajza u fut në pyll. Që prapa trungjeve të dendura doli një burrë. Ishte Zabiti. Ai e mori automatikun në dorën e majtë dhe filluan të putheshin.

— Bjeri! — pëshpëriti bariu.

— S'kam sesi, — tha Omeri. — Po të qëlloj Zabitin, mund të vras edhe atë...

— Edhe ajo e ka hak plumbin!

Omeri nuk foli. Pështyu me neveri.

Të mbërthyer me njëri-tjetrin, Zabiti dhe vajza u futën në një grumbull ahesh të reja, të shpeshta si gishtat e dorës. Sapo u nda nga vajza, Zabitin e përshkuan dy plumba njëherësh. Ai ktheu automatikun dhe arriti ta shkreppte, para se të rrëzohej. Omeri dhe bariu shtinë prapë mbi të. Banditët që ruanin Zabitin shtinë me automatikë e hodhën disa bomba, mandej u tërhoqën në thellësi të pyllit...

Kur shkuan te kufoma e përgjakur e Zabitit, Omeri vuri re një vargua të ndritshëm që shkëlqente në qafën e tij. Kureshtja doli më e fortë se pështirosja. Ai u përkul dhe e tërhoqi vargoin e artë nga gjiri i të vrrarit. Në të varej një medalion me fotografinë e një femre që buzëqeshte. Dukej mirë se ajo femër nuk ishte shqip-tare. Kokrra e rrufesë që e bënte të paprekshëm nga plumbi! — mendoi Omeri dhe i erdhi për të qeshur.

Bariu solli gjokun e Zabitit nga pylli. Ata e hipën të vrrarin në të, e lidhën si mundën që të mos binte dhe zbritën në fshat.

Kufomën e Zabitit e lanë disa orë në qendër të Gurajës, që ta shihnin pleq, gra e fëmijë. Atyre u bënte shumë përshtypje medalioni me fotografinë e femrës së huaj, që buzëqeshte mbi kraharorin e të vrrarit. Rreth kufomës vërtiteshin e gumëzhinin miza të gjelbëryera e grerëza që s'i trazonte askush.

Dielli lindi e perëndonte, stinët ndiqnin njëra-tjetrën në vallen e tyre të pambaruar, por tani secila sillte diçka të re për Gurajën dhe për njerëzit e saj. Kjo

nuk do të thotë se atje ishte duke ndodhur ndonjë mrekulli. E rëndësishme ishte se gurajasit besonin që e nesërmja do të ishte më e mirë se e sotmja dhe kjo gjë do të arrihej nga duart e tyre, me ndihmën e pushtetit të ri.

Pjesëtarët e bandës së Zabit Malotës ishin vrarë ose ishin kapur të gjallë. Në Gurajë ishin ngritur një shkollë e re, një tregtore për shitblerje, një infermieri dhe një punishte rakië. Kishin filluar punimet për hapjen e një kanali të ri e të madh, që ishte projektuar nga një inxhinier e dy teknikë të ardhur nga kryeqyteti. Shteti kishte sjellë lëndë plasëse, vegla pune, kishte bërë edhe investime për ndërtimin e tij. Tek ama e kanalit nuk ishte therur asnjë dash i zi, megjithatë puna po ecte mbarë. Ditë për ditë lugina e Ujëbardhës shungullonte nga plasjet e minave. Kur frynte veriu, kjo shungullimë dëgjohej edhe në Gurajë. Nga kodrat kundruall luginës shiheshin shtëllungat e bardha të tymnajës që gufonte nga shkëmbinjtë e çarë e ngjitej deri në qiell.

Një nga ata njerëz që ngazëlloheshin më shumë, kur u kapte veshi shungullimat e reja që vinin nga lugina e Ujëbardhës, ishte Prruk Moti. Atë e kishin lënë sytë, por e merrte për krahu ndonjë fëmijë dhe e përcillte deri te Bliri i Madh. Plaku ulej midis rrënjëve të moçme, nxirrte lahutën nga trasta dhe i binte me kularin e thantë...

Omeri vajti te Bliri i Madh dhe e gjeti Prrukun vetëm.

— Shëndet e këngë! — i tha duke përdorur një përshëndetje të moçme lahtarësh. Prruku e njohu në zë dhe iu zdrit fytyra.

— Kam dëgjuar se ke filluar një këngë për kanalin e ri, — tha Omeri.

— Këngën do ta bëj, — tha Prruku. — Ndoshta kur të mbarojë kanali, unë do të kem bar mbi kraharor, por lahutën nuk do ta marr me vete...

Omeri e dëgjonte tek fliste dhe shikonte me dhimbje

ata kokërdhokë të tharë që tani e kishin humbur ngjyrën dhe gjallërinë e mëparshme.

— Tash po, tash do të ngihet Guraja me ujë, — tha Prruku. — Po ndryshon njerëzia. Po shlyhet faji i hershëm...

— Cili faj, baca Prruk? — tha Omeri.

— Një faj fort i rëndë, o bir... — tha Prruku duke i përcjellë këto fjalë me një ofshamë të gjatë. Omerit iu duk sikur edhe bebëzat pa jetë të plakut lëshuan xixëllima të befta, u përlotën.

— Ti ke dëgjuar gjithfarë historish të vjetra për kuçedra e për floçka, — vazhdoi Prruku. — Asnjëra prej tyre nuk është e vërtetë. Këtë po ta thotë Prruk Moti që s'ka gënjyer kurrë në jetën e vet e që sot është në fill të morties. Të gjitha këto histori janë shpikur për të fshehur fajin që ka bërë një nga të parët e Gurajës e që është përsëritur ditë për ditë deri në kohën tonë.

— Po cili është ky faj?! — e pyeti Omeri me njëfarë padurimi që vinte nga mënyra e rrëfimit të plakut.

As kësaj radhe Prruku nuk i dha përgjigje pyetjes së Omerit. Ai ndiqte rrjedhën e mendimeve të veta dhe i dukej sikur pranë tij nuk ishte vetëm Omeri, por ishin qindra e mijëra njerëz të gjallë e të vdekur, që kishin shkelur tokën e thatë të Gurajës; që kishin mbjellë e kishin korrur; që kishin bërë të mira e të këqija; që kishin qeshur e kishin qarë...

Motit të jetës në Gurajë jetonte një burrë bashkë me të shoqen, i rrethuar prej të gjitha të mirave. Në pronën e tij kishte gjë e mall, ara të plleshme, hardhi e pemë, gurra me ujë të cemtë për t'u freskuar e rrëke që nuk shtereshin as në ditët e djegagurit. Në bjeshkën e tij kishte pyje të mëdha për të prerë lëndë, ahe për të mrizuar tubat, shpendë e gjithfarë shtazësh të egra për të gjuajtur. Gruaja e donte të shoqin aq sa nuk e kishte dashur kurrë një grua burrin e vet në fytyrë të kësaj

toke. Edhe burri e donte nusen e tij, por ishte i hidhëruar e i shqetësuar që s'po i bënte fëmijë.

Kur u mbushën dhjetë vjet, gruaja mbeti shtatzënë. I shoqi sa s'u çmend prej gëzimit, duke shpresuar se do të bëhej me trashëgimtar, të cilit do t'ia linte pasurinë e pronat e veta. Në vend të djalit që priste, lindi vajzë. Burri u inatos kaq shumë, sa që një ditë i ra shkelm djepit ku ishte lidhur vajza dhe e përmbysi. Kur erdhi gruaja nga kroi, e gjeti foshnjën të vdekur. Ajo e kuptoi se djepin e kishte përmbysur i shoqi, briti në kupë të qiellit e thirri orë e zanë të ndëshkonin atë njeri të pashpirt.

Burri e nxori gruan nga shtëpia, e çoi në mes të një ahishte dhe e la aty në mëshirë të bishave të malit. Gruaja qau e vajtoi aq shumë, sa zanat e malit e bënë qyqe, që të kukatë rremb më rremb sa të jetë jeta. I shoqi i saj mori një nuse tjetër, bëri me të disa fëmijë, por kaloi një pleqëri të zezë. Mbërriti sa të dëshirojë edhe ujë e dru. Qysh prej asaj kohe ahe e bredha u thanë, krojet humbën, përrenjtë u shterën dhe toka u bë rreshpe e thatë...

Pasi mbaroi së treguari, Prruku mori lahutën në dorë dhe këndoi vargjet e fundit të baladës së lashtë.

*Kuku, briti mori e zeza nanë,
Gur e dru, besa, me e pasë randë.
Zana e malit atëhere çka ka thanë,
Me ndie diell, besa, me ndie hanë:
«Bredha e ahe këtu sot u thafshin,
Edhe ma kurrë mos u përtërfshin!
Këtu kroje ma kurrë mos burofshin,
Zogjtë e malit këtu mos këndofshin,
Kumonë gjaje mos tingëllofshin!
Mos u gjettë — o hije me mrizue,
Mos u gjettë ma ujë me u freskue;
Kudo shkofsh, o fatzi, e kudo qofsh
Deri ujë e dru dëshirofsh!...*

Klithma e thekshme që dilte nga kraharori i drunjtë i lahutës u tërhoq prapë në thellësi të zgavrës së errët. Tani gishtat e holluar të Prrukut, me lëkurë të lëmuar e të varur, nëpërmjet së cilës spikatnin eshtrat e gjata, ngjanin si të gurëzuar. Omeri nuk kishte dëshirë të fliste, ta prishte atë heshtje që e mbështillte si një lëvozhgë qelqi. Kishte përshtypjen se, po të thoshte vetëm një fjalë, heshtja do të nxirrte një zhurmë xhamash që thyhen.

— Kur të thashë qëparë se Gruaja do të njomet, nuk e pata fjalën vetëm për kanalet, — tha Prruku. — E pata fjalën për diçka tjetër: në Gurajë gratë e çikat nuk poshtërohen më, siç janë nëpërkëmbur motit. Por do të vijë një ditë që ato të nderohen, o bir. Do të nderohet gjiri i gruas, puna e saj, fjala e saj. Atëherë, po, do të njomet toka e nëmur e Gurajës...

Thatësira po tërhoqej pak nga pak prej trupit të Gurajës, por vegimi i saj do të mbetej edhe për shumë kohë në vetëdijen e njerëzve. Ky vegim gjëllinte në nxehtësinë dhe zabullimën e djegagurit, në këngën e gjinkallave, në mitet dhe gojëdhënat e lashta. Të ulur nën hijen e pemëve plim me kokrra, të pjergullave të ngarkuara me rrush, apo të mrizeve ku preheshin tubat në vapë, të moshuarit u flisnin fëmijëve për kohën e thatësirës, të cilën e quanin «vjeta e keqe» ose «vjeta e zezë».

Ishte verë. Gjashtëdhjetë ditë e net pa rënë pikë shi në tokë. Tharë e bërë shkrumb krejt Guraja. Nuk mbaheshin mend livadhet djegur ashtu. Kallamboqi po ndizej flakë nëpër ara.

Atë vjet u rrudh tërë dushku i malit. U tha toka e u bë barut. Ruheshin kostarët të mos shkundnin llullat, se digjeshin livadhet.

Atë vjet piku rrëshira në rrasë të gurit, mori zjarr prej të nxehtit e u dogj tërë Pishnaja e Epër. Veç pishat e rralla nëpër shkrepë shpëtuan pa u djegur.

S'kishte pikë ujë në përrenj as në kroje, veç merrnim borë te Shpella e Borës e mbushnim lugjet për bagëtitë. Edhe njerëzit pinin ujë bore...

Bëja shumë rrush për gjithë vjet: rrush të zi e rrush të bardhë. Atë vjet nuk u bë asnjë kazan rrush, por iu thanë fletët e i ranë përtokë. Gështenjat u thanë boçash e nuk bënë asnjë kokërr.

Atë vjet në shumë ara të Gurajës s'u bë drithë me ia zgjidhë kujt tirqit. U detyruam të ndërrojmë farën.

Ka vuajtur gjindja si gjarpri nën gur. Kanë ndenjtur nga një javë e nga dy pa ngrënë çka hyn nën gur të mullirit. Tërë ditën shkundnim manat e i hanim në vend

të bukës. Fëmijët nuk linin kurrfarë peme që të pijej. Zienim fletë rrushi, hithra e barishte të egra. Si ajo vjetë e zezë mos ardh të më!...

Omeri u ngrit nga tryeza ku po shkruante dhe vajti te dritarja e hapur që binte nga ana e maleve. Larat e borës vezullonin si copërat e një pasqyre të thyer. Ai e kërkoi me sy dhe e gjeti atë larën si shumëkëndësh i çrregullt, të cilën me siguri e shikonin ditë për ditë ata që prisnin të dilnin në bjeshkë. Ndonëse dielli i fortë i qershorit e hante dhe e brente nga të gjitha anët, ajo nuk e kishte marrë ende formën e një kali.

Ai ndjeu një ngashërim të beftë dhe qenia e tij fërgëlloi si gjethet e plepit që shushurinte matanë dritares. Iu bë sikur ishte ende djalë i ri, duke vështruar atë larë bore e duke pritur Jerinën në bregun e Ujëbardhës së shkumëzuar, që lloçoçitej midis gurëve të bardhë e të lëmuar, shkëlqente e gurgullonte, rendte e merrte me vete bashkë me zajat e panumërta edhe hijet e drurëve të përkulur mbi të, edhe fytyrën e Omerit që pasqyrohej në rrjedhën e kthjellët...

Tani tëmthat e Omerit kishin filluar të zbardheshin dhe rrudhat te buzët e te sytë zgjatoheshin si degët e pemës së dhimbjes që kishte mbirë në zemrën e tij pas vrasjes së Jerinës. Ishte bërë më i përmbajtur e më i heshtur. Kishte çaste kur i dukej vetja si një lumë i turbullt, tërë gurë e dhera, që rrjedh me ngathësi midis brigjeve të veta të gërryera. Megjithëse këto çaste ishin të rralla, ai bënte çmos t'u dredhonte. E dinte se prej këtyre kundërshtarëve tinëzarë mund ta mbronte vetëm një gjë: puna. Dhe punët, telashet, mbledhjet, ngatërresat e mëdha e të vogla nuk ishin të pakta. Ku më shumë e ku më pak, atij i takonte një pjesë e të gjitha shqetë-

simeve të Gurajës. Në të njëjtën kohë gëzohej duke parë se thatësira e vjetër po largohej jo vetëm nga bucat e dheut, por edhe nga shpirtrat e njerëzve.

Megjithëse i mbetej pak kohë të merrej me ta, përpiquej që djali dhe vajza të mos e ndienin mungesën e nënës. Madje ndonjëherë luante e qeshte me ta, kujdesej për përparimin e tyre në mësim. Të rrethuar nga kujdesi i dyfishtë i Omerit dhe i prindërve të tij, fëmijët po rriteshin të shëndetshëm e të gëzuar.

Marrëdhëniet e Omerit me prindërit, veçanërisht me t'atin, ishin bërë më të ngrohta. Tani ai i gjykonte më me zemërgjerësi fjalët e veprimet e t'et. Edhe Demushi e kuptonte më mirë dhe i jepte të drejtë të birit për mjaft gjëra që dikur e kishte kundërshtuar.

Prindërit e Omerit ishin pikëlluar për vrasjen e Jerinës, mirëpo ata mendonin se kjo gjë kishte qenë e pashmangshme, sepse atë që shkel kanunin, e vret zoti. Duke lënë të fejuarin e duke u martuar në gjak, ajo kishte bërë një faj të rëndë, që e kishte paguar me jetën e saj. Jerina kishte sjellë kobin në këtë kullë dhe kobi kishte dalë jashtë bashkë me të. Nuk ishte zemra që i bënte të ashpër e të padrejtë, por mendësia dhe padituria e tyre.

Dikush trokiti në derë. Ishte një trokitje e lehtë, e druajtur, që mezi ta kapte veshi. Pasi dëgjoji zërin e Omerit, në zyrë hyri një vajzë flokëverdhe, e zbehur, me sy të trembur, të përlotur. Nuk i kishte mbushur ende të katërmbëdhjetë vjetët. Omeri e njihte atë vajzë: ishte Sosja, e bija e Kurteshit. I ati kishte dashur ta hiqte nga shkolla e ta mbyllte në shtëpi, por e kishin kritikuar në mbledhjen e fshatit dhe e kishin gjobitur.

Vajzës i dridhej buza dhe belbëzonte. Në fillim Omeri mezi ia mori vesh fjalët, por pak nga pak ajo u qetësua. Trembja dhe ankthi po ia lëshonin vendin mllëfit.

— E pashë për birë të derës, kur ia numëroi tim eti paret në dorë.

— A ishte «dhëndri», apo i ati?

— Nuk e di...

— Ty a të kanë thënë gjë për këtë punë?

— Jo.

— As nëna jote?

— As ajo.

— A e dinë që ke ardhur këtu?

— Jo, por do ta marrin vesh e... do të më kalbin në dru!

Sytë e saj u bënë prapë të trembur.

— As me majën e gishtit të vogël s'do të guxojnë të të prekin!

— Im atë është i pashpirt. Motrës së madhe që tash është e martuar, i ka përvëlur këmbën me ujë të valë që të mos shkonte në hekurudhë.

Omerit iu kujtua prapë Jerina. Ajo ia kishte treguar këtë ngjarje shumë e zemëruar. Madje kishte kërkuar që Kurteshi të dënohej. I kishin thirrur po në këtë zyrë Kurteshin e të bijën, por vajza kishte thënë se ishte këputur veriga e kuisë dhe i kishte rënë në këmbë ujët e valë. Për shkak të këmbës së djegur nuk kishte shkuar në hekurudhë dhe ishte bërë nuse brenda atij muaji...

Kurteshi hyri brenda bashkë me korrierin që kishte dërguar Omeri. Sa pa të bijën, u bë dhé në fytyrë.

— Bukur shpesh po vjen në këtë zyrë! — i tha Omeri.

— Mua s'më merr malli ta shoh me sy edhe treqind vjet! Por zori të fut të gjallë në dhé...

— Ti e merr me mend pse të kam thirrur.

— E di se ti mund të më thërrasësh kur të duash, se ke edhe gurin edhe arrën në dorë! — tha Kurteshi duke hungëruar si një ari i xhindosur.

— Kurtesh, mos harro ku je dhe fol mirë, — i tha Omeri që ndiente se mllëfi po i gufonte përbrenda. — Mos u përpig të dredhosh, sepse nuk pinë më ujë dredhitë e tua... Ti mendon ta martosh vajzën pa pëlqimin e saj, por dije mirë se kjo nuk do të ndodhë!

— Kam kujtuar se baba i saj jam unë!

— Vërtet ti je baba i saj, por duhet të jesh babë i mirë e i drejtë.

— Gjithëka që të ka thënë kjo shtrigë, janë rrena! E kanë shti kundër meje! E di unë kush e ka shti, por...

Duart e mëdha të Kurteshit u përdrodhën dhe gishtat e tij të trashë u ngërthyen në ajër, sikur po zinte për fyti një njeri të padukshëm e po i merrte frymën.

— Në qoftë se do ta prekësh vajzën me dorë, kur të shkosh në shtëpi, nuk do të flasim më bashkë, por do të të vëmë hekurat!

— Atëherë vërmi qysh tash! — tha Kurteshi duke i shtrirë duart përpara.

— Të thashë se do të t'i vëmë, po u bëre për to, Kurtesh. Dhe këto fjalë t'i thashë që të mos bëhesh për to. Paret që ke marrë për vajzën, duhet t'ia kthesh atij që t'i ka dhënë.

Omeri ishte munduar ta zbuste zërin e të fliste më shtruar. Shprehja «do të vëmë hekurat» që kishte përdorur më parë, ia vriste veshin, por me Kurteshin duhej të flisje me atë gjuhë. Duhej të ishte i ashpër me Kurteshin që të mbroje atë që është njerëzore.

Omeri doli me ta deri në oborr. Atë e bijë i thanë ditën e mirë dhe u larguan. Flokët e vajzës dukeshin sikur ishin ndezur flakë nga rrezet e diellit. Kushedi si do të ishte e ardhmja e kësaj vajze. Por një gjë dihej me siguri: ajo nuk do të detyrohej të arratisej në mes të natës, nuk do të rrinte e ngujuar në një kullë të gurtë si nuse e marrë në gjak...

Edhe pse nuk e kishte më gjallërinë e pranverës, fshati ende nuk ishte topitur nga vapa. Omeri thithte me ëndje erën prej mjalti që flladi e sillte nga pylli i gështenjave

të lulëzuara dhe kundërmimin e barit të prerë që vinte nga livadhet e kositura.

Dikush ujiste kopshtet e perimeve, dikush ujiste jonxhën, kurse në lagjen e poshtme kishte filluar edhe ujitja e misrit. Nëpër koriqe dëgjohej kënga e pandërprerë e gjinkallave, por ajo nuk dukej më e vrazhdë dhe e pikëlluar si dikur. Oshëtima e saj ishte pakësuar nga gurgullimat e vijave të ujit që tani rridhnin ditë e natë përmes Gurajës...

Një plak që po shkulte në arë barishte të egra, e pa Omerin tek po ngjitej rrugës dhe iu afrua gardhit që rrethonte arën.

— I thashë tim biri të më nxirrte pak eshkë, por nuk e ka zier mirë e nuk po merr zjarr, — tha plaku.

Omeri i dha një cigare dhe ia ndezi me shkrepëse.

— Nuk më shijon duhani, po s'qe i kopshtit tim, po s'e griva me duart e mia e po s'e ndjeva erën e mirë të eshkës, kur ta ndez me të, — tha plaku.

— Zheg i madh sot! — tha Omeri, duke vënë buzën në gaz.

— Zhegu i ka shtatë bereqete, kanë thënë të vjetrit, — tha plaku. — Tash zhegu është bereqet edhe për Gurajën, se ka ujë.

— Së shpejti do të ketë edhe më shumë, — tha Omeri.

Diku andej nga ana e poshtme e fshatit u dëgjuan britma njerëzish.

— Po zihen për ujët, — tha plaku. — Guraja s'do të ngihet kurrë me ujë, edhe në ia lëshofsh në krye tërë Ujëbardhën. Sa t'i bjerë dielli tokës, do të ketë grindje për ujët...

Pas pak shamata u shua.

Po, do të ketë grindje për ujët, mendonte Omeri, duke përsëritur fjalët e plakut. Do të ketë grindje jo vetëm për ujët, por edhe për tokën, për kullotat, për pyjet, derisa të vijë ajo ditë kur në Gurajë s'do të ketë më gurë kufiri.

Ai e dinte se gurët e kufirit do të shkuleshin, ashtu

siç do të ndërtohej kanali i ri, ku do të ngrihej edhe një hidrocentral i vogël, për t'u dhënë dritë elektrike Gurajës e disa fshatrave fqinjë, siç do të vinte në fshat rruga e makinës. Mirëpo kjo gjë s'do të bëhej pa dhimbje e përpjekje dhe prapë dikujt do t'i duhej të mbante një barrë më të madhe se të tjerët.

Mendimet e tij i ndërpreu shungullima e minave që për disa minuta mbuloi çdo zë e çdo zhurmë tjetër dhe zbriti deri në Gurajë. Në arat e saj gjelbëronte drithi i ri dhe frutat rriteshin nën diellin e fortë.

Papleka, N.

Gjaku i tokës. Roman.

[Red.: Xh. Abazi] T., «Naim
Frashëri», 1985.

300 f.

(B. m.) dhe

(B.v.) : 891.983-31

P 24

Tirazhi 9000 kopje

Format 78x109/32

Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1985